



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“AGJENCINË PËR EFICENCËN E ENERGJISË”

93

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË NË
“AGJENCINË PËR EFICENCËN E ENERGJISË”

TIRANË, TETOR 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
-----	------------	------

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4-9
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	10-12
2.	Identifikimi i çështjes	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve	
5.	Kriteret e vlerësimit	
6.	Standardet e auditimit	
7.	Metodat e auditimit	
8.	Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13
2	-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
2.1	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.	13-16
2.2	Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm	16-16
2.3	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij	16-26
2.4	Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.	26-29
2.5	Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit.	30-42
2.6	Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Zbatimi i legjisllacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve	42-163
2.7	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e projekteve të zhvilluara, për eficientësinë e energjisë, lidhjen e zbatimin e kontratave.	163-166
2.8	Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit	166-179
IV	REKOMANDIME	180-200

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZhR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NjA	Njësi Administrative.
ShA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) është person juridik publik buxhetor nën përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

AEE u krijua me VKM Nr.852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”, si dhe filloi funksionimin e saj në vitin 2019 me një staf prej 10 personash në strukturë organizative. Në mars të vitit 2021 struktura e AEE-së u zgjerua, duke e çuar në 20 numrin e punonjësve.

AEE-ja është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për eficiencën e energjisë në fushat e transportit, industrisë dhe ndërtesave. AEE-ja ka statusin e drejtorisë së përgjithshme dhe organizohet në nivel qendror.

AEE-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit të linjës. AEE-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Struktura dhe organika e punonjësve të AEE-së miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit. AEE-ja ushtron juridiksionin dhe veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet zyrës së saj qendrore në Tiranë.

AEE për vitin 2023 ka një buxhet total në vlerën 29.8 milion lekë, nga të cilat vlera 19.9 lekë është shpenzime pagash, vlera 3.1 milion lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, vlera 6.7 milion lekë shpenzime operative dhe vlera 19 mijë lekë për llogarinë 606.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

AEE është institucion i rëndësishëm, pasi është përgjegjëse për të përmirësuar dhe promovuar eficiencën e energjisë në të gjithë ciklin e energjisë dhe, në të gjithë sektorët dhe zonat ekonomike të vendit, duke u mundësuar konsumatorëve të ulin kostot e tyre të furnizimit me energji dhe të reduktojnë ndikimin negativ të sektorit të energjisë në ndotjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike. Për ta arritur këtë, AEE ndërmerr një sërë aktivitetesh, të tilla si: përgatitja e akteve nënligjore dhe zbatimi i tij; vendosja e kërkesave minimale për performancën energjetike në ndërtesa; trajnime profesionale për eficiencën e energjisë, lëshimi i certifikatave për audituesit e energjisë dhe menaxherët e energjisë; lidhja e marrëveshjeve vullnetare etj.

Një përgjegjësi tjetër kryesore është përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe monitorimi i zbatimit të tij masë pas mase, duke synuar arritjen e objektivave të përcaktuara dhe promovimin e masave përkatëse të eficiencës së energjisë për të gjithë sektorët publikë dhe privat (sektori i ndërtesave, sektori industrial, sektori i transportit, sektori bujqësor).

Nga vetë rëndësia që ka institucioni i AEE, rrjedh edhe rëndësia që ka për KLSH auditimi i këtij institucioni, me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së këtij institucioni, me kuadrin ligjor në fuqi, mbi të cilin duhet të zhvillojë veprimtarinë, përmbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit, evidentimin e parregullsive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre, etj.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi **Agjencinë për Eficiencën e Energjisë (AEE)**, për periudhën prej 01.01.2019 deri më 31.12.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve të veprimtarisë kryesore për të cilën është krijuar AEE.

Qëllimi i auditimit është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi baze risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren etj. Siguria e arsyeshme e auditimit ka ardhur kryesisht si rezultat i punës mbi dokumentacion, për arsye se institucioni është i ri dhe rrisku vlerësohet në nivelin mesatar.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Në raportin përfundimtar janë formuluar 21 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 3 gjetje dhe rekomandime për shpërbllim dëmi në vlerën 1,941,574 lekë, 1 gjetje për përdorim të fondeve publike pa efektivitet, me vlerë 82,499,604 lekë pa TVSH.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

a-Përshkrimi i gjetjeve kryesore:

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk ka ngritur një sistem rregullash të shkruara efikas të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjatë periudhës 2019-2023, nuk ka hartuar rregullore të brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit. ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve etj.

Gjetje nga auditimi: Në kontratën me objekt “*Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër*”, të lidhur midis AEE dhe OE “E..”SHPK, Nr.306/12prot. datë 14.05.2021 me vlerë 98,999,525 lekë me TVSH dhe afat përfundimi 6 muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit nga dokumentacioni i dosjes u konstatua se punimet nuk kanë përfunduar plotësisht dhe sistemi i instaluar nuk është vendosur në funksion. Gjatë zbatimit të projektit, janë hasur vështirësi në lirimimin e sheshit të ndërtimit dhe dhënien e lejes nga bashkia Tiranë si dhe përcaktimi i pikave të lidhjes në sistemin ekzistues nga OSHEE. Nga njoftimi i përfundimit të punimeve datë 28.12.2022 e deri në fund të periudhës audituese nuk gjenden gjurmë shkresore që Autoriteti Kontraktor të ketë kërkuar nga Bashkia Tiranë dhe OSHEE zgjidhjen e problemeve të hasura për vendosjen në funksion të investimit të kryer.

Ky projekt i iniciuar si një zgjidhje inteligjente do të shërbente në uljen e konsumit të energjisë elektrike dhe në rritjen e aksesimit të makinave elektrike, për tu karikuar në stacione të fuqishme (Fast charger), nuk ja ka arritur qëllimit dhe vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar) deri në këtë fazë të auditimit konsiderohet shpenzim pa efektivitet.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i efencës së energjisë të AEE, është implementuar sipas kontratës nr. 5663/2 datë 18.12.2017 lidhur midis BOE “A...” SHPK dhe “K...”. SHPK dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me afat 4 vjeçar. Sistemi është dorëzuar nga kompania “K...” SHPK pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Për periudhën objekt auditimi, sistemi nuk ka pasur mirëmbajtje apo upgrade të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme si në hedhjen e të dhënave ashtu edhe në përpunimin e tyre. Grupi i auditimit konstatoi pamundësinë e gjenerimit të raporteve të ndryshme nga ky sistem, raporte të cilat ishin të nevojshme për të kryer sondazhe në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor AEE ka nisur procedurën e prokurimit me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, pa kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM-it), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar nga AEE. Gjithashtu AEE ka kryer këtë investim në kushtet e mos bashkëpunimit me AKUM-in dhe si rezultat në mungesë të një informacioni të nevojshëm për njohjen e gjendjes së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në vend, mbi bazën e të cilit duhet të ishin përcaktuar dhe entitetet e UK që kanë nevojë më emergjente për përmirësimin e efiçencës së energjisë në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Nuk ka dokumentacion që të shpjegojë se mbi bazën e kujt kritereve AAE përzgjedhi UK Durrës për kryerjen e këtij investimi.

Gjetje nga auditimi: Në kontratën me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e efiçencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” në UK Durrës, të lidhur midis AEE dhe BOE “V...” SHPK & “E...” SHPK & “H...” SHPK me Nr.308/11 prot. datë 11.03.2021 me vlerë 62,400,000 lekë me TVSH dhe afat përfundimi 5 muaj, është parashikuar hartimi i raportit të auditimit paraprak të energjisë që konsumojnë stacionet si dhe projekti që duhet të realizohet për rritjen e efiçencës së tyre, por në përfundim të investimit nuk është hartuar raporti i auditimit përfundimtar i efiçencës së energjisë mbi bazën e të dhënave faktike të konsumit të energjisë pas kryerjes së investimit, për të verifikuar se investimi i kryer ja ka arritur qëllimit dhe në çfarë mase.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit informatik EECERT, në të cilin gjenerohen certifikata paraprake dhe përfundimtare të performancës, konstatohet se sistemi çdo aplikim të çelur e njeh si një objekt ku i korrespondon një projekti me pjesët përbërëse të tij dhe AEE për llogaritjen e tarifave e ka marrë si një ndërtesë të vetme, pavarësisht se ka lëshuar CPE për çdo njësi të projektit (që është pjesë përbërëse e ndërtesës).

Nga ana e grupit të auditimit janë përzgjedhur në mënyrë rastësore disa aplikime ku ndërtesat janë të veçuara (vila) dhe është llogaritur tarifa si ndërtesa më vete referuar përkufizimit të ligjit dhe karakteristikave të tyre, ku rezultuan diferenca me vlerën e tarifës të llogaritur si një objekt i vetëm nga ana e AEE. Diferenca në vlerën e llogaritjes së tarifës për rastet e përzgjedhura është 571,334 lekë, por në rast se do të përlllogariteshin të gjitha rastet që janë në sistem për këtë tipologji ndërtesash të veçuara vlera do të ishte më e madhe e kështu kemi të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Këto diferenca kanë ardhur si rezultat i paqartësisë midis Ligjit 124/2015 “Për efiçencën e energjisë” neni 4, “Përkufizime”, pika 20. “Ndërtesë” dhe Urdhrit Nr. 5 datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores për formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik” neni 16, “Pagesa e audituesit energjetik”.

Gjetje nga auditimi: **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, në 13 raste u konstatuan parregullsi në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi disa prej tyre nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërish në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kryesisht këto kritere lidhen me kapacitetin teknik, si me ekzistencën e punonjësve në listë pagesat e operatorëve ekonomik për një periudhë të gjatë kohe, përvoja të suksesshme të ngjashme të mëparshme, liçencat e shoqërisë, numrin e punonjësve, numri i makinerive etj. Në disa raste nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit kritere të cilat kanë qenë të nevojshme për objektin e prokurimit. Në 2 raste nga autoriteti kontraktor janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë nuk është e plotësuar me të gjithë numrin e punonjësve të miratuar. Kjo agjenci ka të miratuar në

strukturë 20 punonjës, por tre prej pozicioneve të punës janë të pa plotësuara. Gjithashtu nuk u konstatuan procedura të kryera nga institucioni me qëllim plotësimin e këtyre vendeve bosh.

Gjetje nga auditimi: Në analizimin e zërit Pasive Afatshkurtra dhe nënkategorisë “*Furnitor e llogari te lidhura me to*”, vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri. Në vitin 2021 kjo vlerë është 50,147,442 lekë pa TVSH, ndërsa në vitin 2023, në vlerën 93,379,039 lekë pa TVSH, ku në të cilën janë të përfshira detyrimet e mbartura ndaj furnitorëve ku për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre.

b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që të hartohet rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve.

Rekomandimi: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të marri masa për përfundimin e projektit dhe vendosjen në efikasitet të tij, duke shmangur koston e amortizimit të tyre dhe për projekte që ka disa aktorë për zhvillimin e tyre të ketë një veprim ndërinstitucional të menjëhershëm për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi.

Rekomandim: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të bashkërendojë punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në lidhje me përmirësimin e sistemit të auditimit të ndërtesave/industrive, të krijojë një bazë të dhënash lidhur me konsumin final të energjisë si dhe të kryejë përmirësimet ligjore në lidhje me masat që duhet të ndërmerren mbi mosplotësimin e kushteve nga konsumatorët e mëdhenj.

Rekomandim: AEE të mos kryej investime lidhur me projektet për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, pa kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM-it), e cila duhet të argumentojë nevojën për investimin e kërkuar.

Rekomandim: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të kërkojë nga strukturat përkatëse ndryshimin e bazës ligjore ku i referohet pagesës së audituesit energjetik, konkretisht Urdhër Nr. 5 datë 12.01.2021 neni 16, duke e llogaritur këtë tarifë për çdo ndërtesë me vete pavarësisht se janë në të njëjtin aplikim, e kështu duke shmangur mungesën e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Rekomandim: Agjencia për Efiçencën e Energjisë në rastet e kryerjes së projekteve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, por jo vetëm, menjëherë pas përfundimit të investimit, të kryej monitorimin e efikasitetit të energjisë së arritur në fakt dhe të bëjë krahasimin e saj me efikasitetin e përlogaritur përpara investimit, me qëllim arritjen e konkluzioneve të sakta se sa efektiv ka qenë realisht investimi në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

Rekomandim: Titullari i autoritetit kontraktor si dhe njësia e prokurimit, të marrin masa që në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, hartimi i kërkesave të veçanta të kualifikimit të jetë i argumentuar teknikisht dhe ligjorisht, të përfshijnë të gjitha kriteret specifike të nevojshme për zbatimin e kontratës, si dhe të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Të ndërprëriten e praktikatat e kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i AEE dhe Sektor i Shërbimeve Mbështetëse që mbulon dhe burimet njerëzore, të marrin të gjitha masat e duhura për plotësimin e vendeve bosh në strukturën e miratuar, me qëllim që struktura të funksionojë në përputhje me numrin e miratuar dhe garantimin që çdo detyrë funksionale të kryhet nga punonjësi përkatës sipas strukturës.

Rekomandim: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të marrë masat që të kryejë prioritarizimin e shërbimeve/pagesave në mënyrë që të likujdohë në kohë detyrimet, ose të krijojë një rend mbi shlyerën e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit.

Opinion i modifikuar (kualifikuar) mbi auditimin e përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Agjencia për Efiçencën e Energjisë (AEE), me kuadrin ligjor në fuqi, për periudhën 2019-2023 dhe në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se gjatë veprimtarisë së AEE janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një opinionin të modifikuar (kualifikuar), e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e modifikuar (kualifikuar):

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionin. Opinionin mbështetet mbi parregullsitë e konstatuara si vijon:

- Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk ka ngritur një sistem rregullash të shkruara efikas të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjatë periudhës 2019-2023, nuk është hartuar rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve etj. Nga strukturat përgjegjëse të AEE nuk janë planifikuar programe trajnimi për punonjësit, duke mos identifikuar nevojat për trajnim dhe duke mos marrë masat e duhura për zhvillimin profesional të stafit.

- Struktura e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë nuk është e plotësuar me të gjithë numrin e punonjësve të miratuar. Kjo agjenci ka të miratuar në strukturë 20 punonjës, por tre prej pozicioneve të punës janë të pa plotësuara, duke mos garantuar që çdo detyrë funksionale të kryhet nga punonjësi përkatës sipas strukturës. Gjithashtu nuk u konstatuan procedura të kryera nga institucioni me qëllim plotësimin e këtyre vendeve bosh.

- AEE ka nisur procedurën e prokurimi me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, në UK Durrës, me kërkesën e kësaj të fundit, por pa kërkesën dhe bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM-it), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar nga AEE dhe ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjetllës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor, përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin, rehabilitimin, zgjerimin e sistemeve të ujësjetllës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Përveç kërkesës së UK Durrës për investimin, nuk ka dokumentacion tjetër që të shpjegojë se mbi bazën e kujt kritereve AAE përzgjedhi UK Durrës për kryerjen e këtij investimi.

- Në përfundim të investimit me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e efiçencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, AEE nuk ka kryer monitorimin e efiçencës së energjisë reale të arritur. Raporti përfundimtar për efiçencën e energjisë së projektit, ka të dhëna hipotetike

të parashikuara në raportin paraprak. Ky raport nuk është hartuar mbi bazën e konsumit real të energjisë elektrike, menjëherë pas realizimit të investimit, duke mos përcaktuar realisht nëse investimi i kryer ja ka arritur qëllimit lidhur me rritjen e efikasitetit të energjisë.

- Në kontratën me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-Rruga e Energjisë Pastër”, të lidhur midis AEE dhe operatorit ekonomik “E...” SHPK, Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021 me vlerë 98,999,525 lekë me TVSH dhe afat përfundimi 6 muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit, nga dokumentacioni i dosjes u konstatua se punimet nuk kanë përfunduar plotësisht dhe sistemi i instaluar nuk është vendosur ende në funksion, duke bërë që investimi deri në momentin e kryerjes së auditimit të jetë një investim pa efektivitet, pasi nuk e ka arritur qëllimin e tij.

Projekti i zbatimit të këtij investimi nuk është pajisur me leje ndërtimi/infrastrukturore dhe për të nuk është kryer oponenta teknike.

- Sistemi i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i efikasitetit të energjisë të AEE, nuk ka pasur mirëmbajtje apo upgrade të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme, si në hedhjen e të dhënave, ashtu edhe në përpunimin e tyre. Grupi i auditimit konstatoi pamundësinë e gjenerimit të raporteve të ndryshme nga ky sistem, raporte të cilat ishin të nevojshme për të kryer sondazhe në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

- Agjencia për Efikasitetin e Energjisë ka për detyrë të krijojë dhe përditësojë një bazë të dhënash kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtjet në kursimin saj, e cila shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efikasitetit të energjisë, por kjo detyrë nuk është kryer prej këtij institucioni.

- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, në 13 raste u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterit të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi disa prej tyre nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në disa raste nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit kriteret të cilat kanë qenë të nevojshme për objektin e prokurimit.

- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, në 2 raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit. Në këtë mënyrë nga autoriteti kontraktor është lidhur kontratë me operatorë ekonomik të shpallur fitues, si rezultat i një procesi jo të rregullt të vlerësimit të ofertave, si dhe në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura nga vetë autoriteti kontraktor. Vlera e të dy kontratave së bashku është 64,765,000 lekë pa TVSH.

- Në datën 31.12.2023 u konstatua një vlerë detyrimi e AEE ndaj të tretëve në vlerën 93,379,039 lekë pa TVSH, që do të thotë se AEE nuk ka marrë masat e duhura për likuidimin e kreditorëve.

- Sistemin i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i efikasitetit të energjisë të AEE, i implementuar sipas kontratës Nr. 5663/2 datë 18.12.2017, nuk ka pasur mirëmbajtje apo përmirësim të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme, si në hedhjen e të dhënave ashtu edhe në përpunimin e tyre.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 1043/1 Prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.01.2024 deri më datë 03.06.2024, në subjektin Agjencia për

Eficencën e Energjisë, u krye auditimi i Përputhshmërisë, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2019 deri më 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

B. M.(Përgjegjës Grupi)

S. H. auditues

E. K. auditues

A.F. audituese,

I. U. auditues,

J. M. auditues

Audituesi A. L. i cili ka kryer detyrën e përgjegjës të grupit të auditimit deri në datën 19.04.2024 dhe pas kësaj date nuk ka qenë pjesë e grupit të auditimit, pasi me shkresën Nr. 1043/6, datë 19.04.2024 të Kryetarit të KLSH, është zëvendësuar nga audituesi B.M.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi i auditimit: Të vlerësohen dhe evidentohen shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së pasurisë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve; dhënia e rekomandimeve për përmirësime të punës.

Identifikimi i çështjes: Sipas veprimtarisë së subjektit, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara me programin e auditimit, si më poshtë:

- Mbi vlerësimin e funksionimit të MFK dhe auditit të brendshëm.
- Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiar.
- Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.
- Veprimtarisë financiare e institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni. Inventarizimi i pasurisë së institucionit.
- Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e projekteve të zhvilluara, për eficencën e energjisë, lidhjen e zbatimin e kontratave.
- Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i AEE është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mastrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, prokurimeve publike, certifikimin e audituesve dhe enaxherve të energjetikë, realizimin e objektivave dhe politikave për të cilat AEE është krijuar, me qëllim për të përmirësuar dhe promovuar eficencën e energjisë në të gjithë ciklin e energjisë dhe në të gjithë sektorët dhe zonat ekonomike të vendit, duke u mundësuar

konsumatorëve të ulin kostot e tyre të furnizimit me energji dhe të reduktojnë ndikimin negativ të sektorit të energjisë në ndotjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, etj.

Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe IFAC; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH, etj.

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”; Ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; Ligji nr. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar.
- VKM nr. 852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë për eficientësinë e energjisë”; VKM Nr.256, datë 27.3.2020 "Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, të njësive dhe të elementeve të ndërtesave"; VKM nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM nr.244, datë 30.03.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar "Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimit të saj.; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM nr. 934, datë 25.11.2020 "Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa"
- Strategjia Kombëtare e Energjisë, 2018-2030;
- Direktiva 2009/72/EC për energjinë, 2009.
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar;
- Urdhër Nr.5 datë 12.01.2021 Për miratimin e rregullores “Për formatin e auditimit energjetik dhe pagesa për audituesin energjetik”.

Standardet e auditimit të aplikuara: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe IFAC; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH, etj.

Metodat e auditimit: Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Auditim është kryer me zgjedhje, bazuar në rrishtun e vlerësuar.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rrishtun në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistomi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

AEE u krijua me VKM Nr.852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Eficencën e Energjisë”, si dhe filloi funksionimin e saj në vitin 2019 me një staf prej 10 personash në strukturë organizative. Në mars të vitit 2021 struktura e AEE-së u zgjerua, duke e çuar në 20 numrin e punonjësve.

Agjencia për Eficencën e Energjisë ka certifikuar përgjatë 3 viteve 100 auditues të energjisë në ndërtesa, 150 menaxherë të energjisë dhe 11 auditues të energjisë në instalime industriale.

AEE-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit të linjës. AEE-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Struktura dhe organika e punonjësve të AEE-së miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit. AEE-ja ushtron juridiksionin dhe veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet zyrës së saj qendrore në Tiranë.

2-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit.

2.1.Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të Pikës 1 të Programit të Auditimit Nr.1043/1 prot, date 29.12.2023 “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Për vlerësimin e 5 komponentëve të MFK, respektivisht, Mjedisin e Kontrollit, Menaxhimin e Riskut, Aktivitetin e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi dhe Monitorimi, është përdorur baza ligjore si më poshtë:

-Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

-Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

-Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”;

-VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018;

-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;

-Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

-Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016.

Qëllimi i auditimit të MFK është që të vlerësojë nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të realizohen.

Bazuar në formularin e vetëvlerësimit institucional të bërë nga A.E.E, si dhe problematikat e konstatuara në lidhje me kërkesat e zbatimit të ligjit të MFK për 5 komponentët, nga auditimi konstatohet se:

“Mjedisi i kontrollit”

Mjedisi i kontrollit, i cili përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën dhe përbëhet nga dy aspekte, nga strukturat

formale dhe aspektet e sjelljes individuale.

Nga auditimi konstatohet se:

- Agjencia për Eficiencën e Energjisë, përgjatë 2019-2023, nuk ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës të saj;
- Për periudhën objekt auditimi, nga strukturat përgjegjëse nuk janë planifikuar programe trajnimi për punonjësit e AEE, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA);
- Nuk është ngritur një strukturë e përshtatshme organizative dhe vendosja e linjave të raportimit, të cilat mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të stafit të AEE;
- Nëpunësit zotërojnë informacion, por, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar në të gjitha elementët e tij, për këtë arsye nuk analizohen dhe nuk raportohen dobësitë e kontrollit të brendshëm;
- MIE, ministria e linjës, nuk ka zhvilluar programe apo misione të auditimit të brendshëm pranë AEE-së, përveç auditimit të zhvilluar në vitin 2021 për të cilin nuk është nxjerrë raport auditimi;
- Nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS) të AEE, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të ligjit të MFK. AEE ka përfaqësim në GMS e MIE por nuk dokumentohet realizimi i takimeve lidhur me pjesëmarrjen.
- AEE nuk ka bord apo këshill drejtues që ndikon në projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publik.
- Në AEE mungon një deklaratë dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme që bëhet në bazë të vetëvlerësimeve. Pra mungon një sistem i brendshëm raportimi për të marrë informacion për të mbështetur deklaratën.
- Nuk ka një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- Menaxherët e strukturave/njësive të vartësisë nuk janë përfshirë në diskutimet për planin strategjik dhe as palët e treta (janë në fazë konsultimit me MIE);
- Në AEE nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.
- Pavarësisht se institucioni ka një zyrë protokolli, nuk funksionon sistemi i ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit.

Për sa më lart, për mosplotësimin e kërkesave ligjore, respektivisht për periudhën objekt auditimi, titullarët e institucionit z. E.B., z. E. D. si dhe z. A.H., ngarkohen me përgjegjësi pasi kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e MFK dhe kryesisht të nenit 20, ku parashikohet se: *Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.*

“Menaxhimi i Riskut”:

Në drejtim të vlerësimit të menaxhimit të riskut, nga auditimi konstatohet që:

- AEE nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zhvillimit strategjik afat mesëm (afat 3-5 vjeçar);
- AEE nuk ka hartuar plan-veprime vjetore për arritjen e objektivave të institucionit;
- AEE nuk ka hartuar një regjistër të risqeve, përveç vitit 2023, ku të përfshihen të gjitha strukturat e AEE, për monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë, me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;
- Mungon raportimi mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsisive që pengon realizimin e objektivave, si dhe masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë. Pra, mungon dhënia e sigurisë që objektivat e vendosura nga institucioni do të arrihen;
- Programi financiar “Financa 5” (prokuruar në nëntor të vitit 2022), nuk ka qenë funksional

për të pasqyruar saktë pasqyrat financiare, etj, përveç hyrjet e daljet e magazinës.

Për sa më lart, për mosplotësimin e kërkesave ligjore, respektivisht për periudhën e auditimit 2019-2023, znj. A.Ç., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe titullarët e institucionit z. E.B., z. E.D. si dhe z. A.H., në cilësinë e nëpunësve autorizues, të cilët ngarkohen me përgjegjësi pasi kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e MFK dhe kryesisht të nenit 10 “Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut” si dhe të nenit 21 “Menaxhimi i riskut”.

Si përfundim, AEE nuk ka hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të risku, në përputhje me kërkesat e MFK, gjithashtu strukturat përgjegjëse institucionit nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve, si dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë.

“Aktivitetet e Kontrollit”:

Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për “Aktivitet e Kontrollit”, u konstatua se:

- AEE nuk ka hartuar rregullore mbi sigurinë e të dhënave në sistemet IT;
- Nuk ka gjurmë të auditimit për proceset e punës të AEE;
- Në A.E.E nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;
- Në mungesë të rregullores së brendshme të institucionit, për periudhën objekt auditimi, si rezultat mungojnë hartat dhe manualët e proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi të stafit të AEE;
- Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit;

Për sa më lart, mangësitë e evidentuara, janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Informimi dhe Komunikimi: Komunikimi është shkëmbimi i informacionit të dobishëm në të gjitha nivelet e njësisë publike, si në mënyrë vertikale dhe horizontale, për të mbështetur vendimet dhe koordinimin e aktiviteteve të njësisë.

Informacioni duhet t’iu komunikohet menaxherëve dhe punonjësve të tjerë që kanë nevojë për to, në një formë dhe brenda një afati kohor dhe që i ndihmon ata të kryejnë përgjegjësitë e tyre.

Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për “Informacioni dhe Komunikimi”, u konstatua që:

- Nuk identifikohet mbledhja dhe përhapja e një informacioni në një format të përshtatshëm.
- Nuk ka një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë të njësisë. Nuk shpërndahen udhëzime dhe urdhra të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Nuk dokumentohen proceset dhe veprimtaritë kryesore, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit.
- Nuk ka një sistem deklarimi efikas dhe të përpiktë, që të përfshijë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e

zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.

Titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit kanë vepruar në mospërputhje me nenin 23 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Monitorimi dhe Raportimi: Sistemi i MFK-së kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme, se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efëciente me kalimin e kohës.

Nga auditimi konstatohet që:

-AEE nuk ka njësi të auditimit të brendshëm dhe këtë funksion e kryen drejtoria përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

-Nuk përditësohen dhe rishikohen operacionet dhe aktivitetet kryesore të njësisë publike. Nuk ka informacione, raporte, memo etj., nga menaxhimi për ecurinë e realizimit të buxhetit, apo rishikimin e risqeve gjatë hartimit të regjistrit të riskut etj.

-Nuk janë identifikuar masa, që synojnë zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të monitorimit.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku thuhet: *Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.*

Konkluzion:

Për sa më lart, MFK në institucionin Agjencia e Efiçencës së Energjisë për 5 (pesë) komponentët integral, konstatohet se:

1. Mjedisi i Kontrollit për periudhën objekt auditimi, është jo efektiv.
2. Nuk funksionon një sistem efektiv për menaxhimin e riskut.
3. Institucioni ka mangësi në aktivitetet e kontrollit duke mos qene efektiv në veprimtarinë e përditshme.
4. Nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.
5. Mungon sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, prandaj sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën objekt auditimi në institucionin Agjencia e Efiçencës së Energjisë konstatohet se është jo efektiv.

Me veprimet apo mosveprimet brenda periudhës së ushtrimit të detyrës së titullarit të institucionit të AEE duke mos siguruar dhe ngritur një sistem efektiv të kontrollit dhe menaxhimit financiar ngarkohen me përgjegjësi z. E.B., z. E.D., si dhe z. A.H., me cilësinë e titullarëve të AEE njëkohësisht të nëpunësit të autorizuar dhe znj. A.Ç., në cilësinë e nëpunëse zbatuese, pasi kanë vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 8,10, 20, 21, 23 dhe nenit 24 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2.2. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm

Në lidhje me pikën 2 të programit të auditimit Nr.1043/1 prot, datë 29.12.2023 “Auditim mbi

Përputhshmërie në Agjencinë për Efiçencën e Energjisë” mbi vlerësimin e e veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, kjo pikë nuk u auditua pasi institucioni nuk ka një njësi të auditit të brendshëm, gjithashtu konstatohet se nga Ministria e linjës MIE nuk është programuar dhe zhvilluar asnjë mision të auditimit të brendshëm për periudhën objekt auditimi.

2.3. Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij.

Në zbatim të pikës të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë.

Të dhëna mbi buxhetin e vitit 2019-2023

- Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
- Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit, mënyra e përdorimit të të ardhurave.
- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve. *(Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve nga Ministria e linjës etj.).*

Baza Ligjore

- Ligji për efiçencën e energjisë 124/2015, i ndryshuar.
- Ligji Nr.116/2016 për performancën e Energjisë në ndërtesa
- Ligji Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”
- VKM Nr.195, datë 05.04.2003 “ Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”
- Udhëzimi Nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar
- Udhëzimi Nr.5, datë 28.02.2023 të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”
- Udhëzimi plotësues Nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”

Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor:

Të dhëna mbi buxhetin e vitit 2019

Me shkresën Nr.761/4 Prot. date 22.02.2019 MIE ka përcjellë detajimin e buxhetit të vitit 2019 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj, për AEE.

Tab.Nr.1

në lekë

Llogaria ekonomike	Emërtimi i produktit	Viti 2019	Pakësuar	Shtuar	Buxheti me ndryshimet
230	Auditimi energjetik i stokut të ndërtesave publike	47,000,000	47,000,000		-
231	Rikonstrukcion Godine AEE	8,000,000			8,000,000

231	Kosto lokale për projektin “Efikasiteti Rajonal i Energjisë”	3,000,000			3,000,000
231	Projekti REHUB” Efikasiteti Rajonal i Energjisë”	10,000,000	10,000,000		-
Totali					11,000,000

Burimi: AEE

Tab. Nr.2. Programi buxhetor për shpenzimet korente për vitin 2019

Viti/Llog	Llog.Ekonomike	6000000	6010000	6020000	6060000	Totali
2019	Buxheti i ndryshuar	15,854,400	3,877,685	2,000,000	30,000	21,762,085

Burimi: AEE

Të dhëna mbi buxhetin e vitit 2020

Me shkresën Nr. 2169/30 Prot. datë 03.03.2020, Nr. 1718/2 Prot. date 10.03.2020, Nr. Prot. 4948/4 datë 20.08.2020 (Nr. i Prot të MIE), Nr. 7930/2 Prot. datë 10.12.2020, MIE ka përcjell detajimin e buxhetit të vitit 2020, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj. Në tabelën e mëposhtme paraqitet detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj me paksimet dhe shtimet për AEE për programin buxhetor “Mbështetje për Energjinë”.

Tab. Nr.3

në lekë

Llogaria ekonomike	Emërtimi i produktit	Buxheti fillestar Viti 2020	pakësua	Shtuar	Buxheti i ndryshuar
231	Kosto lokale për projektin “Efikasiteti Rajonal i Energjisë”	2,200,000	2,200,000		-
231	TVSH projekti REHUB + ”Efikasiteti rajonal i energjisë”	1,500,000	1,500,000		-
231	TVSH projekti REHUB	2,000,000	2,000,000		-
231	TVSH “Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”	6,150,000	5,979,000		171,000
231	Kosto lokale “Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”	1,200,000	1,200,000		-
230	Projekt ide, studim fisibiliteti dhe projekt zbatimi i sistemit të ngrohjes se Korçës duke përjashtuar lenden drusore (projekt i ri)	1,500,000	18,000,000	16,500,000	-
230	Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik te makinave “2 km Smart City-rruga e energjisë se pastër”	1,650,000		10,350,000	12,000,000
230	Standardet e ndriçimit Urban dhe Rrugor ne Republikën e Shqipërisë	1,500,000	1,500,000		-
230	Studim i plotë i fisibilitetit për vendosjen e kullave të karikimit për makinat elektrike ne Republikën e Shqipërisë	1,500,000		43,559,000	45,059,000
Totali		19,200,000	32,379,000	70,409,000	57,230,000

Burimi: AEE

Tab. Nr.4 Programi buxhetor për shpenzimet korrente për vitin 2020

në lekë

Viti/Llog	Llog.Ekonomike	6000000	6010000	6020000	6060000	Totali
2020	Buxheti i ndryshuar	10,400,000	2,500,000	2,500,000	-	15,400,000

Burimi: AEE

PBA 2021-2023

Me shkresën Nr.590/1 datë 18.01.2021, Nr.1875 Prot. datë 21.09.2021, MIE ka përcjellë miratimin e planit të buxhetit shpenzimet korrente për vitin 2021-2023. Në zbatim të Ligjit Nr.137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, MFE me shkresën 23724/67 Prot., date 14.01.2021 ka miratuar detajimin e planit të buxhetit të shpenzimeve korrente për vitet 2021-2023, sipas klasifikimit buxhetor në nivel artikulli dhe produkti, për njësinë shpenzuese AEE. Shpenzimet korrente me ndryshimet, paraqitet në tabelës Nr.5.

Tab.Nr.5

në lekë

Institucioni	Kap	Programi	Llog.Ek.	Buxheti 2021
AEE	01	04320	600	9,900,000
	01	04320	601	2,500,000
	01	04320	602	4,014,000
	01	04320	606	36,000
Totali				16,450,000

Burimi: AEE

Të dhëna mbi buxhetin e vitit 2021

Me shkresën Nr.383/21 Prot. datë 26.02.2021, Nr. 2546 Prot. datë 07.12.2021, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, ka përcjellë detajimin e buxhetit për vitin 2021-2023, për shpenzimet kapitale, me financim të brendshëm dhe të huaj për programin “Mbështetje për energjinë”.

Tab.Nr.6

në lekë

Llog.	Emërtimi i produktit	Buxheti fillestar 2021	Viti	Pakësuar	Shtuar	Buxheti i ndryshuar
231	TVSH “Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”	2,000,000				2,000,000
231	Kosto lokale “Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”	300,000				300,000
230	Projekt ide, studim fisibiliteti dhe projekt zbatim i sistemit të ngrohjes së Korçës duke përfshirë lenden drusore (projekt i ri)	7,600,000			4,000,000	11,600,000
230	Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e energjisë së pastër”	11,650,000			3,388,000	15,038,000
230	Standardet e ndriçimit Urban dhe Rrugor në Republikën e Shqipërisë	3,000,000			5,000,000	8,000,000
230	Studim i plotë i fisibilitetit për vendosjen e kullave të karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë	13,000,000			3,400,000	16,400,000
230	Blerje e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes së CPE projekt për standardet e ndriçimit rrugor dhe urban në Shqipëri	2,141,000			1,800,000	3,941,000
230	Projekt ide mbi elektrifikimin e linjave të transportit urban dhe ndërrqytetës në Bashkinë Tirane, Vore, Durrës (me faza)	17,800,000			8,628,134	26,428,134
230	Projekt për përlogaritjen e kostos Optimale për kushtet minimale në ndërtesa	3,000,000			1,300,000	4,300,000
230	Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujerave të zeza	13,000,000			5,237,000	18,237,000
230	Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së energjisë në impiantet e furnizimit me ujë	11,000,000			5,000,000	16,000,000
230	Projekt pilot për ndërtimin një godine me “0” energji	24,000,000		20,000,000		4,000,000
230	Projekt faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimi dhe trajnimi për eficienten e energjisë	6,000,000			3,200,000	9,200,000
230	Supervizion i projekteve të zbatimit të projekteve me lart	2,000,000				2,000,000
230	Hartimi i projektit të detajuar të sistemit të ngrohjes së Korçës duke përfshirë lëndën drusore	8,000,000			3,200,000	11,200,000

230	Vendosja e sistemit te ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik te makinave “ 2 km Smart City-Rruga e Energjisë Paster”	20,000,000		7,500,000	27,500,000
230	Hartimi i projektit te detajuar per vendosjen e kullave te karikimit per makinat elektrike ne Republikën e Shqipërisë	14,900,000		7,500,000	22,400,000
231	Projekti REHUB “ Efikasiteti Rajonal i Energjisë” (kodi 18BI015)	2,500,000	2,500,000		-
231	Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero	20,224,000	20,224,000		-
231	Projekti REHUAB+”Efikasiteti Rajonal i Energjisë” (kodi 19AC201)	6,000,000	6,000,000		-
Totali		188,115,000	20,000,000	59,153,134	198,544,134

Burimi: AEE

PBA 2022-2024

Me shkresën Nr.147/2 datë 24.01.2022 MIE ka përcjellë miratimin e planit të buxhetit shpenzimet korrente për vitin 2022-2024. Në zbatim te Ligjit Nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, MFE me shkresën 22922/112 Prot., datë 18.01.2022 ka miratuar detajimin e planit të buxhetit të shpenzimeve korrente për vitet 2022-2024, sipas klasifikimit buxhetor në nivel artikulli dhe produkti, për njësinë shpenzuese AEE., sipas tabelës Nr.1.

Tab.Nr. 7

në lekë

Institucioni	Kap	Programi	Llog.Ek.	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Buxheti 2024
AEE	01	04320	600	19,100,000	19,100,000	21,170,000
	01	04320	601	3,500,000	3,500,000	5,000,000
	01	04320	602	9,795,000	9,795,000	11,795,000
	01	04320	606	0	0	0
Totali				32,395,000	32,395,000	37,965,000

Burimi: AEE

Me shkresën Nr. 616/3 Prot. datë 16.02.2022 MIE ka përcjellë ne AEE miratimin e detajuar te fondit te veçantë për vitin 2022. Mbi bazën e shkresës Nr.1801/1, datë 04.02.2022 të MFE e cila ka akorduar fondin e veçantë në planin e buxhetit 2022 sipas tabelës Nr.2.

Tab. Nr.8

në lekë

Institucioni	Kap	Programi	Llog. Ekonomike	Debiti/ Miratuar	Emërtimi i produktit	Kod Produkti
AEE	01	04320	606	72,000	Ligje te përmirësuar ne fushën e eficencës se energjisë	90602AB

Burimi: AEE

-Me shkresën 2242/8 datë 24.03.2022, MIE ka dërguar detajimin e buxhetit 2022-2024 për shpenzimet kapitale ne programin “Mbështetje për energjinë” sipas tabelës Nr.9.

Tab. Nr.9

Në lekë

emri institucionit	kapitulli	programi	llogaria ekonomike	titulli i projektit	buxheti 2022	buxheti 2023	buxheti 2024
Agjencia e Eficences së Energjisë	01	04320	230&2031	Mbështetje për energjinë	178,769,000	228,350,000	242,966,700

Burimi: AEE

-Ne zbatim të Aktit Normativ Nr.3 date 12.03.2022 “Për disa ndryshime ne ligjin Nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, MFE me shkresën Nr.4934/51 Prot., date 27.03.2022 ka miratuar detajimin e shpenzimeve korrente, ne planin e rishikuar te buxhetit për vitin 2022, sipas programeve buxhetore, siç paraqitet ne tabelën Nr.10.

Tab. Nr.10 Llog 600, 601, 602 për programin mbështetje për energjinë

Institucioni	Kap	Programi	Llogaria Ekonomike	Buxheti 2022
AEE	01	04320	600	477,500
	01	04320	601	87,500
	01	04320	602	1,943,500
	Total			2,508,500

Burimi: AEE

-Me shkresën Nr.6362/4 Prot., date 14.09.2022 MIE mbështetur ne shkresën e MFE Nr.16197/1 date 08.09.2022 ka përcjell transferimin e fondeve për shpenzimet korrente për Agjencinë e Eficences se energjisë për programin “Mbështetje për Energjinë” për vitin 2022, nga ku llogaria 600 pakësohet me 3,500,000 lekë dhe shtohet tek llogaria 602 me shumën 3,500,000 lekë.

-Ne zbatim te VKM Nr. 898 date 29.12.2022 “ Për mbështetjen financiare te menjëhershme te punonjësve te njërive te qeverisjes se përgjithshme dhe institucioneve të arsimit te larte publik për zbutjen e krizës” MFE me shkresën Nr.24043/32 Prot., datë 11.01.2023 ka miratuar akordimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korrente të vitit 2022, në programin buxhetor të MIE, dhe AEE ka bërë shtesë në shumën 210,000 lekë për llogarinë paga (606).

Ne tabelën Nr.11 pasqyrohet ne mënyrë te përmbledhur buxheti për shpenzimet korrente të vitit 2022 me ndryshimet (paksime/shtime).

Tab. Nr.11

Llogaria Ekonomike	Buxheti fillestar 2022	AN nr.3 datë 12.03.2022	AN nr.12, datë 29.07.2022	AN nr.17, datë 01.12.2022	AN nr.19, datë 29.12.2022	Alokime e për fondin e veçantë	Rialokime / Transferime	Buxheti i ndryshuar 2022	Realizimi 29.12.2022	Realizimi ne %
	32,395,000	- 2,508,500	0	- 2,946,681	0	72,000	0	27,011,819	25,898,553	96%
6000000	19,100,000	-477,500					-3,500,000	15,122,500	14,797,113	98%
6010000	3,500,000	-87,500		-946,681				2,465,819	2,465,819	100%
6020000	9,795,000	- 1,943,500		- 2,000,000			3,428,000	9,279,500	8,600,382	93%
6060000						72,000	72,000	144,000	35,239	24%
	32,395,000	- 2,508,500	0	- 2,946,681	0	72,000	0	27,011,819	25,898,553	96%

Burimi: AEE

Buxheti i miratuar dhe alokuar për vitin 2022 për shpenzimet korrente ka qenë në shumën 27,011,819 lekë, i cili është realizuar në masën 96%.

Me shkresën Nr.3224/3 Prot., datë 17.05.2022 MIE ka dërguar transferimin e fondit buxhetor për shpenzime kapitale me financim të huaj për vitin 2022 për AEE, siç pasqyrohet në tabelën Nr.12

Tab. Nr.12

Emri Institucionit	Kapitulli	Programi	Llog. ekonomike	Titulli i projektit	Buxheti 2022
--------------------	-----------	----------	-----------------	---------------------	--------------

Agjencia e Eficences Energjisë	02	04320	231	Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero	9,890,000
--------------------------------	----	-------	-----	--	------------------

Burimi: AEE

-Me shkresën 6856/2 Prot., datë 29.09.2022 MIE ka përcjell ne AEE transferim te fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale me financim te brendshëm për vitin 2022.

Shtesat dhe paksimet në zërin “Shpenzime kapitale” Nr. Log. 231 duheshin te bëheshin ne muajin shtator 2022. Vlera totale prej 1,700,000 lek e përbërë nga shuma 500,000 lekë (kosto lokale për projektin REHUB+”Efikasiteti Rajonal i Energjisë” kjo vlere është shtuar respektivisht për aparatit e MIE.

-Me shkresën Nr. 8723/3 prot date 02.12.2022 te MIE për vitin 2022 është bere transferimi i “shpenzimeve kapitale” te llogarisë 230, 231 për muajin Dhjetor duke pakësuar respektivisht nga projekti “kosto lokale bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero” shumën 780,000 lekë, nga llog. 230 “Blerje Standarde ndërkombëtare ISO” në shumen 282,000 lekë, për projektin “Projekt për llogaritjen e koston Optimale për kushtet minimale ne ndërtesa” ne shumen 400 lekë, për “Për blerjen e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes se CPE projekt për standardet e ndriçimit rrugor dhe urban në Shqipëri ne shumen 200 lekë dhe 2360 lekë për “Blerje pajisje elektrike dhe hidraulike për nevojat e AEE” pra në total janë pakësuar 1,064,960 lekë te cilat janë shtuar ne llogarinë 231 për “ TVSH bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero.

-Me shkresën Nr.9345/13 Prot., date 21.12.2022 te MIE është dërguar detajimi i ndryshimeve buxhetore paksime/shtesa, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe shpenzimet kapitale me financim të huaj, në planin e rishikuar të buxhetit për vitin 2022, sipas Aktit normativ Nr.17 date 01.12.2022 për programin “Mbështetje për Energjinë” të cilat duhen e bëheshin ne muajin dhjetor 2022, ku paksimet janë në shumen totale 53, 581, 200 lekë dhe shtimi në shumën 133,581,200 lekë

Në tabelën Nr. 13 paraqitet shuma e buxhetit te vitit 2022, e cila është në shumen 254, 592, 848 lekë.

Tabela Nr.13 Buxheti i konsoliduar për investime kapitale në AEE për vitin 2022.

Titulli i projektit	Plan			Fakt	Realizimi
	Buxheti 2022	Shtese /pakësim	Total	Realizuar	%
Mbështetje për energjinë	188,659,000	80,000,000	268,659,000	254,592,848	94.76%

Burimi: AEE

Monitorimi i buxhetit për vitin 2022

AEE me shkresën 55/1 Prot., date 27.02.2023 ka përcjell ne MIE raportin vjetor te monitorimit te buxhetit.

- Analiza e shpenzimeve faktike të programit, 12 mujorin e 2022
Fondet buxhetore të planifikuara në programin "Mbështetje për Energjinë", përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e Eficencës së Energjisë.
Në total, buxheti vjetor për vitin 2022 i rishikuar, për programin "Mbështetje për Energjinë", është në vlerën 293,970,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 291,470,000 lekë ose 99.1 % e realizuar.

Shpenzimet korrente.

-**Plani i miratuar** për vitin 2022, për shpenzimet korrente të programit është 32,395,000 lekë, me aktet-normative gjatë vitit shpenzimet korrente u ulën në vlerën 5,527,181 lekë, kurse realizimi financiar është në vlerën 26,202,000 lekë, ose 97 % e planit e realizuar, ku këtu përfshihet si njësi shpenzuese Agjencia për Eficencën e Energjisë dhe fondet e vitit 2022, të realizuar si më poshtë:

-**Fondi për pagat** e punonjësve planifikuar në vlerën 19,100,000 lekë me aktin normativ u pakësuan në vlerën 4,188,000 lekë, fondi aktual është në vlerën 14,912,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 14,797,000 lekë, ose 99.2 % e planit të realizuar.

-**Fondi për sigurime shoqërore**, planifikuar në vlerën 3,500,000 lekë me aktin normativ u pakësuan në vlerën 1,034,000 lekë, fondi aktual është në vlerën 2,466,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 2,466,000 lekë, ose 100% planit të realizuar.

-**Fondi për shpenzimet** operative, planifikuar në vlerën 9,795,000 lekë me aktin normativ u pakësuan në vlerën 516,000 lekë, fondi aktual është në vlerën 9,279,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 8,694,000 lekë, ose 94 % e planit të realizuar.

-**Fondi për transfertat** buxhetore për familje e individë, planifikuar 144,000 lekë me aktin normativ u shtuan në vlerën 210,000 lekë, fondi aktual është në vlerën 354,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 245,000 lekë, ose 70 % e planit të realizuar.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Në projektet me financim i brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën e auditimit energjetik, rinovimit të ndërtesave me efikasitet energjetike, instalimit të ndriçimit me efikasitet të lartë dhe përdorimin e energjive të rinovueshme . Këto projekte janë implementuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor, janë në vlerën 177,069,000 me aktin-normativ Nr. 17 datë 01.12.2022 u shtuan në vlerën 80,000,000 lekë dhe plani i rishikuar është në vlerën 257,069,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 254,592,000 lekë, ose 99 % e planit të realizuar.

Objektivat e këtij programi realizohen nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, e cila për vitin 2022, realizoi procedurën për realizimin e 11 projekteve të reja në vlerën 56,895,000 lekë dhe 17 projekte ekzistues në vlerën 200,174,000 dhe realizim financiar është në vlerën 254,592,000 lekë ose 99% e planit të realizuar.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj për projektin “Bashkëpunimi Greqi Shqipëria për ndërtesat me konsum zero” sipas planit vjetor janë në shumën 9,890,000 lekë dhe realizimi është në shumën 10,676,350 lekë ose 108% kundërt planifikimit.

Programi buxhetor afatmesëm 2023-2025 për shpenzimet korrente.

Me shkresën Nr.861/1 Prot date 25.01.2023 MIE ka dërguar të miratuar detajimin e planit buxhetor, për shpenzimet korrente të vitit 2023-2025, në nivel artikulli dhe produkti sipas tabelës Nr.14

Tabela Nr.14

Institucioni	Kap	Programi	Llog.Ek.	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025
AEE	1	4320	600	19,100,000	18,980,000	18,980,000
	1	4320	601	3,500,000	5,000,000	5,000,000
	1	4320	602	9,795,000	11,795,000	11,795,000
Totali				32,395,000	35,775,000	35,775,000

Llog.Ek.	BUXHETI FILLESTAR (1)	SHITESA FONDI VEÇANTE (2)	Transferime (3)		AKORDIM FONDE SHPENZIME PERSONELI VKM 325 & 326 (4)	AN nr.5, datë 18.10.2023 (5)	AN nr.6, datë 14.12.2023 (6)	AKORDIM FONDE SHPENZIME PERSONELI VKM 795 & 834 (7)	BUXHETI I RISHIKUAR (8=1+2+3+4+5+6+7)	Realizimi Faktik 2023 datë 30.01.2024	% e realizimit
			PAKESIME	SHTESA							
600	19,100,000	0	0	1,550,000	0	0	-1,150,000	476,000	19,976,000	19,973,973	
601	3,500,000	0	0	0	0	0		0	3,500,000	3,167,940	
602	9,795,000	0	1,580,000	0	0	0		0	8,215,000	6,732,111	
606	0	0	0	30,000	0	0		0	30,000	18,702	
Totali	32,395,000	0	1,580,000	1,580,000	0	0	-1,150,000	476,000	31,721,000	29,892,726	94.2%

-Me shkresën Nr.3288/2 date 02.05.2023 MIE ka dërguar te miratuar planin e buxhetit për vitet 2023-2025, për shpenzimet kapitale ne programin buxhetor “mbështetja për energjinë” në shumën 211,225,850 lekë për vitin 2023, 215,234,608 lekë për vitin 2024 dhe 226,300,000 lekë për vitin 2025 dhe financimin e huaj për vitin 2024 ne shumen 40,000,000 lekë për projektin “ Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar shkresës 3936 Prot. date 03.11.2022 me objekt “Tërheqje vëmendje”, pasi AEE ka paraqitur me vonese raportimin e të dhënave të projektit me financim te huaj “Goal nZebS” duke vepruar në mospërputhje me udhëzimin Nr.35 date 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, pika 7.3 në të cilën përcaktohet se:

Në rastet e konstatimeve të qëndrimeve që kanë të bëjnë me mosrespektimin e përsëritur të afateve kohore apo pasaktësi në raportimin mujor duke iu referuar legjislacionit në fuqi, do të procedohet me masa administrative

Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore ”Fato Berberi” në Gjirokastrë

Në kuadër të programit Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme “Greece – Albana 2014-2020” midis vendeve të rajonit ku lider i projektit është shteti Greqia. Në këtë project përfshin edhe Agjencia për Eficencën e Energjisë.

Gjatë vitit 2020 janë ndjekur procedurat e konkurimit për realizimin e projektit të zbatimit duke përdorur procedurat e konkurimit PRAG të Bashkimit Europian.

Pas përfundimit të konkurimit në datë 24.07.2020 është lidhur kontrata midis Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe operatorit ekonomik “N..,” shpk për realizimin e projektit të zbatimit.

Pas dorëzimit të projektit të zbatimit në muajin Maj 2021 ka filluar procedura për realizimin e procedurave të konkurimit për realizimin e punimeve të zbatimit, duke përdorur përsëri procedurat e konkurimit PRAG të Bashkimit European dhe në 20 shtator 2021 është lidhur kontrata midis Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe operatorit ekonomik “A..,” shpk. Pas lidhjes së kontratës është kërkuar nga Bashkia Gjirokastrë mbështetje për dhënien e lejes së ndërtimit. Meqenëse objekti ndodhet në zonën e qendrën historike të qytetit të Gjirokastrës “Trashëgimi Kulturore”, (por objekti në vetvete nuk është i klasifikuar si objekt i trashëgimisë kulturore), nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë ka vazhduar procedura për miratimin e marrjes së lejes përkatëse për realizimin e projektit.

Në datë 30.03.2022 me Vendim Nr. 67 Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka miratuar projektin dhe në datë 15.04.2022 me Vendim Nr.26, Bashkia Gjirokastrë ka lëshuar *Deklaratën për Kryerje Punimesh.*

Në datë 27.04.2022 ka filluar nisja e punimeve të zbatimit, me një afat 5 muaj për realizimin e tyre. Për arsye të mungesës së mbështetjes nga pala shqiptare me fonde provizore për të kryer pagesat sipas realizimeve të punimeve ndërtimore afati i përcaktuar në kontratën bazë nuk është realizuar. Për këtë arsye nga pala shqiptare i është kërkuar palës greke që është edhe *Lideri i* këtij partneritetit të projekteve të përmendura më sipër, për të shtyrë afatin e realizimit të punimeve. Procedurat janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik në portalin e Bashkimit European edhe për dy procedurat e tjera që zhvillohen në Greqi. Pas konfirmimit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve është lidhur një shtesë kontrate për shtyrje të realizimit të objektit 15 muaj nga data e marrjes së lejes së ndërtimit deri në 30 Qershor 2023. Për këtë objekt ka patur edhe një auditim nga Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi European.

Realizimi i treguesve të buxhetit

Ne mënyrë të përmblodhur në tabelën paraqitet shpenzimet korrente dhe ato kapitale për vitet objekt auditimi 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023

Llogaria Ekonomike	2019			2020			2021			2022			2023		
	Buxheti i ndryshuar	Realizimi	Realizimi %	Buxheti i ndryshuar	Realizimi	Realizimi %	Buxheti i ndryshuar	Realizimi	Realizimi %	Buxheti i ndryshuar	Realizimi 29.12.2022	Realizimi %	Buxheti i ndryshuar	Realizimi	Realizimi %
6000000	15,854,400	4,910,854	31	10,400,000	5,920,750	57	9,900,000	9,367,788	95	15,122,500	14,797,113	98	19,976,000	19,973,973	100
6010000	3,877,685	789,930	20	2,500,000	988,406	40	2,500,000	1,545,983	62	2,465,819	2,465,819	100	3,500,000	3,167,940	91
6020000	2,000,000	932,623	47	2,500,000	1,080,039	43	4,014,000	1,707,635	43	9,279,500	8,600,382	93	8,215,000	6,732,111	82
6060000	30,000	-	0				36,000	15,800	44	144,000	35,239	24	30,000	18,702	62
Totali	21,762,085	6,633,407	30	15,400,000	7,989,195	52	16,450,000	12,637,206	77	27,011,819	25,898,553	96	31,721,000	29,892,726	94
2300000				57,059,000	57,059,000	100	196,244,134	189,926,080	97	53,876,400	251,400,248	99	229,382,921	199,123,767	87
2310000	11,000,000	7,156,654	65	171,000		0	2,300,000		0	3,192,600	3,192,600	100	12,137,337	12,137,336	100
Totali	11,000,000	7,156,654	65	57,230,000	57,059,000	100	198,544,134	189,926,080	96	257,069,000	254,592,848	96	241,520,258	211,261,103	87
Financim huaj															
2300000															
2310000										9,890,000	10,676,350	108	40,000,000	5,733,121	14
Totali										9,890,000	10,676,350	108	40,000,000	5,733,121	14

AEE nuk ka hartuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2019, 2020, 2021, duke vepruar në mospërputhje me:

- kërkesat e ligjit 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- udhëzimit të MFE Nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 266, ku thuhet: “Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, nivelin e performances gjatë realizimit të objektivave dhe trajtimin e risqeve të lidhura me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve dhe raporteve të monitorimit, parashtrihen nga Nëpunësi Autorizues në mbledhjet periodike të Grupit për Menaxhimin Strategjik të kryesuar nga Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e masave konkrete për përmirësimin e procesit dhe minimizimin e risqeve (duke përcaktuar dhe drejtuesin përgjegjës për menaxhimin e tyre),

- udhëzimin Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 4 dhe 33 ku thuhet (4): „Monitorimi është një procs vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktik të performancës me ato të planifikuar“, (33): „Procesi formal i raportimit mbi performancën kërkon përgatitjen e tre raporteve periodike të monitorimit në vit, mbi performancën e produkteve për secilin program, ...konkretisht ë 30 maj, 30 shtator dhe raporti vjetor në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm“.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi titullarët e institucionit brenda periudhës së auditimit z. E.B., (04.10.2019), z. E.D., (22.06.2021-12.10.2022).

2.4. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Respektimi i dispozitave ligjore për për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Agjencisë për Eficencën e Energjisë.

Nga grupi i auditimit u verifikuan:

Struktura organizative

Dosjet e personelit

Rregullorja për përcaktimin e e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës


Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës

Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës

Procedurat e dhënies të masave disiplinore

Struktura dhe organizimi i institucionit.

STRUKTURA E AGJENCISË PËR EFICIENCËN E ENERGJISË



Institucioni drejtohet nga në vartësi direkte e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtori i Përgjithshëm i cili ka Drejtorinë Teknike dhe Sektorin

Ndryshimet e pësuara mbi drejtuesin e institucionit për periudhën nën auditim.

Me anë të urdhrit Nr. 370/1, datë 12.04.2018 emërohet znj. E.C., në pozicionin drejtues, Drejtor i Përgjithshëm për Eficencën e Energjisë nga ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. B. B.,

Me anë të urdhrit Nr. 359, datë 04.10.2019 autorizohet z. E. B. të ushtrojë krahas detyrave funksionale dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Eficencën e Energjisë nga ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. B.B.,

Në procesverbalin Nr. 3729/2 datë 22.06.2021 lirohet dhe emërohet në pozicionin e nivelit të lartë drejtues, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Eficencën e Energjisë z. E.D.

Me anë të urdhrit Nr. 198, datë 14.10.2022, "Për ushtrimin e përkohshëm të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Eficencën e Energjisë", z. A.H. urdhërohet të ushtrojë përkohësisht edhe funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Eficencën e Energjisë si dhe me anë të procesverbalit Nr. 5270/3 Prot., datë 20.10.2023 emërohet në po të njëjtin pozicion.

Me urdhër Nr. 38, datë 17.03.2021, me objekt "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Eficencën e Energjisë", në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit Nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit Nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", nga Kryeministri z. Edi Rama, urdhërohet si më poshtë:

Struktura e Agjencisë për Eficencën e Energjisë të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Organika e Agjencisë për Eficencën e Energjisë të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Numri i punonjësve të Agjencisë për Eficencën e Energjisë të jetë, gjithsej, 20 veta.

Urdhri Nr.56, datë 20.4.2017, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Eficencën e Energjisë", shfuqizohet.

Me shkresën Nr. 2397/2 Prot., datë 18.03.2021 është kërkuar krijimi i Komisionit të Ristrukturimit për institucionin e Agjencisë për Eficencën e Energjisë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. V.H. drejtuar Departamentit të Administratës Publike, duke i propozuar si përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Komisionin e Ristrukturimit të jenë znj. V.H., znj. V.C.

Me urdhër Nr. 51 datë 19.03.2021 "Për krijimin e komisionit të ristrukturimi në kuadër të ristrukturimit të agjencisë për eficientë e energjisë", krijohet komisioni me përbërje znj. O.M. znj. V.H. dhe znj. V.C.

Komisioni i Ristrukturimi me Vendim Nr. 2397/5 Prot. datë 23.03.2021 vendosi:

T'i propozojë Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse:

Transferimin e përhershëm të z. B.A. nga pozicioni Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Performancës dhe Shërbimeve Energjetike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III-a, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Auditimeve dhe Certifikimeve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III-a.

Transferimin e përhershëm të znj. K.T. nga pozicioni Specialist në Sektorin e Auditimit të Performancës dhe Shërbimeve Energjetike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist në Sektorin e Auditimeve dhe Certifikimeve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Transferimin e përhershëm të z. O.I. nga pozicioni Specialist në Sektorin e Auditimit të Performancës dhe Shërbimeve Energjetike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist në Sektorin e Shërbimeve Energjetike, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Transferimin e përhershëm të z. A.M. nga pozicioni Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Eficencës së Energjisë, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III-a/I, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III-a.

Transferimin e përhershëm të znj. B.M. nga pozicioni Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Projekteve të Eficencës së Energjisë, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist (Jurist) në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Transferimin e përhershëm të znj. Xh.A. nëpunës civil në periudhë prove nga pozicioni Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Projekteve të Eficencës së Energjisë, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist në Sektorin e Auditimeve dhe Certifikimeve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Transferimin e përhershëm të znj. A.K. nga pozicioni Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Programeve të Eficencës dhe Analizës, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III-all, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Eficencës dhe Analizës, Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria III a.

Transferimin e përhershëm të z. M. K. nëpunës civil në periudhë prove nga pozicioni Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Programeve të Eficencës dhe Analizës, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist në Sektorin e Shërbimeve Energjetike, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Transferimin e përhershëm të znj. K.M. nëpunës civil në periudhë prove nga pozicioni Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Programeve të Eficencës dhe Analizës, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a, në pozicionin Specialist në Sektorin e Programeve të Eficencës dhe Analizës, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, kategoria IV-a.

Marrëdhëniet e punës

	Emër Mbiemër	Sektori	Pozicioni	Kategoria e Pagës	Universiteti / Fakulteti / Dega	Niveli i Diplomës/ Profesionit	Data e emërimit në institucionin aktual
1	A. H.	Eficienta e Energjise	Drejtor I Pergjithshem	I-4	Queen Mary University of London/ juridik	Master Shkencor	20.10.2023
2	Vakant	Eficienta e Energjise	sekretare		arsim I larte		
3	A. M.	Eficienta e Energjise	Drejtor Drejtorie	II-1	UPT/Inxh. Ndertimi/Arkitekture	Master Shkencor	01.03.2020
4	Xh. A.	Sektori i Auditimit dhe Certifikimit	Pergjegjes Sektori	III-2	Upt/ Inxh. Mjedisi/Energjitike	Master Shkencor	15.03.2019
5	vakant	Sektori i Auditimit dhe Certifikimit	Specialist	IV-2			
6	K. H.	Sektori i Auditimit dhe Certifikimit	Specialist	IV-2	American university of Bulgaria/Ekonomik	Bachelor	12.04.2023
7	O. I.	Sektori i Shërbimeve energjitike	Pergjegjes Sektori	III-2	UET/Juridik	UT/Master Shkencor	10.04.2019
8	vakant	Sektori i Shërbimeve energjitike	Specialist				
9	A.B.	Sektori i Shërbimeve energjitike	Specialist	IV-2	UPT/Inxhinieri Elektrike	Master Shkencor	01.05.2022
10	K.T.	Sektori I Menaxhimit dhe Monitorimit te Projekteve	Pergjegjes Sektori	III-2	UPT//Arkitekture	Master Shkencor	4.08.2021
11	Xh. Sh.	Sektori I Menaxhimit dhe Monitorimit te Projekteve	Specialist	IV-2	UPT//Energjitike	Master Shkencor	21.09.2021
12	Xh. S.	Sektori I Menaxhimit dhe Monitorimit te Projekteve	Specialist	IV-2	UPT//Energjitike	Master Shkencor	22.06.2021
13	M.K.	Sektori I Programeve te Eficences dhe Analizes	Pergjegjes Sektori	III-2	Inxhinieri Mjedisi/ Greqi	Master Shkencor	28.02.2022
4	F.D.	Sektori I Programeve te Eficences dhe Analizes	Specialist	IV-2	UPT//Inxh. fizike	Master Shkencor	21.06.2021
15	K. M.	Sektori I Programeve te Eficences dhe Analizes	Specialist	IV-2	Upt/ Inxh. Mjedisi/Energjitike	Master Shkencor	14.09.2021
16	A. Ç.	Sektori I Finances dhe shërbimeve mbështetëse	Pergjegjes Sektori	III-2	Shkenca Ekonomike	Master Shkencor	09.03.2022
17	D. K.	Sektori I Finances dhe shërbimeve mbështetëse	Specialist	IV-2	UT/Ekonomik	Master Shkencor	06.07.2021
18	V. Gj.	Sektori I Finances dhe shërbimeve mbështetëse	Specialist	IV-2	UET/ Shkenca Sociale / Marrredhenie nderkombetare	Master Shkencor	1.06.2022
19	B. M.	Sektori I Finances dhe shërbimeve mbështetëse	Specialist	IV-2	UET/Juridik	UET/Master Shkencor	13.12.2018
20	E.M.	Sektori I Finances dhe shërbimeve mbështetëse	Specialist	IV-3	UT/Shkenca Sociale/Filozofi	Bachelor	22.06.2022

Marrëdhëniet e punës për Agjencinë për Eficencën e Energjisë rregullohen nga Departamenti i Administratës Publike.

Për vitet periudhë nën auditim nuk janë hapur procese gjyqësore padi kundër AEE, me objekt “Ndërprerje e padrejtë e marrëdhënieve të punës”.

Sa më sipër konstatohet që:

- Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive;
- Në strukturën e miratuar dhe dorëzuar grupit të auditimit konstatohen vende vakante të cilat mund të ndikojnë në performancën dhe arritjen e objektivave të institucionit.

2.5. Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël. Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. Inventarizimi i pasurisë së institucionit.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Agjencisë për Eficencën e Energjisë.

Në lidhje me auditimin e pikës së mësipërme të programit, grupit të auditimit ju vunë në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat e pozicionit financiar.
- Pasqyrat e performancës financiare.
- Pasqyrat e flukseve monetare (Cashfloë).
- Pasqyrat e Ndryshimeve ne Aktivet Neto/ Fondet Neto.

Ref. e	E M E R T I M I	2023	2022	2021
Llogariv				
A	A K T I V E T	903,500,23	799,939,52	351,954,64
	I.Aktivët Afat shkurtër	105,309,08	115,740,51	88,215,828
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	8,735,725	8,430,780	3,622,435
520	Disponibilitete ne Thesar	8,735,725	8,430,780	3,622,435
59	Provizjone zhvlersimi letra me vlere (-)			
	2.Gjendje Inventari qarkullues	722,626	40,800	40,800
31	Materiale	722,626	40,800	40,800
32	Inventar I imet	-	-	-
39	Provizjone perzhvlersimin e inventarit (-)			
	3.Llogari te Arketushme	95,850,731	107,268,93	51,294,504
411	Kliente e llogari te ngjashme			
468	Debitore te ndryshem	-	-	-
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	95,850,731	107,268,93	51,294,504
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive			
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)			
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	-	-	33,258,089
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	-	-	33,258,089
	II.Aktivët Afat gjatë	798,191,15	684,199,01	263,738,81
20	1.Aktive Afatgjatë jo materiale	245,647	307,060	-
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave			
202	Studime dhe kerkime	-	-	-
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	245,647	307,060	
21	2.Aktive Afatgjatë materiale	77,949,824	13,020,873	9,597,082
210	Toka, T.roje, Terene	-	-	-
211	Pyje, Plantacione			

212	Ndertesa e Konstruksione	67,332,821	-	
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	-	-	
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	-	-	
215	Mjete Transporti	109,355	-	
218	Inventar ekonomik	10,507,648	13,020,873	9,597,082
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	-	-	-
	4.Investime	719,995,68	670,871,07	254,141,73
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	697,509,09	658,563,68	246,985,08
231	Per Aktive Afatgjata materiale	22,486,591	12,307,393	7,156,654
B	PASIVET(DETYRIMET)	104,586,45	115,699,71	88,175,028
	I.Pasivet Afat shkurtra	104,586,45	115,699,71	88,175,028
	1. Llogari te Pagushme	104,586,45	115,699,71	88,175,028
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	93,379,039	105,832,78	50,147,442
42	Detyrime ndaj personelit	1,469,073	1,001,539	796,622
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	341,880	91,259	77,155
435	Sigurime Shoqërore	438,284	301,504	239,845
436	Sigurime Shëndetësore	62,455	41,844	33,440
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere			
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	8,735,725	8,430,780	3,622,435
467	Kreditore te ndryshëm	160,000		33,258,089
4341	Operacione me shtetin(detyrime			-
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)			
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	-	-	-
419	Kreditore, Parapagime	-	-	
	II.Pasivet Afat Gjata	-	-	-
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	798,913,78	684,239,81	263,779,61
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	798,913,78	684,239,81	263,779,61
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	798,231,95	684,239,81	263,738,81
12	Rezultatet e mbartura			-
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	681,826	-	40,800
	Te Tjera			
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	903,500,23	799,939,52	351,954,64

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë për Eficencën e Energjisë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 dhjetor 2021, 2022 dhe 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e ndryshimeve të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

- Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen, integritetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare të Agjencisë për Eficencën e Energjisë, si dhe të gjitha informacionet e tjera të përfshira në Raportin Vjetor të Autoritetit. Pasqyrat financiare të Agjencisë për vitet 2021, 2022, 2023 u përgatitën në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht të Republikës së Shqipërisë. Pasqyrat financiare vjetore u dërguan pranë Degës së Thesarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si më poshtë:

- Dërgimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021 me shkresën me nr. 664 Prot., datë 30.03.2022,
- Dërgimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 me shkresën me nr. 222 Prot., datë 29.03.2023
- Dërgimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2023 me shkresën me nr. 143 Prot., datë 20.03.2024.
- Të dhënat mbi pasqyrat financiare u arritën të merren në dy formatet, atë fizik dhe elektronik për vitet 2021,2022 dhe 2023, ndërsa për vitet 2019 dhe 2020 u arrit të merren vetëm ne formatin fizik. Agjencia për Eficencën e Energjisë për mbajtjen e llogarive të bilancit dhe veprimeve ekonomike ka prokuruar programin financiar, i cili akoma nuk është populluar nga ana e AK.
- Llogaria Aktivitet Neto jepet si më poshtë:

Nr.	Referenc	E M E R T I M I	dhe Grante	Rezerva	Tjera	e Mbartura	e Ushtrimit	Aktive/neto
Reshti			Kapitale		te veta	Teprioc/Deficit	Teprioc/Deficit	Fonde/ Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	-			-	-	-
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/FONDET NETO(1+2)	684,239,812		71,013,348	159,044,555	320,499,226	798,913,784
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	684,239,812	-		159,044,555	320,499,226	727,900,436
4	105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	522,062,515		211,261,104		-	733,323,619
7	12	Nga Rezultatet e mbarura(+,-)	40,800					40,800
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)					681,826	681,826
9	111	Nga Rezervat (+,-)					321,181,052	321,181,052
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	162,136,497		225,000	159,044,555		321,406,052
11	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)					-	-
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)			6,370,809		-	6,370,809
17		2.NGA BURIME TE JASHTME	-	-	71,013,348	-	-	71,013,348
19	1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)			71,013,348			71,013,348
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA (I+II)	684,239,812	-	71,013,348	159,044,555	320,499,226	798,913,784

- Në analizimin e zërit Pasive Afatshkurtra dhe nënkategorisë “Furnitorë e llogari të lidhura me to” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri si më poshtë:

2023	2022	2021
93,379,039	105,832,785	50,147,442

ku në të cilën janë të përfshira detyrimet e mbarura ndaj furnitorëve ku për të cilët administrata nuk ka ndjekur asnjë rrugë duke caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre.

Blerjet me vlera të vogla

Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim Pastrimi”, viti 2020.

Kërkesa për shërbim për pastrimin e ambienteve të zyrave të AEE është bërë nga specialistja e Sektorit të Investimeve znj. Xh.A. sipas shkresës me nr. 21 Prot., datë 16.02.2020. Për shërbimin e pastrimit Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 23 datë 17.02.2020, me përbërje znj. B.M., znj. K.T. dhe znj. A.K. me vlerë të fondit limit 666,666 lekë pa TVSH. Në lidhje me vlerësimin e ofertave të bërë nga Komisioni si më sipër, referuar procesverbalit për këtë procedurë kanë shprehur interes 18 operator ekonomikë ku sipas aktit me nr. 25/1 Prot., datë 19.02.2020 OE “M...” është shpallur fitues me ofertën ekonomike në shumën 198,000 lekë pa TVSH. Pas konfirmimit nga komisioni i blerjeve të vogla mbi dokumentacionin e shkruar të dorëzuar pas

shpalljes fitues nga OE “M.”, AK ka lidhur me këtë OE Kontratën nr. 26 Prot., datë 20.02.2020. Për shërbimin e ofruar kontraktuesi ka paraqitur pranë AK AEE faturat tatimore si më poshtë:

- Fatura nr. 7, datë 12.06.2020 në vlerën 71,280 lekë me TVSH, për periudhën 20 Shkurt-20 Maj 2020, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 59, datë 15.11.2021;
- Fatura nr. 39, datë 12.09.2020 në vlerën 71,280 lekë me TVSH, për periudhën 21 Maj-20 Gusht 2020, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 60, datë 15.11.2021;
- Fatura nr. 72, datë 04.12.2020 në vlerën 71,280 lekë me TVSH, për periudhën 21 Gusht-20 Nëntor 2020, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 61, datë 15.11.2021;
- Fatura nr. 88, datë 31.12.2020 në vlerën 23,760 lekë me TVSH, për periudhën 20 Nëntor-31 Dhjetor 2020, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 62, datë 15.11.2021;

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

- Nga ana e anëtarëve të komisionit të blerjeve me vlerë të vogla nuk është mbajtur proces verbali mbi përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike;

- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.

- Anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve të vogla nuk kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit;

- Komisioni i blerjeve të vogla nuk ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim;

- AK nuk ka kërkuar paraqitjen e deklaratës së konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;

- AK nuk ka kërkuar nga OE pjesëmarrës që punonjësit e pastrimit të kenë kontratë pune me këta OE;

- AK nuk ka kërkuar që punonjësit e pastrimit të figurojnë në listat e të punësuarve të shoqërisë, për të paktën tre muajt e fundit;

- AK nuk ka përcaktuar kriterë/kërkesa të veçanta të specifikimeve teknike për pajisjet dhe detergjentët e pastrimit që do të duhet të ofrojnë OE të kualifikuar dhe të shpallur fitues, për të siguruar cilësinë e shërbimit të kërkuar sipas kërkesave të AK;

- Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë AEE të OE “M.” i shpallur fitues konstatohet se mungojnë:

-Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore;

-Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;

-Deklarata të konfliktit të interesit;

-Vërtetimi se operatori nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv);

AEE, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të vendosura në ftesën për ofertë ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE të renditur i pari për nga oferta ekonomike, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara nga AK. Komisioni i blerjeve të vogla duhej të skualifikonte OE të renditur i pari dhe të shpallte fitues OE pasardhës.

- Kontraktuesi “M.” nuk ka dokumentuar informacion për mjetet dhe solucionet gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së shërbimit (20.02.2020- 31.12.2020);

- Nuk administrohet Urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim;

- Faturat tatimore për kryerjen e shërbimit janë likuiduar më datë 15.11.2021 për shërbimin e kryer më 20 shkurt – 31.12.2020, pra me vonesë duke sjellë risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale;

Veprimet dhe mosverimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7.

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:
-neni 28, pikat 2 dhe 5_neni 59, neni 61, pika 2,
-neni 64, pika 2, neni 66, pika 3, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat nr. 42 dhe 43, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 5, Kontrata nr. 26 Prot., datë 20.02.2020, pika 15.4 dhe 16.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E.B. si dhe anëtarët e KPVV znj. B.M., znj. K.T. dhe znj. A.K.

Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kancelarie”, viti 2022.

Hartimi dhe përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike

Me Urdhrin nr. 119, datë 20.01.2022, është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV), me përbërje znj. B.M., z. F.D. dhe znj. D.K. Kërkesa për për blerje materiale kancelarie është bërë me shkresën nr. 1070 të datës 28.04.2022, nga znj. D.K. dhe znj. A.Ç. nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Me shkresën nr. 1070/1 Prot., datë 09.05.2022, KPVV ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku vlera e fondit limit është 625,000 lekë pa TVSH, i përlllogaritur ky nga studimi i tregut mbi bazë të ofertave të marra nga e operatorë ekonomikë të ndryshëm (Copier & Computer Center, Infosot Office, Office Solution). Urdhri i Prokurimit nr. 1145, datë 10.05.2022, “Blerje materiale kancelarie” i Titullarit ka emëruar anëtarët znj. B.M., z. F.D. dhe znj. D.K.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ku sipas shkresës me nr. 1145/2 datë 12.05.2022, referuar klasifikimit përfundimtar në SPE, kanë paraqitur interes 17 operatorë ekonomikë nga të cilët janë s’kualifikuar OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht:

OE “M.M.”

OE “M.B”

OE “I.”

OE “E..”

OE “M.& D”

OE “E.Q”

Janë s’kualifikuar OE për arsye se kanë ofertuar nën 50 % të fondit limit, konkretisht:

OE “E.Q”

Në datë 13.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE “F. H.” me vlerë të ofertës 433,000 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 1145/3 Prot., datë 13.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për s’kualifikimin e OE për arsye tërheqje nga procedura. Në datën 16.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE “D-R..” me vlerë të ofertës 554, 900 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 1145/4 Prot., datë 16.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për s’kualifikimin e OE për arsye se nuk është paraqitur brenda afateve të përcaktuara. Në datën 17.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE “O.T.” me vlerë të ofertës 556, 667 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 1145/5 Prot., datë 17.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për s’kualifikimin e OE për arsye se nuk është paraqitur brenda afateve të përcaktuara. Në datën 17.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE “L.D.” me vlerë të ofertës 590,000 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 1145/6 Prot., datë 17.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për skualifikimin e OE për arsye se ka paraqitur tërheqje. Administruar një shkresë për tërheqje pa nr Prot., datë e pa firmosur nga OE. Në datën 18.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE “H.H.” me vlerë të ofertës 599,990 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr.1145/7 Prot., datë

18.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për s'kualifikimin e OE për arsye se ka paraqitur tërheqje. Në datën 19.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE "CRF" me vlerë të ofertës 608,120 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr.1145/8 Prot., datë 19.05.2022, ka mbajtur procesverbalin për s'kualifikimin e OE për arsye se ka paraqitur tërheqje nga procedura. Me shkresë të datës 19.05.2022 OE ka njoftuar tërheqjen nga procedura. Më datë 19.05.2022, në SPE është shpallur fitues OE "I.O." me vlerë të ofertës 610,000 lekë pa TVSH, si dhe me shkresë nr. 1145/9 datë 20.05.2022 "Formulari i Njoftimit i Fituesit".

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

Nga auditimi i dokumentacionit i sipërcituar rezultojnë mangësitë si më poshtë:

- Në urdhrin e prokurimit është përfshirë edhe fondi limit;
- AK nuk ka kërkuar deklaratë të konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;
- Nuk është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga ana e KPVV;
- Në Sistemin Prokurimit Elektronik të APP-së është publikuar vetëm ftesa për ofertë nr. 1145/1 datë 11.05.2022 por bashkëlidhur saj nuk është publikuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim;
- AK nuk ka kërkuar deklaratë të konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;
- AK nuk ka kërkuar mostër për letrën A4 për të cilën janë përcaktuar specifikime teknike të detajuara në ftesën për ofertë;
- AK nuk ka përcaktuar certifikata ISO për cilësinë e letrës (kodi përkatës);
- Nuk është reflektuar në SPE oferta e refuzuar për arsye të mosparaqitjes të OE për të realizuar objektin e prokurimit;
- Në dokumentacionin e OE fitues "I.S." rezulton se sipas vërtetimit me nr. 392 datë 12.04.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ky OE ka detyrime në Tatimin në Burim. Në këto kushte, kur nuk janë përmbushur kriteret e vendosura nga AK sipas ftesës për ofertë, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës si dhe të bënte s'kualifikimin e tij pasi mungesa e dokumentacionit sipas ftesës për ofertë përbën kusht për skualifikim;

Nuk administrohet urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit përkatës të marrjes së mallit në dorëzim. Marrja e mallit është kryer nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV).

Veprimet dhe mosverimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40, pika 2, 3 dhe 6, neni 73, pika 4, neni 78, pika 2, neni 82, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 8, pika 11, pika 15, germa b, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 42 dhe 43.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E.D. si dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël znj. B.M., z. F.D. dhe znj. D.K.

-Procedura e prokurimit me vlere të vogël me objekt: "Blerje Tонера Printeri" për vitin 2022.

Në procesverbalin nr.811/1 Prot. datë 15.04.2022 është përlogaritur fondi limit në vlerën prej 613,433 lekë pa TVSH, me anën e ofertave të marra në treg nga O.E "R" në vlerën prej 611.300 lekë pa TVSH, OE "P.O." në vlerën prej 620,000 lekë pa TVSH, dhe OE "A.-S." në vlerën prej 609.000 lekë pa TVSH.

Në formularin e njoftimit të fituesit nr.1094/1 prot. datë 09.05.2022 është shpallur fitues operatori “P.O.” në vlerën prej **440.000 lekë** pa TVSH, i gjashti në renditjen përfundimtare në sistemin elektronik.

Në përfundim të afatit të dorëzimit të ofertave, në datë 20.04.2022, oferta ekonomike e “P.O.” në SPE në vlerën prej 440.000 lekë pa TVSH, është **180,000 lekë** më e ulët se oferta e po këtij operatori në datën 15.04.2022, e përdorur për rillogaritjen e fondit limit (mesatarja e tre ofertave). Me uljen e ofertës në SPE, operatori fitues “P. O.”, praktikisht ruan një renditje të “favorshme” krahasuar me fondin limit të llogaritur me ofertën e tregut. Në rastin konkret ndryshon baza krahasuese për operatorin fitues.

- Procedura e prokurimit në vlerë të vogël me objekt “Blerje Materiale Pastrimi”, viti 2023.

Në procesverbalin nr.389/1 Prot. datë 29.06.2023 është përlllogaritur fondi limit në vlerën prej **621,247 lekë** pa TVSH, me anën e ofertave të marra në treg, operatorët “E...” në vlerën prej 624,880 lekë pa TVSH, “M.V.” **618,060 lekë** pa TVSH, dhe “X...” Grup 620.800 lekë pa TVSH. Në zbatim Urdhrit të Prokurimit Nr.61, datë 12.07.2023 është hartuar ftesa për ofertë nr. 389/6 Prot., datë 13.07.2023.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “M.V.” të radhës, me çmimin me të ulët të ofertës në shumën 410.000 lekë pa TVSH.

Në përfundim të afatit të dorëzimit të ofertave, në datë 14.07.2023, oferta ekonomike e “M. V.” në SPE në vlerën prej 410.000 lekë pa TVSH, është **208,060 lekë** më e ulët se oferta e tij e datës 29.06.2023, e cila është administruar për arsye të ripërlllogaritjes së fondit limit.

Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim Pastrimi”, viti 2021.

Kërkesa për shërbim për pastrimin e ambienteve të zyrave të AEE është bërë nga specialistja e Sektorit të Investimeve znj. Xh.A. sipas shkresës me nr. 341 Prot., datë 05.01.2021. Për shërbimin e pastrimit Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 341/1 datë 05.01.2021, me përbërje znj. B.M., znj. K.T. dhe znj. A. K. me vlerë të fondit limit 666,666 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 341/2 Prot., datë 06.01.2021 AK ka realizuar ftesën për ofertë. Në lidhje me vlerësimin e ofertave të bërë nga Komisioni si më sipër, referuar procesverbalit për këtë procedurë kanë shprehur interes 24 operator ekonomikë ku sipas aktit me nr. 341/3 Prot., datë 18.01.2021 OE B.S.. është shpallur fitues me ofertën ekonomike në shumën 650,000 lekë pa TVSH. OE i renditur i pari është njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit me shkresën nr. 341/3 Prot., datë 18.01.2021. Pas konfirmimit nga komisioni i blerjeve të vogla mbi dokumentacionin e shkruar të dorëzuar dhe shpalljes fitues të OE B.S., AK ka lidhur me këtë OE kontratën me nr. 341/4 Prot., datë 18.01.2021. Me Urdhër nr. 341/5 prot./.. datë 29.06.2021 është bërë zëvendësimi i anëtarit të Njësisë së Prokurimit znj. A.K. për shkak të largimit nga vendi i punës. Për shërbimin e ofruar kontraktuesi ka paraqitur pranë AK AEE faturat tatimore si më poshtë:

- Fatura nr. 182/2021, datë 29.10.2021 në vlerën 645,612 lekë me TVSH, për periudhën 18 Janar-31 Tetor 2021, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 92, datë 28.12.2021.
- Fatura nr.202/2021, datë 01.12.2021 në vlerën 67,272 lekë me TVSH, për periudhën 01 Nëntor-30 Nëntor 2021, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 93, datë 28.12.2021.
- Fatura nr. 239/2021, datë 31.12.2021 në vlerën 67,116 lekë me TVSH, për periudhën 01 Dhjetor-31 Dhjetor 2021, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 99, datë 31.12.2021.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

- Nga ana e anëtarëve të komisionit të blerjeve me vlerë të vogla nuk është mbajtur proces verbali mbi përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike;
- Nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, nuk dokumentohet studimi tregut dhe as kontratat e mëparshme;
- Anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve të vogla nuk kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit;
- Komisioni i blerjeve të vogla nuk ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim;
- AK nuk ka kërkuar paraqitjen e deklaratës së konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;
- AK nuk ka kërkuar nga OE pjesëmarrës që punonjësit e pastrimit të kenë kontratë pune me këta OE;
- AK nuk ka kërkuar që punonjësit e pastrimit të figurojnë në listat e të punësuarve të shoqërisë, për të paktën tre muajt e fundit;
- AK nuk ka përcaktuar kritere/kërkesa të veçanta të specifikimeve teknike për pajisjet dhe detergjentët e pastrimit që do të duhet të ofrojnë OE të kualifikuar dhe të shpallur fitues, për të siguruar cilësinë e shërbimit të kërkuar sipas kërkesave të AK;
- Nga verifikimi rezulton se OE “P.S.” dhe OE “P.A.” janë s’kualifikuar me arsyetimin se kanë tejkaluar vlerën e fondit limit, ndërkohë që ofertat e tyre ekonomike janë përkatësisht 605,000 lekë dhe 609,000 lekë, duke u s’kualifikuar padrejtësisht pasi vlera e fondit limit është 666,666 lekë pa TVSH;
- Në SPE është dokumentuar vetëm s’kualifikimi i OE “D.& C..” me fond limit 605,000 lekë pa TVSH për tërheqje nga gara ndërkohë për OE “M.-M.” me fond limit 624,000 lekë pa TVSH dhe OE “EB” me fond limit 624,520 lekë pa TVSH nuk dokumentohet s’kualifikimi i tyre. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim;
- Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë AEE të OE “B.S..” i shpallur fitues konstatohet se mungojnë:
 - Vërtetimi për xhiron vjetore të vitit të fundit, lëshuar nga administrata tatimore;
 - Vërtetimi se O.E nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv);
 - Vërtetimi se O.E nuk është dënues për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP;
 - Vërtetimi se OE nuk është dënues me vendim gjykate të formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
 - Vërtetimi se O.E ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
 - Deklarata së konfliktit të interesit;
 - Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave;
- AEE, në kushtet e mosplotësimit të kritereve të vendosura në ftesën për ofertë ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE, në kushtet e mosplotësimit të kritereve të kërkuara nga AK. Komisioni i blerjeve të vogla duhej të s’kualifikonte OE të renditur i pari dhe të shpallte fitues OE pasardhës.
- Nuk administrohet Urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim;
- Fatura tatimore nr. 182/2021, datë 29.10.2021 në vlerën 645,612 lekë me TVSH për kryerjen e shërbimit është likuiduar më datë 28.12.2021 për shërbimin e kryer më 18 Janar-31 Tetor 2021, pra me vonesë duke sjellë risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:

-neni 27, pikat 3 dhe 5, 59, neni 61, pika 2, neni 64, pika 2, neni 66, pika 3, neni 68,

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat nr. 42 dhe 43, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 5 dhe pika 17, Kontrata nr. 341/4 prot., datë 18.01.2021, pika 15.4 dhe 16.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarët e AK z. E.B. dhe z. E.D. si dhe anëtarët e KPVV znj. B.M., znj. K.T. dhe znj. A.K.

Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Materiale Pastrimi”, viti 2022.

Kërkesa për blerjen e materialeve është bërë nga znj. A.C. dhe znj. D.K. sipas shkresës së administruar në AEE me nr. 697 Prot., datë 01.04.2022. Nga Anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogla është mbajtur proces verbal mbi përllogaritjen e fondit limit me shkresë nr. 697/1 Prot., datë 01.04.2022, ku vlera e fondit limit është 469,467 lekë pa TVSH, i përllogaritur nga studimi i tregut mbi bazë të ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (“E..”, “A..”, “XH..”). Nga ana e Titullarit është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 712, datë 04.04.2022 për blerjen e materialeve të pastrimit me përbërje të grupit znj. B.M., z. F.D. dhe znj. D.K.. Ftesa për ofertë është bërë sipas shkresës me nr. 712/1 Prot., datë 04.04.2022. Referuar proces verbalit të komisionit të blerjeve të vogla në këtë procedurë kanë shprehur interes 30 Operatorë Ekonomikë. Në datën 06.04.2022, në SPE është shpallur fitues OE “XH... GROUP” me vlerë të ofertës 284,400 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 712/3 Prot., datë 07.04.2022 ka mbajtur procesverbalin për s’kualifikimin e tij për arsye se disa prej produkteve kryesore nuk plotësonin specifikimet teknike të kërkuara. Nuk dokumentohet arsyeja e mospërputhjes së specifikimeve teknike për produktet e sjella nga OE. Në datën 08.04.2022, në SPE është shpallur fitues OE “B. L.” me vlerë të ofertës 287,000 lekë pa TVSH, për të cilin KPVV me shkresën nr. 712/4 Prot., datë 11.04.2022, ka mbajtur procesverbalin për s’kualifikimin e tij për arsye se OE është tërhequr. Referuar procesverbalit të komisionit të vlerësimit me shkresën nr. 712/5, datë 14.04.2022, është shpallur fitues OE “M.V.” me vlerë të ofertës 288,570 lekë pa TVSH AK ka lidhur me këtë OE kontratën nr. 712/6 datë 15.04.2022. Në procesverbalin e mbajtur me shkresën nr. 712/7 datë 20.04.2022, për marrjen në dorëzim të mallit, KPVV është shprehur se materialet e pastrimit janë sjellë sipas sasisë dhe specifikimeve teknike, duke përcaktuar dhe renditur të gjitha produktet e sjella nga OE. Në vijim, fatura tatimore nr. 43, datë 20.04.2022, në vlerën 346,284 lekë me TVSH është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 44, datë 26.04.2022 dhe Fletë -Hyrja për sasi të produkteve dhe çmimeve përkatëse të tyre mban nr. 04.20.04.2022. Sipas Ditarit të Fletë -Daljeve të Magazinës për Vitin 2022, kjo sasi produktesh është bërë dalje.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

- Në urdhrin e prokurimit është përfshirë fondi limit;
- Nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla;
- Nuk është hartuar procesverbal mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga KPVV;

- Në Sistemin Prokurimit Elektronik të APP-së është publikuar ftesa për ofertë por bashkëlidhur saj nuk është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim;
- AK nuk ka kërkuar paraqitjen e deklaratës së konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;
- AK nuk ka kërkuar kërkuar mostër për secilin produkt pastrimi për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike;
- AK nuk ka kërkuar pajisjen e OE me certifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente me të;
- Dokumentacioni i administruar në dosje i OE fitues nuk rezulton të jetë protokolluar dhe sjellë pranë AK brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*:

- Neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Neni 73, pika 4, Neni 78, pika 2, Neni 84, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar Pikat nr. 42 dhe 43, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, *“Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, pika 8, Pika 11, 17.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E.D. si dhe anëtarët e KPVV znj. B.M., z. F.D. dhe znj. D. K.

Për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje tonera printeri” 2023.

Me urdhër nr. 3 me nr. 3 Prot., datë 05.01.2023 është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV) me përbërje z. O. I., z. F.D. dhe znj. D.K. Kërkesa për blerje tonera printeri është bërë me shkresën nr. 525 Prot., datë 20.10.2023 nga znj. Xh.S., specialiste e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve. Me shkresën nr. 525/1 datë 23.10.2023, KPVV ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku vlera e fondit limit është 375,000 lekë pa TVSH, përllogaritur nga studimi i tregut mbi bazë të 3 ofertave nga operatorë ekonomikë të ndryshëm (administruar ofertat nga operatorë ekonomikë “C..”, “I. O”, “Gj. K”). Urdhri i Prokurimit nr. 89, ka nr. 525/2 Prot., datë 23.10.2023, “Blerje tonera printer”, me përbërje z. O.I., z. F.D. dhe znj. D.K. Më datë 24.10.2023 është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, nga KPVV, si dhe bashkëlidhur ftesa për ofertë nr. 525/3 datë 24.10.2023. Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje z. O.I., z. F.D. znj. D.K.. Më datë 25.10.2023, nga KPVV, referuar klasifikimit përfundimtar në SPE, kanë shprehur interes 26 operatorë ekonomikë. Janë s’kualifikuar 2 OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit, konkretisht:

OE “C...” në vlerën 434,000 lekë pa TVSH

OE “B.T...” 378,900 lekë pa TVSH .

-OE “IT Gj.K...” i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 187,500 lekë pa TVSH, është njoftuar në datë 25.10.2023 nëpërmjet SPE, si dhe me shkresë nr. 525/5 datë 30.10.2023 “Formulari i Njoftimit i Fituesit”.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

Nga auditimi i dokumentacionit i sipërcituar rezultojnë mangësitë si më poshtë:

- Në urdhrin e prokurimit është përfshirë fondi limit;

- Nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla;

- AK nuk ka kërkuar deklarata të konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;

- AK nuk ka kërkuar deklarata mbi gjendjen gjyqësore;

- AK nuk ka kërkuar certifikatë ISO për të siguruar cilësinë e mallit të prokuruar;

- AK nuk ka përcaktuar qartë procedurën për dorëzimin e mostrave të mallit të kërkuar;

- Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në pikën 4 nga AK është kërkuar që *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e kërkuara në ftesën për ofertë dhe dokumentacionin për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike”*, ndërkohë edhe në ftesën për ofertë, pika 8 është kërkuar *“një mostër të secilit model të tonerave të kërkuara më sipër”*. Në fakti, nuk dokumentohet që OE të ketë dorëzuar një mostër të secilit model të tonerave të kërkuar nga AK si më lart përmendur, si dhe nuk është administruar as kthimi i mostrave të ofertuesi, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës. Në kushtet kur, nga OE shpallur fitues nuk janë plotësuar kriteret e vendosura nga AK sipas ftesës për ofertë, KPVV duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij. Në lidhje me zbatimin e kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 526/6 Prot., datë 07.11.2023 mes AK dhe OE fitues IT Gj.K. rezulton se nuk administrohet urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim. Marrja e mallit është kryer nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV).

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr. 4413, datë 10.11.2023, në vlerën 225,000 lekë me TVSH, ku është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 218, datë 21.11.2023, në Raiffeisen Bank. Në procesverbalin e mbajtur sipas shkresës me nr. 525/7 Prot., datë 10.11.2023, për marrjen në dorëzim të mallit, KPVV është shprehur se tonerat janë sjellë sipas sasisë dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në kërkesën dhe ftesën për ofertë, pa përcaktuar dhe renditur të gjitha specifikimet e mallit, ku ndër të tjera tonerat duhet të jenë origjinalë, me paketim origjinal dhe të mbyllura nga prodhuesi. Lidhur me këtë konstatim, nga grupi i auditimit është mbajtur Akt Verifikim nr. 1 datë 24.01.2024, mbi tonerat e marra në dorëzim nga AK. Konkretisht sipas fletë hyrjes nr. 07 datë 10.11.2023, kanë hyrë 10 tonera HP sipas kodeve përkatës të tonerave, nga të cilat janë bërë dalje 3 të tilla sipas fletë daljes nr. 50 datë 10.11.2023 (nga 1 copë për secilin kod). Pra, rezultojnë të jenë gjendje 7 tonera, nga të cilat 4 rezultojnë të jenë origjinale, ndërsa 3 të tjerë, në shumën 20,925 lekë, nuk janë origjinale.

Vlera e tonerave si më lart, në shumën 20,925 lekë me TVSH, do të konsiderohet shpenzim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Veprimet dhe mosverimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Neni 73, pika 4, Neni 82, pika 2, Udhëzimi nr. 2 datë 02.05.2019 *“Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE”* të APP, pikat 2, 3 dhe 4, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, pikat nr. 42, 43, 45,47, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, *“Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, pika 8.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. A.H. si dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël z. O.I., z. F.D. dhe znj. D.K.

Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mobilje zyre”, viti 2023.

Me Urdhrin nr. 3, datë 05.01.2023 është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV), me përbërje z. O.I., z. F.D. dhe znj. D.K. Kërkesa për blerjen e mobiljeve është bërë për nevoja të arkivimit të dokumenatcionit me shkresën nr. 478 të datës 11.09.2023 nga z. M.K. me pozicion specialist pranë Sektorit të Programeve të Eficencës dhe Analizës si dhe znj. B.M. me pozicion specialistë pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Me shkresën nr. 478/1 Prot., datë 04.10.2023, KPVV ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku vlera e fondit limit është 375,000 lekë pa TVSH, përlllogaritur ky nga studimi i tregut mbi bazën e 3 ofertave nga operatorë ekonomikë të ndryshëm (“A...”, “N.. A..”, “A C..”). Në vijim të sa më sipër është hartuar Urdhri i prokurimit me object “Blerje mobilje zyre” i cili mban nr. 86 dhe ka nr. 478/2 Prot., datë 16.10.2023, ka përcaktuar në përbërje z. O.I., z.F.D. dhe znj. D.K. Vlerësimi i ofertave është realizuar nga KPVV ku referuar klasifikimit përfundimtar në SPE rezulton si më poshtë. Në datën 18.05.2022, nga KPVV, referuar klasifikimit përfundimtar në SPE, kanë paraqitur interes 33 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s’kualifikuar për arsye se kanë ofertuar me vlerë mbi fondin OE si më poshtë:

OE “E..K.”.

OE “I.B”.

OE “H.”..

OE “G...XH.”

Gjithashtu, është s’kualifikuar për arsye se ka ofertuar nën 50 % të fondit limit OE “D.A.” dhe janë s’kualifikuar OE për arsye parashikuar në pikën 15/a të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 të APP, konkretisht:

OE “E.G”.

OE “J.T”

OE “A.K”.

OE “S.G”.

Në datën 18.10.2023, në SPE është shpallur fitues OE “E” me fond limit 187, 500 lekë pa TVSH dhe me shkresë nr. 478/5 Prot., datë 23.10.2023 “Formulari i Njoftimit i Fituesit”. OE “E...” ka lëshuar faturën tatimore nr. 25, datë 03.11.2023, në vlerën 225,000 lekë me TVSH, ku është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 226, datë 04.12.2023.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

-AK nuk ka kërkuar deklaratë të konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;

-AK nuk ka kërkuar katalog për mallin që prokurohet, apo certifikatë lidhur me cilësinë e materialeve që do të përdoren;

- Nga verifikimi në QKB, konstatohet se: O.E “A.C.” dhe “N. A..” nuk kanë si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit e për rrjedhojë marrja e ofertës ekonomike për një mall të caktuar nga subjekte si më sipër nuk garanton çmimin real të ofruar nga këto subjekte;

- Nuk administrohet urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim; Marrja e mallit është kryer nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 12 pika 4 dhe neni 13 dhe neni 76, Neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Neni 73, pika 4.

Në urdhrin e prokurimit është përfshirë edhe fondi limit, në mospërputhje me pikën 8 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat nr. 42 dhe 43.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. A.H. si dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël z. O.I., z. F.D. dhe znj. D.K.

Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale kancelarie”, viti 2023.

Me Urdhrin nr. 3, datë 05.01.2023 është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV) me përbërje z. O. I., z. F. D. dhe znj. D. K. Kërkesa për blerjen e materialeve të kancelarisë është bërë me shkresën nr. 406 e datës 10.07.2023, nga specialistja znj. V. Gj. e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Me shkresën nr. 406/1 Prot., datë 17.07.2023, KPVV ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku vlera e fondit limit është 541,667 lekë pa TVSH, përllogaritur nga studimi i tregut mbi bazë të ofertave nga 3 operatorë ekonomikë të ndryshëm (“C. & C. C”, “I. O”, “Gj. K.”). Urdhri i Prokurimit me nr. 406/2, datë 19.07.2023, “Blerje materiale kancelarie”, kë përcaktuar në përbërje z. O. I., z. F. D. dhe znj. D. K. Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni si më sipër dhe në datën 21.07.2023, nga KPVV, referuar klasifikimit përfundimtar në SPE, kanë paraqitur interes 13 operatorë ekonomikë. Nga këta janë s’kualifikuar OE për arsye se kanë ofertuar me vlerën mbi fondin limit:

OE “M. B”.

OE “M. LI”.

Është s’kualifikuar OE për arsye se kanë ofertuar nën 50% të fondit limit:

OE. “A.”

Në datën 21.07.2023, në SPE është shpallur fitues OE “I. O.” me vlerë të ofertës 447,000 lekë pa TVSH dhe me shkresën nr. 406/5 datë 27.07.2023 është bërë njoftimit i fituesit. Kontrata me OE fitues “I.O.” është lidhur sipas aktit me nr. 406/6 datë 28.07.2023 dhe pas lëshimit të faturës tatimore nr.10660, datë 02.08.2023, në vlerën 536,000 lekë me TVSH, është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr.161, datë 25.08.2023.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:

- AK nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit për OE pjesëmarrës;
- AK nuk ka kërkuar mostër për letrën A4 për të cilën janë përcaktuar specifikime teknike të detajuara në ftesën për ofertë;
- AK nuk ka përcaktuar certifikata ISO për cilësinë e letrës (kodi përkatës);
- Në urdhrin e prokurimit është përfshirë edhe fondi limit;
- Nuk administrohet urdhri i Titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim; Marrja e mallit është kryer nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV).

Veprimet dhe mosverimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:

- Neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat nr. 42 dhe 43.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK Titullari z. A.H. si dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël znj. B.M., z. F.D. dhe z. D. K.

2.6. Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Zbatimi i legjisllacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve (me vlera të larta).

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 1043/1 Prot., datë 29.12.2023, “Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve”, u shqyrtua dokumentacioni shkresor i vënë në dispozicioni nga ana e Agjencisë për Eficencën e Energjisë, si dhe dokumentacioni elektronik i disponueshëm nga sistemi i prokurimit elektronik në faqen e APP.

Për periudhën e auditimit 2019-2023, Agjencia për Eficencën e Energjisë ka zhvilluar 23 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 853,252,095 lekë pa TVSH. Bazuar në vlerësimin e riskut, janë përzgjedhur për auditim 17 procedura, me vlerë të fondit limit 641,537,358 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 614,590,099 lekë pa TVSH. Procedurat e audituara, në numër përbëjnë 74% të procedurave të zhvilluara, ndërsa në vlerë 72% të tyre.

Në mënyrë të detajuar në vijim janë procedurat e audituara, ndërsa rregjistri i realizimit të prokurimeve me vlera të larta, si dhe procedurat e audituara, paraqiten në aneksin Nr.1, seksioni me emërtimin “Anekse, në fund të Raportit të Auditimit.

Procedurat e zhvilluara në vitin 2021

Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza).

Projekti konsiston në zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e disa pompave të UKD dhe përmirësimin e sistemit SKADA.

1.Urdher Prokurimi: nr.308/4 Prot., date 24.12.2020	3.Hartuesit e dokumenteve te tenderit: Urdhër nr. 308/1 Prot., date 17.12.2020	4.Komisioni I Vlerësimit te Ofertave. A.M. O. I. A.K.
2.Iloji I Procedurës: E hapur	B. A. K. T. B. M.	
5.Fondi Limit (pa TVSH) 54,166,667 leke	6.Oferta fituese (pa TVSH) 52,000,000 lekë BOE “V.. E-A, H- c.”	7.Diferenca me Fondin Limit (pa TVSH) 2,166,667 leke
8.Data e hapjes tenderit Datë 27.01.2021	9.Burimet e financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender. 2 (dy) b)S’kualifikuar. asnjë c)Kualifikuar. 2 (dy)
11.Ankimime: AK. S’ka; APP. S’ka; KPP s’ka	12.Pergjigje Ankesës nga AK S’ka	13.Pergjigje Ankesës nga APP apo KKP: S’ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e Kontratës nr.308/11 Prot., date 11.03.2021	15.Vlera e Kontratës 62,400,000 lekë me TVSH	16. Kohëzgjatja e kontratës 5 muaj

Autoriteti Kontraktor AEE, ka nisur procedurën e prokurimi me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me kërkesën e Shoqërisë Ujësllës Kanalizime Durrës, kërkesë e bërë me shkresën Nr. 2930 Prot., datë 15.12.2020 (të dhëna të UKD), protokolluar në AEE me nr.320 Prot., datë 17.12.2020, por pa kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Ujësllës Kanalizime dhe Mbetjeve te Ngurta (AKUM-it), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar nga AEE. Kjo agjenci (AKUM-i) është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësllës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, dhe ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësllës – kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet

sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor, përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Gjithashtu AEE ka kryer këtë investim në kushtet e mos bashkëpunimit me AKUM-in dhe si rezultat në mungesë të një informacioni të nevojshëm për njohjen e gjendjes së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në vend, mbi bazën e të cilit duhet të ishin përcaktuar dhe entitetet e UK që kanë nevojë më emergjente për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Nuk ka dokumentacion që të shpjegojë se mbi bazën e kujt kritereve AAE përzgjedhi UK Durrës për kryerjen e këtij investimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: ligjin 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, neni 24, 25, ligjin nr.431, datë 11.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, neni 3, 10, 12. *AEE ka planifikuar dhe prokuruar një investim i cili konsistonte vetëm në zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e disa pompave të UKD dhe përmirësimin e sistemit SKADA, duke planifikuar dhe realizuar këtë procedurë të hapur prokurimi në mungesë të kërkesës nga AKUM.*

Në VKM nr.431, datë 11.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, në pikën 3 dhe 10 përcaktohet se:

AKUM-i është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim.

AKUM-i ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës – kanalizimeve, **trajtimin e ujërave të ndotura** dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas pikës 3, të këtij vendimi, deri sa ndërmarjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione. **Në pikën 12** të vendimit, përcaktohet se: AKUM-i, nëpërmjet autoritetit të tij ligjor e teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor. AKUM-i mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve.

Në nenin 13 pika c të vendimit, përcaktohet se, AKUM-i:

Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të **trajtimit të ujërave të ndotura** (ITUN).....

Në pikën d, të nenit 13, përcaktohet se, AKUM-i:

Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuar për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, **të trajtimit të ujërave të ndotura...**

-Referuar VKM nr.852 datë 07.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë për efikasitetin e energjisë” pika III/e. Përgjegjësitë dhe detyrat e AEE, përcaktohet se: **e.** Të vlerësoj teknikisht projektet e investimeve në fushën e efikasitetit të energjisë, të paraqitura pranë Fondit të Efikasitetit nga subjektet e interesuara.

Referuar ligjit 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, në nenin 25, pika ç, të tij përcaktohet:

Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efikasitetin e energjisë dhe ka detyrat e mëposhtme:

ç. të bashkëpunojë me autoritetet qendrore dhe vendore, shoqëritë që operojnë në objektet industriale dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e bazës së nevojshme të të dhënave të energjisë, përfshirë llogaritjen e treguesve të efikasitetit të energjisë, si dhe për zbatimin e masave për nxitjen e efikasitetit të energjisë;

Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK të AEE z. E. B. i cili ka qenë në këtë detyrë prej 04.10.2019 deri më 22.06.2021.

-Me urdhër nr.308 datë 11.12.2020, titullari i institucionit z. E. B. ka ngarkuar komisionin e përbërë nga K. T., B. M. dhe B.A. të hartojnë DST për procedurën e prokurimit “Projekt pilot për përmirësimin e Efikasitetit të Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”

-Njësia e prokurimit në zbatim të urdhrin nr.308 datë 11.12.2020, bashkëlidhur procesverbalit nr. 308/1 Prot., datë 17.12.2020 ka hartua dhe paraqitur termat e referencës për këtë procedurë.

2.3.1 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
N.P – 1A Punime gërmimi në tokë.
N.P. – 2A Ndërtime civile dhe industriale
N.P – 7B Ujssjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P – 10A Ndërtimi i impiantëve për prodhimin e energjisë elektrike.
N.P – 11A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
N.S – 14A Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
N.S – 17B. Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
N.S – 18A Punime topogjeodezik

Operatori Ekonomik duhet të ketë dhe të paraqesë certifikatat vijuese të vlefshme ISO:

- i. Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001: 2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit. (e vlefshme ose ekuivalente)
- ii. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001: 20018 / ose BS OHSAS 18001: 2013, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit. (e vlefshme ose ekuivalente)
- iii. Certifikata për kërkesat e cilësisë për saldimin me saldim të materialeve metalike, ISO 3834: 2006 (e vlefshme ose ekuivalente)
- iv. Certifikatë për menaxhim të energjisë ISO 50001-2012 e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit. (e vlefshme ose ekuivalente).

Operatori ekonomik i tenderit duhet të jetë i licencuar nga Kodi III.2.A i Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Për auditimin mjedisor dhe ndikimin në mjedis

Për produktet e mëposhtëm, në rastet kur operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet të vërtetojë me njëautorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalentin e saj) e cila tregon marrëdhëniet midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ndërmjet ofertuesit-shpërndarësit te autorizuar, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhënat e plota si: telefoni, posta elektronike, faqja e internetit, etj., kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktues në rast të verifikimit, si dhe dokumentet teknike (prospektet teknike, katalogu, etj.) duhet të përkthehen në ato pjesë që pasqyrojnë kërkesat teknike të specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Pajisjet duhet

te shoqërohen me certifikata konformiteti dhe cilësie për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.

- F.V. Pompa hidraulike për ujësjellësa
- F.V. Panele fotovoltaik për prodhim energjie elektrike.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë licensë projektimit ose të kontraktojë me një shoqëri projektuese të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 ” *Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*”.

Licensa e projektimit duhet të ketë kategorite si me poshtë :

Kat. 4.a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

Kat. 4.c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

Kat. 4.g - Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

Kat. 8.a - Rilevime inxhinierike.

Kat. 10.a - Projektim centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare).

Kat. 10.c - Projektim impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era, etj.

Kat. 10.e - Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

Kat. 14 - Studime e projekte të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujrave të zeza.

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që në preventiv nuk përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndriçuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat nuk kërkojnë pajisjen me licensat përkatëse si:

Kat. 10.e - Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm, e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A

Gjithashtu në lidhje me licensat e projektimit është kërkuar licensa Kat. 4.a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK nuk duhej të kishte kërkuar licensën e mësipërme.

2.3.3 Staf

a. Staf Kryesor

1 (një) *Inxhinier hidroteknik*

1 (një) *Inxhinier elektrik*

1 (një) *Inxhinier mekanik*

1 (një) *Inxhinier topograf/gjeodet/markshaidër*

1 (një) *Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në instalime industriale)*

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që nuk është i nevojshëm pjesëmarrja e inxhinierit mekanik në mbulimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

b. Staf Ndihmës

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit ndihmës të shoqërisë ose të kontraktuar me marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme:

1 Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë në instalime industriale).

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira:

- Pajisje GPS

c. Staf kryesor të inxhinierëve

1 (një) *Inxhinier hidroteknik*

1 (një) *Inxhinier elektrik*

1 (një) Inxhinier elektronik

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier gjeodet/markshaidertopograf

1 (një) Menaxher energjie (i certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, për Menaxhim Energjie)

d. Operatorët ekonomikë për realizimin e shërbimit duhet të paraqesin stafin ndihmës si më poshtë:

• Operatori ekonomik të ketë punësuar si pjesë e stafit një *ekspert të zjarrfikësve*.

• Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit “*Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”.

• Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen emergjente*” .

• Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë “*Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit*” .

• Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*”.

e. Operatori ekonomik duhet të paraqes në stafin e tij punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit dhe sigurisë teknike nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe dëshmi të kualifikimit profesional / diplomës / certifikatës së trajnimit, ku nga këto janë të paktën;

- 1 Teknik ndërtimi

- 2 Specialist hidraulik

- 2 Specialist elektrikist

f. Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 10 punonjës të punësuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin e kontratës si më poshtë.

a) Mjetet dhe pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike do të paraqiten këto dokumente:

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1 - 5 ton – 1 copë

Minieskavatore – 1 copë

Pirun ngritës me kapacitet ngritës deri ne 3.5 ton – 1 copë

Saldatrice – 1 copë

Afatet kohore të realizimit të këtij projekti pilot sipas termave të referencës janë:

▪ Hartimi i raportit paraprak të auditimit: **30 ditë kalendarike**

▪ Hartimi i projekt idesë dhe projekt zbatimit: **30 ditë kalendarike**

▪ Zbatimi i punimeve të ndërtimit: **60 ditë kalendarike**

▪ Hartimi i raportit përfundimtar të auditimit të energjisë, shoqëruar me nxjerrjen e certifikatës së performancës së energjisë: **30 ditë kalendarike.**

Për përlllogaritjen e Fondit Limit, AK AEE i ka dërguar ftesë për ofertë me shkresën nr. 183/6 Prot., datë 02.09.2020 shoqërisë “A..”,

Nr.183/7 Prot., datë 02.09.2020 shoqërisë “A.I.”, dhe Nr.183/8 Prot., datë 02.09.2020 shoqërisë “M...”.

Njësia e prokurimit mbi bazën e ofertave të marra siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, ka bërë përllogaritjen e fondit limit për procedurën e hapur “Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” në shumën **55,000,000 leke pa TVSH**

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike leke (Pa TVSH)	Oferta ekonomike mesatare leke (pa TVSH)
1	“A ..-I”	56,000,000	55,000,000
2	“M..”	59,000,000	
3	“A..”	50,000,000	

-Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit nr.308/4 Prot., datë 24.12.2020 për procedurën e hapur me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” me Fond Limit 54,166,667 leke pa TVSH, e cila tregon se nuk është referuar vlerës së përllogaritur nga komisioni i ngritur për përllogaritjen e Fondit Limit në shumën 55,000,000 lekë.

Parregullsitë e mësipërme në hartimin e kriteve të dokumenteve të tenderit janë në janë në kundërshtim me:

- pikën 2, të nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar,

- pikës 2, të nenit 28 (Kontrata e shërbimeve), të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Këto parregullsi ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga z. B. A., me detyrë ish përgjegjës i Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 09.03.2022, znj. K.T. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, B. M., juriste, me detyrë specialiste e Shërbimeve Mbështetëse.

Vlerësimi i KVO

Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga A.M., A. K. dhe O.I. i ngritur me urdhrin nr.308/5 date 05.01.2021 të titullarit të AK z. E.B.

Sipas proces verbalit nr. 373 Prot., datë 28.01.2021, të KVO në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) OE:

1.”A...” me ofertë ekonomike **52,162,500 lekë pa TVSH**

2.BOE “V-k, E-A, H – c” me ofertën ekonomike **52,000,000 leke pa TVSH.**

BOE “V-k, E-A, H–c” është njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit me në.308/7 Prot., datë 11.02.2021.

Referuar raportit përmbledhës të KVO, nr. 308/9 Prot., datë 12.02.2021 i miratuar nga titullari i AK z.E.B., të dy OE pjesëmarrës janë kualifikuar pasi sipas KVO këta OE kanë plotësuar kërkesat dhe kriteret e AK të paraqitura në DST, dhe mbi bazën e kriterit të vlerësimit të çmimit më të ulët, KVO ka shpallur fitues BOE “V-k, E-A, H–c” me ofertën **52,000,000 leke pa TVSH.**

Pas njoftimit të fituesit, BOE “V-k, E-A, H–c” ka përcjellë pranë AK AEE dokumentacionin e shkruar (hard Copy) me nr. Prot., hyrës në AEE nr.308/8 Prot., datë 12.02.2021, OE i shpallur fitues më datë 12.02.2021 ka bërë sigurimin e kontratës në shumën 6,240,000 lekë

Kriteret e veçanta:

Në DST, në kriterin 2.3.3/b “Stafi Ndhmës” në DST është kërkuar që :

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit ndihmës të shoqërisë ose të kontraktuar me marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme:

1. Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Eficences e Energjisë në instalime industriale).

Për audituesin energjetik, duhet të paraqiten këto dokumente provues:

- Certifikata individuale, Kontrata e punës e vlefshme ose marrëveshja e bashkëpunimit me objekt të njëjtë me objektin e kontratës të procedurës së mësipërme.

Nga auditimi në SPE konstatohet se:

1. BOE “V-k, E-A, H-c” nuk plotëson kriterin 2.3.3/b në lidhje me audituesit energjetik të certifikuar nga agjencia e Energjisë për instalimet industriale, duke mos paraqitur certifikatën individuale, kontratën e punës, CV dhe përfshirjen në listë pagesën për çdo muaj për periudhën Qershor -Nëntor 2020 të një audituesi energjetik. Këtë kriter nuk e plotëson OE V- k dhe OE E-A.

2. BOE, nuk plotëson kriterin 2.3.3/c pika 6 nuk pasi nuk ka paraqitur menaxher të energjisë të certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë.

Në DST është kërkuar që për stafin e menaxherit të Energjisë (pika 6) duhet të paraqitet lista e pagave të kompanisë.

3. BOE, nuk plotëson kriterin 2.3.3 pika d, ku kërkohet që:

- Operatori ekonomik të ketë punësuar si pjesë e stafit një *ekspert të zjarrfikësve* të shoqëruar nga: kontrata e punës e vlefshme, leja për ushtrimin e profesionit të ekspertit të zjarrfikësve të lëshuar nga institucionet përkatëse për sigurimin e asistencës teknike dhe trajnimin e punonjësve për masat e MNZ, për t'u paraqitur në lista e pagave të kompanisë për periudhën qershor 2020 - nëntor 2020

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit “*Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”, e vërtetuar nga një kontratë e punës e vlefshme si dhe të paraqitet në listën e pagave të ndërmarrjes për 6 muajt e fundit.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 (një) individ të pajisur me një certifikatë “*Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit*” të vërtetuar nga një kontratë e punës e vlefshme.

4. BOE, nuk plotëson kriterin 2.3.1 pika d ku parashikohet se:

*Për produktet e mëposhtme, në rastet kur operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet të vërtetojë me një autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalentin e saj) e cila tregon marrëdhëniet midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ndërmjet ofertuesit-shpërndarësit të autorizuar, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhënat e plota si: telefoni, posta elektronike, faqja e internetit, etj., kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktues në rast të verifikimit, si dhe dokumentet teknike (prospektet teknike, **katalogu**, etj.) duhet të përkthehen në ato pjesë që pasqyrojnë kërkesat teknike të specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Pajisjet duhet të shoqërohen me certifikata konformiteti dhe cilësie për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.*

F.V. Panele fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike.

Në kushtet e mosplotësimin të disa kriterëve, KVO duhej të s’kualifikonte BOE “V-k, E-A, H-c” gjithashtu nga auditimi në SPE të OE “A.”, konstatohet se ky OE nuk plotëson kriterin 2.3.3/b stafi ndihmës, pasi nuk ka të punësuar si pjesë të stafit ndihmës të shoqërisë ose të kontraktuar me marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme, 1 (një) auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Eficences e Energjisë në instalime industriale).

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO:

z. A.M, me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike të AEE, znj. A. K. me detyrë ish përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit të Programeve të Eficencës dhe Analizës në AEE, pezulluar nga detyra me shkresën nr. 4917/1, datë 18.06.2021, z. O. I, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike, të cilët kanë vepruar në kundërshtim me:

Nga KVO është vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;

- nenin 55, ku thuhet: “Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, **plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët.**

Kontrata e zbatimit

Për objektin “**Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza**”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis AEE dhe BOE “V- K” SHPK & “E-A” SHPK & “H.C.” SHPK me Nr. 308/11 Prot., datë 11.03.2021.*

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*

- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

- *Etj.*

2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis AEE dhe BOE “L. C.” SHPK & “K-P.” SHPK & “G.-A.” SHPK & “N-G.” SHPK me Nr.316/14 Prot., datë 06.05.2021.*

- *Korrespondencat mes AEE dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin B. “L C.” SHPK & “K-P.” SHPK & “G- A” SHPK & “N-G” SHPK etj.*

Kontratrat

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike me Nr.308/11 Prot., datë 11.03.2021 me objekt “*Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza*” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor AEE, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. E. B. dhe B.. “V.-K.” SHPK & “E.-A.” SHPK & “H. C.” SHPK të përfaqësuar nga administratorët z. Gj. B., z. B.M. dhe z. G.P. me licenca profesionale përkatësisht NZ.4933/11, NZ.3279/15 dhe N.6724/7. Vlera e kontratës është 52,000,000 lekë pa TVSH ose 62,400,000 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.316/14 Prot., datë 06.05.2021 me BOE.. “L. C.” SHPK & “K.-P.” SHPK & “G.-A.” SHPK & “N.-G.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh përkatësisht, MK.3336, MK.2533/5, MK.2703/10 dhe MK.3101/8, si dhe me vlerë të kontratës 1,280,000 lekë pa TVSH ose 1,536,000 lekë me TVSH. Afati i kësaj kontrate 5 muaj nga data e nënshkrimit të saj.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.1636 Prot., datë 19.08.2021 me OE “U.-S. SHPK me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1707/8 dhe me vlerë të kontratës 40.000 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Kontrata e punimeve është me çelësa në dorë ku është parashikuar të kryhet rehabilitimi i stacioneve të pompimit duke përmirësuar eficientësinë e tyre. Në fillim është hartuar “Raporti paraprak i auditimit të eficientësisë së energjisë” sipas të dhënave të mbledhura nga UK Durrës dhe në bazë të tij është hartuar projekti i zbatimit. Në këtë projekt zbatim është parashikuar ndërimi i gjashtë pompave zhytëse në stacione të ndryshme dhe mirëmbajtja e pompave të tjera duke zëvendësuar pjesë të tyre si elikë, permesto, guarnicion e kuzhineta. Për sistemin elektrik do të zëvendësohen kutitë dhe kabllot e dëmtuar si dhe përmirësimi i sistemit SCADA.

Me shkresën nr.602 Prot., datë 07.04.2021, kontraktuesi ka dorëzuar Raportin paraprak të eficientësisë së energjisë për sistemimin e kanalizimeve të qytetit të Durrësit dhe projekt zbatimin dhe projekt idenë me numër hyrës në protokollin e AEE nr. 602/1 Prot., date 07.04.2021 ku ka konsumuar dy fazat e para.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve është data 17.05.2021, kjo sipas njoftimit përkatës të bërë nga sipërmarrësi me shkresën Nr. Extra. Prot., datë 17.05.2021 dhe mbikëqyrësi me shkresën Nr.1 Prot., datë 17.05.2021. Sipas këtyre njoftimeve ka filluar Faza III ajo e zbatimit të punimeve dhe përfundimi i tyre është në data 12.07.2021.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në administruar në dosjen teknike, datë 26.08.2021. Marrja në dorëzim të përkohshëm është kryer me aktin Nr.1710 Prot., datë 30.08.2021.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”.		
14.Lidhja e kontratës Nr.308/11 Prot., datë 11.03.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 62,400,000 lekë BOE “V-K” SHPK & “E-A” SHPK & “H.- C.” SHPK	16.Likuiduar deri datë 03.06.2024 62,400,000 lekë me TVSH
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 52,000,000 lekë -Vlera pa TVSH 62,400,000 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 5 muaj, Zbatuar 5 muaj Fillimi punimeve: 11.03.2021 Përfundimi punimeve: 10.08.2021	19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “L.-C.” SHPK & “K.P.” SHPK & “G.-A.” SHPK & “ N.-G.” SHPK	Licenca Nr: MK.3336 MK.2533/5 MK.2703/10 MK.3101/8	Kontrata Nr.316/14 Prot., datë 06.05.2021
21. Kolaudatori i punimeve “U.-S.” SHPK	Licenca Nr: MK.1707/8	Kontrata Nr.1636 Prot. datë 19.08.2021
22.Akt Kolaudimi datë 26.08.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim Nr.1710 Prot., datë 30.08.2021	

Nga verifikimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar dhe vizitës në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të ShRUK Durrës nuk u konstatuan diferenca në punimet e dukshme. **Dorëzimi i materialeve të çmontuara, pompat, flanxhat, saraqineskat etj. i janë dorëzuar UK Durrës sipas procesverbalit të mbajtur datë 10.07.2021 midis sipërmarrësit të punimeve dhe përfaqësuesve të shoqërisë.**

AEE ka realizuar procedurën e prokurimit dhe zbatimit në vitin 2021 me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e eficientësisë së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” (me çelësa në dorë), në UK D. Nga ana e kontraktorit para fillimit të punimeve është hartuar raporti paraprak i auditimit të eficientësisë së energjisë për stacionet e pompave të ujërave të zeza ku janë kryer ndërhyrjet, zëvendësimi i disa pompave si dhe rehabilitimi i tyre me pjesët ndihmëse.

Në projektin pilot, analiza tekniko ekonomike e pasqyruar i referohet konsumit të pajisjeve të instaluar në çdo stacion me orë pune maksimale dhe pa ndërprerje për 24 orë sipas projektit dhe grafikut të vënies në punë. Konsumi i energjisë elektrike sipas faturave të OSHEE nuk përputhen me faktin pasi të dhënat e paraqitura nga UK Durrës janë me mungesa të theksuara prandaj është zgjedhur konsumi sipas metodës së mësipërme.

Gjithashtu edhe raporti përfundimtar nuk ka të dhëna faktike por ato hipotetike të parashikuara në raportin paraprak. Për të verifikuar se investimi i kryer ja ka arritur qëllimit nga ana e AEE duhet të ishte kërkuar që raporti përfundimtar të kryhej në një periudhë të mëvonshme duke grumbulluar të dhënat faktike.

Nisur nga fakti se të dhënat e pasqyruara për konsumin e energjisë në raportet e auditimit, paraprak dhe përfundimtar janë jo reale dhe nuk mund të gjykohej nëse investimi ja ka arritur qëllimit, ju kërkua AEE të vendosi në dispozicion të dhëna faktike. AEE me shkresën Nr.277/Prot., datë 24.05.2024 i është drejtuar përfituesit UK Durrës për vendosjen në dispozicion të faturave të konsumit të energjisë për vitet 2020-2022 në stacionet ku është kryer investimi. ShRUK Durrës me shkresën Nr.2291/1Prot., datë 31.05.2024 të administruar në AEE me Nr.277/1Prot., Date 31.05.2024, ka përcjellë informacionin e kërkuar ku sqaron se: *“faturimi në vitin 2020 nga ana e OSHEE nuk është kryer në mënyrën e duhur pasi kemi mungesë të theksuar të leximeve të matësive, por në vitin 2021 u bë rakordim i konsumit të munguar gjë e cila pasqyrohet dhe në vlerat e paraqitura në tabelë. Ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 është kryer proces normal i leximit dhe faturimit të energjisë elektrike, duke na venë në dijeni në çdo moment që kryhet leximi”*. Nga të dhënat e SHRUK Durrës konsumi i energjisë për stacionet ku është kryer investimi pasqyrohet për katër vite, 2 para investimit dhe 2 pas investimit.

Viti	2020	2021	2022	2023
Energjia konsumuar (Kv)	2,491,448	3,349,963	2,012,697	1,680,405

SHRUK Durrës thekson se konsumi i energjisë për vitin 2020 nuk është i saktë dhe rakordimet janë kryer në vitin 2021 e për rrjedhojë u analizuan dy vite të marra së bashku para dhe pas investimit. Konsumi i energjisë, për të gjitha stacionet i marrë së bashku, për dy vite para investimit 2020-2021 është 5,841,411 Kv dhe për dy vite pas investimit 2022-2023 është 3,693,102 Kv, ku tregohet se investimi ja ka arritur qëllimit. Nga të dhënat e paraqitura, duke i marrë së bashku për të gjitha stacionet e pompimit, tregohet se investimi ka patur rezultat por duke i analizuar të dhënat e çdo stacioni më vete tregohet se rezultati nuk është ai i pritshëm, konkretisht në stacionet EPS6, EPS2 nuk ka pasur rezultat.

Për sa më sipër, shprehemi me rezervë se investimi ka realizuar pritshmërinë e kërkuara pasi në informacionin për konsumin e energjisë ka mangësi dhe paqartësi të cilat vijnë si rezultat i mos leximit të matësit në mënyrë periodike nga OSHEE dhe konsumi në fund të vitit (nqs se është i pa lexuar në muajt e fundit) mund të kaloj në vitin pasardhës.

- **Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër.**

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

1.Urdher Prokurimi: nr.306/2 Prot., date 05.01.2021	3.Hartuesit e dokumenteve te tenderit: Urdhër nr.306 Prot., date 11/12/2020	4.Komisioni i Vlerësimit te Ofertave.
---	---	--

2. Iloji I Procedurës: E hapur	B. A. K. T. B. M.	A. M. O. I. A.K.
5. Fondi Limit (pa TVSH) 83,333,333 leke	6. Oferta fituese (pa TVSH) 82,499,604.17 leke	7. Diferenca me Fondin Limit (pa TVSH) 833,728.83 leke
8. Data e hapjes tenderit Datë 09.02.2021	9. Burimet e financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender. 3 (tre) b) S'kualifikuar 2 (dy) c) Kualifikuar 1 (një)
11. Ankimim AK Nr.416 Prot., date 17.02.2021	12. Pergjigje Ankesës nga AK Shkresa nr.416/1 Prot. datë 18.02.2021	13. Pergjigje Ankesës nga KPP. Nr. 366 Prot. date 01.03.2021
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e Kontratës nr.306/12 Prot., datë 14.05.2021	15. Vlera e Kontratës 98,999,525 leke me TVSH	16. Kohëzgjatja e kontratës 6 muaj

Burimi i financimit: Fonde të vena në dispozicion Buxheti i Shtetit.

Projekti i zbatimit/Oponenca teknike/leje ndërtimi

Projekti i zbatimit për objektin “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër” është hartuar BOE “I.-K.” SHPK & “H C.” SHPK me nr. licence N.6769/11 në Dhjetor 2020. Grupi i projektimit përbëhet nga: Ing. R.S., Ing. S. M., Ing. G. H., Ing. A T., Ing. D.H., Ing. E.M. dhe Ing. E.K..

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje rezulton se: Nga AK (AEE) projekti i zbatimit me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër” nuk është pajisur me Leje Ndërtimi/infrastrukturore.

Në termat e referencës, pjesë e dokumenteve të tenderit është përcaktuar se:

“Nëse për realizimin e projektit të zbatimit do të nevojitet leje ndërtimi, atëherë i gjithë dokumentacioni i duhur dhe aplikimi për leje ndërtimi do të kryhet nga operatori ekonomik fitues në bashkëpunim me autoritetin kontraktor”.

Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes me Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, në rastin konkret, është kryer në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi, për sa kohë neni 39 i ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton se: “Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji”. Gjithashtu në lidhje me përgjegjësitë për veprime në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar, neni 39, pika 3 e ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton se: “Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit”.

Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, duke rënë ndesh me këtë të fundit. Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar,

ngarkohet me përgjegjësi: Titullari i Autoritetit Kontraktor i AEE z. E.B., i cili ka ushtruar këtë detyrë deri në datën 22.06.2021, mbikëqyrësi, sipërmarrësi dhe zbatuesi i punimeve.

Neni 39 i ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton se: “Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji”.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, në lidhje me procedurën e sipërcituar.

Ky veprim dhe mosveprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, germa (a) për ndërtimet publike, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha”:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivi së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK (AEE).

Miratimi i projektit të zbatimit nga titullari i AEE, në mungesë të oponencës teknike, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”.

Për sa më sipër, referuar pikës 4 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori, që do të thotë se përgjegjësia për mos kryerjen e oponencës teknike është e titullarit të AK, z. E.B.

Hartimi i Fondit Limit

Fondi limit për këtë procedurë është përcaktuar mbi bazën e projektit të zbatimit dhe preventivit në procedurën e zhvilluar në vitin 2020 me objekt “Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City”,” Rruga e Energjisë së Pastër”. Kontraktuesi “Infrakonsult” i shpallur fitues me njoftimin nr.264 Prot., datë 04.11.2020, ka hartuar preventivin e projektit nr.302 Prot., datë 10.12.2020 në vlerën 83,333,333 Lekë pa TVSH, e cila ka shërbyer si fond limit për procedurën “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër”.

Termet e referencës

Titullari i institucionit z. E.B. me urdhrin nr.138 Prot., datë 17.07.2020 ka ngritur grupin e punës së përbërë nga z. B.A, znj. B.M. dhe znj. K.T. për përcaktimin e fondit limit dhe termave të referencës për projektin “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City, rruga e Energjisë së pastër”.

Grupi i punës i sipërcituar, ka hartuar termet e referencës “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër” pasqyruar në proces verbalin nr.138/1 Prot., date 26.08.2020.

Referuar termave të referencës të hartuara nga grupi i punës, është përcaktuar si afat i zbatimit të punimeve afati 6 muaj. Në lidhje me lejen e ndërtimit referuar termave të referencës është parashikuar se gjithë dokumentacioni i duhur dhe aplikimi për leje ndërtimi do të kryhet nga OE fitues në bashkëpunim me autoritetin kontraktor.

Hartimi i DST

Komisioni për hartimin e DST i përbërë nga znj. K.T., znj. B. M. dhe z. B. A. është ngritur me urdhër Nr.306, datë 11.12.2020, të cilët kanë hartuar proces verbalin Nr.306/1 Prot., datë 17.12.2020.

Titullari i AK ka nxjerr urdhrin e prokurimit Nr.306/2, datë 05.01.2021 për procedurën me objekt "Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër", me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH.

Në pikën 2.3.1 të seksionit të kapaciteti teknik dhe profesional, nga njësia e prokurimit është vendosur kriteri

- Referuar projekt preventiv, janë parashikuar punime ndërtimi për bazamentet e pajisjeve dhe për linjat dhe pusetat elektrike, apo punime topografike (në preventivin ofertues përbëjnë 6,402,851 lekë pa TVSH), punime ndërtimi për të cilat nga njësia e prokurimit nuk janë kërkuar licencat profesionale përkatëse që lidhen me këto zëra punimesh (si punime prishje, gërmimi, transporti, betoni, etj.). Sa më sipër, në pikën 2.3.1 të seksionit të kapaciteti teknik dhe profesional, njësia e prokurimit duhet të kishte kërkuar edhe kategoritë përkatëse në licencën e shoqërisë, si "N.S-1; N.S-18, etj.". Kriteret për kategoritë e licencës nuk rezultojnë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Në pikën 2.3 të seksionit të kapaciteti teknik, lidhur me përvoja të mëparshme të suksesshme, nga njësia e prokurimit është vendosur kriteri që *"Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë eksperiencën të mëparshme në Shqipëri për procedurën e miratimit të lidhjes së impiantit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes dhe marrëveshje me OSHEE për: "Marrëveshje e lidhjes së vet prodhuesit të energjisë elektrike nga dielli sipas skemës së matjes neto" . Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kopje të miratimit dhe marrëveshjes dhe një fature mujore lëshuar nga OSHEE sipas skemës së matjes "Neto".*

Vendosja e kriterit të mësipërm lidhur me eksperiencën të mëparshme në Shqipëri për procedurën e miratimit të lidhjes së impiantit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes dhe marrëveshje me OSHEE, është i pa argumentuar teknikisht dhe i panevojshëm, pasi këto janë procedura normale të cilat do të realizohen pas lidhjes së kontratës me AK. Ky kriter është në kundërshtim me pikën 2.c.ç.d të nenin 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku thuhet:

Qëllimi i këtij ligji është:...

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Vendosja e kriterit të mësipërm është i pa argumentuar teknikisht nga njësia e prokurimit, në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të nenit 61 (Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit), të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku thuhet:

1.Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

2.Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

- Në pikat 2.3.3 deri në 2.3.3.6 (Stafi kryesor) nga njësia e prokurimit është vendosur kriteri se: *Stafi kryesor dhe stafi ndihmës, duhet të jetë në listën e pagave të kompanisë për çdo muaj për periudhën janar 2020 - nëntor 2020.... Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;*

- *Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore duke specifikuar numrin e të punësuarve për çdo muaj për periudhën janar 2020 – nëntor 2020.*

- *Lista e pagave të punonjësve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formatit të kërkuar nga ligji në fuqi, për periudhën janar 2020 – nëntor 2020.*

Vendosja e kriterit lidhur me ekzistencën e punonjësve për periudhën 11 mujore janar 2020 – nëntor 2020, është i pa argumentuar, si dhe kriteri i pa nevojshëm, pasi përcaktimi i kësaj përvoje të gjatë të mëparshme në listëprezencë, nuk kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, si dhe nuk është argument që ti shërbej garancisë së realizimit të kontratës. Kuadri ligjor në fuqi, kërkon numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin e kontratës, por nuk kërkon përvojën e tyre të mëparshme në një shoqëri të caktuar. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik dhe për këtë mjafton që OE të vërtetojë qoftë edhe muajin e fundit se ka numrin e nevojshëm të punonjësve të kërkuar. Nuk sjellë asnjë dobi, asnjë ndryshim për autoritetin kontraktor nëse OE vërteton që i ka punonjësit e kërkuar për muajin e fundit, apo për një kohëzgjatje 11 muaj, si është kërkuar në dokumentet e tenderit.

Vendosja e kriterit për afatin 11 mujor, janar 2020 – nëntor 2020, përjashton nga konkurimi operatorë të tjerë ekonomik që mund ti kenë po kaq punonjës por për një periudhë më të vogël kohe dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit me përbërje: B.A., K.T., arkitekte, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, B. M., juriste, me detyrë specialiste e shërbimeve mbështetëse.

Ky kriter është në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): neni 26: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

(LPP, neni 46): *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Për mangësitë e mësipërme të konstatuara në dokumentet e tenderit, mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit me përbërje: z. B.A., inxhinier mekanik, profili energjetik, me detyrë ish përgjegjës i Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës me AEE në datën 09.03.2022, znj. K.T., arkitekte, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, znj. B.M., juriste, me detyrë specialiste e Shërbimeve Mbështetëse.

Vlerësimi i ofertave

Në tender kanë marrë pjesë 3 OE, dy prej të cilëve janë skualifikuar dhe një OE, konkretisht “E...” SHPK është kualifikuar dhe shpallur fitues, sipas tabelës në vijim:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	“R...” SHPK	74,170,706	S’kualifikuar	L52125110A
2	“E...” SHPK	82,499,604	Kualifikuar, fitues	L01808013Q
3	“R...”	Nuk ka paraqitur ofertë	S’kualifikuar	L71502060S

Me urdhrin nr. Nr.306/3, datë 08.01.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z. A. M. (kryetar), znj. A. K. dhe z. O.I., anëtar.

KVO me proces verbalin Nr.306/5 Prot., datë 12.02.2021, ka kualifikuar OE “E..” SHPK me ofertë ekonomike në shumën 82,499,604 lekë dhe ka skualifikuar OE “R.K.” SHPK pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në SPE, si dhe ka skualifikuar OE “R.C.” SHPK për mos plotësim të kriterëve të vendosura në DST.

Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE “R.C.” SHPK me ofertë ekonomike në shumën 74,170,706 lekë.

1. Për dhënie të informacioneve të rreme (në zbatim të nenit 45 dhe 47 të LPP). OE “R.C.” SHPK ka paraqitur dy autorizime nga Solartracking-Germani.de dhe New World Wind për paisjet Smart Flower dhe Wind Tree. Për sa më sipër KVO ka kontaktuar me prodhuesit zyrtar të këtyre dy paisjeve për të verifikuar këto autorizime. Në përgjigjen e tyre ato janë shprehur se kompania “R.C.” nuk ka asnjë autorizim për paisjet e tyre.

2. OE “R.C.” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3 (Kapaciteti teknik) të dokumenteve të tenderit, në të cilin është kërkuar:

2.3.1 *Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

3. OE “R.C.” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3. *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë eksperiencë të mëparshme në Shqipëri për procedurën e miratimit të lidhjes së impiantit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes dhe marrëveshje me OSHEE për: "Marrëveshje e lidhjes së vet prodhuesit të energjisë elektrike nga dielli sipas skemës së matjes neto". Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kopje të miratimit dhe marrëveshjes dhe një fature mujore lëshuar nga OSHEE sipas skemës së matjes "Neto".*

4. OE “R.C.” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3 (Kapaciteti teknik) të dokumenteve të tenderit, në të cilin është kërkuar:

Për produktet e mëposhtme, në rastet kur operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet të vërtetojë me një autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalentin e tyre) e cila tregon marrëdhëniet midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ndërmjet ofertuesit-shpërndarësit të autorizuar, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhënat e plota si: telefoni, posta elektronike, faqja e internetit, etj., kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktues në rast të verifikimit, si dhe dokumentet teknike (prospektet teknike, katalogu, etj.) duhet të përkthehen në ato pjesë që pasqyrojnë kërkesat teknike të specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Pajisjet duhet

te shoqërohen me certifikata konformiteti dhe cilësie për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.

- Furnizim vendosje për kullat e karikimit të makinave elektrike
- Furnizim vendosje për Smart Floëer për prodhim energjie
- Furnizim vendosje për Wind Tree për prodhim energjie
- Furnizim vendosje për PV System (Tree PV) për prodhim energjie

5. OE “R. C.” SHPK është s’kualifikuar nga KVO për mos përmbushje të kriterit 2.3.4 “Mjetet dhe pajisjet teknike”, në të cilin është kërkuar që OE të vërtetojnë se disponojnë mjetet për realizimin e kontratës:

1. Mjet ATP me kapacitet deri ne 3.5 Ton – 2 copë
2. Mjet ATP me kapacitet deri ne 1.2 Ton – 2 copë

Në vijim të këtij kriteri në DST është kërkuar që për mjete të marra me qira, duhet të paraqitet: - kontrata e qirasë, me objekt të njëjtë me objektin e kontratës se procedurës së mësipërme (kontratës që po prokurohet).

KVO është shprehur se OE ka dorëzuar kontrata qiraje për mjetet e kërkuara, por jo me objektin e kontratës që po prokurohet.

Nga auditimi u konstatua se OE “R.C.” SHPK nuk plotëson kriterin për mjetet e kërkuara. Për plotësimin e këtij kriteri prej OE R.C.” SHPK është paraqitur dokumentacion se disponon një kamionçinë me targa AA...YG, me kapacitet 1.1 tonë, si dhe dokumentacion për 4 kamionçina me qira, por kontrata e qirasë nuk ka të përcaktuar si objekt procedurën e prokurimit për të cilin po zhvillohet aktualisht, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në dokumentet e tenderit. Pra ky kriter nuk plotësohet nga OE “R.C.” SHPK.

Nga auditimi u konstatua se OE “R.C.” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3 të seksionit të kapacitetit teknik, ku është kërkuar: *“Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë eksperiencë të mëparshme në Shqipëri për procedurën e miratimit të lidhjes së impiantit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes dhe marrëveshje me OSHEE për: "Marrëveshje e lidhjes së vet prodhuesit të energjisë elektrike nga dielli sipas skemës së matjes neto". Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kopje të miratimit dhe marrëveshjes dhe një fature mujore lëshuar nga OSHEE sipas skemës së matjes "Neto".*

Për përmbushjen e këtij kriteri OE “R.C.” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion, por ka paraqitur deklaratë në të cilën është shprehur se kjo kërkesë nuk duhet të ishte vendosur nga AK, pasi është në kundërshtim me neniun 26, pika 6 të VKM 914 datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për këtë arsye skualifikimi nga KVO i OE “R.C.” SHPK është i drejtë.

Në datën 01.03.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor protokolluar me nr. 366/2 Prot.

Në të njëjtin konkluzion ka arritur dhe KPP me vendimin 153/2021, datë 07.04.2021, pasi ka shqyrtuar ankesën e bërë nga OE “R.C.” SHPK (i cili ka bërë ankesë për këtë qëllim edhe pranë AEE). Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur se ky OE nuk i plotëson kriterin e mësipër 2.3 të seksionit të kapacitetit teknik.

Lidhur me pretendimin e mësipërm të OE “R.C.” SHPK, se nga AK nuk duhet të ishte vendosur kriteri që OE duhet të ketë eksperiencë të mëparshme në Shqipëri për procedurën e miratimit të lidhjes së impiantit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes dhe marrëveshje

me OSHEE..., ky operatorë ka bërë ankesë edhe në KPP, por duke qenë se ankesa është bërë jashtë afateve ligjore, nuk është shqyrtuar prej KPP.

Mbi kualifikimin nga KVO të OE "E.." SHPK

Në aktin e konstatimit grupi i auditimit është shprehur se OE "E.." SHPK nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, për arsye se punonjësit me kontratë nuk i ka në listëpagesë.

Për sa trajtuar më sipër nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 303/1 Prot., datë 07.06.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1043, datë 13.06.2024, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: 1-Bazuar në DST, fuqia punëtore është kërkuar 20 punonjës dhe nga listëpagesat e dorëzuara nga OE rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2020 numri mesatar i punonjësve është 25, duke plotësuar kriterin e vendosur në DST.

2- Përsa i përket mjeteve, nga OE është deklaruar:

-Mjeti ATP me targa AA...YL, për të cilin është paraqitur certifikata e pronësisë, si dhe leje qarkullimi nr. TRD..., me kapacitet 1570 kg (në pikën 23 është masa maksimale e autorizuar).

-Mjeti ATP me targa AA...YL, për të cilin është paraqitur certifikata e pronësisë, si dhe leje qarkullimi nr. TRD..., me kapacitet 1570 kg (në pikën 23 është masa maksimale e autorizuar).

-Mjeti ATP me targa TR...U, për të cilin është paraqitur certifikata e pronësisë, si dhe leje qarkullimi nr. TRD..., me kapacitet 3500 kg (në pikën 23 është masa maksimale e autorizuar).

- Mjeti ATP me targa TR..U, me leje qarkullimi TRF....., me kapacitet 3500 kg.

Qëndrim i grupit të auditimit: 1. Përsa i përket numrit të punonjësve në DST është kërkuar stafi kryesor 2 punonjës, stafi ndihmës 20 punonjës (pra në total 22 punonjës), të vërtetuar për periudhën janar – dhjetor 2020.

Sipas të dhënave të listëpagesave, numri i punonjësve është si më poshtë:

Nr.	Viti 2020	Numri i punonjësve
1	Janar	31
2	Shkurt	34
3	Mars	31
4	Prill	28
5	Maj	24
6	Qershor	25
7	Korrik	23
8	Gusht	18
9	Shtator	22
10	Tetor	19
11	Nëntor	19

Nga auditimi i dokumentit në SPE rezulton se janë lidhur kontrata pune për 10 punonjës, në datën 04.02.2021, të cilët nuk janë në listëprezencë përkatësisht:

-2(dy) kontrata për stafin kryesor, me Z. S.T. dhe Z. Xh. B.

-8(tetë) kontrata për stafin ndihmës, përkatësisht me: E. B., A.Ç., A.S., B.Ç., I.H., E. P., J. K., dhe E. Sh.

Për sa më sipër nga OE "E.." SHPK plotësohet numri i punonjësve i kërkuar në DST dhe observacioni i bërë nga AEE për këtë pikë, merret në konsideratë.

2. Lidhur me pretendimin e pikës nr.2 në observacion:

Në kriterin 2.3.4 "Mjetet dhe pajisjet teknike" është kërkuar që OE të vërtetojnë se disponojnë mjetet për realizimin e kontratës:

1. Mjet ATP me kapacitet deri ne 3.5 Ton – 2 copë
2. Mjet ATP me kapacitet deri ne 1.2 Ton – 2 copë

a) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatori ekonomik , duhet të paraqesë:
-kontratat e shitblerjes ose kontratat e qirasë.

Shenim: Kontratat e qerasë duhet të kenë objekt të njëjtë me objektin e kontratës së procedurës së mësipërme.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- **çertifikatën e pronësisë;**

- **leja e qarkullimit;**

për mjete të marra me qira, duhet të paraqitet:

-kontrata e qirasë, me objekt te njëjtë me objektin e kontratës se procedurës se mësipërme;

-leja e qarkullimit

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- kontrata e blerjes apo zhdoganimit dhe faturat tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit në SPE konstatohet se janë paraqitur dokumente për mjetet në pronësi:

1-Për mjetin me targa AA...YL, është paraqitur certifikata e pronësie, si dhe leje e qarkullimit, ku është shënuar masa maksimale e autorizuar 1570 kg (nr. 23 në leje qarkullimi), masa e mjetit bosh 1166 (nr. 23 në leje qarkullimi).

2-Për mjetin me targa AA... YL është paraqitur certifikata pronësisë, **por nuk është paraqitur leje e qarkullimit.**

3- Për mjetin me targa TR...U, është paraqitur certifikata pronësisë, si dhe leje e qarkullimit ku shënohen masa maksimale e autorizuar 3500 kg (nr. 23 në leje qarkullimi), masa e mjetit bosh 2250 (nr. 24 në leje qarkullimi).

4- Për mjetin me targa AA.. YL, është paraqitur leje qarkullimit, ku shënohet masa maksimale e autorizuar 1570 kg (nr. 23 në leje qarkullimi), masa e mjetit bosh 1142 (nr. 24 në leje qarkullimi), **por për këtë mjet nuk është paraqitur certifikata e pronësisë.**

Bazuar në observacionin e mëposhtëm të bërë nga AEE për projektraportin e auditimit, kjo mangësi konsiderohet devijim i vogël, pasi pronësia vërtetohet nga leja e qarkullimit, në të cilën citohet se kjo leje është lëshuar për shoqërinë "E.." SHPK. Për këtë arsye mjeti me targa AA485 YL, konsiderohet që plotëson kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, sipas observacionit dhe qëndrimit të grupit të auditimit në fazën e raportit të auditimit, si vijon:

Lidhur me mjetin me targa AA.. YL, nga AEE është paraqitur observacion nëpërmjet postës elektronike, në adresën b.m. @klsh.org.al, si dhe me shkresën Nr. 396/1 Prot., datë 26.08.2024 (të dhëna të AEE), protokolluar në KLSH me Nr.1043/13, datë 27.08.2024, në të cilin janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Së pari ju bëjmë me dije se kriteri i përcaktuar në DST, kërkon që OE të ketë në pronësi ose me qira mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Certifikata e pronësisë

është dokument që kërkohet për të vërtetuar plotësimin e kriterit. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit të mjeteve të paraqitura nga Operatori Ekonomik, ka vlerësuar dhe mjetin mjetin ATP me targa AA...YL me Nr. Leje qarkullimi TRDA.... me kapacitet 1570 kg, për këtë automjet operatori ekonomik ka paraqitur lejen e qarkullimit ku në fillim të faqes shfaqet edhe pronari i automjetit. Në këtë mënyrë certifikata e pronësisë nuk është më një dokument i domosdoshëm pasi pronësia e automjetit është verifikuar nga leja e qarkullimit dhe për këtë arsye kriteri është vlerësuar i plotësuar. Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, në nenin 92, pika 3 përcakton se “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, ... si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Oëndrim i grupit të auditimit: Për arsye se pronësia e mjetit vërtetohet nga leje e qarkullimit, observacioni juaj merret parasysh, duke dalë në konkluzionin se mjeti me targa AA485 YL, konsiderohet që plotëson kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye janë bërë ndryshimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit.

Pra nga 4 mjetet në pronësi është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për 3 mjete, për atë me targa AA.... YL dhe TR....U dhe AA....YL.

Për mjetet e mara me qira është paraqitur kontrata e qirasë e datës 22.01.2021, e cila ka si objekt marrjen me qira nga shoqëria “E...” SHPK të mjetit me targa TR...U. Në këtë kontratë është përcaktuar që ky mjet është për objektin e kontratës që po prokurohet.

Në lejen e qarkullimit të këtij mjeti shënohet masa maksimale e autorizuar 3500 kg (nr. 23 në leje qarkullimi), masa e mjetit bosh 2318 (nr. 24 në leje qarkullimi).

Si përfundim, nga 4 mjete të kërkuara në DST, nga OE “E...” SHPK, është paraqitur dokumentacion për 4 mjete, 3 prej të cilëve në pronësi dhe 1 me qira.

Për këtë arsye OE “E....” SHPK, plotëson kriterin 2.3.4 të kapacitetit teknik, lidhur me mjetet.

Për sa më sipër kualifikimi dhe shpallja fitues e OE “E....” SHPK nga KVO dhe autoriteti kontraktor AEE është i drejtë.

Zbatimi i kontratës

Për objektin **“Vendosja e sistemit të ndricimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

3) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis AEE dhe OE “E..” SHPK me Nr.306/12Prot., datë 14.05.2021.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Etj.

4) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis AEE dhe BOE “T.H.C..” & “E.-G.” & “G.C.E.” SHPK me Nr.316/39 Prot., datë 28.05.2021.

- Korrespondencat mes AEE dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin BOE “T.H.C.” & “E.-G.” & “G. C. E..” SHPK
- Etj.

Kontratat

Zbatimi i punimeve civile është kryer sipas kontratës, për punë publike, me Nr.306/12Prot., datë 14.05.2021 me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor AEE, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. E. B. dhe OE “E...” SHPK të përfaqësuar nga z. E. Ç.. Vlera e kontratës është 82,499,604 lekë pa TVSH ose 98,999,525 lekë me TVSH. **Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit.**

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.316/39 Prot., datë 28.05.2021 me BOE “T. H. C.” & “E.-G.” & “G.C.E.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0672/10 dhe MK.1015/17, si dhe me vlerë të kontratës 1,785,000 lekë pa TVSH ose 2,142,000 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit nuk është lidhur Kontratë Shërbimi pasi sistemi i instaluar nuk është lidhur me rrjetin elektrik që të shikohet funksionimi i tij e për rrjedhojë nuk mund të kryhet.

Hartimi i projektit

Projekti me objekt “2 km Smart City, Rruga e Energjisë së Pastër” është hartuar nga BOE “I...” SHPK & “H...” SHPK e prokuruar nga AEE me vlerë preventivi 100,000,000 lekë me TVSH. Projekti është marrë në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor me Nr. 302 Prot., datë 10.12.2020. Në këtë projekt është parashikuar të vendosen 20 panele fotovoltaike, dy smart floëers dhe një pemë eolike të cilat do të gjenerojnë energji të pastër. Gjithashtu do të instalohen dhe 5 karikues mjetesh, katër në rrymë alternative AC me fuqi 22 Kë dhe një në rrymë të vazhduar DC 350 Kw. Të gjitha këto do të jenë të lidhura me pajisjet ndihmëse si, inverter, ruter trasmetimi, potale monitorimi si dhe matsa për prodhimin e konsumin. Përgjatë këtij segmenti, sipas projektit, do të vendosen shtylla të reja ndriçimi duke vendosur sistem led. Gjithë ky sistem i ndërtuar do të monitorohet nëpërmjet një programi në distancë (web), i cili do të tregojë gjenerimin dhe konsumin e sistemit në kohë reale dhe ruajtjen e të dhënave për një kohë të gjatë.

Referuar raportit teknik të hartuar nga projektuesi kthimi i investimit për karikusat e makinave do të jetë 1.67 vite për ato me fuqi 22 KŴ dhe 2 vite për atë me fuqi 350 KŴ. Në raportin teknik nuk del e qartë analiza e kthimit të investimit për pemën fotovoltaike dhe panelet diellore.

Zbatimi i punimeve

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim me Urdhër Nr. 306/13 Prot., datë 14.05.2021 është ngritur komisioni me anëtarët znj. Xh.A. dhe z. M. K. dhe i ndryshuar me Urdhër Nr.306/15 Prot., datë 12.07.2021 me antarët znj. Xh.A., z. F. D. dhe znj. Xh. S.

Dorëzimi i sheshit të ndërtimit është bërë me aktin datë 21.07.2021 të firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe nga përfaqësuesit Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, si përfituese e këtij projekti që zhvillohet në territorin administrativ të saj. **Punimet kanë filluar më datë 26.07.2021** sipas procesverbalit të mbajtur midis palëve dhe njoftimit të mbikëqyrësit të punimeve me shkresën Nr. 47 Prot., datë 26.07.2021.

Me shkresën nr. EU043LB Prot., datë 22.12.2021 drejtuar AEE, sipërmarrësi i punimeve kërkon asistencë për përcaktimin e pikave se ku do të vendoset sistemi i ndriçimit dhe karikuesat elektrik të cilët deri në këtë fazë nuk janë vendosur në dispozicion nga ana e Bashkisë Tiranë.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën Nr.19 Prot., datë 23.12.2021 dhe të administruar në AEE, me Nr.2697 Prot., datë 23.12.2021 kërkon shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 60 ditë.

Arsyeja e kërkesës për shtyrje është si rezultat i vonesave të furnizimit të disa pjesëve të ndriçimit dhe karikuesit për shkak të situatës globale të pandemisë dhe mungesa e bashkëpunimit nga institucionet që kanë në pronësi apo administrim sistemin aktual të ndriçimit. Mungesa e bashkëpunimit është konstatuar në përcaktimin e pikave të lidhjes të furnizimit të karikuesve, pika e lidhjes me rrjetin ekzistues si dhe heqja e shtyllave të vjetra dhe përcaktimi i vend depozitimit të tyre. Sipas kërkesës së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve **AEE ka miratuar shtyrjen e afatit me 60 ditë kalendarike me Shtesë Kontrate Nr.56 Prot., datë 14.01.2022.**

AEE me shkresën Nr.2721Prot., datë 28.12.2021 i është drejtuar Bashkisë Tiranë për asistencë ku të përcaktohen: zëvendësimi i shtyllave të ndriçimit, përcaktimi i pikës së lidhjes me kabinën ekzistuese, përcaktimi i venddepozitimit të shtyllave të vjetra dhe përcaktimi i pikës së lidhjes në rrjetin elektrik për karikuesat e makinave elektrike. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga AEE, Bashkia Tiranë nuk ka kthyer përgjigje për kërkesën e mësipërme. Mbikëqyrësi i punimeve më shkresën Nr.2001 Prot., datë 20.01.2022 të administruar në AEE Nr.56/1 Prot., **datë 20.01.2022 njofton pezullimin e punimeve** referuar njoftimit të sipërmarrësit Nr. 05/1 LB Prot., datë 20.01.2022 si dhe procesverbalit përkatës të mbajtur midis tyre.

Sipërmarrësi i punimeve me shkresën Nr. EU019 LB Prot., **datë 03.06.2022** i është drejtuar Bashkisë Tiranë konkretisht Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2, të administruar prej tyre me Nr.1633 datë 03.06.2022 ku i **kërkohet lejë për çarjen e rrugëve** për kalimin e kabllave dhe vendosjen e pusëve në trotuar, kjo e shoqëruar me akt dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe projektin e miratuar.

Me shkresën Nr.1107 Prot., datë 11.07.2022 të administruar në AEE me Nr.56/2 Prot., **datë 12.07.2022, mbikëqyrësi njofton rifillimin e punimeve** pas lirimit pjesor të sheshit për vendosjen e katër karikuesve me fuqi 22 KŴ, shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.2207 Prot., datë 22.07.2022 të administruar në AEE me Nr.56/5 Prot., **datë 25.07.2022, mbikëqyrësi njofton pezullimin e punimeve**, pasi nga Bashkia Tiranë nuk janë përcaktuar pikat e lidhjes së furnizimit të karikuesve dhe lirimi i sheshit të ndërtimit për pemën voltaike (Wind tree), shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.0109 Prot., datë 01.09.2022 të administruar në AEE me Nr.56/6 Prot., datë **01.09.2022** mbikëqyrësi njofton rifillimin e punimeve pas lirimit të pjesor të sheshit për vendosjen e strukturës së pemës voltaike (Wind tree), shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.0109/1 Prot., datë 16.09.2022 të administruar në AEE me Nr.56/9 Prot., datë **19.09.2022, mbikëqyrësi njofton pezullimin e punimeve**, pasi nga Bashkia Tiranë nuk janë përcaktuar pikat e lidhjes së furnizimit të karikuesve dhe pikat e lidhjes me rrjetin, shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.1912 Prot., datë 08.12.2022 të administruar në AEE me Nr.56/10 Prot., datë 01.09.2022 mbikëqyrësi njofton rifillimin e punimeve pas lirimit të pjesor të sheshit për vendosjen e karikuesit 350 KŴ, shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.1912/1 Prot., datë 19.12.2022 të administruar në AEE me Nr.56/11 Prot., datë 19.12.2022 mbikëqyrësi njofton pezullimin e punimeve pasi nga Bashkia Tiranë nuk janë përcaktuar pikat e lidhjes së furnizimit të karikuesve dhe pikat e lidhjes me rrjetin, shoqëruar me procesverbalin përkatës midis kontraktorit, supervisorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën Nr.30/12 Prot., datë 30.12.2022 të administruar në AEE me Nr. 56/12 Prot., datë 30.12.2022, mbikëqyrësi njofton përfundimin e punimeve në masën 96% por sistemi nuk është vendosur në punë pasi ka patur mungesë të ndërveprimit për dhënien e lejeve.

Proceset që kanë mbetur pa u realizuar janë:

- Mungesa e pikës së lidhjes nga ana e OSHEE tek kabina elektrike NSHRAK B/1.
- Çarja e rrugës kryesore për kalimin e tubacionit, kabllit në zonën përballë zyrave të OSHEE si dhe pika e lidhjes tek kuadri elektrik kryesor.
- Kalimi i linjës elektrike mes kuadrit dhe karikuesit nr.3 tek Kompleksi Delijorgji pasi nuk është dakortësuar ndërhyrja në rrugë.
- Konfigurimet e inverterave fotovoltaike, eolike, sistemi i menaxhimit të ndriçimit pasi këto sisteme kanë të bëjnë direkt me vendosjen në punë dhe furnizimin me energji të panelit kryesor.

Nga njoftimi i përfundimit të punimeve datë 28.12.2022 e deri në fund të periudhës audituese nuk gjenden gjurmë shkresore që Autoriteti Kontraktor të ketë kërkuar nga Bashkia Tiranë dhe OSHEE zgjidhjen e problemeve të hasura për vendosjen në funksion të investimit të kryer.

Mosrealizimi i punimeve dhe moskonfigurimi i sistemit sjell vështirësi në kolaudimin e punimeve dhe marrjen në dorëzim nga ana e Agjencia për Eficencës e Energjisë. Ky projekt i iniciuar si një zgjidhje inteligjente do të shërbente në uljen e konsumit të energjisë elektrike dhe në rritjen e aksesimit të makinave elektrike për tu karikuar në stacione të fuqishme (Fast charger), nuk ja ka arritur qëllimit, pra konsiderohet pa efektivitet. Gjithashtu me kalimin e viteve pajisjet e vendosura do të amortizohen dhe për vendosjen në punë të tyre do të kërkojnë fonde shtesë duke rritur vlerën e investimit si dhe duke sjell humbje të vlerës së energjisë që duhet të prodhohet për pajisjet e instaluar.

Për sa më sipër investimi i kryer deri në këtë fazë të auditimit konsiderohet pa efektivitet dhe ngarkon me përgjegjësi titullarët e AEE për periudhën respektive brenda periudhës së audituar, për mos angazhim ndërinstitucional për zgjidhjen e kësaj situatë dhe vendosjen në funksion të këtij projekti, konkretisht z. E.D. dhe z. A. H. dhe z. A. M. me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike të AEE.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër”.			
14.Lidhja e kontratës Nr.306/12 Prot., datë 14.05.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 98,999,525 lekë OE “E...” SHPK		16.Likuiduar deri datë 03.06.2024 44,599,702 lekë me TVSH
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 93,736,429 lekë -Vlera pa TVSH 78,113,691 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 6+1 muaj, Zbatuar 17 muaj Fillimi punimeve: 26.07.2021 Përfundimi punimeve: 28.12.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate Nr. 56 Prot., datë 14.01.2022
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “T.. & E..-G. & G.C. E.” SHPK	Licenca Nr: MK. 1015/17	Kontrata Nr.316/39 Prot., datë 28.05.2021	
21. Kolaudatori i punimeve Nuk është kryer	Licenca Nr:	Kontrata	
22.Akt Kolaudimi Nuk ka	23.Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk u konstatuan diferenca.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerja e Pajisjeve Teknike të Auditimit për Procesin e Mbikëqyrjes së CPE Projekt për Standardet e Ndriçimit Rrugor dhe Urban në Shqipëri”, viti 2021		
1. Urdhër prokurimi Nr. 315/2, datë 14.01.2021	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Urdhër Nr. 315 datë 11.12.2020 Z. B. A., me detyrë përgjegjës sektori Zj. K. T., me detyrë përgjegjës sektori Zj. B.M., me detyrë specialist/juriste	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr. 315/3, datë 14.01.2021
2.Lloji i procedurës: “E hapur”		
5. Fondi limit (pa TVSH): 10,000,000 lekë (dhjetë milion)	6. Oferta fituese (pa TVSH): 9,869,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 131, 000 lekë pa TVSH
8.Data e hapjes së tenderit: 10.02.2021	9.Burimi i financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 O.E b) S’kualifikuar 1 O.E c) Kualifikuar 1 O.E
11.Ankimime në AK: AK- S’ka APP-S’ka KPP-S’ka		
12.Lidhja e kontratës: Nr. 315/11, datë 12.03.2021	13.Vlera e Kontratës (me TVSH): 11,842,800 lekë	14.Afati i Kontratës (në ditë): 3 muaj/ 90 ditë nga lidhja e kontratës

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Nga dokumentacioni shkresor i dosjes së kësaj procedure konstatohet se nuk administrohet procesverbali mbi kërkesën apo nevojën për fillimin e kësaj procedure si dhe përshkrimi i shkurtër i pajisjeve objekt prokurimi (CPE), procedurë në të cilën është përfshirë edhe kryerja e një shërbimi, konkretisht zhvillimi/ndryshimi i sistemit aktual Flower DMS e formës COTS, veprim ky në mospërputhje me pikën 2 gërma a), neni 12, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. Ndërkohë emërtimi i procedurës në pjesën e dytë të tij “...Projekt për Standardet e Ndriçimit Rrugor dhe Urban në Shqipëri” nuk rezulton të këtë lidhje me procedurën e prokurimit. Sa i takon shërbimit mbi software dhe blerjes së pajisjeve CPE ku janë përfshirë edhe pajisje për përpunim apo raportim të dhënash (të cilat në bazë të specifikimeve teknike në DST janë printer dhe kompjuter nivel user), konstatohet se nuk administrohet korrespondencë me AKSHI-n apo kërkesë drejtuar këtij institucioni, i cili përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën e TIK për institucionet dhe organet e administratës shtetërore, si dhe organizon e kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontrata për sistemet, pajisjet software dhe hardware, veprime këto në mospërputhje me pikën 2/I “Dispozita të Përgjithshme”, si dhe gërmës i) të pikës 5, si dhe gërmës i) të pikës 6, të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Në dosje nuk është dokumentuar me një procesverbal përkatës hartimi dhe përlogaritja e vlerësimit të kontratës, sikurse nuk është ngritur një strukturë e posaçme për kryerjen e kësaj detyre. Më tej, për sa kërkuar lidhur me përcaktimin e fondit limit të kontratës, grupit të Auditimit, i’u vunë në dispozicion tre oferta ekonomike që datojnë të protokolluara pranë AEE, në 2 shtator 2020, në të cilat konstatohet se nga 3 OE është dhënë një ofertë ekonomike për realizimin total të kërkesave, pa përcaktuar koston e secilit prej zërave pajisje teknike apo shërbim. Ndërkohë, me shkresën nr. 315 datë 11.12.2020, nga AK është ngritur një komision për hartimin e termave të referencës. Pra, AK ka marrë oferta ekonomike për studimin e tregut, pa përcaktuar më parë specifikime teknike të objektit që prokurohet, pasi grupi për hartimin e tyre është ngritur dy muaj pasi është studiuar

tregu. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me nenin 59, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet:

“1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”

Në gjykim të Grupit të Auditimit termat e referencës janë një emërtim i gabuar sa i takon kontratave të blerjes së mallrave pasi, në përcaktim të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 11, pika 3/c, termat e referencës janë informacion specifik për kontratat e shërbimeve, citohet se:

Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën: - termat e referencës; - grafikun e ekzekutimit; - kërkesat për personelin kryesor; - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Nga shqyrtimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se grupi i ngritur për hartimin e termave të referencës, nuk ka mbajtur procesverbalin përkatës, pra në dosje nuk dokumentohet hartimi dhe përcaktimi i termave të referencës që shprehin natyrën e shërbimit e ku të përcaktohet qartë objekti, qëllimi e specifikimet teknike, sikurse përcaktohet në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 28, pika 1. Gjithashtu, nuk administrohet nëse për hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve për përpunim të dhënash apo raportim të dhënash (printer e kompjuter) të jenë ndjekur standardet shqiptare të TIK, të përcaktuara nga AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Për sa trajtuar më sipër, mbi parregullsitë e konstatuara në procedurën e prokurimit, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E. B. si dhe Komisionit për Hartimin e Termave të Referencës znj. K.T., znj. B. M. dhe z. B. A.

Hartimi i Kritereve të Kualifikimit

- Anëtarët e NJP, të cilët janë edhe anëtarët e komisionit për hartimin e termave të referencës nuk janë specialistë të fushës (në fushën e IT ose inxhinierisë informatike).

- Në këtë procedurë prokurimi rezulton e pa dokumentuar me procesverbal përkatës hartimi i kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike dhe ato të vendosura në DT nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht;

Veprimet dhe mos veprimet e NJP janë në mospërputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku parashikohet se:

..... Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Gjithashtu, në DT, përkatësisht shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit”, AK nuk ka përcaktuar sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e tyre.

Veprimet dhe mosveprimet si më sipër janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 dhe neni 46, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës....”

Nga shqyrtimi në SPE i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të vendosura për pajisjet CPE, konstatohet si më poshtë:

Në pikën 2.3.2, nga AK OE duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi.

- OE duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi;

- OE duhet të paraqesë Autorizimi nga prodhuesi ose rishitësi i autorizuar ku të specifikojë emrin e saktë të kësaj procedure tenderimi, datën, adresën e qartë të prodhuesit/ rishitësit të autorizuar.

Në rastin e Rishitësit të autorizuar, ky i fundit të paraqesë dhe marrëveshjen (autorizimin) që ka prej prodhuesit të pajisjeve.

- OE duhet të paraqesë gjithashtu Autorizimin e Prodhuesit ose rishitësi i autorizuar, nga i cili lejohet për të realizuar ndërhyrjet, ndryshimet dhe përditësimet e kërkuara në programin kompjuterik të miratuar ekzistues dhe në përdorim nga Autoriteti Kontraktor.

- Sistemi që përdor Agjencia për Efiçencën e Energjisë është i bazuar mbi Flower DMS dhe përditësimet që do të kryhen duhet të zbatohen mbi këtë platformë. Flower DMS është e formës COTS ndaj duhet që operatori ekonomik të zotëroje Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për të zhvilluar këtë platformë. Aplikimi i ndryshimeve të kërkuara duhet të implementohet në sistemin aktual që ka në përdorim Agjencia për Efiçencën e Energjisë.

- Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk kërkon një sistem tjetër por modifikimin e formave, formulave, proceseve, logjikës etj ekzistuese të sistemit që Agjencia për Efiçencën e Energjisë përdor i cili bazohet mbi Flower DMS, dhe këto ndryshime/zhvillime të bëhen mbi këtë instalim aktual të Flower DMS sipas kërkesave të AEE.

Në pikën 2.3.7, nga AK është kërkuar që:

- OE duhet të ketë, të punësuar, në stafin e tij 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier informatik. Inxhinierët duhet të jenë të punësuar pranë OE për një periudhë jo më të vogël se 1 (një) vit.

Në pikën 2.3.8, nga AK është kërkuar që:

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, inxhinieri elektronike informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj) të cilët plotësojnë kriteret në vijim...

Të gjitha këto kriteret sa i takon aftësive profesionale të operatorëve, ku në fillim kërkohen dy inxhinierë, e më pas 5 të tjerë me specializime specifike, si dhe kërkesa Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për të zhvilluar platformën Flower DMS, janë të ekzagjeruara e nuk i shërbejnë AK.

Pra, kriteret e kërkuara nga AK, nuk janë argumentuara teknikisht e ligjërisht. Në vlerësimin e grupit të auditimit ato konsiderohen se janë jo proporcionale me objektin e prokurimit, dhe përveç kësaj janë të tilla që nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE, veprim ky në mospërputhje me pikën 2, të nenit 28 “Kërkesat e veçanta për kontratat e shërbimeve”, si dhe pikën 3 të nenit 27” “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër, mbi parregullsitë e konstatuara në procedurën e prokurimit, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP znj. K.T., znj. B.M. dhe z. B.A.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

KVO ka mbajtur Raportin Përmbledhës nr. 315/10 datë 05.03.2021 në të cilën rezulton se kanë qenë pjesëmarrës këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

BOE “K... & N..” – 9,869,000 lekë pa TVSH;

OE “K..” – pa ofertë ekonomike

Në vijim KVO ka shpallur fitues BOE “K.. & N..” si ofertën e vetme të suksesshme.

Marrja në dorëzim dhe zbatim i kontratës

Me Urdhër të Titullarit nr. 315/3 Prot., datë 10.05.2021, është krijuar komisioni i marrjes në dorëzim znj. Xh.A., z. M.K., të cilët nuk janë ekspertë të fushës, pasi janë inxhinierë mjedisi dhe përveç kësaj numri i këtyre specialistëve duhet të ishte jo më pak se 3. Sa më sipër është në mospërputhje me pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale”.

Nga auditimi rezulton se Kontrata me nr. 315/11 Prot., datë 12.03.2021 nuk është monitoruar nga AK për të siguruar nëse cilësia e mallit të sjellë nga Kontraktuesi është e njëjtë me cilësinë për të cilin ai është shpallur fitues. Pra AK, për monitorimin dhe zbatimin e kontratës nuk ka ngritur një strukturë të veçantë, si dhe nuk është mbajtur një raport përmbledhës për ecurinë e saj. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet si më sipër janë në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe 4, ku përcaktohet se:

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e

kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali.

4. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

Gjithashtu, nga AK nuk është dokumentuar verifikimi, testimi dhe inspektimi i pajisjeve të dorëzuara nga Kontraktuesi, në mospërputhje kjo me pikën 16.1 të Kontratës. Nisur nga fakti se qëllimi i kërkesës së AK ndër të tjera ka qenë rritja e kapaciteteve të programit kompjuterik, duhet të ishte dokumentuar përmbushja e kësaj kërkesë, pra nëse sistemi i dorëzuar ka rritur apo jo kapacitetet atij aktual, sikurse kërkuar në pikën 3 “Të drejtat e kodit të aplikacionit”, Specifikimet teknike, të DT.

Për sa trajtuar ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarit të AK z. E.B. si dhe Komisioni i Marrjes në Dorëzim znj. Xh.A. dhe z. M.K..

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë”		
1. Urdhër prokurimi Nr. 316/2, datë 23.12.2020	3.Hartuesit e Dokumentave të Tenderit: Nr.316 Prot., datë 11.12.2020 Znj. K.T., me detyrë përgjegjës sektori/arkitekte Znj. B.M., me detyrë specialist/juriste Z. B.A., me detyrë përgjegjës sektori/inxh.mekanik-profilu energjetike	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 316/8 Prot., datë 05.01.2021.
2.Lloji i procedurës: “Shërbim Konsulence- E hapur”		
5. Fondi limit pa TVSH: 8,333,333 lekë (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë)	6. Oferta fituese (pa TVSH): O.E pjesëmarrës janë shpallur të suksesshëm për opsionet e nënkontraktimit, me vlerat përkatëse të ofruara të secilit: -8,300,000 lekë -8,310,000 lekë -8,333,333 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSH) - 33,333 lekë - 23,333 lekë -0 lekë
8.Data e hapjes së tenderit: 20.01.2021	9.Burimi i financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 3 O.E b) S’kualifikuar 0 O.E c) Kualifikuar 3 O.E
11.Ankimime në AK: AK- Ka APP-S’ka KPP-S’ka	Përgjigje ankesës nga AK : Nr. 316/7 Prot., datë 31.12.2020 “Të mos pranojë ankesën e O.E”	Përgjigje ankesës nga APP / KPP
12.Lidhja e kontratës: Marrëveshje Kuadër (me disa operatorë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara) Nr. 316/13 Prot., datë 16.03.2021.	13.Vlera e Kontratës (me TVSH): -9,999,999.60 lekë -9,972,000.00 lekë -9,960,000 lekë	14.Afati i Kontratës (në ditë): 12 muaj (365 ditë) nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së kontratës

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Sipas Urdhrit me nr. 316 Prot., datë 11.12.2020 është ngritur Komisioni për Hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit i përbërë nga znj. K.T., znj. B.M. dhe z. B.A.. Në

dokumentacionin e dosjes së procedurës konstatohet se nga anëtarët e NJP nuk është mbajtur procesverbali përkatës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim duke bërë që ato të ngarkohen si DT në SPE pa u argumentuar teknikisht dhe ligjërisht. Veprimet e mosveprimet e NJP janë në mospërputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 61, pika 2, ku parashikohet se:

..... Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Nga auditimi rezulton se nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit, vlera e marrëveshjes kuadër, veprim ky në mospërputhje VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45/1 “Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër” pika 1 dhe 2, të si Udhëzimit nr. 6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7 ku përcaktohet se

1. Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t’u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të pa përfshira në marrëveshjen kuadër”.

Gjithashtu, për përllogaritjen e fondit limit rezulton se nuk është ngritur një strukturë e posaçme për kryerjen e kësaj detyre, veprim ky në mospërputhje me pikën 1, neni 59, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1. Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.

Me Urdhër nr. 316/3 Prot., datë 24.12.2020 është bërë anulimi i procedurës për të cilën nuk rezulton të ketë shkaqet përkatëse.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E.B. si dhe Komisioni për Hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit znj. K.T., znj. B.M. dhe z. B.A.

Hartimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike

Sikurse përmendur më lart, grupi i auditimit rithekson se kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura nga AK, janë të paargumentuara ligjërisht dhe teknikisht.

Në lidhje me kapacitetin Teknik 2.3, është kërkuar:

Në pikën 2.3.1:

Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit....

Kërkesa si më sipër është në mospërputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 28, të VKM Nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. “Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”

Në pikën 2.3.3/a-nga AK është kërkuar staf si më poshtë:

Numri	Pozicioni
	Stafi Kryesor
1 (një)	Arkitekt
1 (një)	Inxhinier Ndërtimi
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik
1 (një)	Inxhinier Elektrik
1 (një)	Inxhinier Mekanik
1 (një)	Inxhinier Gjeodet/Topograf
1 (një)	Inxhinier Gjeolog
1 (një)	Inxhinier Mjedisi
1 (një)	Auditues Energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa)
1 (një)	Auditues Energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në Instalime Industriale)

(Kushti i përcaktuar më sipër për auditues energjetik në Ndërtesa, auditues energjetik në instalime industriale dhe Menaxher energjie mund të plotësohet dhe nga një auditues që i disponon të tre certifikatat)

Pika 2.3.3/c, nga AK është kërkuar:

“...Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit të shoqërisë ose të kontraktuar me marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme:

1 Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë në ndërtesa);

1 Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë në instalime industriale).

Për audituesin energjetik duhet të paraqiten këto dokumenta provues:

Certifikata individuale, Kontrata e punës e vlefshme ose marrëveshja e bashkëpunimit me objekt të njëjtë me objektin e kontratës të procedurës së mësipërme.”

Në fakt, ky kriter duke mos qenë i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, në vlerësimin e grupit të auditimit, është jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, sa i takon dhe specialiteteve të stafit, ku kërkesa për arkitekt nuk është e nevojshme për supervizimin e projekteve si më poshtë:

1. Vendosija e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2km Smart City - rruga e Energjisë së Pastër”;

2. Projekt Pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza;

3. Projekt Pilot për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë; 4. Projekt Pilot për ndërtimin një godine me “0 Energji”

Gjithashtu, gërma c) e kriterit 2.3.3 për auditues energjie është e paqartë, nëse kërkohen dy auditues të tjerë nga ata të kërkuar në gërmën a, si edhe për më tepër kërkesa që këta auditues të jenë të punësuar si pjesë e stafit të shoqërisë është e paargumentuar teknikisht e ligjërisht, pasi mund të jenë edhe të kontraktuar.

-Në pikën 2.3.3/d, nga AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira pajisje GPS, kërkesë kjo e cila gjithashtu nuk është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Për sa më lart, kriteret teknike janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht dhe në vlerësimin e grupit të auditimit janë kërkesa të tepërta e në disa raste edhe jo proporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës, situatë e cila nuk nxit pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit. Sa më sipër është në mospërputhje me pikën 2, të nenit 28 “Kërkesat e veçanta për kontratat e shërbimeve”, VKM nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Me Urdhër nr. 316/6 Prot., datë 31.12.2020, është pezulluar procedura pas ankesës me nr. 921 Prot., datë 30.12.2020 të bërë nga ana e OE “Gj. &C.” mbi kriteret e vendosura në DT. Ankesës i është kthyer përgjigje nga ana e AEE sipas shkresës me nr. 316/7 datë 31.12.2020, përmes të cilës AK ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Komisioni për Hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit znj. K.T., znj. B.M. dhe z. B. A.

Vlerësimi i ofertave

Me Urdhër nr. 316/8 Prot., datë 05.01.2021 është krijuar Komisionit i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga z. A.M. (kryetar), znj. A.K. (anëtare) dhe z. O.I. (anëtar) nga ana e të cilëve është mbajtur procesverbali nr. 316/9 Prot., datë 20.01.2021 për hapjen e ofertave nga operatorët si më poshtë:

“H.C.” – 9,960,000,00 lekë me TVSH

“L. C. & K.” “P. & G.” “A. & N.... “- 9,972,000,00 lekë me TVSH

“T.H.C. & E.” “G & G.” “C.E. “- 9,999,999,60 lekë me TVSH

Në përfundim të procesit të vlerësimit KVO ka mbajtur procesverbalin për vlerësimin e procedurës sipas aktit me nr. 316/10 Prot., datë 21.01.2021 sipas të cilit janë kualifikuar të tre OE si më sipër. Në vijim është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari, sipas shkresës nr. 316/11 Prot., datë 05.02.2021, për marrëveshjen kuadër. Në lidhje me vlerësimin, nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Në kuptim të nenit 47, pika 4, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, marrëveshjet kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP, pasi AK për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.

Supervizioni për projektin pilot “Për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë “- në Bashkinë e Tepelenës).

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Marrëveshja Kuadër Nr.316/13 Prot., datë 16.03.2021;
- Dokumentet Standarde të procedurës së prokurimit për Marrëveshjen Kuadër “Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë”;
- Termet e Referencës për mbikëqyrjen e projekteve të prokuruar;
- Procesverbale dhe raporte të vlerësimit, nga rihapja e konkurimit;
- Urdhëra të Drejtorit të Përgjithshëm për caktimin e komisioneve të prokurimit dhe të vlerësimit;
- Kontrata fituese Nr.316/35 Prot., datë 06.05.2021 supervizioni “Për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë”.
- Njoftimi dhe procesverbali për fillimin e punimeve nr.2805, datë 17.05.2021, nga ana e kontraktorit për zbatimin e kontratës;
- Raport paraprak(mars 2021) dhe përfundimtar (gusht 2021) i auditimit “Për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë”, përgatitur nga sipërmarrësi “A..“ shpk nga procedura e prokurimit REF-83097-12-24-2020;
- Akti i inspektimit nr.1, datë 21.05.2021 ora 10:00;
- Situacion punimesh përfundimtar i punimeve të sipërmarrësit të punimeve (kontraktorit);
- Situacion punimesh përfundimtar i mbikëqyrësit;
- Procesverbal mbi përfundimin e punimeve ndërtimore të kontraktorit, datë 10.07.2021etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Me anë të procedurës së prokurimit, me numër reference REF-83129-12-24-2020 me fond limit 8,333,333 lekë, pa TVSH, është kryer prokurimi për Marrëveshjen Kuadër “Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lart”, në të cilën janë parashikuar kontrata mbikëqyrje për 4 projekte pilot të efikasitetit të energjisë.

Të dhëna të përgjithshme nga rihapja e konkurimit, brenda kësaj procedure prokurimi “Për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë” janë dhënë në tabelën si më poshtë:

<u>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Supervizion i “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë 45,500,000 lekë”.</u>		
1. Urdhër prokurimi Nr.316/4, datë 24.12.2020	3.Hartuesit e Dokumentave Standarde të Tenderit: Urdhëri Nr.316 Prot., datë 11.12.2020 Zj. K.T.; me detyrë përgjegjës sektori Zj. B.M.; me detyrë specialist/jurist Z. B.A.; , me detyrë përgjegjës sektori	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr.316/8Prot., datë 05.01.2021. A.M. Kryetar A.K. anëtar O.I. anëtar
2.Lloji i procedurës: “Shërbim -E hapur”		
5. Fondi limit pa TVSH: Min.1,071,530 lekë Max. 1,163,250 lekë	6. OE fitues (pa TVSH): 1,120,000 lekë.	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSH): 43,250 lekë
8.Data e hapjes së konkurimit: 24.03.2021	9.Burimi i financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët ekonomikë: a) Pjesëmarrës në konkurim 3 O.E b) S’kualifikuar 2 O.E c) Kualifikuar 1 O.E –BOE:

		“L...”SHPK & “N...”SHPK & K.P. SHPK &G. A. SHPK .
11.Ankimime në AK: AK- S’ka APP-S’ka KPP-S’ka	Përgjigje ankesës nga AK S’ka	Përgjigje ankesës nga APP / KPP S’ka
12.Lidhja e kontratës: Nr.316/35 Prot., datë 06.05.2021.	13.Vlera e Kontratës (me TVSH): 1,344,000 lekë.	14.Afati i Kontratës (në ditë): 5 muaj/ 150 ditë nga lidhja e kontratës

Nga procedura e prokurimit të marrëveshjes kuadër, me anë të procesverbalit nr.316/10 Prot., datë 21.01.2021, janë kualifikuar si të suksesshëm 3 operatorët ekonomikë pjesëmarrës si më poshtë:

-BOE “T.” & “E.-G.” & “G.”, në vlerën prej 8,300,000 lekë pa TVSH.

-BOE “L.” & “K.” & “G.” & “N...” në vlerën prej 8,310,000 lekë pa TVSH.

-“H...” SHPK në vlerën prej 8,333,333 lekë pa TVSH.

Marrëveshja Kuadër Nr.316/13 Prot., datë 16.03.2021, e lidhur ndërmjet AEE dhe BOE të cituar më lart, është e llojit kur jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Në objektin e marrëveshjes janë përfshirë rregullat për kontratat, që do të lidhen nga rihapja e konkurimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshje.

Me anën e ftesës për ofertë nr.316/17 Prot., datë 23.03.2021 janë ftuar në rikonkurim palët në marrëveshjen kuadër si më poshtë:

-BOE “T.” & “E.-G.” & “G.”, në vlerën prej 8,300,000 lekë pa TVSH.

-BOE “L.” & “K...” & “G...” & “N...” në vlerën prej 8,310,000 lekë pa TVSH.

-“H...” shpk në vlerën prej 8,333,333 lekë pa TVSH.

Rihapja e konkurimit:

Në zbatim të shkronjës b) pika 6, neni 35/1 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me anë të ftesës për ofertë nr.316/17 Prot., datë 23,03,2021, janë ftuar sërish në konkurim OE, që janë palë në marrëveshjen kuadër dhe brenda të njëjtës procedurë prokurimi. Termat e referencës

Konform kërkesave të përcaktuara në pikën 2 “Kritere të Veçanta” në dokumentet standarde të tenderit (DST), OE duhet të plotësojnë kapacitetet ligjore, ekonomike dhe financiare, si edhe ato teknike, si më poshtë:

-Regjistrimi ne Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe objektin e veprimtarisë;

-Xhiro mesatare e realizuar, 3 vitet e fundit, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Gjithashtu, bilancet e depozituara në organet tatimore për 3 vitet e fundit.

-Dëshni për shërbimet e mëparshme të ngjashme, fatura fiskale tatimore, stafi kryesor, si edhe të disponojë liçensa për kryerjen e shërbimeve, sipas zërave në liçensës, gjithashtu të parashikuara në DST.

Përsa më sipër, për mbikëqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit janë parashikuar pikat NP-1, NP-2, NP-3, NP-5, NP-7, NP-10, NP-11 dhe NP-12.

Nga ana tjetër, lidhur me mbikëqyrjen për punimeve speciale janë parashikuar pikat NS-1, NS-2, NS-3, NS- 4, NS-12, NS-14, NS-18, NS-20.

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në stafin kryesor minimalisht si më poshtë:

Numri Pozicioni

Stafi Kryesor

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Ndertimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Mjedisi

1 (një) Auditues Energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa)

1 (një) Auditues Energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në Instalime Industriale)

Përlllogaritja e fondit limit

Në procesverbalin me nr.392 Prot., datë 10.02.2021, nga ana e njësisë së prokurimit është kryer përlllogaritja e fondit limit, në zbatim të VKM Nr.354, datë 11.05.2016 për mbikëqyrje punimesh. Kontrata e zbatimit të projektit “Për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë” është vlerësuar në masën prej 45,500,000 lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 7, pika 1 të VKM Nr.354, datë 11.05.2016, tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifës minimale dhe maksimale, në përputhje me ligjin e prokurimit publik.

Sa më sipër, sipas nenit 38, grupi tarifor IV dhe V, tarifa maksimale është 12.7830 % e vlerës së zbatimit të projektit, d.m.th.e barabartë me 5, 816, 250 lekë pa TVSH.

Gjithashtu, tarifa minimale është 11.7751% e vlerës së zbatimit të projektit e barabartë me 5,357, 650 lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 36, fazës së VIII të klasifikimit të veprës inxhinerike, përfundimisht tarifa është përcaktuar 20% e vlerës totale të saj, sa më sipër.

Në këtë mënyrë, tarifa e mbikëqyrjes është llogaritur si më poshtë:

-Vlera minimale 20% x 5, 357, 650 lekë = 1,071, 530 lekë pa TVSH;

-Vlera maksimale 20% x 5, 816, 250 lekë = 1,163, 250 lekë (pa TVSH).

Vlerësimi i ofertave

Në përfundim të procesit të rikonkurimit, sipas procesverbalit nr.316/28 Prot., datë 24.03.2021, renditja përfundimtare është dhënë në tabelën si më poshtë:

Nr.	Operatorë ekonomike	Oferta ekonomike lekë pa TVSH	Fondi limit lekë pa TVSH
1.	B.O.E: “L..”SHPK & “N...”SHPK & “K...”SHPK & ”G...” SHPK	1,120,000	min 1,071, 530 max 1,163, 250
2.	B.O.E: “T..” SHPK & “E.-G.”SHPK & “G...” SHPK	1,150,000	
3.	OE: “H....-C”.shpk	1,160,000	

Nga renditja përfundimtare është shpallur fitues BOE: “L.C.” & “K.K.P.P.” & “G. A.” & “N.

Group” me ofertën ekonomike 1,120,000 lekë pa TVSH.

Zbatimi i kontratës:

Kontrata nr.307/14, datë 11.03.2021 me objekt “Për përmirësimin e efijencës së energjisë në impiantet e furnizimit me ujë”- Bashkia Tepelenë, është lidhur ndërmjet AEE (Autoriteti kontraktor) dhe OE A.. shpk (Kontraktori), në vlerën prej 54,600,000 lekë me TVSH.

Nga ana Kontraktorit, në datën 03.05.2021, është përgatitur raporti paraprak i auditimit.

Për mbikëqyrjen e kontratës të sipërcituar është lidhur Kontrata Nr.316/35 Prot., datë 06.05.2021 ndërmjet AEE dhe BOE: “L..” & “K...” & “G...” & “N...”.

Me Urdhërin Nr.316/37, date 06.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AEE është krijuar komisioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës së mbikëqyrjes dhe marrjen në dorëzim, i përbërë nga znj. Xh.A.

Punimet për objektin, sa më sipër, kanë filluar në datën 17.05.2021, dhe afati i kontratës është vendosur 5 muaj.

Nga auditimi, në procesverbalin e fillimit të punimeve, datë 17.05.2021, kontraktori ka deklaruar se stafi i caktuar në objekt, nga ana e tij, është i përbërë si më poshtë:

1(një) Inxhinier Elektronik;

1(një) Inxhinier Hidroteknik;

1(një) Inxhinier Elektrik;

1(një) Inxhinier Gjeodet;

1(një) Inxhinier Mekanik;

1 (një) Auditues Energjetik.

Në aktin e inspektimit nr.1, datë 21.05.2021, ndërmjet kontraktorit A.. shpk dhe mbikëqyrësit të punimeve BOE: “L...” & “K...” & “G...” & “N.. ”, janë konstatuar zërat FV (furnizim vendosje) si saraçineska, kundralvalvola, xhunto antivibruese, pompë horizontale centrifugale, mod.MEC-MR80-3/2G, sistemi i monitorimit SKADA, sensor niveli në depon e ujit etj., por nuk janë treguar as volume dhe as afate.

Punimet e Kontraktorit kanë përfunduar në datën 10.07.2021, gjithashtu janë mbyllur ditari i objektit, libreza e masave, dhe preventivi përfundimtar.

Situacioni përfundimtar i Mbikëqyrësit është nënshkruar në datë 09.08.2021.

Nga ana e Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit, në datën 10.08.2021 është nënshkruar situacioni përfundimtar i punimeve.

Nga ana e kontraktorit të punimeve, është përgatitur raporti përfundimtar i auditimit, nr.1630 Prot., datë 13.08.2021.

1. Titulli i gjetjes: Nga ana e Supervizorit nuk përshkruhen punimet e kryera nga kontraktori në mënyrë analitike, sipas zërave dhe volumeve të aprovuara.

Situata: Në relacionin teknik të punimeve nga ana e mbikëqyrësit është raportuar progresi i Kontraktorit për situacionin nr.1, për periudhën e punimeve 17.05.2021-28.05.2021, sipas tabelës si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi I punimeve	Vlera e kontratës në lekë	Realizimi në %
1.	Raporti paraprak i auditimit.	415,000	100
2.	Projekt i zbatimit.	910,000	100
3.	Zbatimi i punimeve.	43,858,464	18
4.	Raporti përfundimtar i auditimit	316,500	0

Nga auditimi rezulton si më poshtë:

-Supervizori BOE: “L..” & “K...” & “G..” & “N...”, nuk dokumenton se ka paraqitur pranë AEE stafin e tij mbikëqyrës, pjesë e dokumenteve, që duhet të plotësojë operatori ekonomik fitues, sipas kushteve të veçanta të DST, gjithashtu nuk është dokumentuar kohëqëndrimi në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikëqyrës.

-Nuk është raportuar pershkrimi i punimeve që janë kryer gjatë muajit, sipas zërave, si dhe nuk janë treguar volumet progresive të punimeve mujore, apo punimet e aprovuara etj.

-Situacioni Përfundimtar i Punimeve, datë 10.08.2021, si edhe situacionet pjesore, të sipërmarrësit Arkanstudio shpk nuk janë hartuar në mënyrë analitike, por ato japin vlerën totale të punimeve dhe nuk tregojnë as volume dhe as çmime.

Sa më sipër, bien në kundërshtim me pikën 3 dhe 4 të termave të referencës, shtojca 12 e DST.

Kriteri: Në kundërshtim me pikën 3 dhe 4 të termave të referencës, shtojca 12 e Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Ndikimi/Efekti: Reziku i raportimit fiktiv.

Shkaku: Nuk zbatohen kërkesat e DST.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të merren të gjitha masat në të ardhmen, në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë të qartë dokumentacioni përkatës me qëllim kryerjen e të gjitha proceseve të mbikëqyrjes, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse individuale.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar AEE është paraqitur observacion me shkresë nr.298/1 Prot., datë 07.06.2024 nga z. A.H., Drejtor i Përgjithshëm, ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Në datën 02.12.2021 Mbikëqyrësi ka dorëzuar pranë AEE kërkesën për pagesën pjesore nr.02. të punimeve për kontraktorin Arkandstudio shpk, me nr.2533/1Prot., dhe bashkëlidhur kësaj kërkesë gjenden kërkesa për pagesë e kontraktorit, fatura, relacioni teknik i mbikëqyrësit, situacioni pjesor i punimeve nr.02 dhe librezë e masave, gjithashtu situacioni përfundimtar analitik.

Nga ana e mbikëqyrësit është dorëzuar dosja teknike e objektit me anë të shkresës nr.1793 Prot., datë 09.09.2021.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së: Në shkresën nr.119 Prot., datë 09.09.2021, nga ana e mbikëqyrësit me përfaqësues “L.C.” është dorëzuar në AEE dosja përfundimtare e objektit për projektin pilot “Për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë “- në Bashkinë e Tepelenës, nga ku është kërkuar çertifikata e marrjes në dorëzim të objektit. Në pëmbledhësen e dokumentacionit, Dosje e dates 09.09.2021, është treguar se janë dorëzuar 24 dokumente me data përkatëse, por pikat me numër 13, 15, 17, 18, 21, përkatësisht Librezë e Masave, Situacioni Përfundimtar, Akt-Kontrolle, Çertifikata e Cilësisë, Relacioni Përfundimtar i Kontraktorit, janë të firmosura pa datë.

Në observacionin e dates 07.06.2024 është bashkëngjitur procesverbali mbi përfundimin e punimeve ndërtimore në datën 10.07.2021, ndërmjet mbikëqyrësit dhe kontraktorit të punimeve. Nga ana tjetër është treguar se me procesverbalin nr.307/26 Prot., datë 06.07.2021 të komisionit të marrjes në dorëzim të AEE është miratuar situacioni nr.2 pjesor në vlerën prej 8,333,333 lekë, i cili është faturuar nga kontraktori i punimeve në datën 02.12.2021.

Për arsye se ju nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.

Për parregullsitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. E.B., ish-Drejtor i Përgjithshëm i AEE, znj. Xh.A. me cilësinë e anëtarës së komisionit të marrjes në dorëzim, si dhe Supervizori BOE: “L...” & “K...” & “G...” & “N...”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Supervizion i “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”.		
1. Urdhër prokurimi Nr. 316/2, datë 23.12.2020	3.Hartuesit e Dokumentave të Tenderit: Nr. 316 Prot. , datë 11.12.2020 Zj. K.T., me detyrë përgjegjës sektori Zj. B.M. me detyrë specialist/juriste Z. B.A., me detyrë përgjegjës sektori	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër Nr.316/8 Prot. , datë 05.01.2021.
2.Lloji i procedurës: “Shërbim -E hapur”		
5. Fondi limit pa TVSH: 1,287,360 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH): BOE “L...” & “K...” & “G...” & “N...”: 1,280,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 7360 lekë pa TVSH
8.Data e hapjes së tenderit: 20.01.2021	9.Burimi i financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 3 O.E b) S’kualifikuar 0 O.E c) Kualifikuar 3 O.E
11.Ankimime në AK: AK- S’ka APP-S’ka KPP-S’ka	Përgjigje ankesës nga AK : S’ka	Përgjigje ankesës nga APP / KPP S’ka
12.Lidhja e kontratës: Nr. 316/36 prot. , datë 06.05.2021.	13.Vlera e Kontratës (me TVSH): 1,536,000	14.Afati i Kontratës (në ditë): 5 muaj/ 150 ditë nga lidhja e kontratës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

➤ **NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E INVESTIMIT**

Sipas aktit me nr. 316/1 prot., datë 11.12.2020 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit nr. 316/1 prot., datë 11.12.2020. Me Urdhër nr. 316/3 prot., datë 24.12.2020 është bërë anulimi i procedurës së prokurimit dhe me shkresën nr. 316/4 prot., datë 24.12.2020 është ngritur përsëri Urdhri i prokurimit me fond prej 8,333,333 lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, me objekt “*Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë*”. Procesverbali për hapjen e ofertave nga operatorët e mëposhtëm është administruar në AEE sipas shkresës me nr. 316/9 prot., datë 20.01.2021 ku rezulton se kanë marrë pjesë:

“H.-C.”;

“L. “;

“T.”;

Nga verifikimi i dokumentacionit si më sipër konstatohet se AK ka anuluar procedurën e prokurimit, në zbatim të nenit 24, pika 1, gërma a, të L.P.P i ndryshuar, bazuar në kërkesën e APP, ndërkohë në dosjen e procedurës nuk është dokumentuar asnjë shkak për anulimin e saj.

➤ **NË LIDHJE ME FONDIN LIMIT**

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*” sipas shkresës me shkresën nr. 392 prot., datë 10.02.2021 nga anëtarët e njësisë së prokurimit z. B.A., znj. K.T. dhe znj. B.M.. Agjencia për Eficencën e Energjisë ka në procedurat e saj realizimin e punimeve të objektit : Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave

të zeza me vlerë 52,000,000 lekë pa TVSH. Pjesë e procedurës së realizimit të punimeve është dhe vlerësimi i tarifave të mbikëqyrjes.

Vlera minimale 100 % e projektit të zbatimit është 11.383 % e vlerës së realizimit të zbatimit e barabartë me 5,919,200 lekë pa TVSH.

Vlera maksimale 100 % e projektit të zbatimit është 12.3785 % e vlerës së realizimit të zbatimit e barabartë me 6,436,800 lekë pa TVSH.

Mbikëqyrja e objektit (faza VIII) vlerësohet 20 % e vlerës totale të projektit të zbatimit.

Vlera minimale e mbikëqyrjes 20 % x 5,919,200 lekë = 1,183,840 lekë pa TVSH.

Vlera maksimale e mbikëqyrjes 20 % x 6,436,800 lekë = 1,287,360 lekë pa TVSH.

➤ NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DST

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik”, rezulton se ndër të tjera është kërkuar:
- Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

N.P-5 Punime nëntokësore, ura e vepra Arti.

N.P-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

N.P-11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

N.S-2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

- Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në ekipin e tij minimalisht :

Arkitekt 1(një)

Inxhinier Gjeolog 1 (një)

Nga auditimi konstatohet:

Kriteret e mësipërme nuk janë të nevojshme, janë të paargumentuara dhe nuk lidhen me natyrën e kontratës dhe nuk duhet të ishin kërkuar nga AK, duke mos nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën e OE në tender. Për sa më sipër është në kundërshtim me :

Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 2, “Qëllimi”, ku përcaktohet :

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se OE “L...” ka mungesë të Certifikatës për menaxhimin e energjisë ISO 50001-2012. Ky veprim përbën kusht për s’kualifikim dhe nuk është në përputhje me “**Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**”, kapitulli 2.3.3, pika b ku shprehet :

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej tyre duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mësipërme, në varësi të punimeve që do të kryhen.

Referuar shërbimit që do kryhej janë konstatuar se kërkesat e vendosura nga AK AEE, në seksionin “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në kapitullin 2.3.2, janë jo të nevojshme, duke vendosur të gjithë pikat e licensës së disponueshme nga BOE: “N..”, “L..” dhe “K...”

Kërkesa për inxhinier gjeolog dhe arkitekt, është e pa argumentuar, pasi kontrata është për mbikqyrje punimesh dhe nuk përfshin projektim fasadash, apo punime gjeologjike.

Vendosja e kriterëve në mënyrë të pa argumentuar bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26, pika 5.

Në gërmën d) të pikës 2.3.3, nga AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera, pajisje GPS, kërkesë kjo që në vlerësimin e grupit të auditimit nuk është e nevojshme dhe e tepruar për objektin e kontratës.

Gjithashtu konstatohet se, nuk është reflektuar vlerësimi i s’kualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve mbi kushtet e konfliktit të interesit, nëpërmjet vetëdeklarimeve përkatëse të parashikuara për këtë lloj procedure. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me pikën 3 të nenit 37 të VKM nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

➤ NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Në tender kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 3 OE mes të cilëve është shpallur fitues oferta me vlerë më të ulët. Për këtë procedurë nuk rezultojnë të ketë patur ankesa.

Sipas shkresës me nr. 316/10 Prot., datë 21.01.2021 është mbajtur procesverbali i vlerësimin të ofertave si dhe Raporti Përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër nr. 316/12 prot., datë 05.02.2021 ka identifikuar si OE të suksesshëm:

1-BOE “T..” & “E.- G.” & “G..” me vlerë 8,300,000 lekë pa TVSH.

2-BOE “L..” & “K..” & “G..” & “N..” me vlerë 8,310,000 lekë pa TVSH.

3-“H..” sh.p.k me vlerë 8,333,333 lekë pa TVSH.

Në vijim është nënshkruar marrëveshja kuadër nr. 316/13 Pot., datë 16.03.2021 me objekt “Supervizion i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë”.

Ftesa për ofertë për mbikëqyrjen e Kontratës me Objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” është bërë sipas shkresës me nr. 316/16 prot., datë 23.03.2021. Nga OE janë paraqitur ofertat si më poshtë:

Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza		
Nr.	OE	Oferta
1	“T..”& “E..” & “G...”	1,285,000
2	“H...- C”.	1,286,000
3	“L..” sh.p.k & “N...”sh.p.k & “K...” sh.p.k & “G..”.	1,280,000

Raporti përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit të minikonkursit është administruar në AEE sipas shkresës me nr. 316/31 prot., datë 06.05.2021. BOE “L..” SHPK & “N...” SHPK & “K..” SHPK & “G..” SHPK “ është operatori ekonomik më i suksesshëm me oferte ekonomike prej 1,280,000 lekë pa TVSH i cili është njoftuar sipas aktit me nr. 316/34 Prot., datë 06.05.2021.

Nga auditimi konstatohet :

AK nuk ka Urdhër për krijimin e një komisioni vlerësimi gjatë rihapjes së konkurimit për dhënie e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër. Ky veprim në mospërputhje me pikën 12.2 të Udhëzimit nr. 6, datë 16.01.2018 ku citohet :

Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurimit autoriteti kontraktor është i detyruar të krijojë një komision vlerësimi për dhënie e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër. Përbërja e komisionit nuk është e nevojshme të jetë identike me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

➤ **NË LIDHJE ME ZBATIMIN E KONTRATËS**

Kontrata e shërbimit është lidhur sipas aktit me nr. 316/36 prot., datë 06.05.2021 dhe me shkresën nr. 316/37 prot., datë 06.05.2021 është caktuar nga ana e Titullarit për ndjekjen e kontratës Xh.A. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve janë paraqitur në total sy situacione:

Situacionit Nr. 1 i mbikëqyrësit të punimeve me nr. 316/40 Prot., datë 28.05.2021 në shumën prej 256,000 lekë;

Situacionit nr. 2 i mbikëqyrësit të punimeve me nr. 1093 Prot., datë 05.05.2022 në shumën prej 1,024,000 lekë;

Sipas shkresës me nr. 1637 Prot., datë 19.08.2021 është kryer dorëzimi i dosjes tekniko-ekonomike me sipërmarrës BOE “V..” & “H...” & “E..- A”...

Nga ana e ndjekësit të kontratës të caktuar sipas shkresës me nr. 316/36 Prot., datë 06.05.2021 është bërë marrja në dorëzim e shërbimit sipas shkresës me nr. 316/42 Prot., datë 31.05.2021. Procesverbali i marrjes në dorëzim të situacionit përfundimtar të mbikëqyrësit të punimeve është bërë sipas shkresës me nr. 316/46 Prot., datë 02.09.2021 nga Xh.A. nga ana e të cilit është konstatuar se është marrë në dorëzim dosja përfundimtare e kryerjes së shërbimit.

Për sa trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E.B. si dhe anëtarët e njesisë së prokurimit znj. K.T., znj. B.M. dhe z. B.A.

Procedura të zhvilluara në vitin 2022

- *Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shume familjare (blloqe banimi) me efijencë energjie në qytetet: Elbasan, Belsh, Cërrik, Rrogozhinë, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Kavajë Fier, Lushnje dhe Divjakë, viti 2022.*

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “ Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efijencë energjie në qytetet: Elbasan, Belsh, Cërrik, Rrogozhinë, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Kavajë Fier, Lushnje dhe Divjakë		
Urdhër Prokurimi : nr.1043 prot. date 28.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit A.M. O. I. Xh.S.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: K.T. M.P. Xh.S.
4. Fondi limit (pa TVSH): 21,066,666.67 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 16.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: 5 Operatorë Ekonomik b) Kualifikuar: OE “N..”	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Xh.A. F. D.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 20,223,995 lekë

BOE OE "S...".	Xh.Sh.	
10. Data e lidhjes së kontratës nr.1763 prot. date 26.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 842,671 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja USH nr.215, datë 14.11.202 35,000.000 lekë me TVSH USHnr.237, datë 12.12.2023 3,118,990 lekë me TVSH. USHnr.249, datë 09.01.2024 16,149,804 lekë me TVSH	15. Afati i kontratës 11 muaj + 2 muaj amendim kontrate

Titullari i AK AEE, nëpërmjet Urdhrit nr. 665 Prot. datë 31.03.2022, ka ngritura grupin e punës për studim tregu, hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit me përbërje nga: K.T., M.P., Xh.S.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, grupi i punës ka hartuar termat e referencës duke marrë në shqyrtim 32 objekte, të përzgjedhura nga 50 njësi në total nga 11 bashkitë të cilat janë pjesë e projektit. Për këto njësi do të bëhet një analizë e detajuar mbi konsumin e pajisjeve. Sipas termave të referencës në terren do të auditohen rreth **57,600 m²**, të ndara në mënyrë proporcionale në secilën prej bashkive të sipërcituara.

Projekti do të përfshijë 3 (tre) faza:

Faza I: Auditim paraprak energjetik i godinave të përzgjedhura duke përfshirë analizën e gjendjes ekzistuese dhe certifikatat e gjendjes ekzistuese.

Faza II: Projekt zbatim

Faza III: Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së energjisë (paraprake).

Sipas Procesverbalit nr.963/4 Prot., datë 20.04.2022, të grupit të punës është llogaritur sipërfaqe njollë për një objekt 360m².

Sip fasade=sip totale e banuar X 1.1 ku

Sip totale e banuar= sip njolle X 5 kate

Sip totale e banuar= 360 m² X 5 kate= 1800 m²

Sip fasade = 1800 m² x 1.1 = 1980 m²

Sipërfaqja e dritareve duke patur parasysh se dritaret zënë rreth 22% të sipërfaqes së fasadës.

Sip dritaresh = Sip fasade x 0.22

Sip dritaresh = 1980 * 0.22 = 435.6 m²

Sipërfaqja e mureve llogaritet si:

Sip muresh = Sip fasade – Sip dritaresh

Sip muresh = 1980 m² - 435.6 m² = 1544.4 m²

Përlllogaritja e përafërt e vlerës së investimit

Sip veshje termoizoli m	Çmimi mesata r m ²	Total Izolim	Sip dritare	Çmim i dritare	Total dritare	Sip Tarrac a	Çmim i tarraca	Total tarraca	Total investim për objekt 1
1,544	3,296	5,090,342	436	28,270	12,314,412	360	4,014	1,445,040	18,849,794

Nr. objekte	Investim për 1(një) objekt	vlera totale
32	18,849,794	603,193,421

Referuar rregullores për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik pagesa e audituesit për sipërfaqe mbi 1000 m² është 250 lek/m².

Totali auditimi = Sip totale e banueshme x 250 = 1800 m² x 32 ndërtesa x 250 lek/m² = **14,400,000 lekë**

Sipërfaqe Totali auditim = Sip totale e banueshme x nr i ndërtesave = 1800 m² x 32 ndërtesa = **57,600 m²**

Vlera e propozuar e realizimit të projektit

Fazat e auditimit	Njësia	Vlera ne Lekë
Auditim paraprak energjetik i ndërtesave (Nxjerrja e CPE) paraprake para punimeve të zbatimit	Lekë	14,400,000
Projekti i zbatimit	Lekë	7,221,912.16
Vlera totale pa TVSH	Lekë	21,621,912

Titullari i AK AEE ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit nr.1043 datë 28.04.2022 me fond limit 21,066,666.67 lekë pa TVSH, me njësi prokurimit të përbërë nga: A.M., O.I. dhe Xh.S.

2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

2.3.2.a Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës ose të paraqesin kontrate bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe auditimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, për kategoritë e mëposhtme:

- Kat 2/a - Projektim arkitekturor për objekte banimi-objektet industrial-objekte turistike
Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë, si më poshtë:

-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme

2.3.4 Staf

2.3.4.a) Staf Kryesor

1 Arkitekt

2 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa)

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

2.3.4.b) Stafi Ndhmës

10 (dhjetë) arkitekt ose inxhinier ndërtimi ose inxhinier mekanik ose inxhinier elektrik ose inxhinier mjedisi.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Stafi, në lidhje me kërkesën për 10 arkitekt ose inxhinier ndërtimi, nisur dhe nga preventivi i punimeve është i pa arsyetuar dhe paargumentuar nga ana e Njesisë së prokurimit.

2.3.4.c). Për të realizuar me sukses procesin e auditimit operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

Pajisje e mëposhtme të auditimit.

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (W/m²K).
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë.

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të vecanta të dokumenteve të tenderit kanë përgjegjësi anëtarët e njesisë së prokurimit të përbërë nga z. A.M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike në AEE, z. O.I., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike dhe znj. Xh., me detyrë speciliste në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Për sa më sipër është në mospërputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr.1047 datë 28.04.2022 të titullarit të AK AEE është ngritur KVO e përbërë nga z. M.K., znj. Xh.A., z. Xh.Sh. dhe me urdhrin nr.1301 datë 24.05.2022 z. M.K. është zëvendësuar me z. F.D.

Faza e parë

KVO bëri hapjen e fazës së parë të procedurës dhe ka hartuar proces verbalin nr.1043/3 datë 16.05.2022.

Në këtë fazë janë paraqitur operatorët ekonomike:

- BOE “4. “K.. & A.”
- BOE “A...& H...”
- Studio Services “K..-S”..
- “N...”
- “T...”(s’kualifikuar)

Sipas proces verbalit nr.1043/4 datë 24.05.2022, të KVO për fazën e dytë janë kualifikuar 4 OE/BOE dhe vetëm OE “T.”..është skualifikuar pasi nuk kishte përmbushur kriteret e përcaktuara në DST. OE “T”...nuk kishte ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3.

Faza e dytë

Autoriteti Kontraktor me shkresën Nr. 1043/5 Prot, datë 03.06.2022, ka dërguar ftesën për propozim të cilës i janë përgjigjur operatorët ekonomik:

- BOE “4. K... & A.”
- Studio Services K...
- “N...-G..”.

Sipas DST, vlerësimi i ofertës fituese do të behet mbi bazën e çmimit dhe propozimit teknik e përcaktuar si me poshtë:

Kriteret e vlerësimit teknik

Kriteret e vlerësimit teknik	Pikët
Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit	[0-10]
Metodologjia e propozuar (përfaqsa teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)	[20-30]
Kualifikimet e Stafit Kryesor të propozuar.	[20-50 (+10)]
Transferimin e njohurive, (nëse kërkohet)	[-]

Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.

Pesha për Propozimin Teknik është 80% e pikëve të propozimit teknik

Pesha për Propozimin Ekonomik është 20% të pikëve të propozimit ekonomik

Komisioni i vlerësimit të ofertave në procesverbalin nr.1043/6 datë 20.06.2022. ka konstatuar se në fazën e dytë kanë paraqitur interes OE/BOE të mëposhtëm me ofertat përkatëse:

1. OE “S..”–S..A, me ofertë **19,095,700** lekë pa TVSH.
2. OE “N..” me ofertë ekonomike **20,223,995** lekë pa TVSH.
3. BOE “4.K.& A.”, me ofertë **20,645,334** lekë pa TVSH.

KVO ka hartuar proces verbalin nr.1043/7 datë 04.07.2022 duke renditur OE/BOE sipas pikëve:

OE/BOE	Piket e vlerësimit ekonomik	Piket e vlerësimit teknik	Totali	Piket ne SEP
OE “N..”	18.88	66.03	84.92	255.60
BOE “4.K... & A..”	18.50	65.76	84.26	252.00
OE “S.. –S” ...	20.00	60.08	80.80	242.40

Referuar vlerësimit të KVO, OE “N..” është njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit nr.1043/8 datë 13.07.2022 nga titullari i AK z. E.D.

Autoriteti Kontraktor me Njoftimin e fituesit Nr. 1043/8 Prot, datë 13.07.2022, ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik “N..” me ofertë 20,223,995 leke pa TVSH.

Pas njoftimit të fituesit nr.1043/10 datë 21.07.2022 të ngarkuar në SPE dhe përfundimit të afateve të ankimimit, Operatori Ekonomik ka dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor Sigurimin e Kontratës me vlerë 2,426,879.4 Lekë dhe në vijim është nënshkruar Kontrata me Nr. 1763, datë 26.07.2022 mes Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik me afat realizimi 11 muaj.

Afatet e realizimit sipas fazave

Faza	Afatet
Faza 1- Analiza e thelluar e gjendjes ekzistuese	6 muaj-26.01.2023
Faza 2- Projekt zbatimi	2 muaj-26.03.2023
Faza 3- Nxjerrja e CPE paraprake	3 muaj- 26.06.2023

Zbatimi i kontratës

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës i ngritur me Urdhrin Nr. 1769, datë 27.07.2022, me përbërje: Xh.A., K.T. dhe B.K., ka hartuar Planin e zbatimit të Kontratës Nr. 1763/2, datë 02.08.2022. Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës ka ndryshuar me urdhrin Nr. 1769/1, datë 07.11.2022 me përbërjen e re: Xh.A., K.T., dhe Xh.S.

Dorëzimi i fazës së parë

OE “N..” ka dorëzuar pranë AK, fazën e parë të auditimit energjetik të thelluar nëpërmjet shkresë përcjellëse nr.4144 datë 05.12.2022.

Mbi bazën e raporteve të dorëzuar dhe të ngarkuar në sistemin informatik të AEE, anëtarët e komisionit për zbatimin e kontratës kanë konstatuar mangësi të cilat i kanë pasqyruara në proces verbalin nr.4144/1, datë 12.12.2022. OE “N..” është informuar për këto parregullsi nga titullari i AK AEE z. A.H. me shkresën nr.4144/2 datë 12.12.2022, si më poshtë:

Të matet me instrumentin e matjes koeficienti i transmetimit të nxehtësisë U-value për elementët konstruktivë si: mur i jashtëm, dritare dhe dyer të jashtme.

Të vendosen Certifikatat e Performancës së Energjisë pasi mungojnë;

Të shikohen me kujdes matjet e infiltrimeve të ajrit dhe të dhënat hyrëse në pajisjen Bloëdoor;

Të vendosen më shumë foto gjatë matjes në objekt si psh: foto gjatë matjes së ndriçimit me pajisje luxometër, dhe foto gjatë matjes me instrumentin kamera termike;

Të kryhet mbi faturat mujore të energjisë elektrike dhe një ndarje e konsumit për secilën nga pajisjet elektroshtëpiake;

OE “N..” ka dorëzuar pranë AK AEE kërkesën për shtyrje të afatit të zbatimit të kontratës nr.256 datë 02.05.2023 me 3 (tre) muaj, si shkak i shtyrjes nga OE “N..” paraqitet mungesa e bashkëpunimit të banorëve si dhe sistemi i efikasitetit të energjisë EECERT të AEE.

Amendimi i kontratës nr. 374 datë 16.06.2023 i cili ka zgjatur afatin e realizimit të kontratës me 2 muaj.

-OE “N..” ka dorëzuar pranë AK AEE raportet e auditimit për analizën e thelluar (duke reflektuar mangësitë e konstatuara nga AEE) nëpërmjet shkresës nr.384 datë 26.06.2023.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ka hartuar proces-verbalin nr.384/1 datë 10.07.2023 dhe ka marrë në dorëzim fazën e parë të projektit.

Kontraktuesi i dorëzon AK AEE nr.384/2 datë 24.07.2023 projekt-zbatimin, Faza 2.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës harton proces-verbalin nr.384/3 datë 03.08.2023 dhe merr në dorëzim fazën e dytë të projektit.

-OE “N..” ka dorëzuar pranë AK AEE me nr. 384/4 datë 25.08.2023 fazën e tretë- Nxjerrja e certifikatës së Performancës së Energjisë Paraprake.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës harton proces-verbalin nr.384/5 datë 01.09.2023 dhe merr në dorëzim fazën e tretë të projektit.

Kontraktuesi dorëzon pranë AK AEE nr.551 datë 08.11.2023 situacionin përfundimtar të tre fazave.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës harton proces-verbalin nr.551/1 datë 13.11.2023 dhe merr në dorëzim situacionin përfundimtar .

• Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Dibër, Tropojë Krujë, Durrës, Rrogozhinë.”, viti 2022.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Dibër, Tropojë Krujë, Durrës, Rrogozhinë.” 2022

Urdhër Prokurimi :		
Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. Xh.S. Z. Al.M. Z. O. I.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike:
4. Fondi limit (pa TVSH): 10.000.000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 23.06.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: O.E. “GJ...&C..” Sh.p.k “K...” O.E. “N..” Sh.p.k “L...” b) Kualifikuar: O.E. “GJ...&C” Sh.p.k “K...”.	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. Xh.A. Z. F.D. Z. Xh.Sh.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 9.801.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 26.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 199.000 lekë	12. Ankimime S’ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 9 muaj

Zhvillimi i procedurës:

Më datë 20.04.2022, u hartua proces verbali me nr. 963/5 Prot., mbi përlllogaritjen e fondit limit për projekt zbatimet për vitin 2022

Më datë 23.12.2020, u ngrit Urdhri nr. 307, datë 11.12.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit” me anëtarë si më poshtë:

- znj. K.T.
- znj. B.M.
- z. B.A.

Më datë 06.05.2022, u ngrit Urdhri i prokurimit nr. 1098, për procedurën e prokurimit Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (bloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Dibër, Tropojë Krujë, Durrës, Rrogozhinë”. Njësia e prokurimit me përbërje:

- z. A.M.
- znj. Xh. S.
- z. O.I.

Me anë të shkresës nr. 1098/1 Prot., datë 09.06.2022 u mbajt procesverbali nga Njësia e Prokurimit, me përmbajtje si më poshtë :

“Në zbatim të urdhrin nr. 665, datë 31.03.2022 “Për ngritjen e komisionit të hartimit të termave të referencës” si dhe në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar dhe VKM-së 914, datë 29.12.2014, Njësia e prokurimit publik ka hartuar Dokumentet e Tenderit në respekt të plotë të udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik”

Fondi limit i përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit është 10,000,000 lekë pa TVSH. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes ose afati për zbatimin e saj është 11 muaj.

Më datë 05.01.2021,i ndryshuar u ngrit Urdhri nr. 1047 “Për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me anëtarë:

- z. F.D.
- z. Xh.A.
- z. Xh.Sh.

Në datën 24.05.2022, u bë hapja publike e procedurës së prokurimit me mjete elektronike.

Grupi i auditimit konstatoi që në pjesëmarrje në garë janë Operatorët Ekonomikë ofertues, si më poshtë:

- BOE :”4.K..” sh.p.k. & “A..” sh.p.k.
- OE “I..” sh.p.k
- OE “N..” sh.p.k.
- OE “S..-S...” sh.p.k.
- BOE “Th...” sh.p.k. & “A...D...”.
- OE “T...” sh.p.k.
- “Gj...&C..” sh.p.k

Me anë të shkresës nr. 307/8 Prot., datë 31.05.2022, u mbajt procesverbal mbi vlerësimin e procedurës së prokurimit publik dhe u vendos të kualifikojë në fazën e dytën

- BOE :4.K....” sh.p.k. & “A...” sh.p.k.
- OE “I...” sh.p.k
- OE “N..” sh.p.k.
- OE “S..-S..” sh.p.k.
- BOE “Th...” sh.p.k. & “A.D”.
- O.E. “Gj...&C...” sh.p.k

si dhe u dërgohet ftesa për propozim me datë 08.06.2022 me nr. 1098/6 Prot. brenda datës 23.06.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë çmimi dhe propozimi teknik

- (i)Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit 0-10
- (ii) Metodologjia e propozuar 20-30
- (iii) Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50
- (iv) Transferimin e njohurive (nëse kërkohet). -

Sipas shkresës nr. 1098/7 Prot., datë 23.06.2022, hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ftesës për propozim i janë përgjigjur O.E të mëposhtëm:

- BOE :”4.K...” sh.p.k. & “A...” sh.p.k.
- OE “I..” sh.p.k.
- OE “N..” sh.p.k.
- OE “S..-S..” sh.p.k.
- O.E. “Gj...&C..” sh.p.k.

Në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në pikën 2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale) është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, si më poshtë:

Kat 2/a - Projektim arkitekturor për objekte banimi-objektet industrial-objekte turistike

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:

-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme

Gjithashtu në pikën **2.3.4 Staf** janë kërkuar:

2.3.4.a) Staf Kryesor

1 Arkitekt

1 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë, në ndërtesa)

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

2.3.4.b) Staf Ndhmës

5 arkitekt ose inxhinier ndërtimi ose inxhinier mekanik ose inxhinier elektrik ose inxhinier mjedisi

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Staf, në lidhje me kërkesën për 5 arkitekt ose inxhinier ndërtimi, nisur dhe nga preventivi i punimeve është i pa arsyetuar dhe paargumentuar nga ana e Njësisë së prokurimit.

2.3.4.c) Pajisje e mëposhtme të auditimit

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (W/m²K)
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 10 (dhjetë) punonjës.

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit kanë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit të përbërë nga z. A.M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike në AEE, z. O.I., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike dhe znj. Xh.S., me detyrë speciliste në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Për sa më sipër është në mospërputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Argumentim mbi vlerësimin e ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
Oferta më e mirë e bazuar në çmim dhe Propozimi teknik

Kriteret e vlerësimit teknik	Pikët
(i)Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit	0-10
(ii) Metodologjia e propozuar	20-30
(iii) Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar	20-50
(iv) Transferimet e njohurive	-

• **BOE "4K..." sh.p.k & "A..." sh.p.k**

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit **[0-10 pikë]**
Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme **[40-80%]**
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shqyrtoi punët e ngjashme që OE BOE "4K..." sh.p.k & "A..." sh.p.k, ka ngarkuar në SPE. Ky operator ka eksperiencë në punë të ngjashme me objektin e procedurës në shqyrtim, si ne projektim por dhe në auditimin energjetik të ndërtesave. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **6 pikë**

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë **[10-20%]**
OE BOE "4K..." sh.p.k & "A..." sh.p.k zotëron të gjitha Certifikatat e kërkuara sipas DST nga AK, dhe ka një kapacitet ekonomik më të lartë se operatorët ekonomikë të tjerë pjesëmarrës. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **2 pikë**

(ii) Metodologjia e Propozuar **[20-30 pikë]**
Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologji **[20-30%]**

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit **[30-40%]**

ii.c. Organizimi i Stafit **[20-30%]**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:

OE i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, dhe ka hartuar metodologjinë për të realizuar shërbimin duke përfutur rezultatet e pritura. Gjithashtu ka shpjeguar fazat e realizimit të shërbimit, dhe detyrat që do të realizohen në secilën fazë. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **8 pikë**

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE ka propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. OE ka propozuar në total një afat kohor prej 10 muaj nga 11 muaj që është vendosur në DST. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **6 pikë**

ii.c. Organizimi i Stafit: Për këtë pikë, bazuar në metodologjinë KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **8 pikë**

Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar **[20-60 pikë]**

[20-60]** pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

a- Kualifikim i përgjithshëm **[5-20%]**

OE ka dëshmi (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij (drejtues teknik, inxhinierë) me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, por dhe përvojë në fushën e efijencës së energjisë në punë të ngjashme. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **12 pikë**

b. Eksperienca në fushën përkatëse **[30-80 %]**

Për këtë kriter, u bazuam në dokumentet përkatëse të stafit të propozuar të OE dhe për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **39 pikë**

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare: **81 pikë**

Pesha e Propozimit Teknik është 80%, prandaj pikët e marra për këtë operator do të konvertohen në **64.8 pikë**

• **OE "N...." sh.p.k**

Nënkriteret

- (i) **Përvoja për punë të ngjashme** **[0-10 pikë]**
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shqyrtoi punët e ngjashme që OE "N.." sh.p.k, ka ngarkuar në SPE. Ky operator ka eksperiencë në punë të ngjashme me objektin e procedurës në shqyrtim, si në projektim por dhe në auditimin energjetik të ndërtesave më shumë se operatorët e tjerë ekonomik pjesëmarrës. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **7 pikë**

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë **[10-20%]**
OE "N.." zotëron të gjitha Certifikatat e kërkuara sipas DST nga AK. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **1 pikë**

(ii) Metodologjia e Propozuar **[20-30 pikë]**
Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia [20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30- 40%]

ii.c. Organizimi i Stafit [20- 30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:

OE i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasje teknike, dhe ka hartuar metodologjinë për të realizuar shërbimin duke përfutur rezultatet e pritura. Gjithashtu ka shpjeguar secilën fazë të realizimit të shërbimit, dhe detyrat që do të realizohen në secilën fazë, por dhe procesin e punës në tërësi me pajisjet përkatëse. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **9 pikë**

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE ka propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. OE ka propozuar në total një afat kohor prej 11 muaj nga 11 muaj që është vendosur në DST. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **5.45 pikë**

ii.c. Organizimi i Stafit: Për këtë pikë, bazuar në metodologjinë KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **8 pikë**

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar **[20-60 pikë]**

[20-60]-** pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

a- Kualifikim i përgjithshëm **[5-20%]**

OE ka dëshmi (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij (drejtues teknik, inxhinierë) me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, por dhe përvoja në fushën e eficientës së energjisë në punë të ngjashme. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **12 pikë**

b. Eksperienca në fushën përkatëse **[30-80%]**

Për këtë kriter, u bazuam në dokumentet përkatëse të stafit të propozuar të OE dhe për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **39 pikë**

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare: **81.45 pikë**

Pesha e Propozimit Teknik është 80%, prandaj pikët e marra për këtë operator do të konvertohen në **65.16 pikë**

• **OE "S.." sh.p.k**

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme **[40-80%]**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shqyrtoi punët e ngjashme që OE "S..." shpk, ka ngarkuar në SPE. Ky operator ka eksperiencë në punë të ngjashme me objektin e procedurës në shqyrtim,. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **5 pikë**

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë **[10-20%]**

OE "S..." shpk zotëron Certifikatat e kërkuara sipas DST nga AK, por ka kapacitet ekonomik më të ulët se operatorët e tjerë pjesëmarrës. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **1 pikë**

(ii) Metodologjia e Propozuar **[20-30 pikë]**

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia **[20-30%]**

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit **[30- 40%]**

ii.c. Organizimi i Stafit **[20- 30%]**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:

OE i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, dhe ka hartuar metodologjinë për të realizuar shërbimin duke përfitur rezultatet e pritura.. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **7 pikë**

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE ka propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikohen midis tyre, hapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. OE ka propozuar në total një afat kohor prej 6 muaj nga 1 1 muaj që është vendosur në DST. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **12 pikë**

ii.c. Organizimi i Stafit: Për këtë pikë, bazuar në metodologjinë KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **7 pikë**

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar **[20-50 pikë]**

[20-50] zëvendësohet me [20-60]**-pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

a- Kualifikim i përgjithshëm **[5-20%]**

OE ka dëshmi (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij (drejtues teknik, inxhinierë) me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, por dhe përvojë në fushën e efijencës së energjisë në punë të ngjashme. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me:

12 pikë

b. Eksperienca në fushën përkatëse

[30-80%]

Për këtë kriter, u bazuam në dokumentet përkatëse të stafit të propozuar të OE dhe për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **32 pikë**

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare: **76 pikë**

Pesha e Propozimit Teknik është 80%, prandaj pikët e marra për këtë operator do të konvertohen në **60.8 pikë**

• **OE "Gj...." sh.p.k**

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme

[40-80%]

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shqyrtoi punët e ngjashme që OE "Gj...." sh.p.k, ka ngarkuar në SPE. Ky operator ka eksperiencë në punë të ngjashme me objektin e procedurës në shqyrtim përfshirë dhe rikonstruksione, si në projektim por dhe në auditimin energjetik të ndërtesave. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **7 pikë**

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë

[10-20%]

OE "Gj..." sh.p.k zotëron të gjitha Certifikatat e kërkuara sipas DST nga AK. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **1 pikë**

(ii) Metodologjia e Propozuar

[20-30 pikë]

Nënkriteret

ii/a. Përgasja teknike dhe metodologjia

[20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

[30-40%]

ii.c. Organizimi i Stafit

[20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:

OE i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, dhe ka hartuar metodologjinë për të realizuar shërbimin duke përfitur rezultatet e pritura. Gjithashtu ka shpjeguar secilën fazë të realizimit të shërbimit, dhe detyrat që do të realizohen në secilën fazë, por dhe procesin e punës në tërësi me pajisjet përkatëse. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **9 pikë.**

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE ka propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. OE ka propozuar në total një afat kohor prej 9 muaj nga 11 muaj që është vendosur në DST. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **6.66 pikë.**

ii.c. Organizimi i Stafit: Për këtë pikë, bazuar në metodologjinë KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **9 pikë.**

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[20-60 pikë]

[20-60]**- pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor te propozuar".

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

OE ka dëshmi (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij (drejtues teknik, inxhinierë) me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, por dhe përvojë në fushën e efikasitetit të energjisë në punë të ngjashme. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **12 pikë.**

b. Eksperienca në fushën përkatëse [30-80%]

Për këtë kriter, u bazuam në dokumentet përkatëse të stafit të propozuar të OE, ku në përbërje të tij gjenden dhe pedagogje me eksperiencë shumëvjeçare në këtë fushë, dhe për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **40 pikë**

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare: **84.66 pikë**

Pesha e Propozimit Teknik është 80%, prandaj pikët e marra për këtë operator do të konvertohen në **67.728 pikë.**

• **OE "I..." sh.p.k**

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme [40-80%]

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shqyrtoi punët e ngjashme që OE "I..." sh.p.k, ka ngarkuar në SPE. Ky operator ka eksperiencë në punë të ngjashme me objektin e procedurës në shqyrtim përfshirë dhe rikonstrukcione, si në projektim por dhe në auditimin energjetik të ndërtesave. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **8 pikë**

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë [10-20%]

OE "I..." sh.p.k zotëron të gjitha Certifikatat e kërkuara sipas DST nga AK. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **1 pikë.**

(ii) **Metodologjia e Propozuar** [20-30 pikë]

Nënkriteret

ii/a. Përgatitja teknike dhe metodologjia [20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]

ii.c. Organizimi i Stafit [20-30%]

ii/a. Përfaqësja teknike dhe metodologjia:

OE i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqëson teknike, dhe ka hartuar metodologjinë për të realizuar shërbimin duke përfituar rezultatet e pritura. Gjithashtu ka shpjeguar secilën fazë të realizimit të shërbimit, dhe detyrat që do të realizohen në secilën fazë, por dhe procesin e punës në tërësi me pajisjet përkatëse. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **9 pikë.**

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE ka propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. OE ka propozuar në total një afat kohor prej 11 muaj nga 11

muaj që është vendosur në DST. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyre unanime të vlerësojë OE me: **5.45 pikë**.

ii.c. Organizimi i Stafit: Për këtë pikë, bazuar në metodologjinë KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **9 pikë**.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-60 pikë]

[20-60]- pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

OE ka dëshmi (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij (drejtues teknik, inxhinierë) me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, por dhe përvojë në fushën e efijencës së energjisë në punë të ngjashme. Për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **12 pikë**.

b. Eksperienca në fushën përkatëse [30-80%]

Për këtë kriter, u bazuam në dokumentet përkatëse të stafit të propozuar të OE, ku në përbërje të tij gjenden dhe pedagogë me eksperiencë disa vjeçare në këtë fushë, dhe për këtë arsye KVO vendosi në mënyrë unanime të vlerësojë OE me: **39 pikë**.

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare: **83.45 pikë**.

Pesha e Propozimit Teknik është 80%, prandaj pikët e marra për këtë operator do të konvertohen në **66.76 pikë**.

Pas vlerësimit të Propozimit Teknik, Komisioni I Vlerësimit të Ofertave vazhdoi me vlerësimin e Propozimit Ekonomik, pasi në sistem duhet të përfundojmë dhe rubrikën "Kuotim", në mënyrë që të vazhdojmë me hapat e tjera të procedurës.

Në këto kushte, KVO bëri hapjen e ofertave ekonomike në sistem, si më poshtë vijon:

- BOE "4.K.." sh.p.k "A..." sh.p.k me ofertë **9,800,000** Lekë pa TVSH;
- OE "N..." sh.p.k me ofertë me ofertë **9,064,000** Lekë pa TVSH;
- OE "S...." shpk me ofertë **6,750,000** Lekë pa TVSH;
- OE "Gj...t" shpk me ofertë **9,801,000** Lekë pa TVSH;
- OE "I...." shpk me ofertë **9,700,000** Lekë pa TVSH;

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri gjithashtu dhe verifikimin e llogaritjeve aritmetike të cilat rezultojnë të sakta.

Për vlerësimin e ofertës më të mirë, KVO zbatoi formulën e përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

OE	Oferta paTVSH	Pe-100*Çu/Ç	Pikët	Pesha e propozimit ek.
BOE "4...&"A..." sh.p.k	9800000	100*8460000/9800000	86.33	17.27
OE "GJ...." shpk	9801000	100*8460000/9801000	86.32	17.26
OE "I...." shpk	9700000	100*8460000/9700000	87.2165	17.44
OE "N....." sh.p.k	9064000	100*8460000/9064000	93.3363	18.67
OE "S...." shpk	8460000	100*8460000/8460000	100	20

•
Çu-çmimi më i ulët

Ç-çmimi i ofertuar i rradhës

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, **vendosi** të miratojë klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

OE "N...." sh.p.k me ofertë	83.83 pikë
BOE "4K...." sh.p.k & "A..." sh.p.k	82.07 pikë
OE "S...." shpk	80.8 pikë
OE "Gj...." shpk	84.99 pikë.
OE "I...." shpk	84.2 pikë

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

- Nuk është qartë nga grupi i auditimit mbi mënyrën e përzgjedhjes së kampionit mbi qytetet e përzgjedhura, duke përfshirë qytete të tilla si Dibër, Tropojë, Krujë, Durrës, Rrogozhinë dhe se cilat do jenë pritshmëritë nga ana e institucionit të Agjencisë për Eficencën e Energjisë.
- Në lidhje me dokumentacionin e mbajtur nga Anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartuesit e termave të referencës nuk kuptohet qartë metoda që ka përdorur për përllogaritjen e fondit limit, të kampioneve të përdoru dhe sipërfaqeve përkatëse të pallateve që do të përdoren si kampion për realizimin e objektit të kontratës.
- Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertave nuk janë bazuar në metodën e çmimit më të ulët, duke skualifikuar oferta të sjellë nga O.E. të cilët kanë qenë më të ulëta se oferta ekonomike e përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- **Projekt Pilot “Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, viti 2022.**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “ Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”		
Urdhër Prokurimi : Nr.1044 datë 28.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T. Z. A.M. Z. O.I.	3. Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: Xh.A. M.P. F.D.
4. Fondi limit (pa TVSH): 66,500,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 16.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: 1. BOE “S..” &”S” &” L..” 2. BOE “N...” & “LL..” 3. OE “A...” 4. BOE “N..” & “T...” 5. OE “A...” b) Kualifikuar: 1. BOE “N..”.&” LL.”.... 2. BOE “S..”.&”S” & “L....”	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. Xh.A. Z. F.D. Z. M.P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 63,241,500 lekë

3. OE "A.."		
10. Data e lidhjes së kontratës Nr. 1638 Prot. datë 04.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 3,258,500 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 11 muaj

Në datë 22.12.2021 është ngritur Urdhri Nr.2680 Prot për krijimin e grupit të punës për studimin e tregut dhe hartimin e termave të referencës për projektet që do të zhvilloheshin gjatë vitit 2022 me përbërje:

K.T.

Xh.Sh.

Xh.S.

Në termat e referencës janë përzgjedhur 5 objekte nga 15 që Bashkia Tepelenë ka përzgjedhur.

Për secilin nga 15 objektet do të përzgjidhen 15 njësi për të cilat do të bëhet një analizë e detajuar mbi konsumin e pajisjeve.

Projekti do të përfshijë 5 (pesë) faza:

Faza I: Auditim paraprak energjetik i godinave të përzgjedhura duke përfshirë analizën e gjendjes ekzistuese dhe certifikatat e gjendjes ekzistuese.

Faza II: Projekt zbatimi

Faza III: Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së energjisë paraprake .

Faza IV - Realizimi i punimeve të ndërtimit

Faza V - Hartimi i raportit përfundimtar të auditimit dhe nxjerrja e Certifikatës së Performancës së Energjisë – përfundimtare (pas punimeve të zbatimit).

Komisioni i përllogaritjes së fondit limit, ka pasqyruar në proces verbalin Nr. 963/2, datë 20.04.2022 analizën e llogaritjes së fondit limit. Referuar proces verbalit të sipërcituar, sipërfaqja totale që do të auditohej është 10,640 m², siç pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Sipërfaqet sipas objekteve

Objekti	kate	m ² /kate	Sip. Totale (m ²)
1	5	250	1,250
4	5	594	2,970
7	5	288	1,440
8	5	278	1,390
16	5	718	3,590
			10,640

Përllogaritja e fondit limit nga grupi i punës është bërë mbi bazën e VKM 354/2016 “Për miratimin e manualit të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim“ dhe çmimit të tregut për dritare të cilat mbi bazën e 3 ofertave të marra në vlerën mesatare janë përcaktuar në shumën 28,270 lekë.

I. Për zërin **2.358/b**. Veshje fasade me polisterol jeshil t=8 cm + rrjete +suva, llogaritja e çmimit të termoizolimit të mureve (8 cm) është përcaktuar në shumën **3189 leke/m²**

II. Për zërin e termoizolimit të tarracave (10 cm) është përcaktuar shuma **3480 leke/ m²**

III. Mbi bazën e të dhënave të pikës I,II, dhe sipërfaqeve të fasadës, mureve, dritareve dhe terracës është përcaktuar vlera e punimeve në shumën **61,443,296 lekë**, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

-Referuar udhëzimit nr.5, date 12.01.2021, për formatin e auditimit, energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik, është përcaktuar që për sip. mbi 1000 m², tarifa është 250 lekë/m².

-Raporti paraprak dhe nxjerrja e CPE **paraprake** nga grupi i punës është llogaritur në shumën 2,347,500 lekë.

-Raporti përfundimtare dhe nxjerrja e CPE **përfundimtare** nga grupi i punës është llogaritur në shumën 2,347,500 lekë.

Vlera e projektim dhe rilevimit është përcaktuar në shumën **500, 000 lekë**.

Vlera e propozuar e realizimit të projektit

Faza I	Auditim Paraprak Energjetik i Ndërtesave	Lekë	0
Faza II	Projekt i Zbatimit	Lekë	500,000
Faza III	Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së Energjisë – Paraprake (Para Punimeve të Zbatimit)	Lekë	2,347,500
Faza IV	Realizimi i Punimeve	Lekë	61,443,296
Faza V	Hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit Dhe Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së Energjisë – Përfundimtare (Pas Punimeve të Zbatimit)	Lekë	2,347,500
	Shuma Auditim, Projektim dhe Ndërtim Pa TVSH		66,638,269

Hartimi i DST

Në datë 28.04.2022 është ngritur urdhri me Nr.1044 Prot për prokurimin e fondeve publike me objekt Projekt Pilot: “Auditim certifikim, hartim projekt-zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës me fond limit 66,500,000 leke pa TVSH.

Në datë 28.04.2022 është mbajtur procesverbali me Nr. 1044/1 Prot për hartimin e dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit me përbërje A.M., O.I., K.T.

Nga auditimi konstatohet se:

Në pikën 2.3.2.a, të DT, AK ka kërkuar: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	P-3C	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
2	P-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
3	S-4C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

Referuar procesverbalit nr. 936/2 Prot. datë 20.04.2022 për llogaritjen e fondit limit konstatohet se vlera totale e punimeve është 61,443,296 lekë pa TVSH.

Grupi i auditimit referuar zërave të punimeve konstatoi se duhet të ishte kërkuar vetëm një nga licencat NP-3 ose NS-4 pasi të dyja i përfshinë punimet që do të kryhen ose të dyja së bashku por duke i kërkuar në kategori të vlerës së punimeve që përfshihen në këto licenca.

Konkretisht licenca NS-4C sipas procesverbalit është kërkuar për “*Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese*” ku përfshihen punimet e vendosjes së dritareve dhe vlera e tyre sipas fondit limit (për 5 pallate) është 26,480,509 lekë pa TVSH, kështu që duhej të kërkohej NP- 3 dhe NS-4 sipas vlerës të kategorisë B 21- 50 milion lekë.

N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Në pikën 2.4.1.b), AK ka kërkuar: “*Operatori ekonomik i tenderit duhet të jetë i licencuar nga Kodi III.2.A i Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Për auditimin mjedisor dhe ndikimin në mjedis*”.

Referuar veprimtarisë që kërkohet të kryet në këtë procedurë prokurimi kërkesa për licencën me Kod III.2.A për auditimi mjedisor dhe ndikimin në mjedis, është një kërkesë e paargumentuar dhe në mospërputhje me përcaktimet e pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike) të VKM në. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Kriteret duhet të jene ne përpjesëtim dhe te lidhur ngushte me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*”.

Në pikën 2.3.4.a) të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar për realizimin e shërbimit të projektimit si dhe të auditimit të efikasitetit të energjisë për pajisjet në objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të regjistruar 2 (dy) Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë në ndërtesa).

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efikasitetin e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë të personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit kanë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit të përbërë nga z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë

Teknike në AEE, z. O.I., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike dhe znj. K.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Për sa më sipër është në mospërputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Vlerësimi i ofertave

Në datë 28.04.2022 është ngritur urdhri me Nr.1046 Prot për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje Xh.A., M.P. dhe M.K. zëvendësuar me F.D. në bazë të urdhrin nr.1300 Prot. date 24.05.2022.

Në këtë procedurë kanë shprehur interes OE/BOE si më poshtë:

BOE “N... & T”...41,577,800 leke pa TVSH.

BOE “S...&S “& “L..”. 61,400,000 leke pa TVSH.

BOE” N...& L.”63,241,500 leke pa TVSH.

OE “A.”...63,616,811 leke pa TVSH.

OE “4K...& A”..... 64,950,000 pa TVSH.

Sipas proces verbalit të sipërpërmendur, KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga OE/BOE, ka kualifikuar për të vijuar me vlerësimin e pikëve sipas kriterëve teknike dhe financiare OE/BOE të mëposhtëm:

1. BOE “N... & T.”..., pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST.
2. BOE “S...”&”S’ & “L”...., pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST.
3. BOE “N... & L”..., pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST.
4. OE “4K... & A.”.., pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST.
5. **Të skualifikojë OE ”A”....**, pasi nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme sipas shtojcës 8 dhe kriteret e veçanta, si: Formularin përmbledhës të vetëvlerësimit, shtojca 8, sigurimin e ofertës shtojca 3, kriteret 2.1 shtojca 8, kriterin2.2.1, kriterin 2.3 dhe kriterin 2.4.

KVO, më pas ka kaluar me vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes fitues, mbështetur në kushtet e përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, bazuar në kriterin e çmimit më të favorshëm bazuar në kosto:

Referuar pikës 4.4. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit në DT janë si më poshtë:

Kriteret e peshës së vlerësimit

Kriteri	Pesha, %	Tipi
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimi social	5.00	Teknike
Stafi/Eksperiencia dhe organizimi i kompanisë	30.00	Teknike
Çmimi	50.00	Financiar
Periudha e garancisë së objektit	5.00	Teknike
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	10.00	Teknike

Në referim të raportit përfundimtar dhe vlerësimit në SPE renditja e OE/BOE nga KVO paraqitet në tabelën e mëposhtme:

KVO ka skualifikuar si ofertë anomalisht të ulët BOE “N...”.&” T.”....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 18.05.2022 ka kërkuar sqarime nga OE BOE “N...” & “T...” pasi oferta e tij klasifikohet si ofertë anomalisht e ulët.

Në datë 20.05.2022 OE ka dërguar sqarimet për ofertën e tij me shkresën Nr. 1273 Prot, i cili është shprehur se: *Meqenëse objekti në fjalë i cili kërkohet të rikonstruktohet, është pranë qendrës kryesore të kompanive tona, ngritja e kantiereve dhe zhvendosjet e tyre në përfundim të objekteve janë shumë të thjeshta dhe organizimi si për ndërtim ashtu dhe heqjen e tyre është më i lehtë dhe me më shumë pak kosto se në objekte me largësi të konsiderueshme.*

Në çmimin e ulet ndikon edhe transporti i materialeve, gjë të cilën kompania jonë e realizon me mjetet e saj, të cilat i ka në pronësi

Në datë 01.06.2022 Komisioni Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimin për këtë procedurë duke e skualifikuar BOE “N...” & “T...” për ofertë anomalisht të ulët, pasi sipas KVO, sqarimet e BOE “N...” & “T...” për ofertën dhe zërat kryesorë nuk justifikonin ofertën anomalisht të ulët.

“Vetë operatori ekonomik në punë të ngjashme të mëparshme të dorëzuara prej tij për zërat që AK ka kërkuar sqarime ka ofertuar më shumë duke marrë parasysh dhe që këto procedura janë kryer vite më parë ku çmimet e materialeve pas kësaj periudhe kishin pësuar rritje të konsiderueshme nisur dhe nga analiza e çmimeve që vetë AK ka kryer për përlogaritjen e fondit limit”.

Nga auditimi konstatohet se:

BOE “N..” & “T..” është skualifikuar si ofertë anomalisht të ulët:

Njoftimi i shpalljes së fituesit Nr. 1044/6 Prot., datë 16.06.2022 shpallet fitues BOE “N...” & “L...” me ofertë 63,241,500 lekë pa TVSH.

Nr.	Nr. Analizë	NG Structures	Studio Services	Net Group	Albavia	Arkonstudio
1	Faza I-Auditimi paraprak energjetik i ndërtesave dhe nxjerrja e certifikatës paraprake te energjisë	1,000,000	450,000	3,415,041	8,181,200	3,500,000
2	Faza II-Projekt zbatimi	500,000	8,310,000	11,383,470	12,102,101	450,000
3	Faza e III-realizimi I punimeve	39,577,800	52,190,000	44,269,050	38,142,218	57,500,000
4	Faza IV-Hartimi I Raportit Përfundimtar dhe Nxjerrja e Certifikatës Përfundimtare	500,000	450,000	4,173,939	5,191,292	3,500,000
				Fitues		
	Shuma e ofertës (Pa TVSH)	41,577,800	61,400,000	63,241,500	63,616,811	64,950,000
	Vlerësimi teknik	40	27	44.35	-	42.7
	Vlerësimi financiar	50	33.86	32.87	-	32.01
	Totali	90	60.86	77.21	-	74.71
	Totali ne SPE	Anomalisht e ulët	183.00	232.05	Skualifikuar	223.80

Në datë 04.07.2022 lidhet kontrata me BOE “N...”.& “L...” me Nr. 1638 Prot.

Në datë 04.07.2022 bëhet shpallja e formularit të njoftimit të kontratës së nënshkruar me Nr. 1638/1 Prot.

Afati i realizimit të kontratës është 11 muaj

Faza	Afatet
------	--------

Faza 1 - Auditim paraprak energjistik i ndërtesave	2 muaj-04.12.2022
Faza 2 - Projekt zbatimi	1 muaj-04.01.2023
Faza 3 - Nxjerrja e CPE paraprake	1 muaj- 04.02.2023
Faza 4 - Realizimi i punimeve te ndërtimit	5 muaj -04.07.2023
Faza 5 - Auditim perfundimtar	2 muaj-04.09.2023

Zbatimi i kontratës.

Për objektin **“Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

5) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis AEE dhe BOE “N...” sh.p.k & “L...” sh.p.k me Nr.1638 prot. datë 04.07.2022.*

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*

- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

- *Etj.*

6) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis AEE dhe OE “D..” sh.p.k me Nr.3654/3Prot. datë 04.10.2022.*

- *Korrespondencat mes AEE dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “D...” sh.p.k, etj.*

Kontratat

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike me Nr.1638 prot. datë 04.07.2022 me objekt *“Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”* të lidhur mes Autoritetit Kontraktor AEE, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. E.D. dhe BOE “N...” sh.p.k & “L...”sh.p.k të përfaqësuar nga administratorët z. V.B. dhe z. A. L. me licenca profesionale N.6830/10 dhe NZ.4838/17. Vlera e kontratës është 63,241,500 lekë pa TVSH ose 75,889,800 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 11 muaj nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve kjo e përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës Neni 4 “Data e fillimit”. Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me Shtesë Kontrate Nr.459/1 datë 30.08.2023 duke e zgjatur me 30 ditë kalendarike me arsyen e temperaturave shumë të larta që kanë sjellë reduktimin e orëve të punës si dhe proceset e punës kërkojnë kushte optimale për realizimin e tyre sipas specifikimeve teknike.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.3654/3 Prot. datë 04.10.2022 me OE “D...” sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1676/12, si dhe me vlerë të kontratës 737,499 lekë pa TVSH ose 884,999 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.533/3 Prot. datë 24.11.2023 me OE “A...” sh.p.k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/6 dhe me vlerë të kontratës 35.000 lekë pa TVSH.

Zbatimi i punimeve

Miratimi me kusht të deklaratës paraprake për kryerje punimesh është miratuar nga Bashkia Tepelenë me Vendim Nr. DP160623, datë 23.06.2023. Ndërhyrjet e realizuara janë në: punime tarrace me polisterol 5 cm llustër çimento dhe hidroizolim me emulsion bitumi 2 shtresa katrama; punime veshje fasade me polisterol 8 cm, rrjetë dhe suva si dhe punime dritare e dyer duke zëvendësuar ato me të reja të cilat duhet të jenë duralumin i veshur me plastik.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve është data 27.06.2023, kjo sipas njoftimit përkatës të bërë nga sipërmarrësi me shkresën Nr. Prot.301, datë 27.06.2021 dhe mbikëqyrësi me shkresën Nr.124/1Prot. datë 27.06.2023. Këto njoftime janë vetëm për pjesën e punimeve të zbatimit në terren, por kontrata ka filluar më datë 04.10.2022 kur është lidhur kontrata e mbikëqyrësit të punimeve. Nga data 04.10.2022 deri më datë 27.06.2023 janë kryer auditim paraprak energjetik i ndërtesave dhe nxjerrja e certifikatës paraprake si dhe realizimi i projektit të zbatimit.

Me shkresat Nr.Prot. 420/1 datë 18.09.2023 sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi me shkresën të administruar në AEE Nr.257/6 Prot. datë 18.09.2023 njoftojnë përfundimin e punimeve civile në terren të shoqëruar me procesverbalin përkatës.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në administruar në dosjen teknike. datë 04.12.2023. Në dosjen teknike gjendet akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm por jo i firmosur nga Bashkia Tepelenë dhe nga Autoriteti Kontraktor AEE.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Projekt pilot “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës””.		
14.Lidhja e kontratës Nr.1638 prot. datë 04.07.2022	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 78,925,224 lekë BOE N....sh.p.k & L... sh.p.k	16.Likuiduar deri dt
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 74,753,365 lekë -Vlera pa TVSH 62,294,471 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 11 muaj, Zbatuar 12 muaj Fillimi punimeve: 04.10.2022 Përfundimi punimeve: 07.01.2022	19. Zgjatja e kontratës Shtesë Kontrate Nr.459/1 datë 30.08.2023
20. Mbikëqyrësi i punimeve “D....” sh.p.k	Licenca Nr: MK. 1676/12	Kontrata Nr.3654/3 Prot. datë 04.10.2022
21. Kolaudatori i punimeve “A....” sh.p.k	Licenca Nr: MK.2892/6	Kontrata Nr.533/3 Prot. datë 24.11.2023
22.Akt Kolaudimi datë 04.12.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim Gjendet në dosje por jo i firmosur nga bashkia dhe AK	

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme ku mund të kryheshin verifikime, në prezencë të grupit të marrjes në dorëzim dhe mbikëqyrësit të punimeve, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **150,220 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë Punime suvatimi e veshje, për zërin Veshje fasade me polisterol t=8 cm +rrjetë + suva në librezat e masave për të gjitha godinat pasqyrohet volum punimesh 6184 m² dhe e njëjta sasi e likuiduar në situacionin përfundimtar. Nga vizita në terren u konstatua se në Godinën 7, faqja veriore në krah të majtë të shkallëve dhe në Godinën 4 faqja perëndimore veshja e tyre ishte realizuar me polisterol të trashësisë 5 cm dhe në Godinën 16 një pjesë e faqes veriore. Nga matjet e kryera në vizatimet sipas faktit rezultoi se, sipërfaqja e realizuar me polisterol me trashësi 5 cm, në Godinën 7 është 78 m², në Godinën 4 është 319 m² dhe në godinën 16 është 183 m² pra në total është 580 m². Referuar analizës së çmimit të paraqitur nga kontraktori duke zëvendësuar në të trashësinë e polisterolit 0.05m rezulton se çmimi është 2766 lekë/m². Pra kontraktori ka përfituar

më tepër diferencën e çmimit me polisterol 5 cm dhe 8 cm për sipërfaqen e realizuar me polisterol 5cm e cila është 259 lekë/m².

An+2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=8cm + rrjete + suva.	m2																	
	Sp + p	op	5.8	185	1073														
	Signumme shoqerore 16.7%	leke	1073	0.167	179														
	Transport	T*km				0.95	21	20											
	Elektro argano	op							0.35	45	15.75								
	Trapano	op							0.18	95	17.1								
	Polisterol 8cm	m2										0.08	7310	585					
	Kolle per rrigjite	kg										4	25	100					
	Upa betoni plastike	cope										9	22	198					
	Rrjete plastike	m2										1.1	80	88					
	Grafiato per suva	kg										5.0	25	125					
	Skele inventar	m2										1.25	130	163					
	Shuma :				1282			20			33		1258	2563	205	256	3028		

Kontraktori ka përfitur më tepër vlerën prej 150,220 lekë pa TVSH (259 lekë/m² x 580 m²) në zërin Veshje fasade me polisterol t=8 cm + rrjetë + suva.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon (sipas ushtrimit të detyrave funksionale përkatëse):

- Nga ana e mbikëqyrësit OE "D..." sh.p.k nuk janë marrë masa për zbatimin e:
 - Kontratës së shërbimit Nr.3654/3 Prot. datë 04.10.2022 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin Projekt pilot 'Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare' me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës", konkretisht:
 - Neni 6, "Detyrimet e Palëve".
 - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"
 - Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës"
 - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

"3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të

Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

- “Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore” viti 2022.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore”, viti 2022		
Urdhër Prokurimi : 1045 datë 28.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T. Z. A. M. Z. O.I.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: znj. K.T. z. Xh.SH. znj. Xh.S.
4. Fondi limit (pa TVSH): 45.000.000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 16.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: O.E. “A.....” Sh.p.k L..... O.E. “LL.....” Sh.p.k K..... b) Kualifikuar: O.E. “A....” Sh.p.k L.....	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. Xh.A. Z. F.D. Z. M.P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 42.250.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 04.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 2.750.000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 11 muaj

Në zbatim të Urdhërit nr 2680, datë 22.12.2021, "Për ngritjen e Komisionit të hartimit të termave të referencës" si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurim publik (i ndryshur) dhe VKM-së 914 datë 29.12.2014 (i ndryshuar) Njësia e Prokurimit Publik ka hartuar dokumentat e tenderit për procedurën me objekt: "Projekt Pilot për "Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës" - Rruga e Energjisë Pastër".

Bashkëlidhur Procesverbalit:

I mbajtur sot më datë 16.05.2022, në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, mbi bazën e Urdhrit nr. 1046, datë 28.04.2022 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: "Projekt Pilot për "Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të

parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodres" — me fond limit 45.000.000 (dyzet e pese milion) lekë pa TVSH, me burim financimi: "Buxheti i Shtetit". nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me perberjen si më poshtë:

- M.K. Kryetar
- Xh.A.
- M.P.

Përsa me sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bëri hapjen e ofertave nga operatorët ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku u paraqitën operatorët ekonomike si më poshtë vijon:

- BOE "A.." shpk, "4K.." shpk, dhe "N..." shpk me ofertë: 42,250,000 (dyzet e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
- OE "Ll..".....shpk me ofertë: 44,500,000 (dyzet e katër milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Më datë 16.05.2022 në SPE, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bëri hapjen e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë si më poshtë:

BOE "A..." shpk," 4 K.." shpk, dhe "N..." shpk me ofertë: 42,250,000 (dyzet e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH "Ll.." shpk me ofertë: 44,500,000 (dyzet e katër milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në pikën 2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale) janë kërkuar licencat e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve	
1	NP-2A	Ndërtime civile dhe industriale	0-20 milione lekë
2	NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	0-20 milione lekë
3	NS-5B	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.	21-50 milione lekë

Në **pikën 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet te disponoje license projektimit, mund të nënkontrakttojë shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, date 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Licensa e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- Kat 4/i Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.
- Kat 4/g Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.
- Kat 8/a Rilevime inxhinierike.

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që në preventiv përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndricuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat kërkojnë pajisjen me licensat përkatëse si:

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A

Gjithashtu në lidhje me licensat e projektimit është kërkuar licenca Kat 4/g në lidhje me projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa e cila nuk gjen zbatim në preventivin e punimeve.

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:

-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

Në lidhje me pikën **2.3.4 Staf**

2.3.4.a) personelin kryesor

1 Inxhinier Elektrik ose elektronik

1 Inxhinier topograf ose gjeodet ose markshaider

1 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë, në instalime industrial)

2.3.4.b) stafin ndihmës

1 Inxhinier Elektrik ose Elektronik

2.3.4.c). Pajisje e mëposhtme të auditimit.

- Luxometër

- Kamera termike

2.3.4.d) stafin kryesor

1 (një) arkitekt ose Inxhinier ndërtimi

1 (një) inxhinier elektrik ose elektronik

1 (një) Inxhinier gjeodet ose markshaider ose topograf

1 (një) Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, për Menaxhim Energjie).

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Staf, në lidhje me kërkesën për 1 arkitekt ose inxhinier ndërtimi, nisur dhe nga preventivi i punimeve është i pa arsyetuar dhe paargumentuar nga ana e Njësisë së prokurimit.

Gjithashtu caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

2.3.4.e) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 (një) individ të pajisur me një certifikatë "**Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit**"

1 (një) individ të pajisur me një certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**"

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	Vinc me kosh	në pronësi ose me qira	Copë 1

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.a) Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë
ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
ISO 50001-2018 Sistemet e Menaxhimit të Energjisë
ISO 14001-2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Për sa më sipër është në mospërputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit kanë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit të përbërë nga z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike në AEE, z. O.I., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike dhe znj. K.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Vlerësimi i ofertave

KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, vendosi:

Të vijojë me vlerësimin me pikë për BOE “A...” shpk, “4K...” shpk, dhe “N...shpk” pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST:

Të skualifikojë OE “L1..”. shpk pasi:

OE Llazo shpk është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të veçanta të DST, përkatësisht;

Në pikën 2.3.2 (**Kapacitetet teknike dhe profesionale**) OE “L1..”. shpk nuk plotëson kategorinë e kryerjes së punimeve NS-5B-Impjante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Në pikën 2.3.2 (**Kapacitetet teknike dhe profesionale**) OE “L1..”. shpk nuk plotëson kategoritë në licencën e projektimit si më poshtë;

- Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme
- Kat 4/i Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive, etj.
- Kat 4/g Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

Në pikën 2.3.4.a) Stafi Kryesor OE “L1..”. shpk nuk plotëson kriterin e pasjes në stafin kryesor 1 (një) Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në instalime industrial).

Në pikën 2.3.4.c) OE “L1..”.shpk nuk plotëson kriterin e pasjes në pronësi ose me qera të pajisjeve të mëposhtme të auditimit.

- Luxometër
- Kamera termike.

Argumentim mbi Vlerësimin

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi

pikët 50

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit

pikët 10

Stafi / Eksperienca dhe Organizimi i Kompanisë

pikët 30

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

pikët 5

Periodha e garancisë së objektit / 0 0

pikët 5

Ofertat e kualifikuara për këtë procedurë janë ofertat e paraqitura nga OE:

BOE “A...” shpk, **“4.K...”** shpk, dhe **”N...”** shpk ka paraqitur ofertën ekonomike me vlere: **42,250,000 Lekë** pa TVSH.

Çmimi [50 pikë].

Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk për çmimin sipas llogaritjes me formulë merr : **50 pikë.**

Metodologjia e propozuar dhe grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [10 pikë]

Operatori ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk ka paraqitur metodologji punimi duke përcaktuar çdo proces pune që do të realizohet sipas termave të referencës, të plotë me 140 faqe. Janë përfshirë detyrat e detajuara për secilën fazë të procesit të punës të përcaktuar në termat e referencës, si dhe metodologjia për një projektim dhe realizim eficient të ndriçimit rrugor.

Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk për **Metodologjia e propozuar** është vlerësuar me **6.5 pikë.**

a) Grafiku i punimeve është paraqitur në një afat kohor prej 7.5 muaj, e ndarë dhe e detajuar sipas secilës fazë të projektit, nga 11 muaj e përcaktuar në DST.

Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk për **grafiku i punimeve** sipas llogaritjes me formulë merr **2.0 pikë**, për **kohën e mobilizimit** sipas llogaritjes me formulë merr **1.0 pikë.**

Stafi / Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë [30 pikë].

Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kriterëve të vecanta të kualifikimit për stafin [5 pikë]

Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [5 pike].

Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [8 pike].

Dëshmi që stafi disponon eksperience në natyrë/kompleksitet të ngjashme për projekte auditimi dhe punë të ngjashme të realizuara në zbatim në fushën e efijencës së energjisë. [10 pike].

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi (0-2 pikë)

Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk për **Stafi/ Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë** sipas vlerësimit merr: **28.7 pikë**, kjo pasi ky operator ka dëshini (kontrata bashkëpunimi) të stafit të tij me kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar, dhe përvojë në fushën e efijencës së energjisë në punë të ngjashme.

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-5 pikë].

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efijente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor.
- b. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-3 pikë]
- c. Propozime konkrete për përnirësim të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-2 pikë].

Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk për **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** sipas vlerësimit të llogaritjes me pikë men: **4.7 pikë.**

Kjo pasi ky operator ka dhënë disa zgjidhje duke punësuar me kontratë të rregullt pune për zbatimin e punimeve të punëtoreve vendas të specializuar për punime sipas kontratës, por dhe duke mbrojtur ambientin dhe personat rreth tij, të paraqitur dhe në metodologjinë e realizimit të punimeve. Operatorët ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk ka ofruar një garanci punimesh 24 muaj për këtë arsye sipas llogaritjes me formulë vlerësohet me **5 pikë**.

Pikët totale të mara nga Operatori Ekonomik BOE “A...” shpk, “4K...” shpk dhe “N...” shpk janë : **97.9 pikë**.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

- Nuk kuptohet qartë nga grupi i auditimit mbi mënyrën e përzgjedhjes së kampionit mbi përzgjedhjen projekteve, specififikisht mbi përzgjedhjen e qytetit të Shkodrës, kryesisht unazave lindore dhe perëndimore, ku numri dhe intesiteti i përdorimit të makinave është më i ulët se në disa zona të tjera të qytetit, duke qenë se objekt i zhvillimit të procedurës së prokurimit janë dhe stacionet e karikimit të makinave.
- Në lidhje me dokumentacionin e mbajtur nga Anëtarët e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartuesit e termave të referencës nuk kuptohet qartë metoda që ka përdorur për përlllogaritjen e fondit limit, të kampioneve të përdorur dhe sipërfaqeve përkatëse të pallatave që do të përdoreshin si kampion për realizimin e objektit të kontratës.
- Në preventiv përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndricuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat kërkojnë pajisjen me licencat përkatëse si:
NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A.
- Gjithashtu në licencat e projektimit është kërkuar licenca Kat 4/g në lidhje me projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa e cila nuk gjen zbatim në preventivin e punimeve. Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë, si më poshtë:
-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- Pika 2.3.4 Stafii, në lidhje me kërkesën për 1 arkitekt ose inxhinier ndërtimi, nisur dhe nga preventivi i punimeve është i pa arsyetuar dhe paargumentuar nga ana e Njësisë së prokurimit.

Kontrata e zbatimit.

për objektin “Projekt Pilot për “Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës” - Rruga e Energjisë Pastër” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

7) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis AEE dhe BOE “A.. & 4. K... & N...” sh.p.k me Nr.1640 prot. datë 04.07.2022.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Etj.
- 8) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis AEE dhe BOE “L.... & A...” sh.p.k me Nr.3653/3Prot. datë 04.10.2022.
- Korrespondencat mes AEE dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “L...” sh.p.k. etj.

Kontratat.

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike me Nr.1640 prot. datë 04.07.2022 me objekt “Projekt Pilot për “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efizienzë të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës” - Rruga e Energjisë Pastër” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor AEE, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. E. D. dhe BOE “A..& 4.K.. & N...” sh.p.k të përfaqësuar nga administratorët z. N.Ç., z. F.P., z. V.B. me licenca profesionale NZ.7087/9, N.6984/3 dhe N.6830/10. Vlera e kontratës është 42,250,000 lekë pa TVSH ose 50,700,000 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7.5 muaj nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve kjo e përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës Neni 4 “Data e fillimit”.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.3653/3 Prot. datë 04.10.2022 me BOE “L... & A...” sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3336/2, si dhe me vlerë të kontratës 520,868.75 lekë pa TVSH ose 625,042.5 lekë me TVSH. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.395/3 Prot. datë 03.07.2023 me OE “A...” sh.p.k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3573 dhe me vlerë të kontratës 32,000 lekë pa TVSH.

Zbatimi i punimeve

Është dorëzuar faza e parë nga supervizori Nr. Prot.3789 datë 12.10.2022 e cila përmban analizën e gjendjes ekzistuese për segmentet rrugore Unaza Lindore dhe Perëndimore, projekt zbatimi, matjet me DIALux dhe preventivin e rishikuar. Nga matjet me DIALux evidentohet se fuqia e ndriçuesve duhet të jetë 82.5 W për të patur një sipërfaqe rrezatimi të madhe por dhe efizienzë të lartë energjie favorizuar kjo dhe nga distanca midis shtyllave. Është uluar numri i ndriçuesve nga 670 parashikuar në Termat e Referencës në 472. Preventivi është rishikuar në vlerën 44,170,036 Lekë me TVSH nga vlera fillestare 50,700,000 lekë me TVSH.

Miratimi me kusht të deklaratës paraprake për kryerje punimesh është miratuar nga Bashkia Shkodër me Vendim Nr. 747, datë 26.10.2022. Ndërhyrjet e realizuara janë në: Vendosje ndriçuesish LED me fuqi më të vogël, shtim të numri të shtyllave, shtrim linjë elektrike, vendosje karikues për makinat elektrike dhe pemë fotovoltaike (Smart Floëer).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve është data 07.11.2022, kjo sipas njoftimit përkatës të bërë nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi me shkresat Nr. Prot. 3489/2, datë 07.11.2022. Këto njoftime janë vetëm për pjesën e punimeve të zbatimit në terren, por kontrata ka filluar më datë 04.10.2022 kur është lidhur kontrata e mbikëqyrësit të punimeve.

Me shkresat Nr. 265 Prot. datë 16.05.2023 të administruar në AEE sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi njoftojnë përfundimin e punimeve civile në terren. Hartimi i raportit përfundimtar është njoftuar me shkresë Nr.Prot.265/1 datë 09.06.2023. Së bashku me raportin përfundimtar është sjellë dhe dosja teknike e cila përmban projektin e azhurnuar si dhe preventivin përfundimtar të rishikuar në vlerën përfundimtare 39,075,366 lekë me TVSH.

Referuar grafikut të punimeve të ofertuar nga BOE për të gjitha fazat e parashikuara në DST me afat 7.5 muaj e cila ka filluar më date 04.10.2022 me lidhjen e kontratës së mbikëqyrësit të punimeve dhe duhet të përfundonte më datë 18.05.2023. Si datë e përfundimit të punimeve është paraqitja e raportit përfundimtar të auditimi të efizienzës së energjisë e paraqitur në AK me shkresën Nr. 265/1 Prot. datë 09.06.2023. Për sa më sipër përfundimi i të gjitha fazave të kontratës

nuk kanë përfunduar sipas afate të përcaktuara por me 22 ditë vonesë e cila është konstatuar edhe nga grupi i ndjekjes së kontratës. Bazuar në Nenin 20 i kontratës “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore” b) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* penaliteti për vonesa është **358,190 lekë pa TVSH** (32,562,805 lekë x 25% x 2/1000 x 22 ditë).

Nga ana e AK nuk është marrë në dorëzim me arsyen se një pjesë e ndriçueseve në Unazën Lindore afërsisht 2.2 km janë jashtë funksionit si dhe pema fotovoltaike e pa lidhur në rrjet. Sipas mbikëqyrësit të punimeve mosfunksionimi i unazës lindore është si rezultat i vjedhjes së linjës elektrike.

Është iniciuar kërkesa për kolaudimin e objektit nga Drejtori Teknik z. A.M. me Nr.395 datë 03.07.2023. Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në dosjen teknike është në datë 25.07.2023. Punimet nuk janë marrë në dorëzim nga ana e grupit të ndjekjes së kontratës pasi nga ana e tyre u konstatuan mangësi në realizimin e punimeve.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve Projekt Pilot për "Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës" - Rruga e Energjisë Pastër			
14.Lidhja e kontratës Nr.1640 datë 04.07.2022	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 50,700,000 lekë BOE "A...& 4K... & N..." sh.p.k		16.Likuiduar deri dt 03.06.2024 10,393,007 lekë me TVSH
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 39,075,366 lekë -Vlera pa TVSH 32,562,805 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 7.5 muaj, Zbatuar 8.2 muaj Fillimi punimeve: 04.10.2022 Përfundimi punimeve: 09.06.2023		19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "L...& A..." sh.p.k	Licenca Nr: MK.3336/2	Kontrata Nr.3653/3 Prot. datë 04.10.2022	
21. Kolaudatori i punimeve "A..." sh.p.k	Licenca Nr: MK.3573	Kontrata Nr. 395/ Prot. datë 03.07.2023	
22.Akt Kolaudimi datë 25.07.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim nuk ka		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme ku mund të kryheshin verifikime, në prezencë të grupit të marrjes në dorëzim dhe mbikëqyrësit të punimeve, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **1,179,100 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

Grupi i marrjes në dorëzim në përfundim të punimeve ka konstatuar se mungon ndriçimi në segmentin rrugor Unaza Lindore në gjatësinë 3 km rrugë të ndara në 2 segmente, përkatësisht:

Pika 1- Kryqëzimi i rrugës “P.W.” me rrugën “S” deri në sheshin “M. L” (1 km)

Pika 2- Kryqëzimi i rrugës “Sh .Sh” me rrugën “R. L.” deri tek Kopshti “D” (2 km). Gjithashtu edhe pajisja Smart Flower karikuesi për makinat elektrike nuk ishin të lidhura në sistemin elektrik, për rrjedhojë nuk e kryenin funksionin e tyre për të cilin ishin vendosur.

Nga vizita në terren u konstatua se në Unazën Lindore ndriçuesit nuk funksiononin për arsye se mungonte kablli elektrik. Referuar vizatimeve sipas faktit dhe zërave të preventivit gjatësia e kabllit ishte konkretisht për zërat: F.V kabëll FG16OR16, CU, G7, 4x6mm² mungonte 320 ml në vlerën 304,000 lekë pa TVSH (320 ml x 950 lekë/ml); F.V kabëll FG16OR16, CU, G7, 4x10mm² mungonte 332 ml në vlerën 420,200 lekë pa TVSH (332 ml x 1100 lekë/ml); F.V kabëll FG16OR16, CU, G7, 4x16mm² mungonte 215 ml, në vlerën 344,000 lekë pa TVSH (215 ml x 1600 lekë/ml) dhe F.V kabëll FG16OR16, CU, G7, 4x4mm² mungonte 210 ml në vlerën 165,900 lekë pa TVSH (210 ml x 790 lekë/ml). Pra në total sipërmarrësi ka përfituar vlerën totale prej **1,179,100 lekë pa TVSH**.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon (sipas ushtrimit të detyrave funksionale përkatëse):

1. Nga ana e mbikëqyrësit BOE "L...& A.." sh.p.k nuk janë marrë masa për zbatimin e:

- Kontratës së shërbimit Nr.3653/3 Prot. datë 04.10.2022 me objekt: "Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës" - Rruga e Energjisë Pastër", konkretisht:

• Neni 6, "Detyrimet e Palëve".

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit".

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës".

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

"3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi Nr.18 datë 03.06.2024 dhe për këtë çështje mbikëqyrësi i punimeve, me shkresën Nr.396/1 Prot., datë 26.08.2024, administruar në KLSH me Nr.1043/13 Prot., datë 27.08.2024, ka dërguar komente dhe shpjegime, konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

1. Për sa i përket punimeve të pa kryera kontraktori është ende në proces pune duke riparuar ndriçuesit që kanë defekt dhe vendosjen e atyre që janë vjedhur së bashku me kabllin e vjedhur. Në momentin që do të testohet rrjeti të gjitha palët do të jenë prezentë për marrjen në dorëzim të objektit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Ju vet theksoni se punimet e konstatuara si të pa kryera nga grupi i auditimit nuk janë realizuar plotësisht, kështu që deri në këtë fazë të auditimit vlera e konstatuar si dëm ekonomik nuk ndryshon deri në realizimin e plotë të punimeve. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës”, viti 2021.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës 2022		
Urdhër Prokurimi : nr. 311/2 Prot., datë 01.03.2021		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T. Z. A.M. Z. O.I.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: znj. K.T. nj. B.M. z. B.A.
4. Fondi limit (pa TVSH): 39,016,667 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 16.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: O.E. “M...” Sh.p.k J..... O.E. “N...” Sh.p.k L..... O.E. “A...” Sh.p.k J..... b) Kualifikuar: O.E. “M...” Sh.p.k J....	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. Xh.A. Z. F.D. Z. M.P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 37.050.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 04.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 1.966.667 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 11 muaj

Me urdhër nr. 311, datë 11.12.2020 ngrihet komisioni për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, me përbërje:

- znj. K.T.
- znj. B.M.
- z. B.A.

Më datë 17.12.2020, me nr 311/1 Prot., mbahet procesverbali mbi hartimin e dokumentave të tenderit nga njësia e prokurimit.

Me urdhër nr. 311/2 Prot., datë 01.03.2021, ngrihet urdhri i prokurimit për kryerjen e prokurimit me fond prej 33,333,333 lekë pa TVSH.

Me urdhër nr. 311/3 Prot., datë 01.09.2021 ngrihet urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

- z. A.M.
- znj. A.K.
- z. O.I.

Më datë 23.03.2021, me nr. 311/4 Prot., hartohet proces verbali mbi hapjen e ofertave për vlerësimin e fazës-1, shprehje interesi dhe parakualifikim (lista e shkurtër) nga O.E. pjesëmarrës si më poshtë:

- O.E. "N..."sh.p.k.
- O.E. "A..."sh.p.k.

Me anë të shkresës nr. 311/6 Prot., datë 30.03.2021, ftohen të paraqesin propozimin Teknik Operatorët Ekonomik të kualifikuar në fazën e 1.

Në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në pikën 2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale) janë kërkuar licencat e mëposhtme:

Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
NP-3C	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
NP-12C	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
NS-4C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Vlerësimi në lekë (milion) për kategorinë e kërkuar	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3C	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	50-100	Vlera total e projektit
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	0-20	Vlera total e projektit
NS-4C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	50-100	Vlera total e projektit

Vlera totale e projektit e fituar nga BOE është 37.050.000 lekë pa TVSH. Kategoritë e kërkuara për licenca nuk e përfshijnë vlerën totale të projektit, ato përfshijnë vetëm vlerën 22,000,000 lekë pa TVSH.

Në **pikën 2.3.3**. Operatori ekonomik duhet të disponoje licencë projektimit, mund të nënkontrakttojë shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, date 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë :

Kat 2/a, Projektim arkitekturor për objekte banimi-objektet industrial-objekte turistike-
Kat 8/a Rilevime inxhinierike.

Në lidhje me pikën **2.3.4 Stafii:**

2.3.4.a) Stafii Kryesor

1 Arkitekt

1 Inxhinier topograf ose gjeodet ose markshaidet

2 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa).

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

2.3.4.b) stafii ndihmës

1 arkitekt ose inxhinier ndërtimi

2.3.4.c). Pajisje e mëposhtme të auditimit.

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (wm2K)
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë
- Anemometër.

Pajisjet e auditimit duhet të jenë në pronësi të audituesit energjetik i cili i regjistron pranë AEE dhe jo në pronësi të OE. Kërkesa për pajisjet e mësipërme vjen si pasojë e kërkesës për auditues energjetik që të jetë pjesë e stafit të O.E..

2.3.4.d) Operatori ekonomik për zbatimin e punimeve të objektit të prokurimit duhet të ketë në stafii kryesor të inxhinierëve:

1 arkitekt

1 Inxhinier ndërtimi

1 Inxhinier gjeodet ose markshaidet ose topograf

1 Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, për Menaxhim Energjie).

2.3.4.e) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 individ të pajisur me një certifikatë "Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit".

1 individ të pajisur me një certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"

2.3.4.f) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 20 (njëzet) persona.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
-----	--------------------	---------	-------

	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	Skeleri	në pronësi ose me qira	500 m ²

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.a) Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 50001-2018 Sistemet e Menaxhimit të Energjisë

ISO 14001-2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

2.4.1.c) Për produktet e mëposhtme, në rastet kur operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet të vërtetojë me një autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalentin e saj) e cila tregon marrëdhëniet midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ndërmjet ofertuesit-shpërndarësit të autorizuar, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhënat e plota si: telefoni, posta elektronike, faqja e internetit, etj., kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktues në rast të verifikimit, si dhe dokumentet teknike (prospektet teknike, katalogu, etj.) duhet të përkthehen në ato pjesë që pasqyrojnë kërkesat teknike të specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Pajisjet duhet të shoqërohen me certifikata konformiteti dhe cilësie për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.

- F.V. Mbështjellëse termoizolim fasade (sipas termave të referencës)

- F.V. Dritare dopioxham (sipas termave të referencës)

Kriteret e vlerësimit Teknik:

(i) Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit 0-10 Pikë

(ii) Metodologjia e propozuar 20-40 pikë

(iii) Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50 Pikë

(iv) Transferimin e njohurive, (nëse kërkohet)

Me anë të shkresës përcjellëse protokolluar me nr. 311/7 datë 14.04.2021 shoqëria Arkonstudio sh.p. dërgon dokumentacionin teknik për projektin.

Për procedurën e prokurimit "Shërbim konsulence" me objekt "Hartimi i projektit të deteluar të sistemit të ngrohjes së Korçës duke përjashtuar lëndën drusore", me fond limit 33 333 333 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Më datë 23.04.2021 u hapën propozimet ekonomike, dhe më pas Komisioni bëri vlerësimin përfundimtar për ofertat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit teknik, rezultatet janë si më poshtë:

- Ofertuesi "A..." shpk është vlerësuar me **94.33 pikë**
- Ofertuesi N..." shpk është vlerësuar me **79.66 pikë**.

Çmimet e propozuara nga ofertuesit janë:

- "A..." shpk 32 330 000 lekë pa TVSH
- "N..." shpk 33 233 333 lekë pa TVSH

Më pas, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave procedoi, për përlllogaritjet e peshës së propozimit ekonomik, në këtë mënyrë:

Pesha e propozimit ekonomik Pikët e propozimit ekonomik u përlllogaritën sipas formulës së mëposhtme:

Pe=1 00*Çu/Ç

Ku:

Pe — Pikët për propozimin Ekonomik

Çu — Çmimi më i ulët i ofruar

Ç — Çmimi i ofertues i radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

Konkretisht:

Pikët për propozimin ekonomik të ofertuesit

“A...” shpk: $100 \times 32\,330\,000 / 32\,330\,000 = 100$ pikë

“N...” shpk: $100 \times 32\,330\,000 / 33\,233\,333 = 97$ pikë

Pesha e propozimit ekonomik u përllogarit me formulën: $Y = Pe \cdot 0.2$

Pesha e propozimit ekonomik të ofertuesit “A...” shpk: $Y = 100 \times 0.2 = 20.00$

Pesha e propozimit ekonomik të ofertuesit “N...” shpk: $Y = 97 \times 0.2 = 19.40$

Pesha për propozimin teknik u përllogarit me formulën: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha e propozimit teknik për ofertuesin “A...” shpk: $X = 94.33 \times 0.8 = 75.46$

Pesha e propozimit teknik për ofertuesin “N...” shpk: $X = 79.66 \times 0.8 = 63.72$

Nr.	Emër subjekti	Pikët propozimit teknik	Pesha specifike propozimit teknik	Pikët propozimit ekonomik	Pesha specifike propozimit ekonomik	Vlerësimi përfundimtar
		a	$x = a \cdot 0.8$	b	$y = b \cdot 0.2$	$V = x + y$
1	“A...” shpk	94.33	75.46	100	20.00	95.46
2	“N...” shpk	79.66	63.72	97	19.40	83.12

Vlerësimi përfundimtar është shuma e peshës së propozimit teknik dhe ekonomik (X+Y), të pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Për sa më sipër, operatori ekonomik "A...." shpk. është shpallur si operatori ekonomik më i suksesshëm me ofertë ekonomike prej 32 330 000 (tridhjetë e dy milion e treqind e tridhjetë mijë) Lekë pa t.v.sh.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

- Në lidhje me dokumentacionin e mbajtur nga anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartuesit e termave të referencës nuk kuptohet qartë metoda që ka përdorur për përllogaritjen e fondit limit, të kampioneve të përdorur dhe sipërfaqeve përkatëse të pallatave që do të përdoren si kampion për realizimin e objektit të kontratës.
- Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiência e Energjisë”,
- Pajisjet e auditimit duhet të jenë në pronësi të audituesit energjetik i cili i regjistron pranë AEE dhe jo në pronësi të OE. Kërkesa për pajisjet e mësipërme vjen si pasojë e kërkesës për auditues energjetik që të jetë pjesë e stafit të O.E.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje znj. K...., z. A.... dhe z. O.I. dhe është në mospërputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Kontrata e zbatimit

Për objektin “Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me eficiency të lartë të energjisë në qytetin e Korçës”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

9) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis AEE dhe BOE “M...” sh.p.k & “A...” sh.p.k & “4K...” sh.p.k me Nr.1641 prot. datë 04.07.2022.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Etj.
- 10) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis AEE dhe OE “E...” sh.p.k me Nr.3652/3Prot. datë 04.10.2022.
- Korrespondencat mes AEE dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “E...” sh.p.k. etj.

Kontratat

Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve civile janë kryer sipas kontratës, për punë publike, me Nr.1641 prot. datë 04.07.2022 me objekt “Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Korçës” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor AEE, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. E.D. dhe BOE “M...” sh.p.k & “A...” sh.p.k të përfaqësuar nga administratorët z. R.H., z. N.C. dhe z. F.P. Vlera e kontratës është 37,050,500 lekë pa TVSH ose 44,460,000 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7.75 muaj nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve kjo e përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës Neni 4 “Data e fillimit”.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.3652/3 Prot. datë 04.10.2022 me OE “E...” sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1015/17, si dhe me vlerë të kontratës 482,365 lekë pa TVSH ose 578,838 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.398/3 Prot. datë 03.07.2023 me OE “I... & S...” sh.p.k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3921 dhe me vlerë të kontratës 32,100 lekë pa TVSH ose 38,520 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Ndërhyrjet e realizuara janë në: punime tarracë me polisterol 5 cm llustër çimento dhe hidroizolim me emulsion bitumi 2 shtresa katrama; punime veshje fasade me polisterol 10 cm, rrjetë dhe suva si dhe punime dritare e dyer duke zëvendësuar ato me të reja të cilat duhet të jenë duralumin i veshur me plastik. Këto punime janë kryer në tre pallate të pozicionuara afër stadiumit “Skënderbeu”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se zbatimi i kontratës me të gjitha fazat e saj ka filluar më datë 04.10.2022. Projekti i hartuar është dorëzuar me shkresën e administruar në AEE me nr.3788 prot. datë 12.10.2022 si dhe zbatimi i punimeve në terren sipas shkresës së sipërmarrësit me nr.17/10 prot. datë 17.10.2022 kanë filluar po më datën 17.10.2022.

Me shkresat e administruar në AEE Nr.393 Prot. datë 02.07.2023 sipërmarrësi njofton përfundimin e punimeve të zbatimit Faza IV të shoqëruara me procesverbalin përkatës.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në AEE nr.433 prot. datë 25.07.2023 si dhe marrja në dorëzim të përkohshëm është me nr. 433/1 prot. datë 25.07.2023.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Korçës”.		
14.Lidhja e kontratës Nr.1641 prot. datë 04.07.2022	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 44,460,000 lekë	16.Likuiduar deri datë 03.06.2024

	BOE “M” sh.p.k & “A” sh.p.k & “4 K” sh.p.k	9,296,985 lekë me TVSH ose 27% e situacionit përfundimtar.
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 40,816,973 lekë -Vlera pa TVSH 34,014,144 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 7.75 muaj, Zbatuar 8.75 Fillimi punimeve: 04.10.2022 Përfundimi punimeve: 02.07.2023	19. Zgjatja e kontratës
20. Mbikëqyrësi i punimeve “E...” sh.p.k	Licenca Nr: MK. 1015/17	Kontrata Nr.3652/3 Prot. datë 04.10.2022
21. Kolaudatori i punimeve “L... & S...” sh.p.k	Licenca Nr: MK.3921	Kontrata Nr.398/3 Prot. datë 03.07.2023
22.Akt Kolaudimi datë 04.12.2023 Nr.433 Prot. datë 25.07.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim Nr. 433/1 Prot. datë 25.07.2023	

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk u konstatuan diferenca.

Referuar dokumentacionit në dosjen teknike u konstatua se punimet e zbatimit të të gjitha fazave nuk janë realizuar sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Afati i përfundimit të punimeve është 7.75 muaj nga data 04.10.2022 e cila është data e fillimit të kontratës, kjo e përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës Neni 4 “Data e fillimit” dhe referuar më sipër punimet duhet të përfundonin më datë 27.05.2023. Nga ana e sipërmarrësit të punimeve është njoftuar se punimet kanë përfunduar më datë 02.07.2023 e kështu punimet kanë përfunduar me 36 ditë vonesë. Këto vonesa janë konstatuar edhe nga grupi i marrjes në dorëzim ku ka llogaritur edhe penalitetet përkatëse. Referuar nenit 20 “Dëmet e likuiduara” pika b ku citohet “Për kontrata me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës” kështu që Autoriteti Kontraktor duhet të aplikojë penalitet në mosrealizimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratë në vlerën **612,254 lekë pa TVSH** (34,014,144 lekë pa TVSH x 25% x 2/1000 x 36 ditë).

Nga auditimi konstatohet realizimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë nuk është pasqyruar nga mbikëqyrësi i punimeve në raportin përfundimtar dhe nga kolaudatori në Aktkolaudimin Nr.433 Prot. datë 25.07.2023.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon (sipas ushtrimit të detyrave funksionale përkatëse):

1. Nga ana e mbikëqyrësit OE “E...” sh.p.k nuk janë marrë masa për zbatimin e:

- Kontratës së shërbimit Nr.3652/3 Prot. datë 04.10.2022 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Projekt pilot “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare” me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Korçës”, konkretisht:

• Neni 6, “Detyrimet e Palëve”.

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve “L... & S...” sh.p.k nuk janë marrë masa për zbatimin e

Kontratë shërbimi Nr.398/3 Prot. datë 03.07.2023 me objekt: “Kolaudim i objektit, Projekt pilot ‘Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare’ me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Korçës”, konkretisht:

- Neni 6, “Detyrimet e Palëve”.

- Udhëzimi Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, pika 3, Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

- **Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet. Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë, viti 2022.**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet. Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”		
Urdhër Prokurimi : nr.1041 Prot. date 28.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit A.M. O.I. Xh.S.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: K.T., M. P., Xh.S.
4. Fondi limit (pa TVSH): 23,666,666.66 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 16.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: 7 Operatorë Ekonomik b) Kualifikuar: BOE” I... & M... & P... “	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Xh.A. F.D. Xh.Sh.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 22,950,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 26.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 716,666 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja USH nr.231., datë 06.12.2023 6.500,000 lekë me TVSH USH nr.248., datë 09.01.2024 8,302,000 lekë me TVSH	15. Afati i kontratës 11 muaj

Grupi i punës për hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit është ngritur me Urdhrin nr.665 datë 31.03.2022 dhe përbëhej K.T., M.P., Xh.S.

Në termat e referencës është kërkuar që për 50 njësi të përzgjedhura nga 12 Bashkitë pjesa e projektit kërkohet të bëhet një analizë e detajuar mbi konsumin e pajisjeve që konsumojnë energji brenda banesave (elektrike, gaz, lëndë drusore etj.)

Sipas grupit të punës i ngarkuar për llogaritjen e fondit limit, sipërfaqja në total do të auditohen në terren është rreth 64,800 m².

Projekti do të përfshijë 3 (tre) faza:

Faza I: Auditim paraprak energjetik i godinave të përzgjedhura duke përfshirë analizën e gjendjes ekzistuese dhe certifikatat e gjendjes ekzistuese.

Faza II: Projekt zbatimi

Faza III: Nxjerrja e certifikatës së performances së energjisë-paraprake (para punimeve të zbatimit).

Sipas Proces-verbal nr.963/6 datë 20.04.2022 të grupit të punës është llogaritur sipërfaqe njollë 360m² për një objekt.

Sip fasade=sip totale e banuar x 1.1 ku

Sip totale e banuar= sip njolle x 5 kate

Sip totale e banuar= 360 m² x 5 kate= 1800 m²

Sip fasade = 1800 m² x 1.1 = 1980 m²

Sipërfaqja e dritareve duke patur parasysh se dritaret zënë rreth 22% të sipërfaqes së fasadës.

Sip dritaresh = Sip fasade x 0.22

Sip dritaresh = 1980 * 0.22 = 435.6 m²

Sipërfaqja e mureve llogaritet si:

Sip muresh = Sip fasade – Sip dritaresh

Sip muresh = 1980 m² - 435.6 m² = 1544.4 m²

Përlllogaritje e përafërt e vlerës së investimit.

Sip veshje termoizolim	Çmimi mesatar m ²	Total Izolim	Sip dritare	Çmimi dritare	Total dritare	Sip Tarraca	Çmim tarraca	Total tarraca	Total investim për 1 objekt
1,544	3,296	5,090,342	436	28,270	12,314,412	360	4,014	1,445,040	18,849,794

NR OBJEKTESH	Investim për 1 objekt	vlera totale
36	18,849,794	678,592,598

Referuar rregullores për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik¹ pagesa e audituesit për sipërfaqe mbi 1000 m² është 250 lek/m².

Totali auditimi = Sip totale e banueshme x 250 = 1800 m² x 36 ndërtesa x 250 lek/m² = **16,200,000** lekë

Sipërfaqe Totali auditim = Sip totale e banueshme x nr i ndërtesave = 1800 m² x 36 ndërtesa=**64,800 m²**

Vlera e propozuar e realizimit të projektit sipas fazave pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Fazat e auditimit	Njësia	Vlera në lekë
Auditim paraprak energjetik i ndërtesave (Nxjerrja e CPE) paraprake para punimeve të zbatimit	Lekë	16,200,000
Projekti i zbatimit	Lekë	8,076,541
Vlera totale pa TVSH		24,276,541

Hartimi i DST

Titullari i AK AEE ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit nr.1041 Prot. datë 28.04.2022 me fond limit 23,666,667 lekë pa TVSH.

¹ Miratuar me urdhrin nr.5 date 12.01.2021

Në zbatim të urdhrat të prokurimit njësisë e prokurimit ka hartuar DST dhe me proces verbalin nr.1041/1 datë 28.04.2022 ka bërë argumentimin e kriterëve dhe specifikimet teknike të vendosura në dokumentet e tenderit.

Në SPE është publikuar njoftimi i shkurtuar i kontratës nr.1049 datë 28.04.2022.

2.3.3 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

2.3.2.a Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës ose të paraqesin kontratë bashkepunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe auditimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesin liçencën profesionale të shoqërisë në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, për kategoritë e mëposhtme:

- Kat 2/a - Projektim arkitekturor për objekte banimi-objektet industrial-objekte turistike. Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhet të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:
-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

2.3.4 Stafi

2.3.4.a) Stafi Kryesor

1 *Arkitekt*

2 *Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa).*

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. *Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:*

a) *zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;*

b) *është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;*

c) *është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.*

2.3.4.b) Stafi Ndhimes

10 (dhjetë) arkitekt ose inxhinier ndërtimi ose inxhinier mekanik ose inxhinier elektrik ose inxhinier mjedisi.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Stafi, në lidhje me kërkesën për 10 arkitekt ose inxhinier ndërtimi, nisur dhe nga preventivi i punimeve është i pa arsyetuar dhe paargumentuar nga ana e Njësisë së prokurimit.

2.3.4.c). Për të realizuar me sukses procesin e auditimit operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

Pajisje e mëposhtme të auditimit.

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (Ë/m2K)
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë.

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri hapjen e fazën së parë të procedurës dhe harton procesverbalin nr.1041/4 datë 24.05.2022.

Në këtë fazë janë paraqitur operatorët ekonomike:

1. BOE “4.K....& A....”
2. OE “G...”.
3. OE “N...”.
4. BOE “Th....& A....”,
5. OE “S....-S...”
6. BOE “I...& M....”
7. OE “T....” shpk.

Sipas proces verbalit nr. 1041/5 datë 31.05.2022 të KVO janë kualifikuar 6 (gjashtë) OE dhe vetëm OE “T.”. është Skualifikuar, për mos plotësim të kërkesave të AK duke ngarkuar në SPE vetëm ekstraktin dhe ofertën ekonomike.

Referuar ftesës për propozim nr.1041/6 datë 08.06.2022 të nënshkruar nga titullari i AK z. E.D., subjektet e mëposhtme pas vlerësimit të dokumentacionit të kërkuar nga AK në fazën e parë, janë kualifikuar për fazën e paraqitjes së propozimeve brenda datës 23.06.2022 ora 11:00.

- 1.”G...”.
- 2.”S....-S...”.
- 3.”N...”.
- 4.BOE “4.K....” & “A....”
- 5.BOE” I..& M...& P.”
- 6.BOE “Th.....& A...”

Sipas DST, vlerësimi i ofertës fituese do të behet mbi bazën e çmimit dhe propozimit teknik e përcaktuar si me poshtë:

Kriteret e vlerësimit teknik

Pikët

- | | |
|--|---------------|
| 1. Përvoja për pune të ngjashme të konsulentit | [0-10] |
| 2. Metodologjia e propozuar (përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) | [20-30] |
| 3. Kualifikimet e Stafit Kryesor të propozuar. | [20-50 (+10)] |
| 4. Transferimin e njohurive, (nëse kërkohet) | [-] |

Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.

Pesha për Propozimin Teknik është 80% e pikëve të propozimit teknik.

Pesha për Propozimin Ekonomik është 20% të pikëve të propozimit ekonomik.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në procesverbalin nr.1041/7 datë 23.06.2022, ka konstatuar se në fazën e dytë kanë paraqitur interes operatorët ekonomik të mëposhtëm:

- 1.BOE “4.K... & A....”.
- 2.”N....” shpk.
- 3.BOE “I...& M..”...

4. "S....-S..."

Referuar SPE, OE "Th..." dhe OE "G..." nuk kane paraqitur ofertë ekonomike.

KVO ka hartuar procesverbalin nr.1041/8 datë 05.07.2022 duke renditur OE/BOE sipas pikëve:

1. BOE "I.& M..." me 261.60 pikë dhe ofertë 22,950,000 lekë.
2. BOE "4.K... & A.." me 257.40 pikë dhe ofertë 22,720,000 lekë.
3. OE "N..." me 255.60 pikë dhe ofertë 23,460.00 lekë.
4. OE "S....-S.." shpk me 242.40 pikë dhe ofertë 21,200,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi në SPE konstatohet se:

BOE "I...& M....", përfaqësuar nga OE "I." ka paraqitur propozimin ekonomik formalisht sipas shtojcës 4 por nuk i ka bashkëlidhur preventivin sipas fazave të hartimit të projektit të zbatimit. Referuar seksionit " S.." në SPE., AK AEE ka ngarkuar formatin e kërkuar të preventivit sipas fazave.

Nga auditimi i ofertave të BOE/OE të tjerë të kualifikuar në këtë procedurë, konstatohet se ata e kanë plotësuar preventivin e fazave të këtij projekti duke ja bashkëlidhur atë me formularin e ofertës sipas kërkesës së AK.

Në këto kushte KVO, megjithëse oferta ekonomike e shpallur fitues ishte me e favorshme ne drejtim te çmimit me te ulet, duhej ta refuzonte këtë ofertë.

KVO ka vepruar ne mospërputhje me nenin 82 te të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar". pika 2 ku parashikohet se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

"Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

"Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

"Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Me veprimet apo mos veprimet lidhur me parregullsitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: znj. Xh.A., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, z. F.D., me detyrë specialistë në Sektorin e Programeve te Eficences dhe Analizes, si dhe z. Xh.Sh., me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit te Projekteve, si dhe z. E.D. në cilësinë e titullarit dhe miratuesit te procedurës.

Për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit dhe hartimit të DST: z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike në AEE, znj. Xh. S., me detyrë specialiste e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, z. O.I. me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Energjitike,

të cilët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike), të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Njoftimi i fituesit

Referuar vlerësimit të KVO, BOE ”I...”sh.p.k &M& P..”sh.p.k është njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit nr.1041/9 datë 13.07.2022 nga titullari i AK z. E.D BOE “I.”sh.p.k & M... & P..”sh.p.k është shpallur fitues, me vlerën financiare 22,950,000 lekë dhe 261.60 pikë.

Klasifikimi përfundimtar është:

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Vlera financiare	Totali i pikëve
1	BOE “I.& M... & P..”.	22,950,000	261.60
2	BOE “4.K...” & “A...”	22,720,000	257,40
3	OE “N...”	23,430,000	255.60
4	OE ‘S... –S..”.	21,200,000	242.40

Lidhja e kontratës

Pas njoftimit të fituesit nr.1041/11 datë 21.07.2022 të ngarkuar në SPE dhe përfundimit të afateve të përfundimit të ankimimit.

AK AEE ka lidhur Kontratën nr.1764 datë 26.07.2022 me BOE “I...&M....& P....”

Afati i realizimit të kontratës është 11 muaj.

Faza	Afatet
Faza 1- Analiza e thelluar e gjendjes ekzistuese	6 muaj-26.01.2023
Faza 2- Projekt zbatimi	2 muaj-26.03.2023
Faza 3- Nxjerrja e CPE paraprake	3 muaj- 26.06.2023

Njësia e prokurimit nr.1764/1 datë 26.07.2022 ka ngarkuar në SPE formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Plan-zbatimi i kontratës është dërguar në APP me nr.1764/2 Prot. 02.08.2022.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës i përbërë nga K.T., Xh.A., B.K. është ngritur me Urdhrin nr.1769 datë 27.07.2022

Anëtari i këtij grupi B.K.i është zëvendësuar nga Xh.S. me Urdhrin nr.1769/1 datë 07.11.2022.

Sipas Akt Konstatimit nr. 52 datë 26.01.2023 të komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, në bazë të grafikut të realizimit të kontratës faza e parë (Analiza e gjendjes ekzistuese/identifikimi i situatës, matjet e parametrave ekzistues, analiza kompjuterike e objekteve në studim), duhet të ishte dorëzuar pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë në datë 26.01.2023, si afati i fundit për këtë fazë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se:

Në Sistemin informatikë të auditimit të efiçences së energjisë, 50 njësitë e para të ndërtesave të banimit që do të shërbenin për të analizuar gjendjen ekzistuese të objekteve, nuk janë kryer brenda afateve nga OE I...., dhe raporti i auditimit (i thelluar) për gjendjen ekzistuese nuk është hartuar dhe dorëzuar brenda afatit të zbatimit të kontratës nga OE I....

AK ka informuar me shkresë nr.52/1 datë 26.01.2023 OE Infrakonsult për mos respektim të grafikut dhe afateve të dorëzimit të raportit paraprak të Efiçences së energjisë (analize e thelluar e gjendjes aktuale të konsumit të energjisë)

OE Infrakonsult dorëzon nëpërmjet shkresës përcjellëse nr.52/3 Prot. datë **10.03.2023** raportet e auditimit të Eficences se energjisë për 50 njësitë e para të analizës së thelluar.

Vlerësimi i raporteve të auditimit të efikasitetit të energjisë

Sipas proces-verbalin nr.18/3 datë 18.03.2023 të komisionit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, në raportet e dorëzuar nga OE Infrakonsult, konstatohen shumë problematika, të cilat janë në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik të miratuar me urdhrin nr.5 datë 12.01.2021 të ministrit përgjegjës për energjinë, duke ia përcjellë konstatimet dhe problematikën e konstatuar në projektet e dorëzuar me shkresën nr.52/4 datë 18.03.2023. Në mënyrë të përmbledhur, me poshtë paraqiten konstatimet e grupit të zbatimit të kontratës:

Në raportet mungojnë Certifikatat e Performancës së Energjisë në ndërtesa për gjendjen ekzistuese, e cila është e domosdoshme për të konstatuar klasin energjetik të ndërtesës, me qëllim përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme për të përmirësuar performancën e ndërtesës.

Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë U-value, të paraqitet sipas formulës së llogaritjes.

- Të matet me instrumentin e matjes koeficienti i transmetimit të nxehtësisë U-value për elementët konstruktivë si:

Mur i jashtëm, Dritare dhe Dyer të jashtme;

Të rishikohen shtresat përbërës për elementin konstruktiv “Soletë”;

Të vendoset në raport dhe llogaritja e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë U-value për elementin konstruktiv dysheme në kontakt me tokën ose dysheme fundore;

Të vendoset për secilën nga Certifikatat e Performancës së Energjisë klasi përkatës në përshkrim:

Të shikohen me kujdes matjet e infiltrimeve të ajrit dhe të dhënat hyrëse në pajisjen Bloëdoor;

Të vendosen më shumë foto gjatë matjes në objekt si p.sh.: foto gjatë matjes së ndriçimit me pajisje luxometër, dhe foto gjatë matjes me instrumentin kamera termike;

Të kryhet mbi faturat mujore të energjisë elektrike dhe një ndarje e konsumit për secilën nga pajisjet elektroshtëpiake;

Mos respektim i fazës së dytë

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr.52/6 datë 27.03.2023 konstaton se në bazë të grafikut të realizimit të kontratës, të propozuar nga ana e Kontraktuesit, përse i përket fazës së dytë (Projekt-Zbatimit), i cili duhet të ishte dorëzuar pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë në datë 26.03.2023, si afati i fundit për këtë fazë, nuk është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

Kontraktuesi i dorëzon AK AEE nr.52/10 datë 16.06.2023 projekt-zbatimin, Faza 2.

Penalitet për mos respektim të afateve të fazës së parë dhe të dytë

Në kushtet e mos respektimi të afateve kohore respektivisht të fazës së parë me 43 dite dhe 82 ditë për fazën e dytë. Grupi i auditimit të KLSH, përlllogaritit për afërsisht detyrimin e OE I...ndaj AK AEE, shumë e cila do të zbritet nga vlera totale e kontratës.

Referuar, pikës 15.b të Kontratës nr. Prot. date 26.07.2022 ku përcaktohet se:

Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jete 2/1000 të vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e shërbimit të konsulencës, janë **1,479,167 lekë**.
[(23,666,667 *0.25)*0.002]*125 ditë vonesë për të dyja fazat

Shtyrja e afatit te kontratës

Kontraktuesi dorëzon pranë AK AEE nr.52/11 datë 16.06.2023 një kërkesë për shtyrje afati të kontratës me 2 (dy) muaj në mënyrë që të vazhdojë më fazën e tretë për mbylljen e plotë të projektit. Kjo shtyrje kërkohet për shkak të problematikave të hasura si mos-bashkëpunimi I banorëve si dhe probleme ne sistemin EECERT.

Amendim Nr.1 kontratë sipërmarrje nr.52/12 midis AEE dhe BOE "I... & M..." shpk. Afati i kontratës është shtyre me 1 muaj

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës harton proces-verbalin nr.52/13 datë 26.06.2023 ku merr në dorëzim fazën e parë të projektit.

Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës harton proces-verbalin nr.52/14 datë 03.07.2023 dhe merr në dorëzim fazën e dytë të projektit.

Faza e trete

Kontraktuesi dorëzon pranë AK AEE nr.52/15 datë 26.07.2023 fazën e tretë- Nxjerrja e certifikatës së Performancës së Energjisë Paraprake bashkë me 50 raporte kopje fizike të njësive tip në godinat pjesë e projektit.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Projekt për informim, fushatë ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi për eficientë e Energjisë në fushën e banesave, industrisë dhe transportit", viti 2022		
1. Urdhër prokurimi Nr. 3967, datë 11.11.2022	3.Hartuesit e Dokumentave të Tenderit: Nr. 3967, datë 11.11.2022	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 3968, datë 11.11.2022
2.Lloji i procedurës: "Shërbim Konsulence- E hapur"	znj. K.T., me detyrë përgjegjës sektori znj. Xh.S., me detyrë specialist z. Xh.Sh., me detyrë specialist	
5. Fondi limit pa TVSH: 10,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH): 9,676,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 324,000 lekë
8.Data e hapjes së tenderit: 02.12.2022	9.Burimi i financimit: Buxheti Shtetit	10.Operatorët ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 3 O.E b) S'kualifikuar 1 O.E c) Kualifikuar 2 O.E
11.Ankimime në AK: AK- S'ka APP-S'ka KPP-S'ka		
12.Lidhja e kontratës: Nr. 58, datë 01.02.2023	13.Vlera e Kontratës (me TVSH): 11,842,800	14.Afati i Kontratës (në ditë): 15 muaj/450 ditë nga lidhja e kontratës.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se AK nuk ka dokumentuar kërkesën nga sektori përkatës apo një përshkrim të nevojës për iniciimin e kësaj procedure prokurimi duke vepruar kështu në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 2 gërma a), neni 2 "Dokumentimi i procesit", të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Në vijim, me urdhrin nr. 3917 datë 01.11.2022, është ngritur Komisioni për përcaktimin e fondit limit dhe hartimin e termave të referencës.

Sipas termave të referencës është parashikuar që ofruesit të shërbimit t'i kërkohet të kryejë informimin, fushatën e ndërgjegjësimit, edukimin dhe trajnimin për eficientë e Energjisë në fushën e banesave, industrisë, dhe transportit si dhe shërbimin për përmirësimin e faqes zyrtare WEB zyrtare të AEE e cila ka qenë ekzistuese në momentin e zhvillimit të procedurës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton e padokumentuar gjendja ekzistuese e WEB-it zyrtar të AEE si dhe nuk administrohet asnjë komunikim apo korrespondencë zyrtare me AKSHI-in, lidhur me dhënien e mendimit për këtë shërbim, pasi AKSHI ndër të tjera është ofrues i shërbimeve TIK dhe shërbimeve elektronike, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si edhe institucioneve të tjera publike, me kërkesë të vetë institucionit. Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me germën h), pika 6, të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, si dhe pikën 1 e 2 të nenit 21, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për sa i takon përcaktimit të fondit limit, në studimin e tregut sipas procesverbalit të datës 09.11.2022, komisioni ka marrë katër oferta duke përcaktuar vlerën e përgjithshme të kontratës. Nga auditimi rezulton e pa ndarë me zëra të vecantë ofrimi i këtyre shërbimeve, veprim i cili do të kishtë mundësuar saktësimin e produkteve/shërbimeve të ofruara dhe vlerësimin e tyre gjatë marrjes në dorëzim.

Hartimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikeve teknike

Sipas termave të referencës projekti do të realizohet në tri faza:

-Faza 1 Në fazën e parë, qëllimi do të jetë përgatitja e materialit që do të prezantohet të gjithë grupeve të interesit si edhe materiale mbi një fushatë të vogël komunikimi në kanalet zyrtare të bashkive dhe Agjencisë për Efiçencën së Energjisë.

-Faza 2 Faza e dytë do të shërbejë për të lokalizuar dhe kontaktuar të gjitha bashkitë dhe grupet e interesit në secilën prej tyre që do të jenë pjesë e konferencave.

-Faza 3 Në fazën e tretë do të zhvillohen aktivitetet në të gjitha qarqet e vendit, këto aktivitete do të zhvillohen në një periudhë kohore deri 15 muaj nga lidhja e kontratës. Kalendarit i aktiviteteve do të propozohet nga vetë aplikuesi. Në fund e aktiviteteve, do të organizohet konferenca përmbledhëse në qarkun e Tiranës.

Gjithashtu, në termat e referencës, pjesë e projektit është edhe riformulimi dhe mirëmbajtja e faqes WEB. Në pikën 2.3.2/a “Kapacitetet teknike dhe profesionale”, nga AK janë kërkuar:

- *1 Drejtor Kreativ përgjegjës për zhvillimin e konceptit kreativ të eventeve dhe dorëzimit të materialeve me cilësi të lartë, me të paktën 5 vite eksperiencë;*

- *1 menaxher projekti përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me autoritetin kontraktor dhe monitorimin e vazhdueshëm të projektit deri në zbatimin e plotë të tij me të paktën 5 vite eksperiencë;*

- *1 Menaxher Eventit përgjegjës për organizimin e eventeve, mbarëvajtjen e tyre, zhvillimin e ngjarjeve në kohë, në cilësinë e duhur dhe brenda buxhetit të parashikuar me të paktën 3 vite eksperiencë;*

- *1 Media Strategjist përgjegjës për strategjinë e fushatës për promovim gjithëpërfshirës në media me të paktën 3 vite eksperiencë në fushën e strategjisë dhe planifikimit të fushatave publicitare;*

- *1 Webmaster përgjegjës për krijimin, dizajnin dhe zhvillimin e WEBit, mirëmbajtjen e faqes dhe përmbajtjes, sigurimin që WEB të përmbushë të gjitha funksionalitetet e nevojshme dhe përditësimet të ndryshme për të siguruar që faqet të përputhen me qëllimet dhe objektivat me të paktën 3 vite eksperiencë;*

- *1 Video editor/fotograf përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë dhe progresin e inxhinierisë dhe redaktimit të audios dhe videos me të paktën 2 vite eksperiencë;*

- *1 Dizajner përgjegjës për implementimin e dizajneve dhe krijimeve grafike;*

Pra, bazuar në punimet respektive të përfshira në procesin e zhvillimit të projektit në fjalë, konstatohet se kërkesat për:

“- 1 Dizajner përgjegjës për implementimin e dizajneve dhe krijimeve grafike. Kjo kërkesë plotësohet nga kërkesa për Webmaster përgjegjës, duke qenë se të dy janë profile programuesi dhe Webmasteri përgjegjës mund të bëjë edhe implementimin e dizajneve e krijimeve grafike.

- 1 Menaxher Eventi përgjegjës për organizimin e eventeve, mbarëvajtjen e tyre, zhvillimin e ngjarjeve në kohë, në cilësinë e duhur dhe brenda buxhetit të parashikuar me të paktën 3 vite eksperience. Edhe kjo kërkesë plotësohet nga kërkesat për 1 menaxher projekti përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me autoritetin kontraktor dhe monitorimin e vazhdueshëm të projektit deri në zbatimin e plotë të tij, si dhe 1 Media Strategjist përgjegjës për strategjinë e fushatës për promovim gjithëpërfshirës në media. Të dy këto të fundit mbulojnë më së miri kërkesën e një menaxheri eventit”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit janë kërkesa të tepërta, të cilat nuk janë proporcionale me objektin e kontratës, të cilat gjithashtu nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi në prokurimin publik, konkretisht: me nenin 2, pikën 1 të nenit 77 “Kërkesat për Kualifikim”, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP znj. K.T, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, znj. Xh.S. me detyrë specialiste e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe z. Xh.Sh., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Vlerësimi i ofertave:

Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës sipas shkresës me nr. 3967/8 prot., datë 23.01.2023, ku rezulton se:

-Janë kualifikuar për fazën e dytë O.E:

“B.... & O...”;

“P”;

-Është s’kualifikuar OE” TH....”, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta në DST:

- Sigurimin e Ofertës sipas shtojcës 3
- Kriteri 2.2.1 Vërtetim Xhiro 3 vitet e fundit
- Kriteri 2.31.a Dëshmi për përvoja të mëparshme të ngjashme.

S’kualifikimi i këtij O.E qendron.

Më tej, pas vlerësimit teknik dhe atij ekonomik nga KVO, BOE “B.... & O...” është vlerësuar si OE fitues mes OE të kualifikuar, me ofertë ekonomike **9,676,000 lekë pa TVSH**, i cili është edhe OE me vlerën më të ulët.

Marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratës

Me urdhër nr. 8 datë 01.02.2023 është krijuar Komisioni për ndjekjen e zbatimit dhe marrjes në dorëzim të kontratës. Afati kohor i zhvillimit të aktiviteteve, pra realizimit të projektit, është 15 muaj nga lidhja e kontratës, duke parashikuar si datë të përfundimit 01.05.2024. Në lidhje me zbatimin e kontratës konstatohet se nuk janë zhvilluar të gjitha konferencat dhe aktivitetet e parashikuara në termat e referencës si dhe në kalendarin përkatës të aktiviteteve të propozuar nga BOE “B.... & O...”.. (Plani i Punës dhe Grafiku i dorëzimeve) e të miratuar nga AEE. Sipas Planit

të Punës e grafikut të dorëzimeve, si dhe kalendarit përkatës, rezulton se të gjitha aktivitetet e rrethve (Tiranë, Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër, Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Dibrë dhe Kukës) duhet të zhvilloheshin brenda javës së fundit të muajt mars 2024, ndërkohë aktivitetet në rrethet Gjirokastrë dhe Vlorë, janë kryer në datat 4 dhe 5 prill 2024, duke mos respektuar grafikun e parashikuar. Ndërkohë është ende pa u zhvilluar aktiviteti përmbyllës në Tiranë i cili duhet të ishte kryer brenda muajit prill 2024, sipas Planit të Punës dhe grafikut të përcaktuar të dorëzimeve. Gjithashtu, për sa i takon amendamentit të kontratës për shtyrjen e afatit të kontratës deri në datën 01.07.2024 (që është bashkëlidhur observacionit) sqarojmë se në lidhje me këtë praktikë në dispozicion të Grupit të Auditimit nuk është vendosur asnjë dokument dhe/apo informacion me qëllim shqyrtimin e tij përgjatë fazës së auditimit në terren.

Për sa i takon materialeve të papostuara më parë të aktiviteve në faqen zyrtare të WËB-it të AEE www.eficenca.gov.al, rezulton se pas konstatimit nga ana e Audituesve të KLSH, faqja u azhurnua duke ngarkuar materialet ndërgjegjësuere apo aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këtij projekti por nuk ka ende një relacion përshkrues mbi të gjitha ndërhyrjet e kryera në wëb nga BOE fitues. Nga grupi i marrjes në dorëzim, nuk administrohet procesverbali lidhur me riformulimin dhe mirëmbajtjen e faqes së WËB-it si dhe elementët që do të përfshihen në përmirësimin e tij. Kontrata është lidhur më datë 01.02.2023 dhe në këto kushte ky shërbim duhet të ishte i vazhdueshëm, sikurse përcaktuar në termat e referencës “Riformulimi dhe mirëmbajtja e faqes së WËB”, “Elementët që duhet të përfshihen në përmirësimin e Website” dhe parashikimet e Kontratës, neni 5 “Dorëzimi” dhe nenet 6, 7 dhe 8 “Përgjegjësitë e Kontraktorit”. Nga informacioni zyrtar i AK, rezulton se nuk janë kryer pagesa për BOE” B.... & O...,” i cili deri më datë 18.04.2024 nuk ka paraqitur pranë AEE faturë tatimore dhe as situacion për pagesë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Zbatimit të Kontratës dhe Marrjes në Dorëzim znj. V. P., me detyrë ish këshilltar i jashtëm për median, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.07.2024, znj. Xh.A., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, znj. V.Gj., me detyrë specialiste në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Procedura të zhvilluara në vitin 2023

“Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Për projektin pilot për instalimin e ndriçimit urban me efencë të lartë energjie në qytetin e Dibrës”, viti 2023.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “për projektin pilot për instalimin e ndriçimit urban me efencë të lartë energjie në qytetin e Dibrës”		
Urdhër Prokurimi nr. 33 datë 02.06.2023		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T Z. A. M. Znj. K.H.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: znj. K.T. znj. Xh.S. z. Xh.Sh.
4. Fondi limit (pa TVSH): 33,333,333 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: OE "G....." shpk pa ofertë BOE "M...." shpk & "E...." shpk & "D..." & "V...." me ofertë: 32,720,000 pa TVSH.	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. O.I. znj. A.B. z. M.P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 32,234,000 lekë

OE "N..." shpk me ofertë: 31,500,000 Lekë pa TVSH. BOE: "S..." sh.p.k & "Sh....." sh.p.k & "A... – S..." me ofertë: 32,234,000 Lekë pa TVSH. b) Kualifikuar: BOE: "S.....-L... 2000" sh.p.k & "Sh..." sh.p.k & "A...."		
10. Data e lidhjes së kontratës 21.08.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 1,099,333lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 11 muaj

Me urdhër nr. 7, datë 31.01.2023 ngrihet komisioni për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, me përbërje:

- znj. K. T.
- znj. Xh. S.
- z. Xh.Sh.

Më datë 28.05.2023 mbahet procesverbali me nr. 263 Prot., mbi përlllogaritjen e fondit limit për projektin pilot për instalimin e ndriçimit urban me eficencë të lartë energjie në qytetin e Dibrës. Gjatë kësaj analizë është përdorur Manuali 2 Analiza Teknike për zërat e punimeve Mars 2015.

Analiza ka 3 komponentë kryesorë:

- Analiza e çmimit të projektimit
- Analiza e çmimit të realizimit të punimeve
- Analiza e auditim dhe certifikim.

Objekti “projekt pilot për instalimin e ndriçimit urban me eficencë të lartë energjie në qytetin e Dibrës” ka si preventiv zërat e punimeve si më poshtë:

- Analiza dhe projekti 387,840 lekë
- Realizim punimesh 33,244,819 lekë
- Auditim 250,000 lekë

Më datë 02.06.2023 me nr 305/1 Prot., mbahet procesverbali mbi hartimin e dokumentave të tenderit nga njësia e prokurimit me përbërje,

- z. A.M.
- znj. K.T.
- znj. K.H.

Me urdhër nr. 33 me nr 335 Prot., datë 02.06.2023, ngrihet urdhri i prokurimit për kryerjen e prokurimit me fond prej 40,000,000 lekë pa TVSH.

Me urdhër nr. 44 me nr. 340 Prot., datë 02.06.2023 ngrihet urdhri për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

- z. O.I.
- znj.A.B.
- z. M.P.

Në po të njëjtën datë me nr. 344 Prot., hartohet njoftimi i shkurtuar i kontratës me përmbajtje si më poshtë:

- Lloji i procedurës së prokurimit: Punë – E hapur
- Fondi limit 33,333,333 lekë pa TVSH

· Kohëzgjatja e kontratës 11 muaj.

Më datë 23.06.2023, mbi bazën e Urdhrit nr. 44, datë 02.06.2023 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: "Projekt pilot për instalimin e ndriçimit urban me efikasitet të lartë energjie në qytetin e Dibrës", mbahet procesverbal nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bëri hapjen e ofertave nga operatorët ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku u paraqitën operatorët ekonomikë si më poshtë vijon:

- OE "G....." shpk pa ofertë
- BOE "M...." shpk & "E..." shpk & "D...." & "V. S." me ofertë: 32,720,000 pa TVSH.
- OE "N..." shpk me ofertë: 31,500,000 Lekë pa TVSH.
- BOE: "S..." sh.p.k & "Sh...."sh.p.k & "A – S" me ofertë: 32,234,000 Lekë pa TVSH.

KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, **vendosi:**

- Të vijojë me vlerësimin me pikë për BOE: "S..." sh.p.k & "Sh..." sh.p.k & "A-S " shpk pasi përmbush kriteret e përcaktuara në DST.
- Të skualifikoje OE "N...." shpk pasi:

OE "N...." shpk është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të veçanta të DST, përkatësisht;

Në pikën 2.3.1(Kapacitet teknik) OE "N..." shpk nuk plotëson kërkesën për të paraqitur punë të ngjashme.

Në pikën 2.3.2a (Kapacitetet teknike dhe profesionale) OE "N..." shpk nuk plotëson kategorinë e kryerjes së punimeve

NS-5B-Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Në pikën 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknik për ekzekutimin e kontratës nuk plotëson kërkesën :

o Kamion me vinc (në pronësi ose me qira)

o Vinc me kosh (në pronësi ose me qira)

□Të skualifikoje BOE "M...." shpk & "E....", pasi:

BOE "M...." shpk & "E...." është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të veçanta të DST, përkatësisht;Në pikën 2.3.1(Kapacitet teknik) BOE "M..." shpk "E..." shpk nuk plotëson kërkesën për të paraqitur punë të ngjashme.

Në pikën 2.3.2a (Kapacitetet teknike dhe profesionale) BOE "M...." & dhe "E..." shpk nuk plotëson kategorinë e kryerjes së punimeve

NS-5B-Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

· Të skualifikoje OE "G..." shpk pasi: OE "G...." shpk nuk ka paraqitur ofertë.

Për sa më sipër KVO vazhdoi me vlerësimin e **Kriterëve të përzgjedhjes së fituesit**, mbështetur në kushtet e përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, bazuar në kriterin e çmimit më të favorshëm bazuar në kosto.

Në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në pikën 2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale) janë kërkuar licencat e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-2A	Ndërtime civile dhe industriale
2	NS-5B	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Në **pikën 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të disponojë license projektimit, mund të nënkontrakttojë shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, date 28/12/2016 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"*

Licensa e projektimit duhet të ketë kategoritë si me poshtë :

- Kat 4/i Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.
- Kat 4/g Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.
- Kat 8/a Rilevime inxhinierike.

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që në të përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndricuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat kërkojnë pajisjen me licensat përkatëse si:

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A

Gjithashtu në lidhje me licensat e projektimit është kërkuar licenca Kat 4/g në lidhje me projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa e cila nuk gjen zbatim në preventivin e punimeve.

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:

Kat 10/c - Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

Kat 11/d - Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Në lidhje me pikën **2.3.4 Stafi,**

2.3.4. a) Stafi kryesor për realizimin e shërbimit të projektimit si dhe të auditimit të efikasitetit të energjisë në objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të regjistruar si më poshtë;

1 *Inxhinier Elektrik ose elektronik*

1 *Inxhinier topograf ose gjeodet ose markshaider*

1 *Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, në instalime industriale)*

2.3.4.b) Stafi Ndihmes:

1 *Inxhinier Elektrik ose Elektronik.*

2.3.4.c) Stafin kryesor të inxhinierëve:

1 arkitekt ose Inxhinier ndërtimi

1 inxhinier elektrik ose elektronik

1 Inxhinier gjeodet ose markshaider ose topograf

1 Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, për Menaxhim Energjie)

2.3.4.d) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

1 individ të pajisur me një certifikatë *"Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit"*

1 individ të pajisur me një certifikatë *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës:

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Stafit. në lidhje me fuqinë punëtore që minimalisht duhet të jetë 15, është e paargumentuar nga ana e tyre. Gjithashtu përfshirja e inxhinierit të ndërtimit ose arkitektit, nisur dhe nga zërat e preventivit, është e paargumentuar nga ana e AK.

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. *Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:*
- a) *zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;*
- b) *është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;*
- c) *është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.*

Për parregullsitë e mësipërme të konstatuara në hartimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të tenderit mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: znj. K.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike, znj. K. H. me detyrë specialiste në Sektorin e Auditimit dhe Certifikimit të cilët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

Argumentim mbi vlerësimin e ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto.

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	pikët 10
Stafi / Eksperiencia dhe Organizimi i Kompanisë	pikët 30
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	pikët 5
Periudha e garancisë së objektit	pikët 5

Ofertat e kualifikuara për këtë procedurë janë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik: BOE: "S..." sh.p.k. & "Sh..." sh.p.k. & "A-S" sh.p.k. me ofertë: 32,234,000 Lekë pa TVSH.

Çmimi (50 pikë)

Operatorët ekonomik BOE "S..." sh.p.k. & "Sh..." sh.p.k. & "A. - S." sh.p.k për çmimin sipas llogaritjes me formulë merr: 50 pikë.

Metodologjia e propozuar dhe grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (10 pikë)

Nënkriteri:

Metodologjia e propozuar 7 pikë

Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: 1.3 pikë

Kohën e mobilizimit në kantier (2 javë) 1 pikë

Grafiku i punimeve të Kontratës 2 Pikë.

BOE "S..." sh.p.k. & "Sh..." sh.p.k. & "A.- S." sh.p.k ka paraqitur metodologji punimi duke përcaktuar çdo proces pune që do të realizohet sipas termave të referencës, të plotë me 50 faqe. Janë përfshirë detyrat e detajuara për secilën fazë të procesit të punës të përcaktuar në termat e referencës.

Stafi / Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë (30 pikë)

Nën-kriteri:

Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperienca në fushën specifike (29 pikë)

Vlerësimi i këtij nënkriteri u realizuar sipas përcaktimeve më poshtë:

- Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kriterëve të vecante të kualifikimit për stafin (**5 pikë**)
- Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin (**5 pikë**)
- Dëshmi që stafi disponon eksperience në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin (**8 pikë**)
- Dëshmi që stafi disponon eksperience në natyrë/kompleksitet të ngjashme për projekte auditimi dhe punë të ngjashme të realizuara në zbatim në fushën e efijencës së energjisë. (**9 pikë**)

Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi (29 pikë)

BOE "S..." sh.p.k. & "Sh..." sh.p.k. & "A-S" sh.p.k për Staf Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë sipas vlerësimit merr: **29 pikë**.

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (4 pikë)

Për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social sipas vlerësimit të llogaritjes me pikë merr: (**4 Pikë**)

Kjo pasi ky operator ka dhënë disa zgjidhje duke punësuar me kontratë të rregullt pune për zbatimin e punimeve të punëtoreve vendas të specializuar për punime sipas kontratës, por dhe duke mbrojtur ambientin dhe personat rreth tij, të paraqitur dhe në metodologjinë e realizimit të punimeve.

Periudha e garancisë së objektit (5 pikë)

Periudha e garancisë e punimeve civile I pajisjeve (jo më pak se 1 vit) [0 5 pikël

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk5 = V_{min}k5 \times X \times P_{max}k5 / Ok5$

$Pk5$ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{min}k5$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{max}k5$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok5$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

BOE: "S..." sh.p.k & "SH..." sh.p.k & "A. – S..." sh.p.k ka ofruar një garanci punimesh 30 muaj për këtë arsye sipas llogaritjes me formulë vlerësohet me **5 pikë**

Piket totale të mara nga BOE: "S..." sh.p.k. & "Sh..." sh.p.k. & "A.– S.." sh.p.k janë : **98 pikë**.

Ky projekt pilot, do të përfshijë fazat si më poshtë vijon:

Faza I - Analiza dhe hartimi i projekt zbatimit

Faza II - Realizimi i punimeve të ndërtimit

Faza III - Hartimi i raportit përfundimtar të auditimit (pas punimeve të zbatimit).

Faza I - Kërkesa projektimi të përgjithshme për rikonstrukcionin dhe përmirësimin e cilësisë së ndricimit në segmentet e sipër përmendura.

Realizimi i projektit.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Realizimi i projektit duhet të sigurojë respektimin e standardeve më të larta të projektimit dhe të zbatimit në mënyrë që të realizohet qëllimi final i rritjes së efijencës së energjisë. Është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik realizimi i një projekti të plotë me efijencë të lartë të përdorimit të energjisë, si zbatimi me rigorozitet i projektit dhe përdorimi i materialeve me standarde të larta.

Sistemi i ndricimit që do të projektohet dhe zbatohet duhet të përmbushë minimalisht kërkesat e mëposhtme lidhur me performancën e energjisë:

Kokat e ndricuesit do të zëvendësohen të gjitha me ndricues LED me specifikat teknike të përcaktuara si më poshtë:

Tensioni (V) 170-305V

Frekuenca 50/60Hz

Fuqia (Ë) 100Ë (Programmable)

Eficienta (lm/Ë) 150lm/Ë

Lumen output (lm) 15000

PF \geq 0.95

Surge Protection 10K

Beam Angle T2/T3/T4/

Faza II - Realizimi i punimeve të ndërtimit dhe instalimit

Punimet do të kryhen brenda afatit të përcaktuar në Termat e Referencës dhe cilësia e tyre do të respektojë specifikimet teknike për materialet e përdorura.

1. Do të vendosen 307 ndricues LED sipas kërkesave të mësipërme.
2. Do të vendosen 108 krahë shtyllë me një degë.
3. Do të vendosen 81 shtylla ndricimi sipas kërkesave të mësipërme.
4. Do të vendosen 8 pemë fotovoltaike sipas kërkesave të mësipërme.
5. Do të vendoset një Karikues 50kË

*Të gjitha punët nëntokësore do realizohen nga Bashkia Dibër

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

- Në lidhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E., në lidhje me përmbushjen e pikës 2.1 Realizimi i projektit, nuk përmbushet kriteri mbi Lumen Output LM 15000, pasi në katalogun bashkëlidhur nga O.E., në specifikimet teknike të ndriçuesve LED, Lumen Output LM është në masën
- Faza e II që përkon me Realizimin e punimeve të ndërtimit, nuk ka përfunduar dhe sipas grafikut të punimeve dhe marrëveshjes në kontratë duhej të ishte ezauruar brenda javës së parë të muajit prill. Për këtë arsye Drejtori i Përgjithshëm z. A.H. ka nisur dhe shkresën me nr. 181 Prot. datë 08.04.2024 me lëndën kërkesë për informacion drejtuar O.E. zbatues i kontratës, për tejkallim afateve ligjore të punimeve. Në korrespondencë të shkresës së mësipërme mbikqyrësi i kontratës sipas detyrimeve ligjore ka nisur shkresën nr. 186 Prot., datë 08.04.2024, mbi arsyet përkatëse për vonesat e krijuara mbi zbatimin e punimeve. Si arsye të vonesave të punimeve mbikqyrësi i kontratës paraqet arsyet si më poshtë:

Nga bashkia është kërkuar të bëhet ndriçimi i disa lagjeve të tjera të cilat nuk kanë qenë parashikuar në preventivin e kontratës, duke na penguar në përfundimin e zbatimit të projektit si dhe prania e dy shtyllave të tensionit të lartë në Rrugën “R. F. B.” e bën të pamundur vendosjen e pemëve fotovoltaike 4.5 Kë në këtë segment. Grupi i auditimit konstatoi që sipas arsyeve të paraqitura mësipër, nuk ka dokumentacion mbështetës në lidhje me korrespondencën me Bashkinë Dibër, si dhe në arritjen e përfundimeve që planifikimi i vendosjes së ndriçuesve Led dhe të Pemëve fotovoltaike nuk ka qenë i saktë dhe jo në përputhje me kërkesat e Bashkisë Dibër, që duhej të ishte palë në hartimin dhe analizimin e projekti të zbatimit. (faza 1).

- **Auditim, projekt zbatimi dhe realizim punimesh me eficientë energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës”, viti 2023.**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Auditim, projekt zbatimi dhe realizim punimesh me efikasitet energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës” 2023		
Urdhër Prokurimi :		
Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T. Z. A.M. Znj. K.H.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike:
4. Fondi limit (pa TVSH): 50.000.000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: O.E. “M...” Sh.p.k J.... O.E. “L...” Sh.p.k K... b) Kualifikuar: O.E. “M...” Sh.p.k J..	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. O.I. Znj. A.B. Z. M.P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 42.250.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 21.08.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 2.750.000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 9 muaj

Të dhëna mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit

Lloji i procedurës së prokurimit: Punë e Hapur

Fondi limit: 50,000,000 lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 13 muaj

Shkollat për të cilat është zhvilluar procedura e prokurimit janë :

- Shkolla 9-vjecare T.H.
- Shkolla 9-vjecare Cërruje
- Shkolla 9-vjecare Xibër

ku sipas AK këto shkolla paraqiten të amortizuara dhe kryerja e ndërhyrjeve në elementë të vecantë shihet me prioritet të vecantë.

AK paraqet disa arsye mbi të cilat duhet zhvilluar procedura e prokurimit, por nuk jep detaje të tjera mbi gjendjen e shkollave në të gjithë Republikën e Shqipërisë, numrin e nxënësve që e frekuentojnë dhe përse janë zgjedhur pikërisht këto 3 shkolla në këtë zonë.

Me datë 02.06.2023 hartohet urdhri i prokurimit me nr. 38 për kryerjen e prokurimit të fondeve publike të investimeve buxhetore, të parashikuara në Buxhetin e vitit 2022 me objekt “Auditim projekt zbatim dhe realizim punimesh me efikasitet energjie në disa shkolla publike në qarkun e Dibrës” me fond limit 60,000,000 lekë me TVSH.

Njësia e prokurimit me përbërje:

- A.M.
- K.T.
- K.H.

Me procesverbalin nr. 334/1 Prot., datë 2.06.2023 ngrihet grupi për hartimin e dokumentave të tenderit me përbërje:

- A.M.
- K.T.

- K.H.

Me procesverbalin nr. 44 datë 02.06.2023, ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

- O.S
- M.P.
- A.B.

Në lidhje me pikën nr. **2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)** janë kërkuar licencat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.P – 3B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S.- 4B - Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknikëndertuese.

Gjithashtu në pikën **2.3.3.** është kërkuar që OE duhet të disponojë license projektimit, mund të nënkontrakttojë shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, date 28/12/2016 ” *Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim* ” Licensa e projektimit duhet te kete kategorite si me poshtë:

- Kat 2/a - Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë, si më poshtë:

- NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre
- NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Në lidhje me pikën **2.3.4 Staf** nga ana e AK është kërkuar:

2.3.4.a) Staf Kryesor

1 Arkitekt

1 *Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Eficiency e Energjisë, për auditimin e energjisë në ndërtesa)*

1 *Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Eficiency e Energjisë, për auditimin e energjisë në instalime industriale)*

2.3.4.b) Staf Ndhmes Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit ndihmës të shoqërisë ose të kontraktuar me marreveshje bashkëpunimi të vlefshme:

1 arkitekt ose inxhinier ndërtimi

2.3.4.c). Pajisjet e auditimit

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (W/m²K)
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë

2.3.4.d) Staf kryesor

1 arkitekt

1 Inxhinier ndërtimi

1 Inxhinier gjeodet ose markshaidet ose topograf

1 Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, për aMenaxhim Energjie)

Caktimi i audituesve energjistik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjistik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjistik nuk kryhet nga një auditues energjistik, i cili:

- a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;
- b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;
- c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjistik.

2.3.4.e) Operatorët ekonomikë për realizimin e shërbimit duhet të disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- 1 individ të pajisur me një certifikatë "*Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit*"
- 1 individ të pajisur me një certifikatë "*Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001;2015*"
- 1 individ të pajisur me një certifikatë "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*"

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 25 (njëzet e pese) punonjës.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Staf i lidhje me fuqinë punëtore që minimalisht duhet të jetë 25, është e paargumentuar nga ana e AK.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin e kontratës si më poshtë.

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	Skeleri	në pronësi ose me qira	1000 m ²

Mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga ana e AK nuk e përmbushin qëllimin dhe objektivat e realizimit të procedurës së prokurimit. Nisur nga vlera dhe preventivi i realizimit të punimeve në kohën e duhur kërkon qasjen me mjete dhe pajisje të tjera për realizimin në kohë dhe si duhet të objektit të procedurës së prokurimit.

Për parregullsitë e mësipërme të konstatuara në hartimin e kriterëve të vecanta të dokumenteve të tenderit mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: znj. K. T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike, znj. K.H., me detyrë specialiste në Sektorin e Auditimit dhe Certifikimit të cilët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

2.4.1.b) Për produktet e mëposhtme, në rastet kur operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet të vërtetojë me një autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalentin e saj) e cila tregon marrëdhëniet midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ndërmjet ofertuesit-shpërndarësit të

autorizuar. Pajisjet duhet te shoqërohen me certifikata konformiteti dhe cilësie për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.

-F.V. Mbështjellëse termoizolim fasade (sipas termave të referencës)

-F.V. Dritare dopioxham (sipas termave të referencës)

Me skadimin e afatit përfundimtar për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi, anëtarëve të KVO-se iu shfaqen në ekran emrat e Operatorëve Ekonomikë Ofertues, të cilët rezultuan si më poshtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka bërë hapjen e ofertave nga OE si më poshtë:

BOE "M.." shpk dhe "T....." shpk me ofertë 48,250,000 lekë pa TVSH

OE "N...." shpk me ofertë 47,500,000 lekë pa TVSH

BOE "S...."shpk & "L....." shpk, "D.H." dhe "V.S." me ofertë 48,550,000 lekë pa TVSH.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE vendosi:

Të vijojë me vlerësimin me pikë për BOE "M.."shpk dhe "T....." shpk me ofertë 48,250,000 lekë pa TVSH,

të skualifikojë OE "N...." shpk pasi:

Në pikën 2.3.1 (kapaciteti teknik) OE "N..." shpk nuk plotëson kërkesën për të paraqitur punë të ngjashme

Në pikën 2.3.2a (Kapacitetet teknike dhe profesionale) OE "N..". shpk nuk plotëson kategorinë e kryerjes së punimeve: NP-3B, NS-4B

dhe të skualifikojë BOE "S.."shpk & "L.."shpk, D. H. dhe V. S. nuk plotëson kriteret e veçanta në DST, përkatësisht:

Në pikën 2.3.5 OE nuk plotëson kërkesën në lidhje me Skeleri (në pronësi ose me qira) 1000 m2.

Në pikën 2.4.1a (kërkesa të veçanta për kualifikim (certifikata për sistemet e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 ose ekuivalent.

KVO vazhdoi me vlerësimin e Krieteve të përzgjedhjes së fituesit, mbështetur në kushtet e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, bazuar në kriterin e çmimit më të favorshëm bazuar në kosto.

Argumentimi mbi vlerësimin nga KVO

(i) Cmimi 50 Pikë

(ii) Metodologjia e Propozuar

[10 pikë]

Nënkriteret

ii/a. Metodologjia e propozuar

7 pikë

ii.b Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin

3 pikë

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[30 pikë]

[20-60]** pasi nuk aplikohet transferimi i njohurive, për këtë arsye pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e kriterit Transferimi i Njohurive, duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar". 29 pikë

(iv) Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-5 pikë]

Nënkriteret

Propozimet konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike që minimizojnë ndikimin mjedisor.

2 Pikë

Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve **2 Pikë**

(v) Periudha e garancisë së objektit [0-5 pikë]

OE kanë ofruar një garanci punimesh 30 muaj për këtë arsye sipas llogaritjes me formulë vlerësohet me 5 pikë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të miratojë klasifikimin përfundimtar BOE “M...”shpk dhe “T...” shpk me **98 pikë**.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

- Nuk kuptohet qartë nga grupi i auditimit mbi mënyrën e përzgjedhjes së kampionit mbi shkollat në qarkun e dibrës. Cilat ishin kriteret e përzgjedhjes së tyre, ku duke u nisur nga qëllimi i institucionit mbi projektet pilot mbi eficientë e energjisë elektikë, të përfitojnë dhe pjesa më e madhe e komunitetit.
- Në lidhje me dokumentacionin e mbajtur nga Anëtarët e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartuesit e termave të referencës nuk kuptohet qartë metoda që ka përdorur për përllogaritjen e fondit limit, të kampioneve të përdorur dhe sipërfaqeve përkatëse të pallatave që do të përdreshin si kampion për realizimin e objektit të kontratës.
- Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertave nuk janë bazuar në metodën e çmimit më të ulët, duke skualifikuar oferta të sjellë nga O.E. të cilët kanë qenë më të ulëta se oferta ekonomike e përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në përmbushje të kriterëve të pikëve dhe çmimit më të ulët, O.E. “N...”. duhej të ishte shpallur fitues i procedurës së prokurimit.

• **Rikonstruktion, Auditim dhe projekt zbatimi me eficientë energjetike në spitalin e Bashkisë Mat**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Projekt Pilot “Rikonstruktion, Auditim dhe projekt zbatimi me eficientë energjetike në spitalin e Bashkisë Mat”		
Urdhër Prokurimi : nr.50 prot. date 21/06/2023		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit A.M. K.T. K.H.	3. Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: K.T. M.P. Xh.S.
4. Fondi limit (pa TVSH): 59,166,666 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 18.07.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: 5 Operatorë Ekonomik b) Kualifikuar: BOE “B....& E...”	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave O. I. A. B. M. P.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 57,490,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës nr.464.prot.,date.29.08.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 1,676,666 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 10 muaj

Drejtori i Spitalit M...z. H.C. me shkresën hyrëse në AEE nr.164 prot. date 13.02.2023 me objekt “Kërkesë për investim” drejtuar Agjencisë së Eficences Energjisë ka kërkuar nga AEE realizimin e rikonstruksionit e godinës së Spitalit Mat.

Projekt studimi për rikonstruksionin e Spitalit Mat është realizuar nga AK Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për Projektin e MSHMS , loti 1” Hartimi i projekt preventivave të zbatimit për disa spitale Rajonale, Bashkiake”-Spitali Mat është shpallur fitues BOE “A...” & “A...” & K...”

Projekti i kontraktuar nga MSHMS ka objekt Rikonstruksion dhe **shtesë kati** të godinën ekzistuese dhe relacion arkitektonik

Spitali i Matit pas realizimit të projekt zbatimit të rikonstruksionit të godinës së Spitalit Mat, kërkesën për investim duhej ta dërgonte pranë MSHMS si institucion përgjegjës për investimet në institucionet e shërbimit spitalor.

MSHMS në rolin e Autoritetit Kontraktor për Projektin e prokuruar dhe kontraktuar për rikonstruksionin e Spitalit Mat ku parashikohet shtese kati, nuk ka përcjellë asnjë kërkesë pranë MIE për realizimin e këtij projekt.

Spitali Bashkiak Mat, një institucion i varësisë së MSHMS, ka përcjellë kërkesë AEE për investim duke u bazuar në projekt zbatimin e kontraktuar nga MSHMS, duke vepruar në mospërputhje me ligjin për shërbimin spitalor nenin 24 dhe 29, ku parashikohet si me poshtë:

Neni 24

Financimi i spitaleve

Spitalet publike financohen nga:

- a) Ministria e Shëndetësisë;*
- b) institucionet e sigurimeve shëndetësore;*
- c) pushteti vendor;*
- ç) donatorët vendas e të huaj.*

Neni 29

Spitalet e zhvillojnë veprimtarinë e tyre financiare, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për institucionet me buxhet të pavarur.

Projektet 230 dhe 231 në institucionet e shërbimit shëndetësor, ku përfshihet dhe Spitali Bashkiak Mat, financohen nga MSHMS.

Referuar VKM nr. 46, datë 30.1.2019 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019” pika 10 përcaktohet se:

*Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson **kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim.** Spitalet universitare e paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

Grupi i punës për hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën Rikonstruksion, Auditim dhe projekt zbatimi me efijçencë energjetike në spitalin e Bashkisë Mat eshte ngritur me Urdhrin nr.7, datë 31.01.2023 dhe përbëhej nga K.T., Xh.S. dhe Xh. Sh.

Referuar kapitullit 3-Objektivat dhe qëllimi AK ka përcaktuar 3 objektiva kryesorë.

Objektivat e realizimi të këtij projekti janë:

Realizimi i të gjitha fazave të projektimit dhe realizimit të zbatimit të punimeve të cilat do të reflektojnë një ulje të konsumit të energjisë në këtë institucion shëndetësor.

Përmirësimi i kushteve të komfortit të ambienteve të brendshme, në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Sensibilizimi i popullatës dhe i personelit të administratës shtetërore nëpërmjet demonstrimit në praktikë të ndërhyrjeve për përmirësimin e efijencës së energjisë. Ky projekt pilot do të nxisë vazhdimësinë e këtij procesi, për të cilin AEE është në realizim të objektivave për uljen e konsumit të energjisë dhe të emetimeve të CO2.

Projekti për rikonstrukcion, auditim dhe projekt zbatimi me efijencë energjetike në spitalin e Bashkisë Mat, do të përfshijë fazat si më poshtë:

Faza I - Auditim paraprak energjetik i institucionit shëndetësor

Faza II - Projekt i zbatimit

Faza III - Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së Energjisë paraprake (para punimeve të zbatimit)

Faza IV - Realizimi i punimeve të ndërtimi.

Faza V - Hartimi i raportit përfundimtar të auditimit dhe nxjerrja e Certifikatës së Performancës së Energjisë përfundimtare (pas punimeve të zbatimit)

-Ak AEE ka përcaktuar ne DST Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto, duke përcaktuar vlerësimin e OE fitues si me poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes se fituesit

Oferta financiare	50 pike
Metodologjia e propozuar dhe grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	10 pikë
Stafi / Eksperienca dhe Organizimi i Kompanisë	30 pikë
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	5 pikë
Periudha e garancisë së objektit	5 pikë

Përlllogaritja e fondit limit

Referuar Proces Verbalit nr.263/2 prot. datë 08.05.2023 të komisionit të sipërcituar përlllogaritja e fondit limit është realizuar si me poshtë:

Hapi i parë: Grupi i punës ka bërë për analizën e vlerës së projektit ka qenë nxjerrja e sipërfaqeve të mbështjellësit të objektit të marrë në shqyrtim.

Të dhënat paraprake janë marrë nga informacioni i dërguar pranë Agjencisë për Efijencën e Energjisë me nr.164 Prot, datë 13.02.2023 nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat për të parashikuar ndërhyrjet e duhura për ti kthyer këto objekte me performancë të lartë të energjisë.

Hapi i dytë: Grupi i punës, pas përcaktimit të sipërfaqeve është bërë përcaktimi e çmimeve për secilin element të mbështjellësit dhe punimeve të tjera.

Emertimi	Njesia (m2/m3/cope)	Çmimi mesatar	Totali per ze	Komente
Termoizolim	1,622	6,366	10,325,652	Çmimi është marrë nga studimi i tregut Nr. Prot 1782/1
Dritare	282	28,270	7,972,140	Çmimi marrë nga studimi i tregut Nr. Prot 963
Davancale mermeri	91	6,678	607,698	Nga matjet ne preventiv dhe në projekt gjerësi mermeri 0.55m , manual 2.273
<i>Tabela 2 në procesverbal</i>				

Soletë	100	27,750	2,775,000	Çmimi i marrë nga projekti Atelier 4 Porositës Ministria shëndetësisë/dhënë nga bashkia Mat
Beton per arkitrarë dhe breza	30	27,690	830,700	Çmimi i marrë nga projekti Atelier 4 Porositës Ministria shëndetësisë/dhënë nga bashkia Mat
Çmontim heqje çatie, dritare etj	1	440,000	440,000	Çmimi marrë nga preventivi
Taracë	860	4,014	3,452,040	Çmimi marrë nga manuali <i>Tabela 1 në procesverbal</i>
Tavan i varur	2,800	2,132	5,970,908	Çmimi marrë nga manuali 2.297/b <i>Tabela 3 në procesverbal</i>
Ndriçues tavanore	403	6,439	2,594,917	Çmimi i marrë nga studimi i tregut Nr. Prot 1782/1
Impjant fotovoltaiik	126	105,937	13,348,062	Çmimi i marrë nga studimi i tregut Nr. Prot 240/13
Kaldaja	1	3,000,000	3,000,000	Çmimi i marrë nga studimi i tregut Nr. Prot 240/13
Impjant ngrohje ftohje salla op	1	8,725,000	8,725,000	Çmimi i marrë nga studimi i tregut E-mail
Vlera Totale				60,042,117

1.1. Analiza e auditimit Energjetik dhe Certifikimit të Performances Energjitike

Çmimet e mëposhtme janë marrë sipas rregullores së miratuar me urdhër ministri nr.5, 12.01.2021, për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik.

Sipas sipërfaqeve të siguruara nga spitali Mat, çmimet për auditimin paraprak dhe përfundimtar

Auditim			
Lloji i auditimit	Sip. totale	Tarifa	Totali
Paraprak	3388	250	847,000.00
Përfundimtar	3388	250	847,000.00
Kosto totale			1,694,000.00

janë si më poshtë:

1.2. Analiza e projektimit

Duke qenë se spitali mat ka realizuar një projekt dhe na ka siguruar disa të dhëna të nevojshme për realizimin e këtij projekti, kemi marrë ne konsiderate vetëm tarifën për:

1. Projektin elektrik
2. Projektin e kondicionimit

Sipas vkm 354/2016 “Për miratimin e manualit të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim“.

Projektet elektrik + kondicionim	
Emërtimi	Vlera
Projekti elektrik	107,741.50 Lek
Projekti i kondicionimit	280,182.00 Lek

1.3. Vlera e propozuar e realizimit të projektit

Në përfundim, pas llogaritjes së secilit komponent, vlera totale e projektit do të jetë **62,124,040.5 Lekë pa TVSH.**

	Emërtimi i fazave	Vlera (në Lekë)
1	auditim paraprak energjetik i ndërtesave	0
2	projekt zbatimi	
2.1	projekt elektrik	107,741
2.2	projekt kondicionimi	280,182
3	nxjerrja e certifikatës së performancës së energjisë – paraprake (para punimeve të zbatimit)	847,000
4	realizimi i punimeve	60,042,117
5	hartimi i raportit përfundimtar të auditimit dhe nxjerrja e certifikatës së performancës së energjisë – përfundimtare (pas punimeve të zbatimit)	847,000
	Auditim, projektim dhe ndertim (pa TVSH)	62,124,040
	TVSH	12,424,808
	Auditim, projektim dhe ndertim (me TVSH)	74,548,848

Titullari i institucionit ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr.50., datë 21.06.2023 për procedurën Rikonstruksion, Auditim dhe projekt zbatimi me efijencë energjetike në spitalin e Bashkisë Mat me fond limit **59,166,666 leke** me TVSH.

Hartimi i DST

Njësia e prokurimit e përbërë nga A.M., K.T. dhe K.H. kanë hartuar dokumentet e tenderit bashkelidhur me proces verbalin e argumentimit te kriterëve te veçanta të përcaktuara në DST me proces verbalin nr.379/1 prot. date 21.06.2023

Kapaciteti Teknik i OE

2.3.2.a Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-3B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
2	N.P 10A	Ndërtimi i impjanteve për prodhimin e energjisë elektrike
4	NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
5	N.S.-12A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
6	N.S – 14A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlerësimi në lekë (milion) për kategorinë e kërkuar	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Përfshin të gjitha punimet që do të realizohen në objekt	21-50	Vlera total e projektit
N.P– 10A	Ndërtimi i impjanteve për prodhimin e energjisë elektrike.	Përfshin instalimin e Paneleve Fotovoltaike	0-20	Vlera total e projektit
NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me	Përfshin të gjitha punimet që do të	21-50	Vlera total e projektit

	material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	realizohen në objekt		
N.S.-12A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	Përfshin punimet e instalimit të sistemeve të ngrohje-ftohjes.	0-20	Vlera total e projektit
N.S- 4A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Përfshin punimet për instalimin e ndricimit të ambienteve	0-20	Vlera total e projektit

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë, si më poshtë:

- NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë licence profesionale në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim ose të paraqesë kontrate/marrëveshje bashkepunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, date 28/12/2016 ” *Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë :

- Kat 2/b3 - Projektim arkitektural për Objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.
- Kat 3/b1 Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
- Kat 4/a Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

2.3.4 Staf

2.3.4.a) Staf Kryesor

Për realizimin e shërbimit të projektimit si dhe të auditimit të efikasitetit të energjisë në objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të regjistruar si më poshtë;

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier Ndertimi
- 1 inxhinier mekanik
- 1 inxhinier elektrik
- 1 Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, për auditimin e energjisë në ndërtesa)
- 1 Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, për auditimin e energjisë në instalime industriale)

Kërkesa e mësipërme për inxhinier mekanik është e paargumentuar nga ana e Njësisë së Prokurimit, pasi në analizimin e preventivit nga ana e grupit të auditimit nuk konstatohet lidhja midis zërave të preventivit dhe inxhinierit mekanik

2.3.4.b) Stafin ndihmës

- inxhinier mekanik ose inxhinier elektrik

2.3.4.c). Pajisje e auditimi.

- Luxometër

- Kamera termike
 - Instrument për matjen e vlerës U (Ë/m²K)
 - Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë
- Pajisjet e auditimit duhet të jenë në pronësi të audituesit energjetik i cili i regjistron pranë AEE dhe jo në pronësi të OE. Kërkesa për pajisjet e mësipërme vjen si pasojë e kërkesës për auditues energjetik që të jetë pjesë e stafit të O.E.

2.3.4.d) Staf kryesor

- 1 arkitekt ose 1 (një)Inxhinier ndërtimi
- 1 Inxhinier mekanik
- 1 Inxhinier elektrik
- 1 Teknik ndërtimi
- 1 Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, për Menaxhim Energjie)

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

- a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;
- b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;
- c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

2.3.4.e) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 individ të pajisur me një certifikatë "**Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit**"

1 individ të pajisur me një certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë**"

1 individ të pajisur me një certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**"

2.3.4.f) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **25 (njëzet e pesë)** persona

Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua që Pika 2.3.4 Staf i lidhje me fuqinë punëtore që minimalisht duhet të jetë 25, është e paargumentuar nga ana e AK.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 Ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3.	Skeleri	në pronësi ose me qira	1000 m ²

Për parregullsitë e mësipërme të konstatuara në hartimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të tenderit mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: znj. K.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, z. A.M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike, znj. K. H, me detyrë specialiste në Sektorin e Auditimit dhe Certifikimit të cilët kanë vepruar në kundërshtim me

nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.a) Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë

<i>ISO 9001:2015</i>	<i>Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent</i>
<i>ISO 50001-2018</i>	<i>Sistemet e Menaxhimit të Energjisë ose ekuivalent</i>
<i>ISO 14001-2015</i>	<i>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent</i>

Titullari i institucionit ka ngritur KVO të përbërë nga: O.I., A.B. dhe M.P. me urdhrin nr.44, datë 02.06.2023.

KVO me date 18.07.2023, ka bërë hapjen e ofertave nga OE në SPE, ku u paraqiten OE si më poshtë:

1. BOE “B...& E..” me ofertë ekonomike 57,490,000 leke pa TVSH
2. BOE “C....” dhe “K....” me ofertë 59,000,000 leke pa TVSH.

Më datë 24.07.2023 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion, Auditim dhe projekt zbatimi me efikasitet energjetike në spitalin e Bashkisë Mat” me nr.379/4 Prot date 24.07.2023. Sipas këtij raporti KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka kualifikuar të dy OE pjesëmarrës për fazën e dytë të vlerësimit mbi bazën e kriterëve të përzgjedhjes së fituesit bazuar në kosto.

KVO ka vlerësuar me 98 pike BOE “B....” & “E...” dhe 90 pike BOE “C...” & “K...”, duke shpallur fitues BOE “B...” & “E....” me 98 pike

Titullari i AK AEE ka njoftuar shpalljen e fituesit nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit nr.379/5 prot. datë 31.07.2023.

Raporti përmbledhës i KVO me nr. 379/6 prot. i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. A. H. është hartuar më datë 07.08.2023

Nga auditimi në SPE konstatohet se:

BOE nuk ka paraqitur certifikata individuale të menaxherit të energjisë të regjistruar në regjistrin e audituesve të energjisë në Agjencinë e Eficences së Energjisë,

Në lidhje me konstatimin e mësipërme pika 3 dhe 4 kanë OE “B... “dhe “E...” kanë paraqitur për plotësimin e kriterit 2.3.4.d. pika 5, 6, njëkohësisht kontratë të lidhur me të njëjtin person dhe në të njëjtën kohë duke qenë punëdhënës.

Për sa më lart, Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë kualifikuar si të suksesshëm të dy BOE pjesëmarrës në këtë procedure në një kohe që asnjeri prej tyre nuk plotësonin të gjitha kërkesat apo kriteret të veçanta të kërkuara në DST, në këto kushte KVO duhej të s’kualifikonte BOE pjesëmarrës dhe të kërkonte anulimin e kësaj procedure.

Për këto konstatime të mësipërme të audituesit të çështjes, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën Nr. 396/1 prot., datë 26.08.2024 (të dhëna të AEE), protokolluar në KLSH me Nr.1043/13, datë 27.08.2024, në të cilin janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me konstatimin se “BOE B...& E...” nuk plotëson kriterin 2.4.1.b për mbështjellëse termoizolim fasade, pasi mungon certifikata e konformitetit dhe cilësisë për parametrat teknik...”

Ju bëjme me dije se bazuar mbi dokumentacion e dorëzuar nga OE ekonomik i shpallur fitues, konkretisht Autorizim nga Thermalite,Elbasan, ai plotëson kërkesat e kriterit 2.4.1.b për F.V. mbështjellës termoizolim fasade, autorizimi shoqërohet me certifikatën e cilësisë së lëshuar nga vetë prodhuesi dhe skedën teknike sipas standartit S SH EN 13164. Gjithashtu specifikimet teknike përputhen plotësisht me kërkesat në termat e referencës.

Në lidhje me konstatimin se OE “B.” shpik ka ngarkuar në SPE kontratën e pa noterizuar të lidhur me datë 11.07.2023 me znj. L.D. si menaxhere energjie në plotësim të kriterit 2.3.4.d pika 5.6, ju bëjme me dije se bazuar mbi kërkesat e vecanta në dokumentat standarte të tenderit kërkohet kontrata e punës e vlefshme ose marrëveshja e bashkëpunimit me objekt të njëjtë me objektin e kontratës së procedurës së mësipërme. Gjithashtu në fazën e dorëzimit të dokumentacionit fizik ka paraqitur kontratën e noterizuar.

Qëndrim i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të autorizimit nga Thermalite dhe kontratave të noterizuara, mori në konsideratë observacionin dhe kreu rregullimet përkatëse përgjatë materialit.

• **Studim auditim dhe projekt zbatim për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Studim auditim dhe projekt zbatim për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza		
Urdhër Prokurimi : nr.51 prot. date 21/06/2023		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit A.M. K.T. K.H.	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: K. T., M. P., Xh.S.
4. Fondi limit (pa TVSH): 43,333,333 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 24.07.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 5 Operatorë Ekonomik b) Kualifikuar: OE N...	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Xh.A. F.D. Xh.Sh.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 41,815,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës nr.534 prot. date 25.10.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 1,518,333 lekë	12. Ankimime S’ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 9 muaj

Planifikimi i procedurës së prokurimit

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar dhe të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se:

Midis ministrisë përgjegjëse të energjisë dhe asaj të shëndetësisë, nuk ka një marrëveshje bashkëpunimi, ku të jetë përcaktuar nder të tjera realizimi i një procedure të hapur prokurimi për shërbimin e konsulencës në lidhje me rritjen e Eficences së energjisë për godinat e QSUT.

Gjithashtu dhe në pikëpamjen formale nuk ekziston asnjë kërkesë e QSUT për AEE në lidhje me nevojën e realizimit të kësaj projekti.

Procedura e prokurimit e realizuar nga AK., AEE ku përfitues është QSUT, një strukture shëndetësore terciare e varësisë së ministrisë përgjegjëse të shëndetësisë, është në mospërputhje me ligjin për shërbimin spitalor nenin 24 dhe 29, ku parashikohet si më poshtë:

Neni 24

Financimi i spitaleve

Spitalet publike financohen nga:

- a) *Ministria e Shëndetësisë;*
- b) *institucionet e sigurimeve shëndetësore;*
- c) *pushteti vendor;*
- ç) *donatorët vendas e të huaj.*

Neni 29

Spitalet e zhvillojnë veprimtarinë e tyre financiare, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për institucionet me buxhet të pavarur.

Projektet (230) dhe investimet (231) në institucionet e shërbimit shëndetësor, ku përfshihet dhe QSUT, financohen nga MSHMS.

Referuar VKM nr. 46, datë 30.1.2019 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019” pika 10 përcaktohet se:

*Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. **Spitalet universitare e paraqesin kërkesën për investime** në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

Titullari i institucionit me urdhrin nr. 9 Prot., datë 08.02.2023 ka ngritur grupin e punës për hartimin e termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit shërbim konsulence me objekt “ Studim, auditim, dhe projekt zbatim për eficiency e energjisë për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Termet e referencës janë hartuar nga K.T., Xh.Sh., Xh.S.

Në termat e referencës, janë paraqitur të dhënat teknike për 10 godinat të QSUT.

Godinat e përzgjedhura janë:

1. Kirurgjia e Përgjithshme dhe Reanimacioni
2. Drejtoria e QSUT
3. Qendra e Konsultave,
4. Neurologjia,
5. Neurokirurgjia,
6. Psikiatria,
7. Spitali Rehabilitimit SP5,
8. Spitali Onkologjik,
9. Spitali i specialiteteve/Spitali Francez,
10. Kardiokirurgji dhe Kardiologjia.

Projekt “Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në qendrën spitalore universitare Nënë Tereza” është parashikuar të realizohet në 3 (tre) faza:

Faza I: Auditim paraprak energjitik i godinave të përzgjedhura duke përfshirë analizën e gjendjes ekzistuese dhe certifikatat e gjendjes ekzistuese.

Faza II: Projekt zbatimi

Faza III: Nxjerrja e Certifikatës së Performancës së energjisë (paraprake).

Përlllogaritja e fondit limit

AK., AEE, nëpërmjet ftesave për ofertë drejtuar

OE “T...” nr.219/2 datë 28.03.2023;

OE “V...” nr.219/3Prot., datë 28.03.2023 dhe

OE “N...” nr.219/4 Prot., datë 28.03.2023,

Në përgjigje të ftesës për ofertë;

1. OE “V....” me shkresën nr.219/5 Prot., datë 31.03.2023, ka ofertuar shumën 41,666,666 lekë pa TVSH

2. OE “T...” me shkresën nr.219/6 Prot., datë 3 1.03.2023, ka ofertuar shumën 45,833,333 lekë pa TVSH

3. OE “N....” me shkresën nr.219/7 Prot., datë 31.03.2023, ka ofertuar shumën 42,500,000 lekë pa TVSH

4. OE të sipërcituar nuk kanë respektuar kërkesën e paraqitur në Termat e References, për dhënie e ofertës të ndarë sipas projekteve për çdo godinë, por OE të sipërpermendur kanë paraqitur një vlerë totale në ofertë për të 10 (dhjetë) godinat.

Referuar proces verbalit nr.219/8 datë 31.03.2023 fondi limit është përlllogaritur në shumën **43,333,333 lekë pa TVSH** nga grupi për përlllogaritjen e tij.

Hartimi i DST

Në Urdhrin e Prokurimit nr.51 datë 21.06.2023 për procedurën e shërbimit të konsulencës “Studim, auditim, dhe projekt zbatim për efikasitetin e energjisë për klinikat në qendrën spitalore universitare “Nënë Tereza” anëtarët e njësisë së prokurimit A.M., K.T. dhe K. H., janë caktuar për hartimin e DST.

Në zbatim të urdhrin të prokurimit, njësia e prokurimit me proces verbal nr.380/1 datë 21.06.2023 ka hartuar DST., si dhe argumentimin e vendosjes së kriterëve të veçanta.

2.3.4 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

2.3.2.a Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës ose të paraqesin kontratë bashkepunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe auditimit të energjisë.

-Kat 2/b3 - Projektim arkitekturor për Objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:

-Kat 4/b Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme

2.3.4 Stafi

2.3.4.a) Stafi Kryesor

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier Ndertimi
- 1 ixhinier mekanik
- 1 ixhinier elektrik
- 1 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, për auditimin e energjisë në ndërtesa)
- 1 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, për auditimin e energjisë në instalime industriale)

Caktimi i audituesve energjetik që të jenë pjesë e stafit të kompanive është në kundërshtim me Neni 17 “Audituesi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, ku citohet:

3. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:

a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;

b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;

c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, i cili, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.

Gjithashtu caktimi i inxhinierit mekanik nuk është e argumentuar nga ana e njësisë së prokurimit dhe pozicioni I tij nuk gjen vend në zbatimin e procedurës së prokurimit.

2.3.4.b) Staf i Ndhimes

- 1 arkitekt ose 1 ing. Ndertimi ose 1 ing. mekanik

2.3.4.c) Pajisjet e auditimit

- Luxometër
- Kamera termike
- Instrument për matjen e vlerës U (W/m²K)
- Pajisje (ventilator) për matjen e infiltrimeve të ajrit në ndërtesë

2.3.4.f) Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 10 (dhjetë) punonjës.

Për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të tenderit, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: z. A. M. me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike të AEE, znj. K.T. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, znj. K.H., me detyrë specialiste në Sektorin e Auditimit dhe Certifikimit, të cilët kanë vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 1, neni 77; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 39.

Procedura e shërbimit të konsulencës përfshin dy faza kryesore

Faza 1-shprehje e interesit dhe parakualifikimi (lista e shkurtër)

Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër.

Faza 2-Paraqitja e propozimeve

Autoriteti/Enti Kontraktor dërgon një ftesë për të dorëzuar propozime, kandidatëve që janë kualifikuar në Fazën 1 (Ofertuesit e përzgjedhur në listën e shkurtër).

Propozimet përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti/Enti Kontraktor. Ky i fundit lidh kontratë me OE që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto:

Kriteret e Vlerësimit teknik

Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit

Pikët

[1-10]

Metodologjia e Propozuar

[20-30]

(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[20-60]

Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

Pe-Pikët për Propozimin Ekonomik; Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar; Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

Vlerësimi përfundimtar

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë = X + Y

Vlerësimi i KVO

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 45 Prot., datë 02.06.2023 përbëhet nga Xh.A., F. D., Xh. Sh.

Vlerësimi Faza I

Në referim të proces verbalit nr.380/3 Prot., datë 24.07.2023 të KVO në fazën e parë, kanë paraqitur interes operatorët ekonomike:

1. BOE “S..&S...” &”M...”

2. OE “Gj... & C...”

3. OE “N...”

Pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE pjesëmarrës në fazën e parë, KVO ka hartuar proces verbalin nr.380/4 datë 27.07.2023 të vlerësimit, duke kualifikuar të 3 (tre) OE për fazën e dytë.

Titullari i AK, pas vlerësimit të fazës së parë nga KVO, i ka dërguar OE të kualifikuar ftesën për propozim nr.380/5 Prot., datë 03.08.2023.

Afati përfundimtar për këtë fazë është data 29/08/2023 ora 10:00

OE fazën e dytë duhet të paraqesin propozimin ekonomik dhe teknik në SPE

Nga auditimi në SPE konstatohet se:

1. BOE “S..&S...” &”M...”, nuk ka plotësuar piken 3.1 të DST ku parashikohet se: *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5.*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 1.040.000.

Referuar procesverbalit të KVO nr. 380/4 datë 27.07.2023, BOE “S..&S..&M...”, është kualifikuar dhe është ftuar për propozim të ofertës ekonomike dhe teknike ndërmjet ftesës për propozim nr. 380/5 prot. datë 03.08.2023.

Anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e DST pika 3.1. dhe përcaktimet e nenit 83, pika 1 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” duke e kualifikuar BOE “S...&S...” &M...”, në fazën e parë dhe për pasojë është ftuar për fazën e dytë, në kushtet kur ky OE duhej të

skualifikohej. Me veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi Xh.A., F. D., Xh. Sh. ne cilësinë e anëtarëve të KVO.

Faza e dytë

KVO bëri hapjen e fazës së dytë në SPE., më datë 29.08.2023. Në këtë fazë sipas proces verbalin nr.380/6 Prot., kanë marrë pjesë OE:

1. BOE "S...&S.." & "M..."
2. OE "Gj.."
3. OE."N...."

Referuar Raportit Përmbledhës të KVO nr.380/9 datë 25.09.2023, vlerësimi i OE pjesëmarrës mbi bazën e vlerësimit Teknik dhe Ekonomik, është si më poshtë:

1. OE "N..." vlerësimi përfundimtar **90.40 pike** dhe sipas SPE **271.20 pikë**.

Oferta ekonomike **41,815,000.00** Lekë pa TVSH

2. OE "Gj..." vlerësimi përfundimtar **84.89 pike** dhe sipas SPE **255.60 pikë**

Oferta ekonomike **42,466,666.34** Lekë pa TVSH.

3. BOE "S...&S.." & "M...", në shumën 31,000,000 leke pa TVSH.

KVO e ka s'kualifikua këtë OE, pasi anëtarët e KVO kanë konstatuar gabime aritmetike më të madhe se 2% të vlerës se ofertës.

Nga auditimi ne SPE, konstatohet se:

1. OE Net Grup nuk ka plotësuar kriterin **2.3.4.a) Stafii Kryesor**, për realizimin e shërbimit të projektimit si dhe të auditimit të efikasitetit të energjisë për pajisjet në objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të regjistruar si më poshtë;

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) inxhinier mekanik

1 (një) inxhinier elektrik

1 (një) Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, për auditimin e energjisë në ndërtesa)

1 (një) Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, për auditimin e energjisë në instalime industriale)

Në SPE, OE" N..." për plotësimin e kriterit 2.34.a., ku kërkohen 2 auditues energjetik te profilit ne ndërtesa dhe instalime industriale, kërkesa do te ishte e plotësuar edhe ne rastin kur këta 2 auditues do te ishin certifikuar për te dy profilet, OE "N...", ka ngarkuar vetëm certifikatën e z.V.B. me profil "Auditues energjetik ne ndërtesa dhe instalime industriale".

2. OE" Gj.&C." per plotësimin e kriterit 2.3.4.a. ka paraqitur dy auditues energjetik ne stafin e tij, për te realizuar projektin dhe auditimin e energjisë, por ne lidhje me audituesin L.P. i profilit "Auditues energjetik ne instalimet industriale" mungon librezja e punës, duke mos përmbushur kriterin 2.3.4.a, ne te cilin parashikohet se:

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës se Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë:

Për audituesin energjetik në ndërtesa dhe ate ne instalime industriale

- kontrata e punës e vlefshme ose marrëveshja e bashkëpunimit me objekt të njëjtë me objektin e kontratës të procedurës së mësipërme,
- Certifikata individuale e audituesit,
- **librezë pune**
- CV.

Në kushtet kur të dy OE e kualifikuar të suksesshëm nga KVO, të cilat nga auditimi në SPE nga grupi i auditimit të KLSH është konstatuar se nuk plotësonin disa nga kriteret e kërkuara në DST, KVO duhej ti s'kualifikonte dhe titullari i AK duhej ta anulonte këtë procedurë, pasi kjo procedurë është e parregullt, e cila ka sjellë lidhjen e kontratës prej 43,333,333 leke, me një OE i shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT.

Për parregullsitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: znj. Xh.A., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, z. F.D. me detyrë specialistë në Sektorin e Programeve të Eficences dhe Analizes, si dhe z. Xh.Sh., me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve. KVO ka vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87, 92, 98, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, nenin 82 pika 2.

- **Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatim për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare” 2023**

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatim për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare” 2023		
Urdhër Prokurimi :		
Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur ”	2. Njësia e Prokurimit Znj. K.T. Z. A.M. Znj. K.H.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike:
4. Fondi limit (pa TVSH): 83.333.333 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit	6. Data e hapjes së tenderit: 05.10.2023
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: O.E. “I...” Sh.p.k K.... O.E. “H...” Sh.p.k K.... O.E. “T...” Sh.p.k K.... b) Kualifikuar: O.E. “T...” Sh.p.k K....	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z. Xh. A. Z. F.D. Z. Xh.Sh.	9. Oferta fituese (pa TVSH): 81.660.000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 26.12.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 1.673.333 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës :	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 8 muaj

Për llogaritjen e fondit limit për projektin: "Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatim për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare"

Sipas ofertave të marra nga tre kompani ku u është kërkuar një oferte ekonomike për studim tregu është kryer analiza ekonomike e mëposhtme duke kryer llogaritjen e mesatares të cmimeve sipas ofertës ekonomike:

Kërkesat për ofertë kanë pasur sasi për produktet më poshtë ndërsa produktet e tjera janë në sasi

1:

Karikues për makinat elektrike Fast Charger DC 50 kwh + AC 22 kwh, 1 dalje DC + 1 dalje AC, përfshirë ndërtim bazamentesh, furnizim vendosje aksesorë të nevojshëm për lidhjen e karikuesve me rrjetin elektrik (linja ushqimi kabllore me kabinat elektrike më të afërta ekzistuese ose ndërtim kabina elektrike të reja), instalim pajisjesh + konfigurim si dhe pagesa e tarifave ndaj OSHEE.

6 Copë

Karikues për makinat elektrike Rapid Charger DC 150 kWh, 2 dalje DC, përfshirë ndërtim bazamentesh, furnizim vendosje aksesorë të nevojshëm për lidhjen e karikuesve me rrjetin elektrik (linja ushqimi kabllore me kabinat elektrike më të afërta ekzistuese ose ndërtim kabina elektrike të reja), instalim pajisjesh + konfigurim si dhe pagesa e tarifave ndaj OSHEE **4 Copë**

Karta RFID për aksesimin e karikuesve **500 Copë**

Adoptim vendparkime si dhe vendosje Sinjalistika horizontale dhe vertikale për personalizimin e vend parkimeve **20 Copë**

Karikues për makinat elektrike Fast Charger DC 50 kwh + AC 22 kwh, 1 dalje DC + 1 dalje AC, përfshirë ndërtim bazamentesh, furnizim vendosje aksesorë të nevojshëm për lidhjen e karikuesve me rrjetin elektrik.

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R..	4,250,000	5,100,000	4,250,000	5,100,000
2	A...	4.350.000	5,220,000		
3	G...	4 150 000	4,980,000		

Karikues për makinat elektrike Rapid Charger DC 150 kWh, 2 dalje DC, përfshirë ndërtim bazamentesh, furnizim vendosje aksesorë të nevojshëm për lidhjen e karikuesve me rrjetin elektrik.

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R..	12,150,000	14,580,000	12,083,333.33	14,500,000
2	A...	12,050,000	14,460,000		
3	G....	12,050,000	14,460,000		

Studim, Auditim dhe projekt zbatim për vendosjen e karikuesve të makinave elektrike në disa qytete apo pika doganore të vendit

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R...	1400 000	1.680.000	1,700,000	2,040,000
2	A....	1 800 000	2 160 000		
3	G....	1,900,000	2.280,000		

Karta RFID për aksesimin e karikuesve

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R....	1 100	1,320	1,016.66	1,220
2	A....	950	1,140		
3	G...	1,000	1,200		

Pajisje Sistem qëndror i menaxhimit të karikuesve elektrike i hostuar në cloud për periudhë 1 vjecare

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R....	9,500 000	11,400,000	9,400,000	11,280,000
2	A....	9 800 000	11,760:000		
3	G.....	8,900 000	10,680,000		

Trajnim stafi dhe mbikëqyrje menaxhim dhe mirëmbajtje e sistemit të instaluar për një periudhe garancie 1 vit

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R....	2,230,000	2.676,000	2,306,666.66	2,768,000
2	A....	2,260,000	2,712 000		
3	G....	2,430.000	2.916,000		

Adoptim vendparkime si dhe vendosje Sinjalistika horizontale dhe vertikale për personalizimin e vend parkimeve

Nr	Kompania	Oferta ekonomike (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike (me TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (pa TVSH) ALL	Oferta ekonomike mesatare (me TVSH) ALL
1	R....	55,000	66,000	56,666.66	68,000
2	A....	50,000	60,000		
3	G.....	65,000	78,000		

PREVENTIV

Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare.			
Nr.	Zëra punimesh	Njësia	Vlera
1	Auditim dhe projektim	Leke	1,700,000
2	Realizim punimesh	Leke	81,900,330
	Shuma Projektim, Ndertim dhe Auditim pa TVSH	Leke	83,600,330
	TVSH	20%	16,720,066
	Shuma Projektim, Ndertim dhe Auditim me TVSH	Leke	100,320,396

Zhvillimi i procedurës së prokurimit:

Lloji i procedurës së prokurimit: Pune -E hapur

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-80532-09-19-2023

Objekti i kontratës i Marrëveshjes Kuadër: Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pika kufitare.

Fondi limit: 83,333,333 lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 13 Muaj

Kriteret e veçanta të kualifikimit

Në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në pikën 2.3.2 (Kapacitetet teknike dhe profesionale) janë kërkuar licencat e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1A	Punime gjurmimi në tokë.
2	NP-2A	Ndërtime civile dhe industriale
3	NS-6A	Sinjalistike Rrugore jo Ndriçuese.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Vlerësimi në lekë	Vlera e punimeve
NP-1A	Punime gjurmimi në tokë.	0-20	Vlera e vogël
NP-2A	Ndërtime civile dhe industriale.	0-20	Vlera total e projektit
NS-6A	Sinjalistike Rrugore jo Ndriçuese.	0-20	Vlera total e projektit

Në **pikën 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të disponojë license projektimit, mund të nënkontraktojë shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 *”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*

Licensa e projektimit duhet të ketë kategorite si më poshtë :

- Kat 2/d Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.
- Kat 4/c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- Kat 4/j Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.
- Kat 8/a Rilevime inxhinierike.

Sipas argumentimeve Kat 2/d Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe. – Është kërkuar pasi objekti i kontratës përveç instalimit të stacioneve të karikimit parashikon edhe sistemimin e sipërfaqeve rreth tij ku parashikohen edhe sipërfaqe të gjelbërta.

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që në përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndricuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat kërkojnë pajisjen me licensat përkatëse si:

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A

Gjithashtu në lidhje me licensat e projektimit është kërkuar licenca Kat 4/g në lidhje me projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa e cila nuk gjen zbatim në preventivin e punimeve.

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtëpërdrejtë, si më poshtë:

Kat 10/c - Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

Kat 11/d - Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Në lidhje me pikën **2.3.4 Stafi është kërkuar:**

2.3.4.a) Stafi Kryesor

1 Arkitekt ose urbanist

1 Inxhinier Elektrik ose elektronik

1 Auditues energjetik (i çertifikuar nga Agjencia për Efijencën e Energjisë, për auditimin e energjisë në instalime industriale)

2.3.4.b) Stafi kryesor

Lista e inxhinierëve

- 1 arkitekt ose Inxhinier ndërtimi
- 2 specialist të Certifikuar për zgjidhjet teknike, instalim dhe mirëmbajtje për karikues elektrik EV Charger;

- 1 specialist te Certifikuar për sisteme virtualizimi të serverave në nivel profesional;
 - 1 specialist te Certifikuar për sigurine e informacionit ne nivelin te avancuar;
 - 1 specialist te Certifikuar përsistemet e baze se te dhenave;
 - 1 specialist te Certifikuar ne sistemet e menaxhimit në Cloud;
dhe një Menaxher energjie (i çertifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, për Menaxhim Energjie)
- 2.3.4.c)** Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht **15 (pesëmbëdhjet)** punonjës.
- 2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1.	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	makineri për vijëzimet e vendeve të posaçme të parkimit	në pronësi ose me qira	Copë 1

Në lidhje me pikën **nr. 2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim** janë kërkuar:

- 2.4.1.a)** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë
- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent
- ISO 27001:2013 Sistemet e automatizuara dhe sistemet e kontrollit ose ekuivalent
- ISO 20000-1:2011 Suport teknik për sistemet ne cloud dhe të pajisjeve IT ose ekuivalent

Me datë 05.10.2022 në SPE, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bëri hapjen e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë si më poshtë:

- BOE "H..." sh.p.k & "B...." sh.p.k.;
 - OE "I." sh.p.k.;
 - BOE "T...." sh.p.k. & "R...& M..." sh.p.k. & "K...." sh.p.k. & "C...." sh.p.k.
- KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomike, vendosi:
Të vijojë me vlerësimin me pikë për BOE "T.." sh.p.k & "R...&M..." sh.p.k & "K...." sh.p.k & "C..." sh.p.k pasi përmbush kriteret e përcaktuara ne DST.
Të skualifikojë BOE "H.." sh.p.k & "B..." sh.p.k pasi nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të DST, përkatësisht:
- 2.3.4.a) Stafi kryesor - Mungon Audituesi Energjetik në instalime industriale (E. Xh. nuk është i certifikuar nga Agjencia per Eficencen e Energjisë si Auditues Energjetik në instalime industriale, E.T. nuk është e certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë si Auditues në instalime industriale).
- 2.3.4.b) pika 2 - BOE nuk ka deklaruar në stafin e tij për zbatimin e punimeve Menaxherin e Energjisë të certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë.
- 2.4.1.a) BOE nuk ka deklaruar certifikimin ISO 20000-1:2011 "Për sistemet e Menaxhimit Cloud dhe të pajisjeve IT).
- 2.4.1.b) BOE nuk ka paraqitur dokumentet teknike (prospektet teknike, katalogu) si dhe certifikatat e konformitetit dhe cilësisë për parametrat teknik dhe garancinë për produktet.
- OE "I..." sh.p.k pasi nuk ka plotësuar kriteret e vecanta të DST, përkatësisht:
OE nuk ka plotësuar formularin e vetedeklarimit sipas shtojces 8 Pjesa III.
OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3.

BOE "T..." sh.p.k & "R...&M.." sh.p.k & "K..." sh.p.k & "C..." sh.p.k me ofertë: 81.660,000 Lekë pa TVSH;

Cmimi [50 pikë]

Operatori ekonomik BOE "T..." sh.p.k & "R...&M.." sh.p.k & "K..." sh.p.k & "C..." sh.p.k për cmimin sipas llogaritjes me formulë merr 50 pikë

Metodologjia e propozuar dhe grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [10 pike].

Nënkriteri:

Metodologjia e propozuar 7 pikë

Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: 3 pikë

Kohen e mobilizimit në kantier (jo më shumë se 11 muaj) 1 pikë

Grafiku i punimeve të Kontratës. 2 pikë

Operatori ekonomik ka paraqitur metodologji punimi ku ka përfshire fazat e procesit të punës. Në metodologji është bërë një përshkrim i stafit që do të marrë pjesë në realizimin e projektit dhe një përshkrim i specifikave teknike i detajuar i karikuesve për makinat elektrike.

Përsa i përket Metodologjia e propozuar Operatori ekonomik është vlerësuar me **5 pikë**

Koha e realizimit të punimeve të kontratës [3 pikë]

Operatori ekonomik ka paraqitur në metodologjinë e punimeve përpos kohës së realizimit ku operatori merr përsipër ta realizojë me beret se afati i përcaktuar në termat e references, dhe një tabele me organizimin e stafit dhe takime me aktorët përgjegjës me qëllim realizimin e një plani teknik të detajuar i cili lehtëson procesin e montimit e vendosjes në punë të karikueseve.

Operatori ekonomik sipas llogaritjes me formule është vlerësuar me **1 pikë**

Grafiku I punimeve të Kontratës [2 Pikë]

Operatori ekonomik ka paraqitur në grafikun e punimeve afatin kohor prej 8 muaj në total për realizimin me sukses të kontratës, e ndarë dhe e detajuar sipas secilës fazë të projektit, nga 11 muaj e përcaktuar në DST.

Për këtë arsye Operatori ekonomik vlerësohet sipas llogaritjes me formulë me **2 pikë**.

Stafi / Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë [30 pikë]

Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës, Operatori për Stafin/ Eksperienca dhe Organizimi i kompanisë sipas vlerësimit merr 23 pikë kjo pasi ky operator ka në stafin e tij persona me eksperiencë shumevjecare, persona të kualifikuar me certifikime që janë të domosdoshme për kryerjen e këtij projekti, dhe që kanë pasur eksperiencë të ngjashme me objektin e projektit që po vlerësohet.

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-5 pike]

Nën-kriteri:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin)/ të ricikluara/ eficente/ materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.

Operatori ekonomik ka paraqitur në metodologji përdorimin e bojrave të cilat janë miqësore me mjedisin dhe që janë të certifikuar sipas standardeve europiane lidhur me ndikimin që ato mund të kenë në mjedis.

Propozime konkrete për përmiresime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur propozime konkrete për përmiresime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve

Për këtë arsye Operatori ekonomik vlerësohet me 0 pikë.

Periudha e garancisë e punimeve civile e pajisjeve [0-5 pike]

Operoret ekonomik ka ofruar një garanci punimesh 2.5 vite për këtë arsye sipas llogaritjes me formulë vlerësohet me 5 pikë.

Pikët totale të mara nga Operatori Ekonomik BOE "T" sh.p.k & "R...&..M" sh.p.k & "K..." sh.p.k & "C..." sh.p.k janë **87 pikë**.

Përsa me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, vendosi të miratojë klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

BOE "T.." sh.p.k & "R...& M" sh.p.k & "K..." sh.p.k & "C..." sh.p.k **me 87 pikë**.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:

Sipas argumentimeve Kat 2/d Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe. – Është kërkuar pasi objekti i kontratës përveç instalimit të stacioneve të karikimit parashikon edhe sistemimin e sipërfaqeve rreth tij ku parashikohen edhe sipërfaqe të gjelbërta.

Gjatë analizimit të zërave të preventivit grupi i auditimit konstatoi që në përfshihen zëra të punimeve elektrike për lidhjen e ndricuesve, të paneleve fotovoltaike të cilat kërkojnë pajisjen me licensat përkatëse si:

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

e cila për vlerën që ka kontrata duhej të ishte kërkuar në kategorinë NP-10A

Gjithashtu në lidhje me licensat e projektimit është kërkuar licenca Kat 4/g në lidhje me projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa e cila nuk gjen zbatim në preventivin e punimeve.

Në lidhje me qëllimin dhe objektin e kontratës si dhe preventivin e zbatimit të punimeve, AK duhej të kishte kërkuar licenca të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë, si më poshtë:

Kat 10/c - Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

Kat 11/d - Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje znj. K.T., z. A.M. dhe znj. K. H. në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta në DST, në mospërputhje me Neni 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 4 të nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përgjegjësia e titullarit të autoritetit kontraktor përgjatë procedurave të prokurimit publik, sipas periudhave në detyrë, rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1, pika 2 dhe 5, neni 8,9, 10 i ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2.7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e projekteve të zhvilluara për eficientë e energjisë, lidhjen e zbatimin e kontratave.

Në zbatim të pikë të 7 të programit të auditimit Nr. 1043/1 Prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar, grupi i auditimit auditoi **Procedurat e Certifikimit të Performancës së Energjisë në Ndërtesa**. Kushtet e certifikimit të performancës së energjisë, për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese, në të gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë, përfshijnë zbatimin e programit kompjuterik të miratuar që gjeneron CPE për ndërtesa nga auditues energjetik të certifikuar.

Gjatë procesit të regjistrimit të CPE-ve strukturat përgjegjëse panë AEE, verifikojnë të dhënat, si: identifikimi i vlerësuesit, identiteti i pronarit të ndërtesës, detajet e ndërtimit dhe të dhëna të tjera.

Nëpërmjet sistemit informatik, AEE verifikon klasën energjetike të ndërtesës dhe në qoftëse vlerat e përlogaritura dhe të paraqitura në CPE janë sipas kërkesave të bazës ligjore në fuqi, struktura përgjegjëse që monitoron këtë proces, vijon me regjistrimin e Certifikatës së Performancës së Energjisë duke marrë një numër unik i cili gjenerohet nga programi kompjuterik.

Audituesi i energjisë i certifikuar, me marrjen e njoftimit në sistem të miratimit të certifikatës, paraqitet pranë AEE dy kopje të printuara të CPE me qëllim marrjen e faturës për arkëtim bazuar në urdhrin nr. 5 datë 12.01.2021 për Formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik. Përlogaritja e vlerës së faturës për arkëtim bëhet në varësi të sipërfaqes ku në çdo rast audituesi energjetik paguan 20% të vlerës që del nga shumëzimi i çmimit (lek/m²) dhe sipërfaqes së ndërtesës së audituar. Vetëm për sipërfaqet nga 0-120 m² pagesa është fikse në shumën 6,000 leke.

Sipërfaqja	0-120 m ²	121-250 m ²	251-500 m ²	501-1000 m ²	mbi 1000 m ²
Çmimi	30,000 leke	330 LEK/m ²	300 LEK/m ²	270 LEK/m ²	250 LEK/m ²

Audituesi i energjisë duhet të dorëzojë pranë sektorit të Auditimit certifikimit, konfirmimin e pagesës sipas faturës së arkëtitimit për marrjen e CPE të vulosur nga AEE, të cilën më pas ja dorëzon pronarit të ndërtesës.

Sistemi ECERT çdo aplikim të çelur e njuh si një objekt ku i korrespondon një projekti me pjesët përbërëse të tij dhe AEE për llogaritjen e tarifave e ka marrë si një ndërtesë të vetëm pavarësisht se ka lëshuar CPE për çdo njësi të projektit. Konsiderimi i çdo aplikimi të çelur si një objekt (ndërtesë) më vete i është referuar ligjit 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” Neni 4, “Përkufizime”, pika 20. “Ndërtesë” është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm. Në Urdhër nr. 5 datë 12.01.2021 Për miratimin e rregullores “Për formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik” neni 16, “Pagesa e audituesit energjetik” 1. Pagesa për audituesin e energjisë që kryen auditimin e energjisë në ndërtesa dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë përcaktohet sipas tabelës në shtojcën 4 të kësaj rregullore.

2. Audituesi i Energjisë paguan tek Agjencia përgjegjëse për Efikasitetin e Energjisë 20% të vlerës së çdo certifikate (pa TVSH).

Në Shtojcën 4 të këtij urdhri ku përcaktohen tarifat sipërfaqja është për ndërtesë ku i referohet përkufizimit të ligjit por pika dy thekson për çdo certifikatë, pra e çdo njësie më vete që është pjesë përbërëse e ndërtesës.

Në sistem të dhënat e ngarkuara nga audituesi janë edhe gjeometria e ndërtesës së bashku me orientimin, fluksi i ndriçimit, infiltrimet e ajrit si dhe sipërfaqja e kontaktit me hapësirën e jashtme. Objektet që janë vila në një aplikim, ku sipërfaqja e tyre totale i kalon 1000 m², nisur nga përkufizimi i ligjit “Ndërtesë, është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm” dhe karakteristikave që ngarkohen në sistem duhet të konsiderohen si ndërtesa më vete. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se llogaritja e tarifës për aplikimet ku projekti është bllok vilash është marrë si një e tërë dhe jo sipas sipërfaqes së audituar e secilës prej tyre.

Në sistem nuk mund të verifikohen se sa aplikime kanë ndërtesa të veçuara, ku sipërfaqja e audituar për secilën prej tyre është e ndryshme, që të arrihet një konkluzion përfundimtar se sa janë diferencat në llogaritjen e tarifës në totalin e tyre.

Nga ana e grupit të auditimit janë përzgjedhur në mënyrë rastësore disa aplikime ku ndërtesat janë të veçuara (vila) dhe është llogaritur tarifa si ndërtesa më vete referuar përkufizimit të ligjit dhe

karakteristikave të tyre ku rezultuan diferenca me vlerën e tarifës të llogaritur si një objekt i vetëm nga ana e AEE. Aplikimet e përzgjedhura dhe diferenat e tyre pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Nr.	Nr.fature	Data e fatures	Audituesi	Subjekti	Investitori	Vlera e fatures AEE	Vlera sipas Urdhër nr.5	Diferenca
1	2230	30.11.2023	B. L.	“T..”	P. / L. D.	46170	54000	7830
2	2392	22.12.2023	R.S.	‘A...’	A.S, I.G, B.S, R.E, K.B	93506	100985	7479
3	996	09.05.2023	A.D.Gj.	A. D.Gj.	“A..-E..” sh.p.k	65420	78504	13084
4	1522	24.07.2023	G.H.	“S.E..”	Dh.M.	53196	68662	15466
5	1595	21.08.2023	L. D.	“4 K...”	“L. I..”	515150	542410	27260
6	1729	04.09.2023	K. T.	“M..”	“M.D.” sh.p.k	191350	222900	31550
7	2070	31.10.2023	E.Sh.	E.Sh.	“A..”	203520	249708	46188
8	2211	22.11.2023	A”N”	E. C.	“A..”Sh.p.k	402155	492720	90565
9	144/1	14.07.2022	L.D.	“4K..”	“N...”	1019550	1088990	69440
10	2069	22.12.2022	R. S.	“A..”	LL.Xh.	93099	115544	22445
11	1948	06.12.2022	L. D.	“4K’	“A..” shpk	27270	40860	13590
12	1056	20.06.2022	S.P.	“M..”	V.K.	90222	143615	53393
13	373	23.04.2021	A.L.	E.A.	“P..” shpk	299985	353559	53574
14	50	19.03.2021	V.B.	“N..”	“H..”shpk	437932	461705	23773
15	1669	08.10.2021	L.D.	“4K..”	“A..” shpk	342400	438096	95696
Shuma totale						3880925	4452259	571334

Konkluzion

Nga AEE për të gjitha aplikimet që kanë ndërtesa të veçuara, referuar planimetrive të ngarkuara në sistem nga audituesi, duhet të llogariste tarifën sipas Urdhër nr. 5 datë 12.01.2021 Për miratimin e rregullores “Për formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik” midis neni 16, “Pagesa e audituesit energjetik” shtojca 4 të këtij urdhri ku përcaktohen tarifrat, sipërfaqja për ndërtesë, ku i referohet “Përkufizime”, pika 20, Neni 4, të ligjit 124/2015 “Për eficientë e energjisë”. Diferenca në vlerën e llogaritjes së tarifës për rastet e përzgjedhura është 571,334 lekë por në rast se do të përllogariteshin të gjitha rastet që janë në sistem për këtë tipologji ndërtesash të veçuara vlera do të ishte më e madhe e kështu kemi të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Referuar paqartësive në urdhër nr. 5 datë 12.01,2021 neni 16 pika 2, dhe shtojcës 4 të shikohen ndryshimet ligjore për rregullimin e saj.

Nga auditimi i sistemit ECERT, konstatohet se:

Brenda periudhës së auditimit në sistemin informatik janë gjeneruar **71,808 copë** Certifikata Paraprake, dhe **17,968 copë** Certifikata Përfundimtare të Performancës së Energjisë në ndërtesa. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur sip. në m² të audituar në total.

Lloji i Certifikatës	Numri Total i Certifikatave	Sipërfaqe në m ² e ndërtesave të audituara
Paraprake	71,808	11,251,520
Përfundimtare	17,968	2,873,734

AEE duhet të verifikoj certifikatat, referuar të dhënave të ngarkuara në sistem nga ana e audituesve, nëse ato janë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në rregullore. Gjithashtu duhet të kryhet dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa. Verifikim dhe mbikëqyrja e certifikatave kryhet nga nëpunës të autorizuar që janë pjesë e listës e fituesve të testit të auditimit të energjisë. Me shkresën Nr.980 prot. datë 19.05.2021 AEE i ka propozuar ministrisë

emrat për miratim si Nëpunës të Autorizuar. Me shkresën Nr. 4231/1 Prot. datë 28.05.2021 ministria ka miratuar Nëpunës të Autorizuar z. A.M., z. B.A., znj. K.T., znj. Xh.A. si dhe z. M.K. Përzgjedhjen e certifikatave që do të verifikohen dhe mbikëqyrjen e kryen vetë sistemi në mënyrë rastësore dhe sasia e tyre duhet të jetë të paktën 5% të numrit të përgjithshëm të certifikatave për performancën e energjisë të lëshuara në një vit të caktuar.

Me Urdhër Nr. 316, datë 10.02.2022 është miratuar plani i kalendarit të mbikëqyrjes me listën e certifikatave të përzgjedhura nga sistemi për ato të miratuara në vitin 2021, 5% e tyre.

Me Urdhër Nr. 20, datë 27.03.2023 është miratuar plani i kalendarit të mbikëqyrjes me listën e certifikatave të përzgjedhura nga sistemi për ato të miratuara në vitin 2022, 5% e tyre.

Me Urdhër Nr. 12, datë 13.02.2024 është miratuar plani i kalendarit të mbikëqyrjes me listën e certifikatave të përzgjedhura nga sistemi për ato të miratuara në vitin 2023, 5% e tyre.

Nga auditimi i sistemit si dhe dokumentacioni konstatohet se nga ana e nëpunësve të autorizuar verifikimi që kryhet brenda 10 ditëve nuk është i dokumentuar me shkrim i certifikatave të përzgjedhura nga sistemi dhe nuk është hartuar një plan brenda afateve të përcaktuara nëse ka parregullsi në certifikatat e lëshuara nga audituesi ose të revokuara.

Mbikëqyrja e certifikatave të lëshuara nuk është kryer nga ana e nëpunësve të autorizuar në asnjë rast për certifikatat përfundimtare të lëshuara nga AEE për periudhën e audituar.

Mosrealizimi i mbikëqyrjes së certifikatave të përcaktuara në urdhrat përkatës është në kundërshtim me VKM Nr. 934, datë 25.11.2020 *“Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”* III. MBIKËQYRJA E CERTIFIKATAVE TË PERFORMANCËS SË ENERGIJISË, pika 4. *“Mbikëqyrja kryhet së paku nga tre nëpunës të autorizuar, që i propozohen për miratim ministrit nga drejtuesi i Agjencisë. Nëpunësit e autorizuar bëjnë pjesë në listën e fituesve të testit të auditimit të energjisë. Një nga tre nëpunësit e autorizuar është firmë e parë dhe dy të tjerët kundërfirmues”*.

Për mosrealizimin e mbikëqyrjes së certifikatave të lëshuara nga AEE ngarkohen me përgjegjësi drejtuesit e Agjencisë (sipas periudhës së ushtrimit të funksionit) z. E. D., z. A.H. dhe Nëpunësit e Autorizuar z. M., z. B. A., znj. K. T., znj. Xh. A. si dhe z. M. K. të miratuar me shkresën Nr. 4231/1 Prot. datë 28.05.2021.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi titullari i institucionit z. A.H. dhe ish titullarët e institucionit znj. E.C., z. E. B. dhe z. E.D.

2.8. Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit

Në zbatim të pikë të 8 *“Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit”*, të programit të auditimit nr. 1043/1 prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar, grupi i auditimit hartoi një pyetësor duke përfshirë të dhëna nga veprimtaria e institucionit, bazuar në rregulloret dhe legjislacionin në fuqi, si më poshtë: Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) është një entitet publik, në përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo agjenci ushtron juridiksionin dhe veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet zyrës së saj qendrore në Tiranë.

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) është krijuar në vitin 2016 me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.852 datë 7.12.2016 ku përcaktohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj.

Themelimi i Agjencisë për Eficencën e Energjisë është përcaktuar sipas Ligjit për Eficencën e Energjisë (124/2015), kreu IV, neni 25, pika 1, ku ndër të tjera AEE është institucioni përgjegjës për promovimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave e të politikave të eficientës së energjisë.

- Legjislacioni ku mbështetet veprimtaria e AEE paraqitet si më poshtë:
- Ligji për Eficencën e Energjisë (124/2015 i ndryshuar)

- Ligji 28/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.124”
- Ligji nr 116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”
- Vendim Nr. 852, Datë 7.12.2016 “për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë për efikasitetin e energjisë”
- Vendim Nr. 407, datë 19.6.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”.
- Vendim Nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”.
- Vendim Nr. 958, datë 2.12.2020 “Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të “certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave”.
- Urdhri nr 5, datë 12.01.2021 “Për formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik”.
- Vendim nr. 872, datë 29.12.2021, “Për miratimin e planit kombëtar për energjinë dhe klimën 2020 – 2030”
- Strategjia kombëtare e energjisë (2020-2030)
- Vendim nr. 1094, datë 24.12.2020 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”.

Në lidhje me sistemin e hedhjes së të dhënave EEcert, sistemi është implementuar sipas kontratës nr. 5663/2 datë 18.12.2017 midis BOE “A..” shpk dhe “K..” shpk” dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me afat 4 vjeçar. Sistemi është dorëzuar nga kompania “K..” pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Për periudhën objekt nën auditim, sistemi nuk ka pasur mirëmbajtje apo ugrade të moduleve. Ai paraqet problematika të ndryshme si në hedhjen e të dhënave ashtu edhe në përpunimin e tyre. Gjithashtu grupi i auditimit hasi probleme në gjenerimin e raporteve të ndryshme ku për të cilët ishte e nevojshme pasi do kryheshin sondazhe të ndryshme në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

Hapja e aksesit kryhej nga titullari i institucionit në rolin e administratorit të caktuar nga përfaqësues të AKSHI-it. Më pas administratori i caktuar kishte të drejta të hapte usera për audituesit e energjisë dhe të stafit të AEE. Në rastin e konstatimit të problematikave nga ana e userave, ato dërgonin email pranë personit të autorizuar si Admin pranë AEE, i cili e përcillte më pas drejt punonjësve të IT pranë MIE.

Grupi i auditimit konstatoi që për sistemin eecert nuk ekziston një manual përdorimi.

Në lidhje me pajisjet e auditimit, regjistrimi dhe përdorimi i tyre, pajisjet gjenden në shtojcën nr .3 të Urdhrit nr. 5, datë 12.01.2021 “Për formatin e raportit të auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik”. Audituesi energjetik dërgon pranë AEE pajisjet që disponon për të vazhduar me procesin e regjistrimit. Këto pajisje regjistrohen pranë AEE duke marrë një kod AEE, Numri Serial i pajisjes, ku më pas audituesit energjetik i bëhet i ditur nëpërmjet një vërtetimi të lëshuar nga AEE.

Në lidhje me Planin Kombëtar të veprimit për Eficencën e Energjisë është ndryshuar emërtimi në Planin kombëtar për Energjinë dhe Klimën (2020-2030) i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me Vendim nr. 872, datë 29.12.2021, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020 – 2030”. Ky plan është në proces rishikimi për të pësuar disa ndryshime nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Përsa i përket analizës vjetore për realizimin e

objektivave të institucionit, Agjencia për Efiçencën e Energjisë nuk e ka hartuar një dokument të tillë.

Agjencia për Efiçencën e Energjisë krijon dhe përditëson një bazë të dhënash kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin saj, sipas formatit të miratuar nga ministri. Baza e të dhënave të energjisë, e krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efiçencës së energjisë. Nga ana e agjensisë nuk është krijuar një bazë e tillë të dhënash.

Gjithashtu shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë i paraqesin Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, të paktën një herë në vit, informacione të përmbledhura statistikore mbi klientët e tyre fundorë. Përgjatë vitit 2023, nga informacioni i marrë nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike rezultojnë se gjithsej janë 96 konsumatorë të mëdhenj të energjisë (përkufizimi në nenin 1, pika 3 I ligjit 28/2021 “Për disa ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 124/2015 “Për Efiçencën E Energjisë”, Të Ndryshuar), pa përfshirë shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime për shkak të ndryshimeve organizative të tyre, ku janë lajmëruar me anë të shkresave mbi detyrimet që i lindin si konsumator i madh i energjisë. Përgjatë vitit 2022, nga informacioni i marrë nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike rezultojnë se gjithsej janë 120 konsumatorë të mëdhenj të energjisë.

Personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion jo të gjithë konsumatorët e mëdhenj të energjisë kishin caktuar një menaxher energjie.

Gjithashtu AEE ofron dhe marrëveshje vullnetare midis AEE dhe konsumatorëve të mëdhenj për dhënien e mbështetjes për marrjen dhe zbatimin e masave për efiçencën e energjisë, por që nuk ekzistojnë marrëveshje të tilla.

Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie”.

Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie dhe është subjekt i auditimit të detyruar, duhet që, brenda dy vjetësh nga marrja e rezultateve të auditimit, të ndër marrë masat dhe kryejë veprimet e rekomanduara për përmirësimin e efiçencës së energjisë. (dokumentacionin mbështetës).

Në total rezultojnë 11 Raporte Auditimi në Instalime Industriale. Në ligjin 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë” nuk ka të parashikuara masa administrative për mosparaqitje të raporteve të auditimit.

Konsumatorët e mëdhenj të energjisë janë të detyruar të dërgojnë pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, një raport me të dhëna mbi konsumin e tyre të energjisë për vitin kalendarik paraardhës, ku pjesa më e madhe e konsumatorëve të mëdhenj nuk e respektojnë këtë pikë të cituar në legjislacion.

Në legjislacionin shqiptar nuk është caktuar asnjë klauzolë në lidhje me masat që duhen të ndërmerren në rast të mosplotësimit të kushteve të mësipërme nga ana e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë.

Për sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë, Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në bashkëpunim me INSTAT-in, nuk ka bërë sondazhe mbi të dhënat për konsumin e energjisë nga konsumatorët në këta sektorë.

Gjithashtu, në zbatim të pikë të 8 “*Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit*”, të programit të auditimit nr. 1043/1 prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni shkresor lidhur me procesin e certifikimit të audituesve dhe menaxherëve të energjisë.

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) është një entitet publik, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është krijuar në vitin 2016 me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.852 datë 7.12.2016.

Referuar VKM Nr. 407, datë 19.6.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, certifikimi i performancës së energjisë kryhet nga audituesit energjetikë të licencuar, të cilët ndahen në dy kategori: a) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa; b) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në instalime industriale.

“Auditues energjetik” është një person fizik ose juridik i licencuar për të kryer auditime energjetike.

Për qëllime të certifikimit të audituesve energjetikë, AEE-ja organizon kryerjen e testimit.

Sipas ligjit Nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin NR. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë”, të ndryshuar, pika 11: “*Konsumator i madh i energjisë*” është një konsumator fundor, i cili ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milion këh energji elektrike në vit.”.

Bazuar në VKM Nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”, personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie, sipas kërkesave të ligjit nr. 124/2015, “Për eficientësinë e energjisë”, të ndryshuar.

Menaxheri i energjisë është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, përmirësimin dhe mbikëqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) pajis menaxherët e energjisë me certifikatën e testimit të njohurive.

Në zbatim të detyrimeve të mësipërme ligjore, AEE ka kryer organizimin e testeve për auditues energjie dhe menaxherë energjie.

Certifikata e performancës së energjisë bëhet e vlefshme pas regjistrimit të saj në regjistrin e Agjencisë së Eficencës së Energjisë.

Me qëllim verifikimit të vlefshmërinë dhe saktësinë e të dhënave përkatëse të certifikatave për performancën e energjisë, bëhet mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve të performancës së energjisë në ndërtesa nga AEE, e cila është autoriteti që regjistron në një regjistër të posaçëm certifikatën e performancës së energjisë së ndërtesave dhe kryen sistematikisht një proces verifikimi për të gjitha të dhënat e referuara në raportet e verifikimit për certifikatat e performancës së energjisë së ndërtesave, të lëshuara nga audituesit e energjisë.

Raporti i mbikëqyrjes lëshohet nga nëpunësit e autorizuar të Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe për rezultatet e tij njoftohet audituesi energjetik, i cili ka lëshuar “Certifikatën për performancën e energjisë” për ndërtesën apo njësinë e saj, si dhe subjekti që ka në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesën apo njësinë e saj, e cila është certifikuar. Nëpunësit e autorizuar të Agjencisë për Eficencën e Energjisë duhet të jenë auditues të licencuar, të cilët nuk kanë të drejtën të ushtrojnë këtë profesion jashtë kësaj agjencie.

Për certifikimin i audituesëve dhe menaxherëve të energjisë.

Në zbatim të pikë të 8 “*Të tjera që mund të dalin gjatë auditimit*”, të programit të auditimit nr. 1043/1 prot., datë 29.12.2023, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni shkresor lidhur me procesin e certifikimit të audituesve dhe menaxherëve të energjisë.

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) është një entitet publik, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është krijuar në vitin 2016 me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.852 datë 7.12.2016.

Referuar VKM Nr. 407, datë 19.6.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, çertifikimi i performancës së energjisë kryhet nga audituesit energjetikë të licencuar, të cilët ndahen në dy kategori: a) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa; b) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në instalime industriale.

“Auditues energjetik” është një person fizik ose juridik i licencuar për të kryer auditime energjetike.

Për qëllime të certifikimit të audituesve energjetikë, AEE-ja organizon kryerjen e testimit.

Sipas ligjit Nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin NR. 124/2015 “Për eficientë e energjisë”, të ndryshuar, pika 11: “*Konsumator i madh i energjisë*” është një konsumator fundor, i cili ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milion këh energji elektrike në vit.”.

Bazuar në VKM Nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”, personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie, sipas kërkesave të ligjit nr. 124/2015, “Për eficientë e energjisë”, të ndryshuar.

Menaxheri i energjisë është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, përmirësimin dhe mbikëqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) pajis menaxherët e energjisë me certifikatën e testimit të njohurive.

Në zbatim të detyrimeve të mësipërme ligjore, AEE ka kryer organizimin e testeve për auditues energjie dhe menaxherë energjie.

Certifikata e performancës së energjisë bëhet e vlefshme pas regjistrimit të saj në regjistrin e Agjencisë së Eficencës së Energjisë.

Me qëllim verifikimin e vlefshmërinë dhe saktësinë e të dhënave përkatëse të certifikatave për performancën e energjisë, bëhet mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve të performancës së energjisë në ndërtesa nga AEE, e cila është autoriteti që regjistron në një regjistër të posaçëm certifikatën e performancës së energjisë së ndërtesave dhe kryen sistematikisht një proces verifikimi për të gjitha të dhënat e referuara në raportet e verifikimit për certifikatat e performancës së energjisë së ndërtesave, të lëshuara nga audituesit e energjisë.

Raporti i mbikëqyrjes lëshohet nga nëpunësit e autorizuar të Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe për rezultatet e tij njoftohet audituesi energjetik, i cili ka lëshuar “Certifikatën për performancën e energjisë” për ndërtesën apo njësinë e saj, si dhe subjekti që ka në pronësi apo përgjegjësi

administrimi ndërtesën apo njësinë e saj, e cila është certifikuar. Nëpunësit e autorizuar të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë duhet të jenë auditues të licencuar, të cilët nuk kanë të drejtën të ushtrojnë këtë profesion jashtë kësaj agjencie.

Certifikimi i Audituesëve dhe Menaxherëve të Energjisë

Në bazë të VKM Nr.407, datë 19.06.2019, “ Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, VKM nr.342, datë 22.05.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherët e energjisë” dhe urdhrin nr.95, datë 26.02.2020, “Për krijimin e funksionimin e komisionit për testimin dhe certifikimin e audituesve të energjisë”, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Nga auditimi konstatohet se:

Bazuar në nenin 17 të ligjit Nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë”, datë 12.11.2015, pikës 3.5 të VKM Nr.407, datë 19.06.2019, “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka nxjerrë urdhrin nr. 95 datë 26.02.2020 të “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit të testimit dhe certifikimin e audituesve të energjisë”, nëpërmjet të cilit është ngritur komisioni për testimin dhe certifikimin e audituesve të energjisë me përbërjen si me poshtë:

E.B. Drejtor i përgjithshëm	AEE	Kryetar
Gj. S. Drejtor i përgjithshëm	MIE	Anëtar
R.Xh. Drejtor	MIE	Anëtar
B.A. Specialist	AEE	Anëtar
K. T. Specialist	AEE	Anëtar

Në piken 4 të urdhrin nr.95 datë 26.02.2020 “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit të testimit dhe certifikimin e audituesve të energjisë” është parashikuar se:

Komisioni merr vendime për:

- a. Pranimin apo refuzimin e kërkesës së aplikantit për t’u pranuar në testim;
- b. kalimin e testimit nga kandidatët, që janë nënshtruar testimit;
- c. lëshimin e certifikatës mbi bazën e rezultateve të testimit;
- ç. shfuqizimin e certifikatës dhe masat administrative, mbështetur, kryesisht, në kushtet e përcaktuara në VKM nr.407, datë 19.06.2019, “ Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”;
- d. përgatitjen dhe miratimin e fondit të pyetjeve si dhe përzgjedhjen rastësore të pyetjeve për testim

-Komisioni i mësipërm me vendim nr.1 datë 06.05.2020 ka zgjedhur znj.R.Xh. si nënkryetare të komisionit, ka miratuar bankën e pyetjeve, ka miratuar listën e kandidatëve.

-Komisioni i posaçëm për testimin dhe certifikimin me vendimin nr.2, datë 07.05.2020 ka miratuar tezen e provimit për certifikatën e audituesit energjetik për z.E.B.

-Komisioni i posaçëm për testim dhe certifikim me vendimin nr.3, datë 07.05.2020, ka vendosur që pas përfundimit të procesit të korigjimit, të certifikoj z.E.B. si auditues energjetik në “Ndërtesa & Instalime Industriale”.

Në vendimin e mësipërm nr.3, datë 07.05.2020, është bërë shënimi se z. E.B. nuk ka qenë i pranishëm (si anëtarë komisioni), për arsye se është pjesëmarrës në testim. Gjithashtu në këtë vendim është bërë shënimi se z. Gj.S.nuk ka qenë i pranishëm për arsye se është pjesëmarrës në testim.

Nga auditimi i dokumentacionit të zhvillimit të provimeve (testimeve) për auditues dhe menaxherë energjetikë u konstatua se për 24 raste, firma e hedhur nga kandidatët në listën e pjesëmarrësve për testim, me shikim me sy të lirë, në disa elementë dukshëm ka ndryshim nga firma e hedhur në tezën e provimit (testimit). Sqarojmë se ky konstatim për të gjitha rastet e trajtuara në këtë material është bërë me shikim me sy të lirë dhe në dukje është si është përshkruar më lartë, por audituesi nuk është ekspert i verifikimit të origjinalitetit të firmës. Për këtë arsye nuk mund të thuhet se ky është një konkluzion përfundimtar, por një përshkrim i situatës së parë me sy të lirë.

Më konkretisht rastet janë të përshkruara sipas situatave të mëposhtme:

Situata 1:

1- Nga auditimi konstatohet se në provimin (testimin) e audituesve të energjisë në ndërtesa dhe në instalime industriale të datës 22.05.2020, firma e kandidatit me numër protokollit 8 në tezën e testimit (që i përket znj.S. B.), në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e hedhur pranë emrit të kësaj kandidateje në listën e pjesëmarrësve për testim, që i përket numrit rendor 48 (Sqarojmë se lista e pjesëmarrësve është e formatuar me këto të dhëna: numër rendor, numër protokollit (i cili njëkohësisht ndodhet edhe te teza e testimit), emër, mbiemër, firma e aplikantit). Me vendim nr.8 datë 22.05.2020 të komisionit të posaçëm për testimin dhe certifikimin, komisioni i përbërë nga E.B.(kryetar), znj. R. Xh.(nënkryetare), z. B. A. (anëtar) dhe znj. K. T. (anëtar) është miratuara teza e provimit për certifikatën e audituesit energjetik.

Objekti i këtij testimi është certifikimi nga AEE për të dyja profilet audituese të energjisë (në ndërtesa dhe në instalime industriale).

Në këtë testim kanë marrë pjesë 91 kandidatë, në përfundim janë certifikuar 26 prej tyre.

Me vendimin nr. 9 datë 22.05.2020 të komisionit të posaçëm për testimin dhe certifikimin i përbërë nga z. E. B.(kryetar), znj. R.Xh.(nënkryetare), z. B.A. (anëtar) dhe znj. K. T. (anëtar), në pikën 2 të vendimit komisioni ka vendosur: *“Pas korrigjimit të tezave nga komisioni, sekretariati hap tezat dhe hedh rezultatet me numrin e protokollit përkatës për secilin kandidat”*.

Me vendimin nr.12, datë 01.06.2020 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E. B (kryetar komisioni, AEE), me detyrë ish drejtor i përgjithshëm i AEE prej datës 04.10.2019, deri në datën 22.06.2021, znj. R.Xh. (nënkryetare komisioni, MIE), z. B. A.(anëtar, AEE), znj. K. T.(anëtare, AEE), është miratuar lista e kandidatëve fitues të testimit të datës 22.05.2020 ora 14:30 *“Për auditues energjetik në ndërtesa, procese industriale dhe, ndërtesa & instalime industriale”*.

Në datën 22.09.2020 është zhvilluar testimi për certifikimin e menaxherëve të energjisë.

Me vendimin nr.13, datë 08.09.2020 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.B. (kryetar), znj. R.Xh. (nënkryetare), z. B.A. dhe znj. K. T., (z. Gj.S. nuk ka qenë pranishëm) është miratuar lista e aplikantëve dhe teza e testimit për menaxherë të energjisë.

Me vendimin nr.18, datë 22.09.2020 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.B. (kryetar), znj. R.Xh. (nënkryetare), z. B.A. dhe znj. K.T., (z. Gj.S. nuk ka qenë i pranishëm dhe nuk ka marrë pjesë në procesin e korrigjimeve të testimeve) është deklaruar se ka përfunduar procesi i korrigjimit të testimeve të datës 22.09.2020 për *“Për menaxher të energjisë”*.

-Në vendimin nr.19, datë 30.09.2020 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E. B. (kryetar), znj. R.Xh. (nënkryetare), z. B.A. dhe znj. K. T., (z. Gj. S. nuk ka qenë i pranishëm), thuhet:

“...Komisioni vendosi: Pas përfundimit të procesit të ankimimit, të miratojë listën e aplikantëve fitues të testimit të datës 22.09.2020 “Për menaxherë të energjisë”. Bashkëlidhur lista e menaxherëve të certifikuar”.

Bashkëlidhur vendimit është lista e 39 fituesve për menaxher të energjisë, nga 101 kandidatë në krye të së cilës shkruhet:

“Lista e aplikantëve fitues të testimit të datës 22.09.2020 “Për menaxherë të energjisë”.

Por nga auditimi i tezave të testimit, konstatohet se në të gjitha këto teza shënohet data 21.09.2020 (pra jo data 22), si dhe ora sipas grupeve të testimit. Pra nuk ka rakordim midis datës së tezave të testimit dhe datës së përshkruar në vendimin nr.19, datë 30.09.2020 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim.

Listë prezenca e kandidatëve, e cila vërteton prezencën e tyre në testim, nuk është e nënshkruar dhe as e firmosur nga asnjë nga anëtarët e komisionit të testimit, apo sekretariatit teknik, duke mos evidentuar se cilët janë personat konkret të komisionit, apo sekretariatit teknik, apo nëse ka pasur persona të tjerë të angazhuar jashtë tyre nga AEE që kanë administruar këtë proces. Kjo parregullsi është konstatuar në të gjitha provimet (testimet) e kryera për auditues dhe menaxherë energjetik.

Gjithashtu janë certifikuar si menaxherë të energjisë edhe dy anëtarë të komisionit, znj. K. T. dhe z. B.A., për të cilët procedura e testimit është zhvilluar më vete për secilin. Për znj. K.T. teza e testimit është miratuar me vendimin të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim nr. 16, datë 10.09.2020, ndërsa certifikimi është bërë me vendimin nr. 17, datë 10.09.2020. Në të dy vendimet e mësipërme znj. K.T.nuk ka qenë pjesë e vendimëmarrjes, po ashtu edhe z. Gj. S. (jo i pranishëm). Për z. B.A. teza e testimit është miratuar me vendimin të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim nr. 14, datë 09.09.2020, ndërsa certifikimi është bërë me vendimin nr. 15, datë 09.09.2020. Në të dy vendimet e mësipërme z. B. A. nuk ka qenë pjesë e vendim marrjes, po ashtu edhe z. Gj.S. (jo i pranishëm).

Situata 2:

Nga auditimi u konstatua se në provimin (testimin) e zhvilluar në datën 22.09.2020, për certifikimin e menaxherëve të energjisë, për 5 kandidatë, në disa elementë firma e hedhur nga kandidatët në listën e pjesëmarrësve për testim, dukshëm ka ndryshim nga firma e hedhur në tezën e provimit (testimit). Sqarojmë se ky konstatim për të gjitha rastet e trajtuara në këtë material, është bërë me shikim me sy të lirë dhe në dukje është si është përshkruar më lartë, por audituesi nuk është ekspert i verifikimit të origjinalitetit të firmës. Për këtë arsye nuk mund të thuhet se ky është një konkluzion përfundimtar, por një përshkrim i situatës së parë me sy të lirë.

Më konkretisht rastet janë si më poshtë:

1) Firma e aplikantit në tezën e testimit e cila mban datën 21.09.2020 për menaxherë të energjisë, me numër protokollit 271, nr. rendor 78, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (R.P.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 271 dhe numër rendor 78.

2) Firma e kandidatit në tezën e testimit e cila mban datën 21.09.2020 për menaxherë të energjisë, me numër protokollit 242, nr. rendor 68, shpallur fitues, dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij

kandidati të hedhur pranë emrit të tij (S.C.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 242 dhe numër rendor 68.

3) Firma e kandidatit në tezën e testimit e cila mban datën 21.09.2020 për menaxherë të energjisë, me numër protokollit 290, nr. rendor 87, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (V.S.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 290 dhe numër rendor 87.

4) Firma e kandidatit në tezën e testimit e cila mban datën 21.09.2020 për menaxherë të energjisë, me numër protokollit 256, nr. rendor 34, shpallur fitues, dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.S.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 256 dhe numër rendor 34.

5) Firma e kandidati në tezën e testimit e cila mban datën 21.09.2020 për menaxherë të energjisë, me numër protokollit 155, nr. rendor 38, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E. V.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 155 dhe numër rendor 38.

Në datën 01.03.2021 është zhvilluar testimi për certifikimin e audituesve të energjisë vetëm për profilin e audituesve të energjisë në ndërtesa.

Me vendim nr.21 datë 01.03.2021 të komisionit për testimin dhe certifikimin, i përbërë nga z. E. B. (kryetar), znj. R. Xh. (nënkryetare), z. B. A. (anëtar) dhe znj. K. T.(anëtar) është miratuara teza e provimit për certifikatën e audituesit energjistik. Bashkangjitur këtij vendimi është edhe lista e aplikantëve pjesëmarrës në testim për auditues të energjisë në ndërtesa.

-Me procesverbalin nr.22, datë 02.03.2021 të mbledhjes së komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.B., znj. R. Xh., z. B.A. dhe znj. K.T. (z. GJ. S. nuk ka qenë prezent), komisioni ka deklaruar se ka përfunduar korrigjimin e testeve të datës 01.03.2021 për auditues të energjisë në ndërtesa dhe ka ngarkuar sekretariatit teknik për njoftimin e aplikantëve lidhur me rezultatet e testimit.

-Me vendimin nr.24, datë 18.03.2021 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.B., znj. R.XH, z. B. A. dhe znj. K.T, (z. Gj. S. nuk ka qenë prezent), është miratuar lista e kandidatëve fitues të testimit të datës 01.03.2021 “Për auditues energjistik në ndërtesa”. Bashkëlidhur vendimit është lista e 68 audituesve të certifikuar (lista e aplikantëve fitues).

Situata 3:

Nga auditimi u konstatua se në provimin (testimin) e zhvilluar në datën 01.03.2021, për certifikimin e audituesve të energjisë për profilin e audituesve të energjisë në ndërtesa, për 15 kandidatë, firma e hedhur nga kandidatët në listën e pjesëmarrësve për testim, në disa elementë dukshëm ka ndryshim nga firma e hedhur në tezën e provimit (testimit). Sqarojmë se ky konstatim për të gjitha rastet e trajtuara në këtë material, është bërë me shikim me sy të lirë dhe në dukje është si është përshkruar më lartë, por audituesi nuk është ekspert i verifikimit të origjinalitetit të firmës. Për këtë arsye nuk mund të thuhet se ky është një konkluzion përfundimtar, por një përshkrim i situatës së parë me sy të lirë.

Më konkretisht rastet janë si më poshtë:

1) Firma e kandidatit në tezën e testimit për auditues energjistik në ndërtesa, me numër protokollit 171, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.R.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 171 dhe numër rendor 111.

2) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 495, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (K.Th.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 495 dhe numër rendor 204.

3) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 485, datë 01.03.2021, shpallur fitues, dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (K.D.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 485 dhe numër rendor 199.

4) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 471, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (A.D.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 471 dhe numër rendor 28.

5) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 167, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (K.S.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 167 dhe numër rendor 195.

Gjithashtu në këtë fletë testi, përveç firmës së kandidatit është shënuar edhe emër mbiemër i aplikantit (K.S.)

6) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 402, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (M.T.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 402 dhe numër rendor 225.

7) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 348, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.I.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 348 dhe numër rendor 86.

8) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 247, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (S.M.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 247 dhe numër rendor 273.

9) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 107, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (M.D.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 107 dhe numër rendor 220.

10) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 41/1, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (R.K.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 41/1 dhe numër rendor 254.

11) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 365, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (F.F.), në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 365 dhe numër rendor 142.

12) Firma e kandidatit në tezën e testimi për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 359, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (I.P.), në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 359 dhe numër rendor 170.

13) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 393, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.D.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 393 dhe numër rendor 131.

14) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 484, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.K.), në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 484 dhe numër rendor 119.

15) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për auditues energjetik në ndërtesa, me numër protokollit 74/1, datë 01.03.2021, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (S.P.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 74/1 dhe numër rendor 282.

Situata 4:

Me vendimin nr. 4, datë 01.02.2022 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.D. (kryetar), znj. R.Xh. (zv/kryetare), z. B.A. dhe znj. K.T., z. A.B., është miratuar data 28.02.2022 për zhvillimin e testimimit të dytë për menaxherë energjie.

Në datën 28.02.2022 është zhvilluar testimi për certifikimin e menaxherëve të energjisë. Në këtë testim kanë marrë pjesë 272 kandidatë, në përfundim janë shpallur 117 menaxher të energjisë.

Me vendimin nr.10, datë 01.03.2022 të komisionit të posaçëm për testim dhe certifikim, i përbërë nga z. E.D. me detyrë ish drejtor i përgjithshëm i AEE, prej datës 22.06.2021 deri në datën 14.10.2022 (kryetar komisioni), znj. R.Xh. (zv/kryetare, MIE), z. B.A. (anëtar, AEE) dhe znj. K.T. (anëtar, AEE), z. A.B.(anëtar MIE), është përfunduar procesi i korrigjimit të testeve të provimit të dytë të menaxherëve të energjisë.

Nga auditimi konstatohet se në tezën e provimit (testimit) për menaxher energjie, të zhvilluar në datën 28.02.2022, në 3 raste firma e hedhur nga kandidatët në listën e pjesëmarrësve për testim, në disa elementë dukshëm ka ndryshim nga firma e hedhur në tezën e provimit (testimit). Sqarojmë se ky konstatim për të gjitha rastet e trajtuara në këtë material, është bërë me shikim me sy të lirë dhe në dukje është si është përshkruar më lartë, por audituesi nuk është ekspert i verifikimit të origjinalitetit të firmës. Për këtë arsye nuk mund të thuhet se ky është një konkluzion përfundimtar, por një përshkrim i situatës së parë me sy të lirë.

Më konkretisht rastet janë si më poshtë:

1) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për menaxher energjie me numër protokollit 656, numër rendor 57, datë 28.02.2022, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (B.Sh.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 656 dhe numër rendor 57.

2) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për menaxher energjie, me numër protokollit 625, numër rendor 109, datë 28.02.2022, shpallur fitues, dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij kandidati të hedhur pranë emrit të tij (E.D.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 625 dhe numër rendor 109.

3) Firma e kandidatit në tezën e testimimit për menaxher energjie, me numër protokollit 511, numër rendor 120, datë 28.02.2022, shpallur fitues, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e këtij aplikanti të hedhur pranë emrit të tij (E. Xh.) në listën e pjesëmarrësve për testim, emër i cili mban numër protokollit 511 dhe numër rendor 120.

Për këto konstatime të mësipërme të audituesit të çështjes, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nëpërmjet postës elektronike, në adresën bmecaj@klsj.org.al, si dhe me shkresën Nr. 396/I prot., datë 26.08.2024 (të dhëna të AEE), protokolluar në KLSH me Nr.1043/13, datë 27.08.2024, në të cilin janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Procedura për testimet për auditues energjetik apo menaxher energjie është mbështetur mbi VKM Nr.407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit I lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, VKM nr.342, datë 22.05.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”, si dhe rregullores nr.43, datë 06.04.2020 “Skemat dhe modalitetet për provimin e audituesve energjetik dhe menaxherëve të energjisë”.

Të gjithë aplikantët janë paraqitur në testim me mjetin e identifikimit dhe pasi kanë firmosur listëprezencën, kanë firmosur dhe fletën e testimi. Identifikimi i tezës nga anëtarët e komisionit apo sekretariati teknik pas procesit të korigjimit ku teza vijon të jetë e sekretuar, me qëllim publikimin e rezultateve dhe njoftimin e pjesëmarrësve bëhet nëpërmjet numrit të protokollit i cili është unik dhe i përket vetëm kandidatit. Firma e aplikantit apo shënimi i emrit në zonën e sekretuar të skantronit nuk cenon konfidencialitetin e testimi pasi gjatë procesit të korigjimit nuk shihet emri i personit në fletën e testimi.

Grupi i auditimit në rastin e dytë kur rekomandon skualifikimin e kandidatëve të cilët, sipas shikimit me sy të lirë të Audituesit duket sikur kanë firmosur ndryshe në listën e prezencës dhe në tezën e testimi ju bëjmë me dije se firmosja në skantron është një mekanizëm që i garanton pjesëmarrësve identifikimin e tezës së provimit në rastin e ankesave dhe jo element nëpërmjet të cilit strukturat e testimi bëjnë identifikimin. Nuk është detyrë e Sekretariatit Teknik apo Komisionit për Testimin dhe Certifikimin të diktoj mënyrën dhe formën se si një aplikant do të firmosi pjesën e sekretuar të tezës pasi kjo i shërben aplikantit për të identifikuar tezën e tij në rast ankesash. Në asnjë pikë të VKM Nr.407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit I lëshohet certifikata e audituesit energjetik” ose VKM nr.342, datë 22.05.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”, ose Rregullores nr.43, datë 06.04.2020 “Skemat dhe modalitetet për provimin e audituesve energjetik dhe menaxherëve të energjisë”, nuk përcaktohen rregulla mbi mënyrën se si një aplikant duhet të firmosi. Firma është individuale dhe personale dhe asnjë aplikant nuk mund të s’kualifikohet për element që nuk kanë asnjë lloj ndikimi në testim për sa kohë ato janë në zonën e sekretuar të tezës.

Megjithatë Agjencia për Eficencën e Energjisë ka thërritur për verifikim disa prej aplikantëve dhe të gjithë kanë konfirmuar se kanë qenë pjesëmarrës në provim dhe kanë konfirmuar firmën e tyre.

Bashkëlidhur observacionit, nga AEE janë paraqitur deklarata të disa aplikantëve të cilët bëjnë pjesë në listën e personave për të cilët nga audituesi i çështjes është thënë se firma e tyre në tezën e testimi, në disa elementë dukshëm ka ndryshim me firmën e hedhur pranë emrit të tij në listën e pjesëmarrësve për testim. Në mënyrë të përmbledhur këta persona kanë deklaruar:

1) S.B.: jam njohur me kundërshtimet e grupit të auditimit dhe konfirmojë me përgjegjësi të plotë se kam marrë pjesë në testimin për auditues të datës 22.05.2020 në orën 14:30 dhe konfirmojë se firma në tezën e testimi është e imja. Kjo firmë është hedhur në këmbë dhe me nxitim e sipër për shkak të shpejtësisë dhe numrit të madhë të pjesëmarrësve dhe gjithashtu edhe të kushteve të pandemisë, kemi qenë me maska e doreza në provim.

- 2) V. S.: : jam njohur me kundërshtimet e grupit të auditimit dhe konfirmojë prezencën time në testim për menaxherë energjie në datën 22.09.2020. Konfirmojë se firmat në listëprezencë në fillim dhe në fletën e tezës janë të miat.
- 3) I.P.: Jam njohur me gjetjet e grupit të auditimit të KLSH dhe konfirmojë se kamë qenë pjesë e testimit të datës 01.03.2021, për marrjen e certifikatës së audituesit energjetik në ndërtesa, grupi II. Konfirmojë se firma e hedhur si në tezën e testimit, ashtu edhe në listë prezence është e imja. Ndryshimet që mund të shfaqen në to kanë ardhur si pasojë e rrethanave të krijuara në ato momente, emocionet, nxitimi, numri i lartë i pjesëmarrësve, çka shkakton pak konfuzitet, etj.
- 4) S.P.: Deklarojë se kamë marrë pjesë në provimin për auditues datë 01.03.2021 për auditues dhe në dokumente e vëna në dispozicion është firma ime.
- 5) M.T.: Jam njohur me konstatimet e grupit të auditimit. Konfirmojë me përgjegjësi të plotë se kam marrë pjesë në testimin për auditues/menaxher të datës 01..03.2021 dhe konfirmojë se firma në tezën e testimit është e imja. Ju bëjë më dije se kjo firmë është hedhur në këmbë dhe në nxitim e sipër për shkak të numrit të lartë të pjesëmarrësve.
- 6) B.Sh.: Jam njohur me konstatimet e KLSH dhe konfirmojë pjesëmarrjen time në provimin e menaxherëve të energjisë të datës 28.02.2022 dhe deklarojë se firma në fletën e listë prezencës dhe në tezën e provimit është e njëjtë dhe e imja.
- 7) R.P.: Deklarojë se kamë marrë pjesë në testimin e menaxherëve të energjisë të datës 22.09.2020 dhe jam njohur me konstatimet e grupit të KLSH. Konfirmojë se firma në listë prezencë dhe në tezën e provimit është e njëjtë dhe e imja.
- 8) E.D.: Jam vënë në dijeni për gjetjet e KLSH dhe deklarojë dhe konfirmojë se firma në listë prezence dhe në tezën e provimit është e imja.
- Qëndrim i grupit të auditimit:** Për shkak se ndryshimet në disa elementë të firmës së hedhur nga kandidatët në listën e pjesëmarrësve për testim, me firmën e hedhur në tezën e provimit (testimit), nga verifikimi me sy të lirë duket se ekzistojnë, grupi i auditimit lë të evidentueshme këtë situatë ashtu si në fakt është nga shikimi me sy të lirë, por nuk merr përsipër të shpjegojë arsyet e kësaj situatë në dukje e tillë, pasi kjo është e pa mundur, si dhe nuk mund të thotë se ky është një konkluzion përfundimtar, pasi si është thënë përshkrimet janë nga shikimi me sy të lirë. Pra kjo çështje ngelet në kuadrin e përshkrimit të një situatë të konstatuar. Për të gjitha arsyet e mësipërme është gjykuar që emrat e personave të ngarkuar me përgjegjësi në projekt raportin e auditimit për këtë çështje, të hiqen në raportin përfundimtar.

Në projekt raportin e auditimit janë trajtuar 13 raste, 4 prej të cilave për tezat e provimit **për certifikimin e audituesve energjetikë në ndërtesa dhe në instalime industriale, ndërsa 9 raste për certifikimin e audituesve energjitik në ndërtesa**, për të cilat si konkluzion nga audituesi i çështjes është thënë se për këto 13 raste, kandidatët pjesëmarrës në provim, në tezën e testimit, përveç firmës kanë shënuar edhe emër mbiemër të tyre. Për këtë arsye provimi, duhet të ishte shpallur i pa vlefshëm dhe kandidatët duhet të ishin s’kualifikuar. Janë kualifikuar në mënyrë të pa drejtë të gjithë audituesit dhe menaxherët energjetikë të cilët kanë shënuar edhe emër mbiemër në tezën e provimit, pasi kjo e bënë tezën e provimit të identifikueshme dhe mund të ketë ndikim në vlerësim. Për këtë arsye nga subjekti i audituar është vepruar në kundërshtim me rregulloren e AEE, Nr. 43, datë 06.04.2020 “Për skemat dhe modalitetet për provimin e audituesve energjetikë dhe menaxherëve të energjisë”, neni 5 “Organizimi i provimit”, pika 4, ku përcaktohet se “Kandidatit nuk i lejohet të shënojë, ose lërë emrin, apo shenja në fletën e provimit (...që e bëjnë fletën e provimit të identifikueshme). Në rast se do të konstatohen shenja të tilla..., provimi do të shpallet i pavlefshëm dhe kandidati s’kualifikohet”.

Për këto konstatime të audituesit të çështjes, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nëpërmjet postës elektronike, në adresën b.m.@kls.org.al, si dhe me shkresën Nr. 396/1 prot., datë 26.08.2024 (të dhëna të AEE), protokolluar në KLSH me Nr.1043/13, datë 27.08.2024, në të cilin janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Procedura për testimet për auditues energjetik apo menaxher energjie është mbështetur mbi VKM Nr.407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”, VKM nr.342, datë 22.05.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”, si dhe rregullores nr.43, datë 06.04.2020 “Skemat dhe modalitetet për provimin e audituesve energjetik dhe menaxherëve të energjisë”. Të gjithë aplikantët janë paraqitur në testim me mjetin e identifikimit dhe pasi kanë firmosur listë prezencën, kanë firmosur dhe fletën e testimit. Identifikimi i tezës nga anëtarët e komisionit apo sekretariati teknik pas procesit të korigjimit ku teza vijon të jetë e sekretuar, me qëllim publikimin e rezultateve dhe njoftimin e pjesëmarrësve bëhet nëpërmjet numrit të protokollit, i cili është unik dhe i përket vetëm kandidatit. Firma e aplikantit **apo shënimi i emrit në zonën e sekretuar të skantronit nuk cënon konfidencialitetin e testimit, pasi gjatë procesit të korigjimit nuk shihet emri i personit në fletën e testimit.** Grupi i Auditimit në rastin e parë kur rekomandon skualifikimin e kandidatëve të cilët kanë firmosur me emrin e tyre në zonën e sekretuar të fletës, i referohet Neni 5, të Rregullores Nr. 43, datë 06.04.2020. **Ju bëjmë me dije se ky nen vlen për shënime që e bëjnë fletën të identifikueshme. Ndërkohë firma dhe emri i aplikantit shënohen në zonën e sekretuar të tezës dhe nuk janë të dukshme në procesin e korigjimit (Faqja 2 e dokumentit).** Për këtë arsye shënimi i emrit në zonën e sekretuar të tezës nuk e bën tezën të identifikueshme. Po ju paraqesim 2 kopje te njërit prej rasteve te cituara prej jush, ku mund të shihni se si duket teza e sekretuar (Faqja 2 e dokumentit) dhe si duket e pasekretuar (Faqja 3 e dokumentit) . Kjo vlen për të gjitha rastet e përmendura nga ana juaj (nëse është nevoja mund të dërgohen të gjitha) dhe siç mund të shihni fletën e sekretuar (fleta ku vula e institucionit është e plote) nuk është i dukshëm as emri as firma e aplikantit. **Në këtë rast ky element nuk e bën tezën të identifikueshme dhe nuk mund të zbatohet Neni 5 i rregullores së testimit.** Gjithashtu shumë persona kanë emër ose mbiemër pjesë së firmës së tyre dhe nuk mund të skualifikohen për këtë arsye. Shembull i një flete testimi të sekretuar ku cepi i djathtë i tezës mbyllet me qëllim mos leximin e numrit të protokollit, firmës apo emrit të aplikantit dhe shmangien e çdo lloj mundësie identifikimi. Siç mund ta shihni emri i aplikantit nuk duket, pra dhe fleta nuk është në asnjë formë e identifikueshme për këtë arsye nuk mund të skualifikohen aplikantët për firmën/emrin në zonën e sekretuar të tezës.

Qëndrim i grupit të auditimit: Për arsye se shpjegimet që keni dhënë në observacion, të cilat shoqërohen edhe me pamje të rastit konkret të një teze provimi të sekretuar, si dhe pas procesit të sekretimit (pasi ka mbaruar korigjimi i tezës) janë të qarta dhe bindëse, observacioni juaj merret parasysh, duke dalë në konkluzionin se shkrimi i emërit dhe mbiemrit te pjesa e sekretuar e tezës, nuk e bënë atë të identifikueshme dhe në këtë mënyrë nuk mund të ketë ndikim në vlerësim. Për këtë arsye pjesa e projekt raportit e cila trajton 13 rastet e kësaj natyre, si dhe pjesa ku për këtë çështje personat janë ngarkuar me përgjegjësi, janë hequr, pra nuk janë bërë pjesë e raportit të auditimit

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia për Efiçencën e Energjisë, nuk ka ngritur një sistem rregullash të shkruara efikas të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjatë periudhës 2019-2023, nuk ka hartuar rregullore të brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve etj.

- Për periudhën objekt auditimi përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), nga strukturat përgjegjëse të AEE nuk janë planifikuar programe trajnimi për punonjësit, duke mos identifikuar nevojat për trajnim dhe duke mos marrë masat e duhura për zhvillimin profesional të stafit. Nuk është hartuar deklarata dhe raporti përkatës vjetorë për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme që bëhet në bazë të vetëvlerësimeve. AEE nuk ka hartuar gjurmë të auditimit për proceset kryesore të punës, si dhe nuk ka hartuar rregulla të shkruara mbi sigurinë e të dhënave në sistemet e IT.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 20, 24. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-16 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që të hartohet rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve. Të evidentohen nevojat e stafit për trajnim dhe të hartohet plani vjetor i trajnimeve nga vetë AEE. Të hartohet deklarata dhe raporti vjetorë për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrolleve të brendshëm, si dhe të hartohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor AEE ka nisur procedurën e prokurimit me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e efiçencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me kërkesën e UK Durrës, por pa kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM-it), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar nga AEE. Kjo agjenci (AKUM-i) është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor, përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin, rehabilitimin, zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Gjithashtu AEE ka kryer këtë investim në mungesë të një plani kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë, si dhe në kushtet e mos bashkëpunimit me AKUM-in dhe si rezultat në mungesë të një informacioni të nevojshëm për njohjen e gjendjes së impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në vend, mbi bazën e të cilit duhet të ishin përcaktuar dhe entitetet e UK që kanë nevojë më emergjente për përmirësimin e efiçencës së energjisë në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Nuk ka dokumentacion që të shpjegojë se mbi bazën e kujt kritereve AAE përzgjedhi UK Durrës për kryerjen e këtij investimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 124/2015 “Për efiçencën e energjisë”, neni 24, 25, Ligjin Nr. 431, datë 11.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, neni 3, 10, 12. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 42-44 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: AEE për realizimin e projekteve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, të bazohet në planin kombëtar të institucionit si dhe në prioritetin e kërkesave nga institucionet e tjera me të cilat duhet të bashkëpunoj, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në kontratën me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza” në UK Durrës, të lidhur midis AEE dhe BOE “V..” SHPK & “E..-A..” SHPK & “H...” SHPK, me Nr. 308/11 Prot., datë 11.03.2021 me vlerë 62,400,000 lekë me TVSH, me afat përfundimi 5 muaj, është parashikuar hartimi i raportit paraprak të auditimit të energjisë që konsumojnë stacionet, si dhe projekti që duhet të realizohet për rritjen e efikasitetit të tyre. Nga ana e kontraktorit para fillimit të punimeve është hartuar raporti paraprak i auditimit të efikasitetit të energjisë për stacionet e pompave të ujërave të zeza ku janë kryer ndërhyrjet, zëvendësimi i disa pompave si dhe rehabilitimi i tyre me pjesët ndihmëse.

Në projektin pilot, analiza tekniko ekonomike e pasqyruar i referohet konsumit të pajisjeve të instaluar në çdo stacion me orë pune maksimale dhe pa ndërprerje për 24 orë sipas projektit dhe grafikut të vënies në punë. Konsumi i energjisë elektrike sipas faturave të OSHEE nuk përputhen me faktin pasi të dhënat e paraqitura nga UK Durrës janë me mungesa të theksuara. Gjithashtu, raporti përfundimtar ka të dhëna hipotetike të parashikuara në raportin paraprak. Nisur nga fakti se të dhënat e pasqyruara për konsumin e energjisë në raportet e auditimit paraprak dhe përfundimtar janë jo reale, u mblodhën të dhënat nga SHRUK Durrës për vitet 2020-2024 për të gjykuar nëse investimi ja ka arritur qëllimit. Nga të dhënat e paraqitura, duke i marrë së bashku për të gjitha stacionet e pompimit, tregohet se investimi ka pasur rezultat, por duke i analizuar të dhënat e çdo stacioni më vete tregohet se rezultati nuk është ai i pritshëm për çdo stacion ku është kryer investimi. Për sa më sipër, grupi i auditimit shprehet me rezervë se investimi ka realizuar pritshmërinë e kërkuara, pasi në informacionin për konsumin e energjisë ka mangësi dhe paqartësi, të cilat vijnë si rezultat i mos leximit të matësit në mënyrë periodike nga OSHEE dhe konsumi në fund të vitit (në qoftë se është i pa lexuar në muajt e fundit), mund të kalojë në vitin pasardhës. Për të verifikuar se investimi i kryer ja ka arritur qëllimit lidhur me rritjen e efikasitetit të energjisë, nga ana e AEE duhet të ishte kërkuar që të dhënat e pasqyruara në raportin paraprak e përfundimtar nga kontraktori, të ishin sipas faturave të konsumit të energjisë, si dhe raporti përfundimtar të kryej menjëherë pas përfundimit të investimit, mbi bazën e konsumit real të energjisë. Miratimi i raportit paraprak dhe përfundimtar të auditimit të efikasitetit të energjisë, me të dhëna jo faktike, është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes Nr. 308/11 Prot., datë 11.03.2021 dhe kontratën e mbikëqyrjes Kontratë Shërbimi Nr. 316/14 Prot., datë 06.05.2021. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-52 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Agjencia për Efiçencën e Energjisë në rastet e kryerjes së projekteve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, por jo vetëm, menjëherë pas përfundimit të investimit, të kryej monitorimin e efikasitetit të energjisë së arritur në fakt dhe të bëjë krahasimin e saj me efikasitetin e përlojaritur përpara investimit, me qëllim arritjen e konkluzioneve të sakta, se sa efektiv ka qenë realisht investimi në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i efikasitetit të energjisë të AEE, është implementuar sipas kontratës Nr. 5663/2 datë 18.12.2017, lidhur midis BOE “A...” SHPK dhe “K...” SHPK dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me afat 4 vjeçar. Sistemi është dorëzuar nga kompania “K...” SHPK pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Për periudhën objekt auditimi, sistemi nuk ka pasur

mirëmbajtje apo upgrade të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme si në hedhjen e të dhënave ashtu edhe në përpunimin e tyre. Grupi i auditimit konstatoi pamundësinë e gjenerimit të raporteve të ndryshme nga ky sistem, raporte të cilat ishin të nevojshme për të kryer sondazhe në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë ka për detyrë të krijojë dhe përditësojë një bazë të dhënash kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtjet në kursimin saj, e cila shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e eficiencës së energjisë, por kjo detyrë nuk është kryer prej këtij institucioni. Personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, janë të detyruar të caktojnë një menaxher energjie. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion jo të gjithë konsumatorët e mëdhenj të energjisë kanë caktuar një menaxher energjie. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë janë të detyruar të dërgojnë pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, një raport me të dhëna mbi konsumin e tyre të energjisë për vitin kalendarik paraardhës, por pjesa më e madhe e konsumatorëve të mëdhenj nuk e respektojnë këtë pikë të cituar në legjislacion.

Në legjislacionin shqiptar nuk është caktuar asnjë klauzolë në lidhje me masat që duhen të ndërmerren në rast të mosplotësimin të kushteve të mësipërme nga ana e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë. Për sa më sipër është në mospërputhje në Ligjin Nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar, neni 6,7,8. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.8, faqe 166-168 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Agjencia për Eficiencën e Energjisë, të bashkërendojë punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në lidhje me përmirësimin e sistemit të auditimit të ndërtesave/industrive, të krijojë një bazë të dhënash lidhur me konsumin final të energjisë si dhe të kryejë përmirësimet ligjore në lidhje me masat që duhet të ndërmerren mbi mosplotësimin e kushteve nga konsumatorët e mëdhenj.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit ECERT konstatohet se çdo aplikim të çelur e njeh si një objekt ku i korrespondon një projekti me pjesët përbërëse të tij dhe AEE për llogaritjen e tarifave e ka marrë si një ndërtesë të vetëm pavarësisht se ka lëshuar CPE për çdo njësi të projektit. Konsiderimi i çdo aplikimi të çelur si një objekt (ndërtesë) më vete i është referuar Ligjit 124/2015 “Për eficiencën e energjisë” neni 4, “Përkufizime”, pika 20, “Ndërtesë është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm”. Në Urdhër Nr. 5 datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores për formatin e Raportit të Auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik”, neni 16, “Pagesa e audituesit energjetik”, përcaktohet:

1. Pagesa për audituesin e energjisë që kryen auditimin e energjisë në ndërtesa dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë përcaktohet sipas tabelës në shtojcën 4 të kësaj rregullore.
2. Audituesi i energjisë paguan tek agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë 20% të vlerës së çdo certifikate (pa TVSH). Në Shtojcën 4 të këtij urdhri ku përcaktohen tarifat, sipërfaqja është për ndërtesë ku i referohet përkufizimit të ligjit, por pika 2 thekson për çdo certifikatë, pra për çdo njësi më vete që është pjesë përbërëse e ndërtesës, e kështu nuk ka një definicion të qartë për bazën ligjore.

Në sistem nuk mund të verifikohen se sa aplikime kanë ndërtesa të veçuara, ku sipërfaqja e audituar për secilën prej tyre është e ndryshme, që të arrihet një konkluzion përfundimtar se sa janë diferencat në llogaritjen e tarifës në totalin e tyre.

Nga ana e grupit të auditimit janë përzgjedhur në mënyrë rastësore disa aplikime ku ndërtesat janë të veçuara (vila) dhe është llogaritur tarifa si ndërtesa më vete referuar përkufizimit të ligjit dhe

karakteristikave të tyre, ku rezultuan diferenca me vlerën e tarifës të llogaritur si një objekt i vetëm nga ana e AEE. Diferenca në vlerën e llogaritjes së tarifës për rastet e përzgjedhura është 571,334 lekë, por në rast se do të përlllogariteshin të gjitha rastet që janë në sistem për këtë tipologji ndërtesash të veçuara vlera do të ishte më e madhe e kështu kemi të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Këto diferenca kanë ardhur si rezultat i paqartësisë midis Ligjit 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë” neni 4, “Përkufizime”, pika 20. “Ndërtesë” dhe Urdhrit Nr. 5 datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores për formatin e Raportit të Auditimit dhe pagesën e audituesit energjetik” neni 16, “Pagesa e audituesit energjetik”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.7 faqe 163-166 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Agjencia për Eficientësinë e Energjisë të kërkojë nga strukturat përkatëse ndryshimin e bazës ligjore ku i referohet pagesës së audituesit energjetik, konkretisht Urdhër Nr. 5 datë 12.01.2021 neni 16, duke e llogaritur këtë tarifë për çdo ndërtesë me vete pavarësisht se janë në të njëjtin aplikim, e kështu duke shmangur mungesën e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me vlera të larta për periudhën 2019-2023, në 15 prej tyre me vlerë të fondit limit **617,066,663 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 576,260,099 lekë pa TVSH**, u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterit të veçanta të dokumenteve të tenderit, në llogaritjen e fondit limit dhe termave të referencës dhe në vlerësimin e ofertave, detajuar si më poshtë:

Në 14 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 607,066,663 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 566,391,099 lekë pa TVSH, janë konstatuar parregullsi në hartimin e kriterit të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi disa prej tyre nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kryesisht këto kriteret lidhen me kapacitetin teknik, si me ekzistencën e punonjësve në listë pagesat e operatorëve ekonomik për një periudhë të gjatë kohe, përvoja të suksesshme të ngjashme të mëparshme, kërkesat në licencat e shoqërisë, numrin e punonjësve dhe numri i makinerive të kërkuara etj. Në disa raste nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit kriteret të cilat kanë qenë të nevojshme për objektin e prokurimit. Parregullsitë në hartimin e kriterit, nuk nxisin konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, përjashtojnë nga konkurrimi operatorë të tjerë ekonomik që mund ti kenë kapacitetin e duhura për realizimin e kontratës, nëse nuk do të ketë devijime në hartimin e kriterit etj.

- Në 2 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 18,333,333 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 17,976,000 lekë pa TVSH (pjesë përbërëse e 15 procedurave të konstatuara me parregullsi), AK nuk ka ngritur strukturat e posaçme për përlllogaritjen e vlerës së kontratës dhe nuk ka dokumentuar hartimin dhe përlllogaritjen e fondit limit në proces verbalin përkatës.

- Në 2 procedura prokurimi (pjesë përbërëse e 15 procedurave të konstatuara me parregullsi), me vlerë të fondit limit 82,833,332 lekë pa TVSH dhe vlerë të kontratës 64,765,000 lekë pa TVSH, janë konstatuar parregullsi në vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, pasi janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit, duke sjellë si pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomik të shpallur fitues si rezultat i një procesi jo të rregullt të vlerësimit të ofertave.

- Në procedurën e prokurimit me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH dhe vlerë të kontratës 9,869,000 lekë pa TVSH, ka rezultuar mungesa e specialistëve të fushës në hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike si dhe në marrjen në dorëzim të mallit. Parregullsitë e konstatuara janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar, neni 46, Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 1, neni 77; VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 3, pika 28, neni 27, pika 3, neni 26 pika 5; VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 39, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82, pika 2, Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87, 92, 98, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82 pika 2, Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 43. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 42-163 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor, njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, të marrin masa që në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, hartimi i kërkesave të veçanta të kualifikimit të jetë i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

6.2. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, të marrin masa për ndërprerjen e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

6.3. Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masat e nevojshme për ngritjen e strukturave të posaçme për përllogaritjen e vlerës së kontratës, dokumentimin e hartimit të përllogaritjes së fondit limit për të gjitha procedurat e prokurimit, si dhe të caktohen specialistë të fushës së objektit të prokuruar në hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës si dhe marrjen në dorëzim të mallit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se projekti i zbatimit për objektin “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave “2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër” është hartuar në vitin 2020 dhe në vijim të projektit është lidhet kontrata me të njëjtin objekt, me Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021. Për këtë objekt nga autoriteti kontraktor AEE nuk është nxjerrë leje ndërtimi, duke bërë që të lidhet dhe të zbatohet një kontratë pa leje ndërtimi. Gjithashtu për këtë projekt nuk është kërkuar kryerja e oponencës teknike nga institucionet përkatëse të specializuara për këtë qëllim, duke mos marrë një garanci shtesë për cilësinë dhe sigurinë e projektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 39, Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 6, gërma (a). *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-54 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa që për të gjitha procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve publike, pavarësisht nga vlera e projektit, të mos vijohet pa marrë më parë miratimin nga institucionet e ngarkuara sipas ligjit për oponencën teknike të projektit të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimeve me vlera të larta rezultoi se në 2 raste AK nuk ka mbajtur apo administruar korrespondencë me AKSHI-n lidhur me shërbimet apo blerjet e pajisjeve (printer, kompjuter). Konkretisht në procedurat “Blerje e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes së CPE”, me vlerë të fondit limit 10 milion lekë, zhvilluar në vitin 2021, si dhe “Projekt për informim, fushatë ndërjegjësimi, edukimi dhe trajnimi për eficientë të Energjisë në fushën e banesave, industrisë, dhe transportit, me vlerë të fondit limit 10 milion lekë, zhvilluar në vitin 2022, nuk

rezulton të jetë bërë kërkesë drejtuar AKSHI-it për dhënien e mendimit lidhur me prokurimin e tyre. Gjithashtu nuk administrohet nëse për hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve për përpunim të dhënash apo raportim të dhënash (printer e kompjuter), të jenë ndjekur standardet shqiptare të TIK, të përcaktuara nga AKSHI. Këto veprime janë në mospërputhje me VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, pika 5, gërma i, pika 6, gërma i dhe h, si dhe Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 21 , pikat 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 64-66 dhe 128-130 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: AEE të marrë masat e nevojshme që për të gjitha procedurat e prokurimit në fushën e TIK, të kërkojë mendim nga AKSHI lidhur me kryerjen e këtyre procedurave, si një i institucion i specializuar dhe që organizon dhe kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontrata për sistemet, pajisjet software dhe hardware në fushën e TIK për institucionet dhe organet e administratës shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Supervizim i projektit pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë”, me vlerë 45,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2021, u konstatua se nga ana e supervisorit nuk përshkruhen punimet e kryera nga kontraktori në mënyrë analitike, sipas zërave dhe volumeve të aprovuara. Supervisor BOE: “L...” & “K...” & “G...” & “N...”, nuk dokumenton se ka paraqitur pranë AEE stafin e tij mbikëqyrës, pjesë e dokumenteve që duhet të plotësojë operatori ekonomik fitues, sipas kushteve të veçanta të DST, gjithashtu nuk është dokumentuar kohë qëndrimi në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikëqyrës. -Nuk është raportuar përshkrimi i punimeve që janë kryer gjatë muajit, sipas zërave, si dhe nuk janë treguar volumet progresive të punimeve mujore, apo punimet e aprovuara etj. -Situacioni përfundimtar i punimeve datë 10.08.2021 dhe situacionet pjesore të sipërmarrësit “A...” SHPK, nuk janë hartuar në mënyrë analitike, por ato japin vlerën totale të punimeve dhe nuk tregojnë as volume dhe as çmime. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3 dhe 4 të termave të referencës, shtojca 12 e DST. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 73-77 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm dhe strukturat përkatëse, në procedurat e supervizimit të kërkohet që nga operatori ekonomik në cilësinë e supervisorit të punimeve, të bëhet dokumentimi i kohë qëndrimit në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikëqyrës, si dhe të përshkruhen në mënyrë analitike të gjitha punimet e kryera nga kontraktori. Të kërkohet që situacionet e sipërmarrësit të punimeve të hartohen në mënyrë analitike, ku të jepen të dhëna për volumet dhe çmimet e punimeve dhe jo vetëm për vlerën totale të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AEE nuk ka hartuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2019, 2020, 2021, ndërkohë që ka pasur detyrimin e përgatitjes së tre raporteve periodike 4 mujore të monitorimit në vit, mbi performancën financiare të produkteve dhe objektivat e realizuara për çdo program buxhetor, nëpërmjet të cilëve (raporteve), duhet të krahasoheshin treguesit faktik të performancës me ato të planifikuar. Në këtë mënyrë nuk është evidentuar për vetë AEE, si dhe nuk është përcjellë informacion në organin epror përkatës, lidhur me çështjet kryesore dhe mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, nivelin e performancës gjatë realizimit të objektivave, arritjet në terma sasiore dhe të vlerës të produkteve të realizuara, si dhe nuk janë identifikuar mos arritjet, shkaqet e tyre dhe masat për përmirësimin e situatës.

Parregullsitë e mësipërme janë në mos përputhje me Udhëzimin e MFE Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 266, udhëzimin Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 4 dhe 33. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-25 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i AEE dhe Sektori i Financës të marrin masa për hartimin e tre raporteve periodike 4 mujore të monitorimit të buxhetit, nëpërmjet të cilëve të bëhet krahasimi i treguesve faktik të performancës së buxhetit me ato të planifikuar, të evidentohen mos arritjet, shkaqet e tyre dhe në bazë të kësaj analize të merren masa për përmirësimin e situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Me shkresën Nr. 3 288/2 datë 02.05.2023 MIE ka dërguar të miratuar planin e buxhetit për vitet 2023-2025, për shpenzimet kapitale në programin buxhetor “Mbështetja për energjinë”, në vlerën 211,225,850 lekë për vitin 2023, vlerën 215,234,608 leke për vitin 2024 dhe vlerën 226,300,000 leke për vitin 2025 dhe financimin e huaj për vitin 2024 në shumën 40,000,000 lekë për projektin “Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero”. Referuar shkresës Nr. 3936 Prot., datë 03.11.2022 me objekt “Tërheqje vëmendje”, konstatohet se AEE ka paraqitur me vonesë raportimin e të dhënave të projektit me financim të huaj “Goal nZeb” duke vepruar në mospërputhje me Udhëzimin Nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, pika 7.3 në të cilën përcaktohet se: “Në rastet e konstatimeve të qëndrimeve që kanë të bëjnë me mosrespektimin e përsëritur të afateve kohore apo pasaktësi në raportimin mujor, duke iu referuar legjislacionit në fuqi, do të procedohet me masa administrative”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-25 të Raportit të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i AEE së bashku me strukturat e tjera të institucionit, në korrespondencën shkresore që mban me MIE, të marrë masa që të respektojnë afatet kohore lidhur me raportimin e të dhënave të projektit me financim të huaj, por edhe të çdo lloj natyre raportimi, me qëllim që AEE të jetë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara, si dhe e të shmangë masat administrative, të cilat shoqërojnë vonesat në raportim.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Agjencisë për Eficencën e Energjisë nuk është e plotësuar me të gjithë numrin e punonjësve të miratuar. Kjo agjenci ka të miratuar në strukturë 20 punonjës, por tre prej pozicioneve të punës janë të pa plotësuara. Gjithashtu nuk u konstatuan procedura të kryera nga institucioni me qëllim plotësimin e këtyre vendeve bosh. Mos plotësimi i strukturës së miratuar me të gjithë punonjësit, nuk garanton kryerjen e të gjitha detyrave funksionale sipas veprimtarisë që kryen AEE, ka ndikim negativ në performancën dhe arritjen e objektivave të institucionit, si dhe është në kundërshtim me strukturën e miratuar për AEE me urdhrin e Kryeministrit Nr. 38, datë 17.03.2021, me objekt “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Eficencën e Energjisë”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 26-29 të Raportit të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i AEE dhe Sektor i Shërbimeve Mbështetëse, të marrin të gjitha masat e duhura për plotësimin e vendeve bosh në strukturën e miratuar, me qëllim që struktura të funksionojë në përputhje me numrin e miratuar dhe të garantohet që çdo detyrë funksionale të kryhet nga punonjësi përkatës sipas strukturës.

Deri më 31.12. 2024

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, në analizimin e zërit pasive afatshkurtra, llogaria “Furnitor e llogari të lidhura me to”, vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri. Në vitin 2021 kjo vlerë është 50,147,442 lekë pa TVSH, ndërsa në vitin 2023, në vlerën

93,379,039 lekë pa TVSH, në të cilën janë të përfshira detyrimet e mbartura ndaj furnitorëve. AEE nuk ka ndjekur asnjë rrugë ligjore duke mos caktuar një rend apo një metodë të drejtë mbi likuidimin e tyre, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, 9, 12. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 29-31 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të marrë masat që të kryejë prioritarizimin e shërbimeve/pagesave në mënyrë që të likuideojë në kohë detyrimet, ose të krijojë një rend mbi shlyerjen e kreditorëve të cilët janë akumuluar ndër vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurat e prokurimit për blerjet e vogla u konstatuan mangësitë si vijon:

- Në 1 procedurë (“Blerje mobilje zyre”, zhvilluar në viti 2023), për përllogaritjen e fondit limit, jo të gjitha subjektet në të cilat është bazuar studimi i tregut, kanë në fushën e aktivitetit objektin e prokurimit, gjë e cila mund të ndikojë negativisht në çmimin real të ofruar nga këto subjekte.

- Në 4 procedura (“Blerje tonera printeri” viti 2023, “Blerje materiale kancelarie”, viti 2022, “Blerje materiale kancelarie”, viti 2023 si dhe “Blerje mobilje zyre”, viti 2023), kërkesat e veçanta të kualifikimit të kërkuara nga AK, nuk përfshijnë të gjitha kriteret specifike në funksion të garantimit të cilësisë së objektit të prokuruar.

- Në 2 procedura (“Blerje tonera printeri” viti 2023 dhe “Blerje materiale kancelarie”, viti 2022), janë shpallur fitues OE në kushtet kur nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

- Në 4 procedura (“Blerje tonera printeri” viti 2023, “Blerje materiale kancelarie” viti 2022, “Blerje materiale kancelarie” viti 2023 si dhe “Blerje mobilje zyre” viti 2023), nga titullari i autoritetit kontraktor nuk është nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Marrja e mallit në dorëzim është kryer nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël. - Gjithashtu në procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Blerje tonera printeri” viti 2023, rezulton se malli i marrë në dorëzim nuk është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi nga 10 tonera HP sipas kodeve përkatës, 3 prej tyre në shumën 20,925 lekë, nuk janë origjinal.

Këto veprime janë në mospërputhje me pikën 4 të nenit 12, nenin 13, neni 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Udhëzimin e APP Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 9.2 & 10, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 40, pikat 2, 3, e 6, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82, pika 2, Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. pika 42 dhe 43. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5 faqe 31-42 të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Nga titullari i autoritetit kontraktor të merren masa që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik me vlera të vogla, ofertat ekonomike të merren vetëm nga subjekte që kanë në fushën e aktivitetit të tyre objektin e prokurimit.

14.2. Rekomandimi: Në raste të veçanta të kërkohet edhe plotësimi i një apo disa kriterëve të veçanta, apo edhe i mostrave të mallit, duke përcaktuar për kriteret paraqitjen e dokumentacionit përkatës.

14.3. Rekomandimi: Komisioni i prokurimit me vlera të vogla të marrë masa që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të mos kualifikohen operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në ftesën për ofertë.

14.4. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor, të marrë masa që në rastet e dorëzimit të mallrave nga operatorët ekonomik, të nxjerrë urdhër për ngritjen e komisioneve për marrjen e mallit në dorëzim. Komisionet nuk duhet të pranojnë mallra, të cilat nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat e KLSH”, gërma (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga **Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblim dëmi, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,420,741 lekë**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kontratës Nr. 1764 Prot., datë 26.07.2022, me objekt “Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi), me efikasitet energjie në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrëz, Mat , Bulqizë”, të lidhur midis AEE dhe BOE “I...& M. & P...”, në datën 26.07.2022, me vlerë 22,950,000 lekë pa TVSH, u konstatua se sipas procesverbalit Nr. 18/3, datë 18.03.2023 të komisionit të ndjekjes dhe të zbatimit të kontratës, në raportet e dorëzuar nga OE “I.” SHPK, konstatohen problematika të cilat janë në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik, të miratuar me urdhrin Nr. 5 datë 12.01.2021 të ministrit përgjegjës për energjinë, duke ia përcjell konstatimet dhe problematikat e konstatuara në projektet e dorëzuara me shkresën Nr. 52/4 datë 18.03.2023. Në kushtet e mos respektimit të afateve kohore respektivisht të fazës së parë me 43 ditë dhe 82 ditë për fazën e dytë, dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e shërbimit të konsulencës, janë 1,479,167 lekë. Sa më sipër është në mospërputhje me pikën 15.b të Kontratës Nr. 1764 Prot., datë 26.07.2022. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 125-128 të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Agjencia për Efikasitetin e Energjisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **1,479,167 lekë pa TVSH**, nga BOE “I...& M. & P...”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vonesa në përfundimin e shërbimit të konsulencës, sipas kontratës Nr. 1764 Prot., datë 26.07.2022.

Deri më 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt “Projekt Pilot për auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndricimit me efikasitet në lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën

lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës, Rruga e Energjisë Pastër”, të lidhur midis AEE dhe BOE “A...& “4K.. & N..” SHPK, me Nr. 1640 Prot., datë 04.07.2022 me vlerë 50,700,000 lekë me TVSH, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe auditimit në terren në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit dhe grupit të marrjes në dorëzim nga AEE, rezultoi se ndriçimi në një pjesë nuk ishte funksional, pasi mungonte kabulli elektrik. Gjatësia e linjave që mungojnë janë përfshirë në librezat e masave për 4 (katër) zëra punimesh në shumën 1,179,100 lekë pa TVSH, ku konsiderohet punim i pa kryer dhe përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kreu III, neni 7, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3; Kontrata e shërbimit Nr. 3653/3 Prot., datë 04.10.2022 me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për objektin projekt pilot auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore në qytetin e Shkodrës, Rruga e Energjisë Pastër”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 112-115 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Agjencia për Efikasitetin e Energjisë të marri masa për vendosjen në funksion të sistemit të ndriçimit nga ana e sipërmarrësit dhe, në rast të mos kryerjes së punimeve të konstatuara të arkëtoj shumën **1,179,100 lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga BOE “A.. & 4K & N..” SHPK sipas kontratës së lidhur me Nr. 1640 Prot., datë 04.07.2022 për realizimin e punimeve civile.

Deri më 31.12.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt “Projekt pilot auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare, me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Korçës”, të lidhur midis AEE dhe BOE “M...” SHPK & “A...” SHPK & “4K...” SHPK, me Nr. 1641 Prot., datë 04.07.2022, me vlerë të realizuar 40,816,973 lekë me TVSH, afat të përfundimit të punimeve 7.75 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit në dosjen teknike u konstatua se punimet e zbatimit të të gjitha fazave nuk janë realizuar sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Konkretisht; afati i përfundimit të punimeve është 7.75 muaj nga data 04.10.2022 e cila është data e fillimit të kontratës, kjo e përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës, neni 4 “Data e fillimit”, pra punimet duhet të përfundonin më datë 27.05.2023. Nga ana e sipërmarrësit të punimeve është njoftuar se punimet kanë përfunduar më datë 02.07.2023, pra 36 ditë vonesë. Këto vonesa janë konstatuar edhe nga grupi i marrjes në dorëzim, i cili ka llogaritur edhe penalitetet përkatëse. Referuar nenit 20 “Dëmet e likuiduara”, pika b, ku citohet “Për kontrata me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”, kështu që autoriteti kontraktor duhet të aplikojë penalitet për mosrealizimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratë, në vlerën **612,254 lekë pa TVSH** (34,014,144 lekë pa TVSH x 25% x 2/1000 x 36 ditë). Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu III, neni 7; Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu II, pika 3,b; Kontratën e shërbimit Nr. 3652/3 Prot., datë 04.10.2022 “Për mbikëqyrjen e punimeve”; Kontratën e shërbimit Nr. 398/3 Prot., datë 03.07.2023

“Për kolaudimin”, si dhe “Kontratën e zbatimit” Nr. 1641 Prot., datë 04.07.2022. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 120-121 të Raportit të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **612,254 lekë pa TVSH** nga BOE “M..” SHPK & “A...” SHPK & “4K..” SHPK, për shkak të mos zbatimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, sipas kontratës së lidhur me Nr. 1641 Prot., datë 04.07.2022 “Për realizimin e punimeve civile”.

Deri më 31.12.2024

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kontratës Nr. 1638 Prot., datë 04.07.2022, me vlerë 63,241,500 lekë pa TVSH, ose 75,889,800 lekë me TVSH, me objekt “Projekt pilot auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare, me efiçencë të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, të lidhur midis AEE dhe BOE “N...” SHPK & “Ll...” SHPK, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit dhe grupit të marrjes në dorëzim nga AEE, rezultoi se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën **150,220 lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kreu III, neni 7, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 8.1, Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Kontrata e shërbimit Nr. 3654/3 Prot., datë 04.10.2022 me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Projekt pilot auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare me efiçencë të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, neni 6, “Detyrimet e Palëve. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6 faqe 102-104 të Raportit të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Agjencia për Efiçencën e Energjisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **150,220 lekë pa TVSH** nga BOE “N...” SHPK & “Ll...” SHPK, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për shkak se rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, sipas kontratës së lidhur me Nr. 1638 Prot., datë 04.07.2022 “Për realizimin e punimeve civile”.

Deri më 31.12.2024

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-Rruga e Energjisë së Pastër”, të lidhur midis AEE dhe OE “E...” SHPK, me vlerë të kontratës 82,499,604 pa TVSH, afat përfundimi 6 muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit, nga dokumentacioni i dosjes u konstatua se punimet nuk kanë përfunduar plotësisht dhe sistemi i instaluar nuk është

vendosur në funksion. Nga vlera e mësipërme e kontratës, bazuar në sitacionin përfundimtar, është situacionuar vlera 78,113,691 lekë pa TVSH.

Gjatë zbatimit të projektit, referuar korrespondencës së kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve, janë hasur vështirësi në lirimin e sheshit të ndërtimit dhe dhënien e lejes nga Bashkia Tiranë, si dhe në përcaktimin e pikave të lidhjes në sistemin ekzistues nga OSHEE. Sipas njoftimit të përfundimit të punimeve, punimet kanë përfunduar në datën 28.12.2022, ku theksohet se për vendosjen në funksion të sistemit kërkohet pika e lidhje nga OSHEE, leje nga Bashkia Tiranë për çarjen e rrugës kryesore për kalimin e tubacionit deri në pikat e lidhjes në sistemin ekzistues. Nga njoftimi i përfundimit të punimeve datë 28.12.2022 e deri në fund të periudhës audituese, nuk gjenden gjurmë shkrësore që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar nga Bashkia Tiranë dhe OSHEE zgjidhjen e problemeve të hasura për vendosjen në funksion të investimit të kryer.

Mosrealizimi i punimeve dhe mos konfigurimi i sistemit, sjell vështirësi në kolaudimin e punimeve dhe marrjen në dorëzim nga ana e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë. Ky projekt i iniciuar si një zgjidhje inteligjente do të shërbente në uljen e konsumit të energjisë elektrike dhe në rritjen e aksesimit të makinave elektrike, për tu karikuar në stacione të fuqishme (Fast charger), nuk ja ka arritur qëllimit. Gjithashtu me kalimin e viteve pajisjet e vendosura do të amortizohen dhe për vendosjen në pune të tyre do të kërkohen fonde shtesë, duke rritur vlerën e investimit si dhe duke sjell humbje të vlerës së energjisë që duhet të prodhohin pajisjet e instaluara. Për sa më sipër vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar) deri në këtë fazë të auditimit konsiderohet shpenzim pa efektivitet si rezultat i mos realizimit të punimeve sipas afatit të kontratës Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, e cila është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-64 të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, të marrë masa për përfundimin e projektit dhe vendosjen në efiçencë të tij, sipas kontratës Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-Rruga e Energjisë së Pastër”, të lidhur midis AEE dhe OE “E.” SHPK, me vlerë të kontratës 82,499,604 pa TVSH dhe vlere të situacionuar 78,113,691 lekë pa TVSH, duke shmangur koston e amortizimit të paisjeve dhe duke bërë që vlera e investimit të plotësojë qëllimin e projektit dhe të kthehet në shpenzim me efektivitet.

Për projektin në fjalë, si dhe për projekte të tjera në të ardhmen në të cilat ka disa aktorë për realizimin e tyre, të ketë një veprim ndërinstitucional të menjëhershëm për përfundimin e tyre në kohë dhe me cilësi, sipas afateve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

I. Për punonjësit në marrëdhënie pune (me status të nëpunësit civil):

Në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja (c), si dhe në zbatim të ligjit Nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, neni 58, “Llojet e masave disiplinore”, VKM Nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në

shërbimin civil”, i rekomandojmë drejtorit të përgjithshëm të AEE, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, (në proporcion me shkeljen e kryer), për punonjësit si më poshtëm:

1. Znj. B.M., me detyrë specialiste e Shërbimeve Mbështetëse:

a) Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për procedurat e prokurimit me vlera të larta, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit etj., në 6 procedura prokurimi, me objekt: “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër”, zhvilluar në datën 09.02.2021, me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH; “Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, vlerë të fondit limit 54,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.12.2020; “Blerja e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes së CPE projekt për standardet e ndriçimit rrugor dhe urban në Shqipëri”, me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar në datën 10.02.2021; “Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë”, me fond limit 8,333,333 lekë, zhvilluar më 20.01.2021; “Supervizion i projektit pilot për përmirësimin e efikasitetit të impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me fond limit 1,287,360 lekë, zhvilluar më 20.01.2021;

“Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me fond limit 54,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.12.2020.

Parregullsitë e konstatuara janë në mos përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 26, pika 5, neni 27, neni 28, neni 61 pika 2 etj., ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, Udhëzimin nr. 6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7, etj.

b) Në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, për parregullsitë e konstatuara në 4 procedura prokurimi me objekt: “Blerje materiale kancelarie”, viti 2022 (për kualifikim të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të vendosura në ftesën për ofertë, etj.), si dhe “Blerje materiale kancelarie”, viti 2023 (për mos hartim të specifikimeve teknike të mallit, etj.), “Shërbim Pastrimi”, viti 2020 dhe “Shërbim Pastrimi”, viti 2021 (për mos hartim të specifikimeve teknike të mallit, etj.). Parregullsitë e konstatuara janë në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimit nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

2. Z. F.D., me detyrë specialistë në Sektorin e Programeve të Eficencës dhe Analizës, **a)** Në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, për parregullsitë e konstatuara në 5 procedura të prokurimit publik, me objekt: “Blerje materiale kancelarie” viti 2022 (për kualifikim të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të vendosura në ftesën për ofertë, etj.), “Blerje materiale kancelarie”, viti 2023 (për mos hartim të specifikimeve teknike të mallit, etj.), procedurën “Blerje tonera printeri” viti 2023 (për parregullsi lidhur me mostrat e mallit, etj.), “Blerje mobilje zyre”, viti 2023 (lidhur me marrjen e ofertave dhe hartimin e ftesës për ofertë), procedurën “Blerje Materiale Pastrimi”, viti 2022 (për kualifikim të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të vendosura në ftesën për ofertë, etj.). Parregullsitë e konstatuara janë në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

b) Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (bllaqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet. Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82, pika 2.

- “Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorëve ekonomik, në kushtet kur asnjë prej operatorëve të kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe tenderi duhej të anulohet, duke vepruar në mos përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87, 92, 98, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, nenin 82 pika 2.

3. Z. O. I., me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Shërbimeve Energjetike:

a) Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, në 6 procedura prokurimi me objekt:

“Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (bllaqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet: Elbasan, Belsh, Cërrik, Rrogozhinë, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Kavajë Fier, Lushnje dhe Divjakë”, me fond limit 21,066,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022; “Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (bllaqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Dibër, Tropojë Krujë, Durrës, Rrogozhinë”, me fond limit 10,000,000 lekë, pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare, me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, me fond limit 66,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022; “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare” me efikasitet të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës”, me fond limit 39,016,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021; “Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (bllaqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022; “Auditim, certifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore”, me fond limit 45,000,000 lekë, zhvilluar në vitin 2022.

Në këto procedura prokurimi është vepruar në mos përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 39, pika 4.

b) Në cilësinë e anëtarit të KVO, në procedurën e prokurimit me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me fond limit 54,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.12.2020, për parregullsi të konstatuara në vlerësimin e ofertave, pasi ka kryer kualifikim të operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e

vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55.

c) Në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, për parregullsitë e konstatuara në 2 procedura prokurimi me objekt: “Blerje tonera printeri” viti 2023 (për parregullsi lidhur me mostrat e mallit, etj.), Blerje mobilje zyre”, viti 2023. (lidhur me marrjen e ofertave dhe hartimin e ftesës për ofertë etj.), për mos zbatim të kuadrin ligjor në fuqi si vijon:

- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pikat 2, 3 dhe 6, Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Udhëzimi nr. 2 datë 02.05.2019 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE” të APP, pikat 2, 3 dhe 4.

Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

4. Znj. K.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve:

a) Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, në 12 procedura prokurimi me objekt:

“Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, vlerë të fondit limit 54,166,667 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 27.12.2020;

“Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër”, zhvilluar më 09.02.2021, me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH;

“Blerja e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes së CPE projekt për standardet e ndriçimit rrugor dhe urban në Shqipëri”, me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar në datën 10.02.2021;

“Supervizioni i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë”, me fond limit 8,333,333 lekë, zhvilluar në datën 20.01.2021;

“Supervizion i projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me fond limit 1,287,360 lekë, zhvilluar më 20.01.2021;

“Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, me fond limit 66,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare, me efikasitet të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës”, me fond limit 39,016,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021;

“Projekt për informim, fushatë ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi për efikasitetin e energjisë në fushën e banesave, industrisë dhe transportit”, me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Projekt pilot për instalimin e ndriçimit urban me efikasitet të lartë energjie në qytetin e Dibrës” me vlerë të fondit limit 33,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Auditim, projekt zbatimi dhe realizim punimesh me efikasitet energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës”, me vlerë të fondit limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Projekt Pilot “Rikonstruksion, Auditim dhe projekt zbatimi me efikasitet energjetike në spitalin e Bashkisë Mat”, me fond limit 59,166,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare”, me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaik, në unazën lindore dhe perëndimore”, me fond limit 45,000,000 lekë, zhvilluar në vitin 2022. Në këto procedura prokurimi është vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 39, pika 4, Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 5, neni 45/1, neni 61, pika 2, etj.

b) Në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, për parregullsitë e konstatuara në 2 procedura prokurimi me objekt: Shërbim Pastrimi”, viti 2020, si dhe “Shërbim Pastrimi”, viti 2021 (për mos hartim të specifikimeve teknike të mallit, etj.), për mos zbatim të kuadrit ligjor në fuqi si vijon: Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28, pikat 2 dhe 5, neni 59, 61, pika 2, neni 64, pika 2, neni 66, pika 3.

5. Z. A. M., me detyrë drejtor i Drejtorisë Teknike të AEE:

a) Në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura prokurimi me objekt:

“Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, me fond limit 54,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.12.2020, për parregullsi të konstatuara në vlerësimin e ofertave, pasi ka kryer kualifikim të operatorit ekonomik, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55;

“Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82, pika 2.

b) Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, në 12 procedurat e prokurimit me objekt:

“Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet: Elbasan, Belsh, Cërrik, Rrogozhinë, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Kavajë Fier, Lushnje dhe Divjakë”, me fond limit 21,066,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Dibër, Tropojë Krujë, Durrës, Rrogozhinë”, me fond limit 10,000,000 lekë, pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, procedurën me objekt “Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare, me efikasitet të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës”, me fond limit 66,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumë familjare” me efikasitet të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës”, me fond limit 39,016,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021;

“Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has,

Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022;

“Projekt pilot për instalimin e ndriçimit urban me efikasitet të lartë energjie në qytetin e Dibrës” me vlerë të fondit limit 33,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Auditim, projekt zbatimi dhe realizim punimesh me efikasitet energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës”, me vlerë të fondit limit 50,000,000 lekë pa TVSH), zhvilluar në vitin 2023;

“Projekt Pilot “Rikonstruksion, auditim dhe projekt zbatimi me efikasitet energjetike në spitalin e Bashkisë Mat”, me fond limit 59,166,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare”, me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023;

“Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për vendosjen e sistemit të ndriçimit me efikasitet të lartë të energjisë, stacioneve të parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaike, në unazën lindore dhe perëndimore”, me fond limit 45,000,000 lekë, zhvilluar në vitin 2022.

Në këto procedura prokurimi është vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 39, pika 4.

c) Gjithashtu edhe në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Teknike të AEE, për përgjegjësitë në parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër, me pasojë që vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar) deri në këtë fazë të auditimit, të rezultojë shpenzim pa efektivitet, si rezultat i mos realizimit të punimeve sipas afatit të kontratës Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011.

6. Znj. Xh. A., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, në cilësinë e anëtares së KVO, për parregullsi të konstatuara në 2 procedura prokurimi me objekt:

“Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (bloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet. Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82, pika 2.

“Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorëve ekonomik, në kushtet kur asnjë prej operatorëve të kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe tenderi duhej të anulohet, duke vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 87, 92, 98,

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, nenin 82 pika 2.

7. Znj. K. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Auditimit dhe Certifikimit, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, në 4 procedurat e prokurimi me objekt: “Projekt pilot për instalimin e ndriçimit urban me efikasitet të lartë energjie në qytetin e Dibrës” me vlerë të fondit limit 33,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023; “Auditim, projekt zbatimi dhe realizim punimesh me efikasitet energjie në disa shkolla publike në Qarkun e Dibrës”, me vlerë të fondit limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023; “Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023; “Realizim punimesh, auditim dhe projekt zbatimi për vendosjen e stacioneve të karikimit për makinat elektrike në disa qytete dhe pikat kufitare”, me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023.

Në këto procedura prokurimi është vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 39, pika 4, etj.

8. Z. Xh.Sh., me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit të Projekteve:

a) Në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura prokurimi me objekt:

“Auditim certifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumë familjare (blloqe banimi) me efikasitet energjie në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbin, Kukës, Has, Lezhë, Pukë, Vau i Dejës, Klos, Fushë Arrë, Mat , Bulqizë”, me fond limit 23,666,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kritereve të vendosura në dokumentet e tenderit, duke vepruar në mos përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 82, pika 2.

“Studim auditim dhe projekt zbatimi për klinikat në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”, me fond limit 43,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023, lidhur me parregullsi në kualifikimin e operatorëve ekonomik, në kushtet kur asnjë prej operatorëve të kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe tenderi duhej të anulohet, duke vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87, 92, 98, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, nenin 82 pika 2.

b) Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, në procedurën e prokurimit me objekt: Projekt për informim, fushatë ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi për efikasitetin e energjisë në fushën e banesave, industrisë dhe transportit”, me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022. Në këtë procedurë prokurimi është vepruar në mospërputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, neni 39, pika 4, etj.

II. Për punonjësit e mëposhtëm që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me AEE dhe të identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi të vogla, konsiderojmë të mos jepet masë disiplinore:

1. Znj. D.K., me detyrë specialiste në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël,

2. Znj. Xh. S., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

III. Për punonjësit e larguar, për të cilët nuk ka adresim institucional.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre:

1. Znj. A.K., me detyrë ish përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit të Programeve të Eficencës dhe Analizës në AEE, ndërprerë marrëdhëniet e punës me shkresën nr. 4917/1, datë 18.06.202, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe në cilësinë e anëtares së KVO për 1 procedurë prokurimi.

2. Z. B. A., me detyrë ish përgjegjës i Sektorit të Auditimit dhe Certifikimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 09.03.2022, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

IV. Për punonjësit e larguar, për të cilët ka adresim institucional.

Në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja (c), si dhe në zbatim të ligjit Nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, neni 58, “Llojet e masave disiplinore”, VKM Nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, neni 37 “Masat disiplinore”, **i rekomandojmë znj. B. B.**, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, (në proporcion me shkeljen e kryer), për **z. A.H.**, me detyrë drejtor i përgjithshëm i AEE, si dhe dhënien e masës disiplinore sipas përcaktimeve të kontratës së punës (në proporcion me shkeljen e kryer), për **z. E.D.** me detyrë ish drejtor i përgjithshëm i AEE, aktualisht administrator i “Albpetrol” SHA, për shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së tyre në subjektin Agjencia për Eficencën e Energjisë, si vijon:

1. Z. A. H., me detyrë drejtor i përgjithshëm i AEE, si dhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, prej datës 14.10.2022 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në:

a) Fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të cilat kanë sjellë si pasojë mos hartimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit, për parregullsi në pesë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm (Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi), për mos ngritjen dhe mos implementimin e një sistem efektiv të menaxhimit financiar kontrollit të brendshëm, veprime në mos zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8,10, 20, 21,22, 23 dhe 2.

b) Për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër, me pasojë që vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar), të rezultojë shpenzim pa efektivitet, si rezultat i mos realizimit të punimeve sipas afatit të kontratës Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011.

c) Në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, për parregullsitë e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, të cilat lidhen me hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, kualifikimin dhe s'kualifikimin e operatorëve ekonomik, shpalljen e fituesit, etj., përgjegjësi të cilat rrjedhin nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, neni 8, 9, 10 i Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

2. Z. E. D. me detyrë ish drejtor i përgjithshëm i AEE për periudhën 22.06.2021-12.10.2022, si dhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, për parregullsitë e konstatuara në:

a) Fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të cilat kanë sjellë si pasojë mos hartimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit, për parregullsi në pesë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm (Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi), për mos ngritjen dhe mos implementimin e një sistem efektiv të menaxhimit financiar kontrollit të brendshëm, veprime në mos zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 8,10, 20, 21,22, 23 dhe 2.

b) Për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-rruga e Energjisë Pastër, me pasojë që vlera e investimit të kryer prej 78,113,691 lekë pa TVSH (sipas situacionit përfundimtar) deri në këtë fazë të auditimit, të rezultojë shpenzim pa efektivitet, si rezultat i mos realizimit të punimeve sipas afatit të kontratës Nr. 306/12 Prot., datë 14.05.2021, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Udhëzimin Nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011.

c) Në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, për parregullsitë e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, të cilat lidhen me hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, kualifikimin dhe s'kualifikimin e operatorëve ekonomik, shpalljen e fituesit, etj., përgjegjësi të cilat rrjedhin nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, neni 8,9, 10 i ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Agjencia për Eficencën e Energjisë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe

me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi, duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative, apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e dëmit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

